

ASLLAN HAMITI



**KULTURA E GJUHËS
PËR TË GJITHË**

ASLLAN HAMITI

**KULTURA E GJUHËS
PËR TË GJITHË**

Shkup, 2017

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie	2
Pasqyra e lëndës	5

Kreu I

1. ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË KULTURËS SË GJUHËS	8
1.1. Ç'është kultura e gjuhës?	8
1.2. Uniteti dhe variacioni historik, territorial, stilistik dhe shoqëror i gjuhës shqipe	12
1.3. Shqipja standarde, shqipja dialektore dhe gjuha e letërsisë.....	17
1.4. Komunikimi verbal dhe joverbal	21
1.5. Marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën standarde.....	22
1.6. Baza dialektore e shqipes standarde	25
1.7. Planifikimi i shqipes dhe politika gjuhësore.....	28
1.8. Shqipja në procesin e globalizimit	35
1.9. Gjuha shqipe në internet	39

Kreu II

2. STILET FUNKSIONALE NË GJUHËN SHQIPE	42
2.1. Ç'është stili e stilistika?	42
2.2. Karakteristikat stilistike të shqipes së shkruar gjatë zhvillimit historik	45
2.3. Stilistika gjuhësore	47
2.4. Shqipja standarde dhe sistemi i stileve	48
2.5. Përdorimi i shqipes në ligjërime	51
2.5.1. Ligjërimi i folur	52
2.5.2. Ligjërimi i shkruar	52
2.5.3. Ligjërimi i shkujdesur	55
2.5.4. Ligjërimi bisedor	56
2.5.5. Ligjërimi libror	57
2.6. Stilet funksionale në gjuhën shqipe	58
2.6.1. Stili shkencor	59
2.6.2. Stili shtetëror-administrativ	61
2.6.3. Stili politiko-shoqëror	64
2.6.4. Gjuha e letërsisë artistike	66
2.6.4.1. Gjuha e prozës	73
2.6.4.2. Gjuha e poezisë	75
2.7. Stili i shkrimtarit	78
2.8. Kujdesi që i kushtojnë shkrimtarët gjuhës	79

Kreu III

3. DREJTSHKRIM E DRTEJTSHQIPTIM	84
3.1. Ç'është drejtshkrimi?	84
3.2. Ç'është drejtshqiptimi?	87
3.3. Shkaqet e thyerjes së normës gjuhësore	90
3.4. Përdorimi i drejtë i zanoreve në shqipen standarde	94
3.4.1. Drejtshkrimi e drejtshqiptimi i disa fjalëve të huaja që kanë [i] të patheksuar	94
3.4.2. Përdorimi i drejtë i zanoreve /i/ dhe /y/	95
3.4.3. Drejtpërdorimi i zanores /u/	95
3.4.4. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i zanores /e/	96
3.4.5. Përdorimi i drejtë i zanores /ë/	97
3.4.6. Përdorimi i drejtë i togjeve të zanoreve	103
3.4.7. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i takimit të dy zanoreve të njëjta	105
3.5. Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve	105
3.5.1. Përdorimi i bashkëtingëlloreve /s/ dhe /z/ nistore	107
3.5.2. Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve sh-/zh-/ç- nistore	107
3.5.3. Drejtshkrimi i /c/-së	108
3.5.4. Takimi i /t/-së me /sh/-në	108
3.5.5. Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores /rr/	108
3.5.6. Drejtpërdorimi i mesgjuhoreve /q, gj/	110
3.5.7. Përdorimi i bashkëtingëllores /nj/	110
3.5.8. Drejtpërdorimi i bashkëtingëllores /j/	110
3.5.9. Drejtpërdorimi i bashkëtingëllores /h/	112
3.5.10. Drejtpërdorimi i bashkëtingëlloreve të zëshme, grupeve dhe takimeve të bashkëtingëlloreve	113
3.5.11. Togje bashkëtingëlloresh	113
3.5.12. Takime bashkëtingëlloresh	115
3.6. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	116
3.7. Paraqitja grafike e tekstit	117
3.8. Theksimi normativ i fjalëve	118
3.9. Ushtrime drejtshkrimore	121

Kreu IV

4. ZBATIMI I NORMAVE MORFOLOGJIKE	124
4.1. Pashquarsia, shquarsia dhe gjinia e emrit	125
4.2. Gjinia asnjënëse e emrave	126
4.3. Numri i emrave	129
4.4. Përdorimi i drejtë i emrave në rasa	133
4.5. Përdorimi i rasave me parafjalë dhe pa parafjalë	134
4.6. Shkrimi i nyjës së përparme	135
4.7. Përemri	140
4.8. Gabime më të shpeshta në përdorimin e drejtë të foljeve	141
4.9. Format normative të foljeve apofonike	148
4.10. Zgjedhimi normativ i foljeve	150
4.11. Përdorimi i drejtë i disa ndajfoljeve dhe i mbiemrave	155
4.12. Shkrimi i disa pjesëzave dhe i parafjalëve	157

4.13. Drejtshkrimi i numërorëve	158
---------------------------------------	-----

Kreu V

5. LEKSIKU I SHQIPES DHE PËRDORIMI I TIJ	159
5.1. Sinonimet	160
5.2. Homonimet	162
5.3. Antonimet	162
5.4. Arkaizmat	163
5.5. Neologjizmat	164
5.6. Krahinorizmat	165
5.7. Huazimet	166
5.8. Barbarizmat	168
5.9. Frazelogjizmat	170
5.10. Intonacioni dhe shenjat e pikësimit	173
5.11. Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë	176

Kreu VI

6. (MOS)PËRDORIMI I SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONI	178
6.1. Gjendja dhe perspektiva e studimeve gjuhësore në Maqedoni	178
6.2. Analfabetizmi funksional në Maqedoni	185
6.3. Përdorimi i gabueshëm i rasave në përkthimet nga maqedonishtja në shqip	188
6.4. Shqipja e gazetave në Maqedoni	196
6.5. Shqipja në dokumentet zyrtare në Maqedoni	203
Literatura e konsultuar	212

PARATHËNIE

Kultura e gjuhës është tashmë një prej degëve të mirënjohura të gjuhësisë, që merret me studimin dhe përcaktimin e normës letrare në të gjitha rrafshet e sistemit të gjuhës, me zbulimin e prirjeve të zhvillimit të gjuhës letrare për të ndikuar mbi të në pajtim me këto prirje, si dhe me rrugët për përvetësimin e zbatimin e normës letrare. Kultura e gjuhës kuptohet, gjithashtu, si kujdesi për të shkruar e për të folur gjuhën letrare sipas rregullave përkatëse e sipas modeleve më të mira të pranuar nga shoqëria në një periudhë të caktuar.

Dihet tashmë se, qysh në periudhën e Rilindjes e më pas, në shtypin shqiptar janë zhvilluar diskutime dhe janë diskutuar probleme të ndryshme të kulturës së gjuhës. Synimi i tyre ka qenë qysh në krye të herës zgjimi i vetëdijes shoqërore ndaj gjuhës, dëshira për ta bërë problem kombëtar e atdhetar ruajtjen e shqipes dhe, natyrisht, për të mprehur konceptimin e gjuhës si tipar themelor i kombit dhe i njësisë kombëtare të shqiptarëve. Në mënyrë të veçantë mbas Luftës së Dytë Botërore, gjatë periudhës së njohur si epoka mbas Çlirimit, kujdesi për gjuhën letrare shqipe u bë edhe problem i përgjithshëm kulturor e shoqëror.

Duhet të përmendet sidomos krijimi i Institutit të Shkencave dhe i sektorëve shkencorë përkatës për mbledhjen, njohjen dhe botimin e leksikut popullor e të vjelë nga botimet e shkruara, duke shpënë më tej atë veprimtari që kishin nisur me vullnet të mirë Kostandin Kristoforidhi dhe nxënësi i tij besnik Aleksandër Xhuvani dhe një plejadë mësuesish e dashamirësh të shqipes. Në vitet 1952, 1953 u bënë diskutime dhe u organizuan konferenca shkencore për probleme të Kulturës së gjuhës, sidomos për ortografinë (drejtshkrimin) dhe pastërtinë e gjuhës. Me rëndësi të dorës së parë që më 1956 botimi i librit “Për pastërtinë e gjuhës” nga Aleksandër Xhuvani, i cili do të mbetej si gur themeli në ngrehinën e gjuhës shqipe.

Në vitin 1967 në Institutin e Historisë së Gjuhësisë u formua edhe një grup pune a sektor i kulturës së gjuhës, që kishte për detyrë kryesore organizimin e punës paraprake për “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe”. Dhe në fakt, në 1967, mbas një pune të gjatë e të kujdesshme u botua dhe “Projekti i rregullave të drejtshkrimit”, i cili i parapriu dhe vendimit e sanksionimit të tyre, së pari, më 1968 me “Konsultën e Prishtinës” dhe, 4 vjet më pas, me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972).

Ka kulturë gjuhësore ai që kujdeset për ta shkruar e për ta folur gjuhën e vet në pajtim me rregullat përkatëse dhe sipas gjedheve më të mira si dhe kujdeset për ta zhvilluar më tej.

Si degë e gjuhësisë, kultura e gjuhës merret me studimin dhe përcaktimin e normës letrare në të gjitha nivelet e sistemit të gjuhës (fonologjik, morfologjik, leksikor e sintaksor).

Problemi më i madh në përdorimin e shqipes lidhet me kulturën e dobët gjuhësore, sidomos e brezit të ri. Mosnjohja e mirë e gjuhës amtare, që me sa duket ka të bëjë me mangësi të rënda në arsimin bazë, por edhe me mungesën e leximit tek të rinjtë, krahas me përvetësimin e gjuhëve të huaja dhe krijimin e brezave dy- a tregjuhësh, ka sjellë edhe zëvendësimin e fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese shqipe, tashmë të panjohura për të rinjtë, me fjalë e shprehje të gjuhëve të huaja, qoftë të marra drejtpërdrejt, qoftë të përkthyer ose kalkuara në shqip sipas modelit të huaj. Vërshimi pa kriter i fjalëve të huaja është një problem, por shohim edhe përdorime të

gabuar në drejtshkrimin, në morfologjinë dhe në sintaksën e shqipes; çka flet për mangësi të formimit gjuhësor në shkollë. Mungesa e kulturës gjuhësore shkon krahas me varfërinë kulturore të përhapur masivisht; mjafton të shohësh gabimet që bëhen në shtypin e përditshëm që pasqyrojnë mungesë kulturore të theksuar. Por përtej këtyre problemeve që lidhen me formimin arsimor-kulturor, pra nuk janë të brendshme për vetë gjuhën dhe funksionimin e drejtë të saj, gjuha shqipe përjeton probleme të tjera që vijnë nga hapja me botën e jashtme dhe e vënë atë përballë sfidash të mëdha, siç është problemi i terminologjisë së disa fushave kulturore, teknike e shkencore, deri dhe të panjohura për shqipen dhe shpesh herë të reja edhe për gjuhët kryesore të Europës. (Anila Omari: Problemi më i madh sot, kultura e dobët gjuhësore, <http://www.forumishqiptar.com>)

Me këtë tekst, të emërtuar Kultura e gjuhës për të gjithë mëtojmë të përmirësojmë kulturën e gjuhës te nxënësit, studentët, arsimtarët, përkthyesit, shkrimtarët, gazetarët, politikanët, mjekët, juristët, ... si dhe të gjithë intelektualët e përdoruesit e shqipes standarde, duke përzgjedhur disa tema me karakter të përgjithshëm formues dhe duke u përqendruar në disa nga gabimet më të shpeshta në zbatimin e normave të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, të normave morfologjike e leksikore.

Do të shtjellojmë tema të tilla si: objekti i lëndës së kulturës së gjuhës. Uniteti (njëjtësia) dhe variacioni i gjuhës shqipe. Shqipja dialektore, shqipja standarde dhe gjuha e letërsisë. Marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde. Baza dialektore e shqipes standarde. Norma gjuhësore dhe zbatimi i saj. Shkaqet e thyerjes së normës gjuhësore. Norma fonetike. Drejtshkrimi e drejtshqiptimi.

Parimet e përgjithshme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Rregullat kryesore të shqiptimit letrar. Përdorimi i drejtë i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve. Drejtpërdorimi i togjeve të zanoreve dhe i togjeve të bashkëtingëlloreve. Takime dy zanoresh e bashkëtingëlloresh të njëjta. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. Përdorimi i shkronjave të mëdha. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. Theksi normativ dhe intonacioni. Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.

Norma morfologjike dhe zbatimi praktik i saj. Përdorimi i drejtë i emrave, foljeve, mbiemrave, përemrave, ndajfoljeve, parafjalëve, pjesëzave, lidhëzave, nyjave etj. Norma sintaksore dhe përdorimi praktik i saj. Rendi i gjymtyrëve në fjali.

Norma leksikore dhe jetësimi i saj. Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera. Për pastërtinë leksikore të shqipes. Prirje të përgjithshme të zhvillimit të shqipes së sotme. Gjuha shqipe dhe globalizmi.

Çdo ditë flasim e shkruajmë. Marrim informata nga të tjerët, por edhe ne i njoftojmë ata për shumë gjëra. Dikush di të flasë mirë e rrjedhshëm, por edhe të shkruajë aq mirë saqë është kënaqësi të lexosh shkrimet e tij. Në revista, në gazeta, në radio e televizor çdo ditë lexojmë e dëgjojmë informata të ndryshme nga jeta e përditshme. Të gjithë ne duhet të përpiqemi të flasim e të shkruajmë sa më mirë. Shkathësia e të folurit dhe e të shkruarit mirë nuk arrihet vetëm me njohuritë nga gramatika.

Ky libër do t'u ndihmojë të arsimuarve të mësojnë si të shkruajnë dhe si të flasin bukur. Për të arritur një shkallë të lartë të kulturës së gjuhës, njeriu duhet të kujdeset jo vetëm në shkollimin parauniversitar e universitar, por duhet të punojë gjatë gjithë jetës. Gjuha është një oqean i pafund me pasuri e mundësi të pashtershme, mirëpo aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie te njerëzit është e shumëllojshme.

Le të shërbejë ky libër si një nxitje e thirrje për gjithë studiuesit e gjuhës shqipe, intelektualët, pedagogët, shkrimtarët, gazetarët, studentët, nxënësit dhe gjithë folësit e shkruesit e shqipes që me veprimtarinë e tyre ta përdorin drejt shqipen standarde dhe të japin ndihmesë profesionale e kërkimore-shkencore në punën e tyre.

Epoka jonë është epokë e ngritjes historike, e pasurimit dhe e forcimit të identitetit gjuhësor e kombëtar. Ta duam, ta ruajmë, ta mësojmë e ta studiojmë gjuhën amtare, sepse ashtu do të ta ruajmë qenien tonë kombëtare.

KREU I

1. ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË KULTURËS SË GJUHËS

1.1. Ç'ËSHTË KULTURA E GJUHËS?

Termi **kulturë** u referohet problemeve shoqërore e materiale, si: mënyrës së jetesës, shijeve, parapëlqimeve dhe qëndrimeve ndaj ushqimit, arkitekturës, natyrës në përgjithësi etj.

Fjala **kulturë** në Fjalorin shpjegues të shqipes jepet me këto kuptime:

1. Tërësia e arritjeve të një populli dhe e të gjithë njerëzve në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor; shkalla e këtyre arritjeve dhe e këtij zhvillimi në një etapë të caktuar; fusha e zhvillimit shoqëror që përfshin krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, në art, në letërsi, në shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore. *Kultura kombëtare. Kultura shqiptare. Kultura popullore. Kultura e lashtë (mesjetare). Kultura e re socialiste. Thesari i kulturës botërore. Zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës.*

2. Shkalla e zhvillimit që ka arritur një popull, një grup shoqëror a një njeri në një fushë të caktuar të veprimtarisë. *Kultura shëndetësore. Kultura muzikore. Kultura gjuhësore (e gjuhës).*

3. Tërësia e njohurive dhe e shprehive të sjelljes a të edukatës së përvetësuar a e përvetëson një njeri në shkollë ose në jetë; zhvillimi i veprimtarisë kulturore e artistike. *Njeri me kulturë. Pallati i kulturës. Vatra e kulturës. Shtëpia e kulturës. Seksioni i arsimit dhe i kulturës. Lëndë të kulturës së përgjithshme. Ka kulturë të madhe.*

4. *bujq.* Puna që bëhet për rritjen e bimëve, të pemëve etj., kultivim; bimë a pemë që kultivohet. *Kulturat pranverore. Kulturat perimore (bishtajore, vajore, drufrutore). Kultura e grurit (e misrit, e duhanit, e patates).*

Kultura e gjuhës është lëndë e përgjithshme me karakter formues që u duhet të gjithë intelektualëve: mësuesve, gazetarëve, folësve të radios e të televizionit, aktorëve, përkthyesve dhe në përgjithësi të gjithë njerëzve që merren me veprimtari intelektuale.

Kultura e gjuhës është pjesë përbërëse e kulturës kombëtare. Përvetësimi i gjuhës standarde shpreh vetëdijen se gjuha që përfaqëson krejt kombin mund të përmbushë kërkesat e tij më të larta. Shkalla e përvetësimit të shqipes standarde bëhet tregues që provon nivelin individual si dhe kulturën e gjithë kombit. **Duke e njësuar, pasuruar dhe përsosur shqipen standarde i japim ndihmë të madhe kulturës sonë kombëtare.**

Kultura e gjuhës si koncept dhe si problem sociolinguistik

Siç dihet, çdo njeri është në gjendje ta rrëfejë një ngjarje para të tjerëve, t'u përcjellë një informatë. Mirëpo, disa këtë punë e bëjnë më bukur, më shkathët e disa më dobët. Dikush mund ta ketë përjetuar një ngjarje dhe kjo t'i ketë bërë përshtypje të madhe, por ai mund të mos jetë në gjendje ta shprehë këtë përjetim as me një përqindje të vogël. Dikush tjetër, me mjeshtërinë dhe aftësinë e vet, arrin që edhe ngjarjet e rëndomta t'i përjetojë e t'i shprehë estetikisht, kështu që rrëfimi i tij bëhet më interesant. Atëherë themi se njeriu i tillë është artist i fjalës.

Për të shkruar mirë, përveç njohurive gramatikore, duhet të kemi para sysh edhe disa kushte të tjera. Ja disa prej tyre:

Si të shkruajmë dhe si të flasim bukur?

- Para se të fillojmë të flasim ose të shkruajmë, duhet të bëjmë një plan se çfarë duam të themi ose të shkruajmë.
- Të jemi të vëmendshëm dhe me kujdesin më të madh të shfrytëzojmë gjithë imagjinatën dhe aftësitë tona krijuese.
- Mendimet duhet t'i shprehim në mënyrë të qartë dhe të drejtë. Të jemi real dhe bindës në atë që e shprehim. Të mos përdorim fjalë fyese. Të flasim qetë e me zë të ulët, jo shumë shpejt as shumë ngadalë.
- Fjalitë duhet t'i ndërtojmë sipas aftësive tona. Të respektojmë rregullat e drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit, të zgjedhim fjalët dhe të krijojmë fjali sipas natyrës së shqipes.
- Shkrimi të jetë i lexueshëm dhe i bukur. Tekstin e shkruar ta rilexojmë disa herë dhe ta përmirësojmë.
- Të lexojmë sa më shumë dhe të ndjekim modelet e mira të të folurit e të të shkruarit. Kështu kanë vepruar edhe shkrimtarët e mëdhenj.

Për të shkruar pa gabime duhet mësuar rregullat e drejtshkrimit. Përvetësimi i rregullave kërkon mjaft mund dhe përpjekje; megjithatë, po të njihet struktura e tyre, detyra e mësimit të rregullave të drejtshkrimit lehtësohet mjaft. Për çdo rast kur ndodhemi në mëdyshje duhet t'i drejtohem fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (të shkruar në letër ose Fjalorit shpjegues elektronik) si dhe Drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Këta fjalorë elektronikë mund të instalohen në kompjuter dhe pa vështirësi mund t'i shfrytëzoni edhe ju studentë të dashur. Me këtë program të rëndësishëm edhe gjuha shqipe bën pjesë në mesin e gjuhëve të kompjuterizuara. Me programin e drejtshkrimit të shqipes mund të korrigjohen mbi një milion fjalë, përkatësisht rreth katër milion trajta të përsëritshme. Shfrytëzuesit nuk i duhet trajnim i veçantë për përdorimin e këtij programi, mjaftojnë vetëm disa minuta për përvetësimin e tij.

Komunikimi gjuhësor me gojë dhe me shkrim është një praktikë e përditshme. Njeriu në çdo hap ballafaqohet me nevojën për të biseduar me të tjerët, për t'u drejtuar dikujt me letër, telefon, internet; për të shkruar ndonjë ftesë, kërkesë (lutje), ankesë, biografi etj. Të gjitha këto forma të komunikimit i shtrohen një kulture të caktuar gjuhësore. Secila formë ka disa kërkesa të caktuara, të cilave duhet t'u përmbahet hartuesi i tyre.

Disa rregulla themelore të kulturës gjuhësore:

- Kultura gjuhësore është shprehje e nivelit të përgjithshëm kulturor të njeriut.
- Përdorimi i gjuhës standarde me mjeshtëri është tregues i njeriut të kulturuar.

- Ai që flet e shkruan mirë, ka shumë sukses në jetën dhe në punën e tij.
- Ka kulturë si të flasësh, por ka kulturë edhe si të heshtësh.
- Çdo thënie duhet të ketë saktësi logjike dhe gramatikore.
- Ajo që thoni ju, duhet të kuptohet nga dëgjuesi.
- Ndërtimi i rregullt i fjalive është kusht i domosdoshëm për t'i thënë drejt e qartë mendimet, për të qenë të kuptueshëm.
- Para se të shkruani ose të thoni diçka, duhet ta dini se ka shumë materiale për atë temë.
- Ka shumë mënyra për ta thënë po atë mendim.
- Mësoni nga modelet më të mira gjuhësore.
- Mos harro kujt i drejtohesh dhe përse. Zgjidh rrugën më të mirë për të shprehur mendimin, kërkesën, lutjen, porosinë, për ta bërë pyetjen etj.

Njohja e mirë e shqipes standarde do t'u ndihmojë edhe për të mësuar më mirë të gjitha lëndët e tjera. Ata përvetësojnë edhe mënyrën për t'u shprehur me përpikëri, me qartësi dhe me rrjedhshmëri logjike. Ai që flet e shkruan mirë, ka më shumë sukses në jetën dhe në punën e tij. Shprehinë që marrim për të përdorur shqipen standarde janë të dobishme për gjithë jetën.

Njohuritë e fituara në kulturën e gjuhës do të ndihmojnë edhe për të kuptuar më mirë, për të analizuar dhe interpretuar jo vetëm krijimtarinë popullore në prozë e në poezi, po edhe për të shijuar dhe futur më thellë analizën e në veprave letrare, për të analizuar gjuhën dhe stilin e shkrimtarëve. Thjesht, materiali i lëndës së kulturës së gjuhës krijon një bazë të shëndoshë njohurish edhe për stilistikën gjuhësore dhe stilistikën letrare.

Stilistika e zbatuar ose praktike i përdor arritjet e stilistikës teorike për nevojat e kulturës së gjuhës, përkthimit, redaktimit, arsimit, praktikës së përditshme dhe në veçanti për hartimin e fjalorëve.

Aftësia e përdorimit stilistik të gjuhës është pjesë e kulturës së gjuhës dhe e sjelljes së njeriut në shoqëri. Stilistika ka vend të gjerë në punën mësimore. Shkolla jep normën standarde, por ajo duhet plotësuar me punën për të edukuar shijen stilistike, për të njohur visaret shprehëse të shqipes, për të shkruar e folur në përputhje me kërkesat e fushave të caktuara, me rrethanat, me qëndrimin ndaj të tjerëve.

Komenti letrar në shkollë ka nevojë të përmirësohet, duke përfshirë vështrimin e sotëm stilistik, që të zbulohen vlerat artistike të letërsisë shqiptare si arti i fjalës. Stilistika pedagogjike jep një mjet mësimor për gjuhën dhe letërsinë në shkollë. Me një vështrim përgjithësues, stilistika mund të quhet një ndër mjetet për njohjen dhe përvetësimin e arritjeve të kulturës kombëtare në gjuhën shqipe dhe për të punuar e krijuar vetë me mjeshtri.

Thënie të mençura për kulturën e përgjithshme, përfshirë edhe kulturën e gjuhës:

- Përmirëso sjelljen tënde, përpara se të kërkojsh nga të tjerët të përmirësojnë të tyren.
- Mendjemadhësia më shumë është shenjë e nënçmimit të vetvetes sesa krenari.
- Nga të gjitha plagët, të pashërueshme janë ato që burojnë nga gjuha, shikimi me përbuzje dhe tallja.
- Të flasësh pa menduar, është si të zbrazësh pushkën pa e vënë në shenjë.
- Njeriu vlen sa di, e di sa mban mend.
- Çdo hap drejt kulturës, është hap drejt lirisë.

- Fjala është si bleta që ka edhe mjaltin edhe thumbin.
- Gjuha eshtra s'ka, por eshtra thyen.
- Fjalën, sa e ke në gojë, e ke robin tënd; kur të del nga goja, bëhesh rob i saj.
- Nuk është turp kur nuk e di, por është turp kur nuk dëshiron ta mësoh.
- Njeriu në jetë ka nevojë për një filxhan shkencë, një shishe kujdes dhe një oqean durim.
- Mund të kemi të gjitha mjetet e komunikimit që ekzistojnë në botë, por asgjë, absolutisht asgjë, nuk e zëvendëson vështirimin e syve të njeriut.
- Një buzëqeshje mund të jetë më e ndritshme se dielli, më e ëmbël se mjalti, më e çmuar se diamanti.
- Kalliri që është plot, rri teposhtë; i zbrazëti – përpjetë.
- Qëllimi i artit është kënaqësia, qëllimi i shkencës është e vërteta.
- Njeriu ka nevojë për arsim, ashtu si bima për ujë.
- Njeriu mendar nuk flet për vetveten dhe për punët e tij.
- Ajo që qeveris botën nuk është as forca, as ligji, por është mirësjellja dhe edukata.
- Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë.
- Mendja e një kombi është arsimi, zemra e tij është morali i përgjithshëm.
- Shumica e mospajtimeve tona vijnë nga keqkuptimet, e këto i shkakton mosdëgjimi. Sikur ta dëgjonim njëri-tjetrin do të pajtoheshim më tepër.
- Të janë dhuruar dy veshë e një gojë, që të dëgjosh më shumë sesa të flasësh.
- Pyeti të diturit, rri me të urtët dhe shoqërohu me të varfrit!
- Jam përgjegjës për atë që them, jo për atë që kupton ti.
- Dy vetë u vranë për një fjalë. Fjala rron ende, njerëzit jo.
- Fjalët e keqdashësit janë si qymyri, që edhe po s'të dogjën, të nxijnë.
- Gjysma e punës është mbaruar kur ajo fillohet me dëshirë.
- Fjala është si shigjeta. Mos e hidh pa u menduar.
- Fjala e mirë dhe buzëqeshja janë më të dashura sesa ndihma materiale.

Format gojore publike, pra fjala përpara auditorit është lëvruar qëmoti nga gojëtaria (oratoria). **Që të flitet bukur**, Rexhep Qosja përmend disa kërkesa: gojëtari duhet të ketë njohuri dhe kulturë të përgjithshme, ta mendojë që më parë atë për të cilën do të flasë dhe të përgatitet, t'i besojë vetë asaj që thotë, ta njohë çështjen që shtjellon, të komunikojë me auditorin duke e nderuar atë, si dhe të zotërojë mirë gjuhën shqipe, pasuritë e saj e mjeshtërinë stilistike. Duke pasur parasysh këtë, shumë njerëz i parapërgatitin fjalimet. P.sh. U. Çerçilli i ushtronte fjalimet e veta parlamentare në kopshtin e shtëpisë. Sh. de Goli i përgatiste diskutimet para pasqyrës, siç përgatisin rolet artistët. Me një specialist si regjisor ka punuar një muaj Xh. Bushi për fushatën elektorale kur do të rizgjidhej. Gojëtaria kërkon ndikimin si me forcën e logjikës, të argumentit e të faktit, ashtu edhe me emocionalitetin e shqiptimit, duke e përvetësuar auditorin edhe me artin e fjalës.

Pyetje e detyra:

1. Ç'është kultura?
2. Ç'është kultura e gjuhës?
3. Si të shkruajmë dhe si të flasim bukur?
4. Thoni disa rregulla themelore të kulturës gjuhësore:
5. Gjeni dhe lexoni nga Interneti fjalë të urta dhe proverba për kulturën e përgjithshme dhe për kulturën e gjuhës.

6. Krijoni nga pesë thënie të mençura për kulturën e përgjithshme.
7. Shikojeni nga Interneti në: dailymotion.com *Shkurtaj dhe Buxheli: Gjuha shqipe po shkon drejt degradimit.*

1.2. UNITETI DHE VARIACIONI HISTORIK, TERRITORIAL, STILISTIK DHE SHOQËROR I GJUHËS SHQIPE

Në çdo gjuhë të gjallë ka laramani historike, gjeografike, stilistike e shoqërore (sociale). Ato nuk janë gjuhë të veçanta, por, variante të ndryshme të një gjuhe të përbashkët. Dialektet janë dukuri shoqërore që shfaqen për shkak të ndryshueshmërisë territoriale të gjuhëve. Gjuha standarde është fryt i marrëveshjes mes një grupi njerëzish në një kohë dhe në rrethana të caktuara historike. Edhe gjuha dialektore dhe ajo standarde kanë varietetet e tyre. Dialektet shfaqen të larmishme nëpër vende të ndryshme, ndërsa gjuha standarde shfaqet e larmishme në ligjërime (të shkruar e të folur: në ligjërimin e shkujdesur, bisedor dhe në ligjërimin libror) dhe në stile funksionale (në stilin shkencor, shtetëror-administrativ, politik-shoqëror, stilin e letërsisë artistike dhe në stilin fetar).

Ligjërimi nuk është aktualizim i thjeshtë i sistemit të gjuhës, por ai realizohet në kohë, në hapësirë e në kushte të caktuara historike-shoqërore nga individët. Ai është i shumëllajtë. Në të pasqyrohen: përkatësia shoqërore, mjedisi gjeografik, shkalla e arsimimit, temperamentit, karakteri, dëshira, d.m.th. një sërë faktorësh shoqërorë e psikofizikë që ndikojnë në të folurit tonë.

Një njeri flet sot shqip: ose në gjuhën standarde, ose në dialekt, ose në gjysmëdialekt në një fushë veprimtarie (në biseda të zakonshme, në shkencë, në letërsi, në politikë, në fe etj.) me njerëz të ndryshëm (me anëtarë të familjes, shokë, studentë, shkencëtarë, administratorë etj.) për ndonjë qëllim të caktuar.

Gjuha shqipe tashmë është formuar si gjuhë letrare kombëtare e njësuar ose si standard i përgjithshëm me norma të ngulitura në të gjitha nënsistemet e saj. Ajo ka arritur në këtë shkallë në një rrugë të vështirë e të gjatë, duke i bërë ballë ndikimit të huaj asimilues, duke kapërcyer ndarjen dialektore dhe duke zhvilluar trajtat e saj të përbashkëta.

Ngulitja e gjuhës standarde, që ka një rrafsh të gjerë asnjans të kodifikuar, ka mundësuar që të dallohen më qartë sistemi i stileve: ngjyrimet e konotacionet, bashkëkohorja nga historikja, norma standarde nga krahinorja e zhargonet, të folurit nga të shkruarit. Kemi një shumësi të madhe burimesh gjuhësore që janë pasuri shprehëse të shqipes.

Shqipja e sotme është një tërësi:

1. variantesh **historike**;
2. variantesh **territoriale**;
3. variantesh **stilistike**, dhe
4. variantesh **shoqërore**.

Për studimin e këtyre larushive gjuhësore ka shkenca të veçanta. Me studimin e varianteve historike merret historia e gjuhës, me variantet territoriale merret dialektologjia, varietetet stilistike i studion stilistika, ndërsa larushitë shoqërore i studion sociolinguistika. **Gjuha standarde është varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të civilizimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar.** Ajo është bërthamë me strukturë të qëndrueshme, ndërsa realizimet e saj historike e të sotme janë variante. Variacioni është i nevojshëm për vetë ekzistencën e gjuhës. Tipat e varianteve dallohen për arsye të ndryshme.

1) Arsyeja e parë e larmisë është **ndryshimi historik** i gjuhës në rrjedhë të kohës: **ilirishtja - shqipja e vjetër - shqipja e mesme - shqipja e re.** Kështu, shqipja arkaike ose protoshqipja njëjtësohet me ilirishten. Shqipja e vjetër vjen deri në shek. VIII-IX, kur ishin degëzuar dy dialektet e saj kryesore (më së voni deri në shekullin X). Shqipja e mesme (e mesjetës) vjen deri në shek. XVII dhe quhet *arbërishte*. Me librin e Gjon Buzukut më 1555 na shfaqet si variant kryesor gjuha e autorëve të vjetër. Shqipja e re flitet nga shek. XVIII e deri në ditët tona dhe tashmë njihet me emrin gjuha shqipe. Në shqipen e re dallojmë tri faza zhvillimi:

- a) periudha e Pararilindjes (shek. XVIII);
- b) periudha e Rilindjes (afërsisht periudha midis viteve 1820 - 1920) dhe
- c) faza e shqipes së sotme (pas vitit 1920 e deri më sot).


Shqipja mund të degëzohet edhe në:

- a) periudhën Parakombëtare (që nga Buzuku - shek. XVI e deri më vitin 1920) dhe
- b) periudhën Kombëtare (nga Rilindja e këtej, përkatësisht nga viti 1920 e deri më sot).

2) **Variantet territoriale të shqipes.** - Arsyeja e dytë e variacionit gjuhësor është **përhapja gjeografike**: degëzimi dialektor i gjuhës. Variantet krahinore ose dialektet e shqipes kanë ndryshime kryesisht në fushën e fonetikës e të fonologjisë, pjesërisht në gramatikë e në leksik. Arbërishtja e shqiptarëve të Italisë në këtë vështrim është variant gjeografik e historik.

gjuha shqipe

dialektet + gjuha standarde



Gjuha standarde është një variant kundrejt dialekteve. Dialektet përballë gjuhës standarde janë të papërpunuara në shkallë normative e kulturore.

Në rrethanat e lëvizjeve të mëdha ose të jetesës në mjedise shumëgjuhësore lindin edhe ndikime (interferenca) ndërgjuhësore. Sot ka larushi të shqipes, të ndikuar nga gjuha joshqipe e mjedisit (shqipja në Greqi, Itali, Turqi, ShBA, Rumani, në Mal të Zi, në Maqedoni etj.).


3) **Variantet stilistike të shqipes.** - Arsyeja e tretë për variacion gjuhësor është përdorimi i shqipes **në ligjërime** dhe **në stile funksionale**: në *formën e folur* dhe *të shkruar*. Gjuha lind dhe jeton në radhë të parë si gjuhë e folur, në trajtën gojore. Në një shkallë të caktuar zhvillimi të kulturës lind shkrimi, kështu që krijohet varianti i shkruar i gjuhës.

Në modelimet gjuhësore veprojnë shumë faktorë jashtëgjuhësorë (kushtet e komunikimit, format e komunikimit, sferat e veprimtarisë shoqërore etj.) dhe faktorë gjuhësorë (funksioni mbizotërues i komunikimit, norma ose qëndrueshmëria e përdorimit të gjuhës etj.). Këta faktorë mundësojnë ndarjen e parë të madhe në: stile ligjërimore ose **ligjërime** dhe **stile funksionale**.

4. **Variantet shoqërore të shqipes.** - Arsyeja e katërt e larmisë gjuhësore lidhet me faktin se ka **grupe të ndryshme shoqërore e profesionale**, që dallohen nga përdorimi i gjuhës. Argotë apo dialektet socialë ndryshojnë nga të folmet vendore në një pjesë të leksikut: duke përdorur fjalë me kuptim metaforik, duke i ndryshuar nga përbërja fonematike ose duke përdorur fjalë të huazuara; në mënyrë që ligjërimi i tyre të jetë i kuptueshëm vetëm pjesëtarët e atij grupi (zejtarë, nxënës, studentë etj.) dhe i pakuptueshëm për ata që nuk i përkasin grupit përkatës. Përveç përdorimeve të përgjithshme, ka edhe *variacione individuale* (idialekte).

Si përfundim, po ritheksojmë se ligjërimi nuk është aktualizim i thjeshtë i sistemit të gjuhës, por ai realizohet në kohë, në hapësirë e në kushte të caktuara historike-shoqërore nga individët. Ai është i shumëllojtë. Në të pasqyrohen: përkatësia shoqërore, mjedisi gjeografik, shkalla e arsimimit, temperament, karakteri, dëshira, d.m.th. një sërë faktorësh shoqërorë e psikofizikë që ndikojnë në të folurit tonë. Një njeri flet sot shqip: ose në gjuhën standarde, ose në dialekt, ose në gjysmëdialekt në një fushë veprimtarie (në biseda të zakonshme, në shkencë, në letërsi, në politikë, në fe etj.) me njerëz të ndryshëm (me anëtarë të familjes, shokë, nxënës, shkencëtarë, administratorë etj.) për ndonjë qëllim të caktuar.

Përmbledhtas mund të thuhet se shqipja e sotme na shfaqet me tri varietete: me larmi funksionale – stilistike (në formën e folur dhe të shkruar), me larmi gjeografike (dialektore) dhe me larmi shoqërore (sociale). Gramatika përshkruese e sotme për objekt studimi ka gjuhën standarde (letrare) në përdorimin asnjans, d.m.th. gjithë mjetet gjuhësore dhe normat themelore që përcaktojnë marrëdhëniet e tyre. Me studimin e larushive funksionale merret stilistika, larminë gjeografike e studion dialektologjia, ndërsa larminë shoqërore – sociolinguistika. Këtë larushi të shqipes së sotme mund ta paraqesim si më poshtë:



Sot gjuha standarde shqipe, - si varianti më i plotë, më i përpunuar dhe me prestigjin më të lartë kulturor e shoqëror, - del në rrafshin mbarëkombëtar, ka përhapje në tërë kombin, ajo përdoret si nga shqiptarët brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë kufijve të saj.

Njëjtësimi gjithëkombëtar i gjuhës është i domosdoshëm. Prania e këtyre dy prirjeve të kundërta: *njëjtësisë* dhe *variacionit* është forcë lëvizëse e zhvillimit dhe e lëvrimit të gjuhës. Gjuha standarde merr përsipër rolin historik për t'iu përgjigjur kërkesave të unitetit e të variacionit. Nga njëra anë, ajo synon një normë sa më të ngulitur e më të përgjithshme; nga ana tjetër, ajo shfaqet me një sistem tërësor variantesh ligjërimore e funksionale. Vendosija e normës standarde sjell ngadalësimin e ndryshimeve strukturore, sidomos në fonetikë e morfologji.

Sipas gjuhëtarëve, **pasuria leksikore e një gjuhe sillet në rreth 200.000 fjalë** (me përjashtim të anglishtes që numëron trefishin). Në varësi të aftësive, prejardhjes, shkallës së arsimit, profesionit etj., **njerëz të zakonshëm kanë në përdorim të përditshëm një fjalor aktiv me rreth 7.000 deri në 8.000 fjalë**. Brenda këtij inventari fjalësh, një mjek do të ketë më të përdorshme terma të mjekësisë; një kritik letrar do të ndjehet më rehat me figura dhe togfjalësha letrarë; një politikan do të flasë me zhargonin e politikës (që, meqë ra fjala, është edhe pjesa më e ndotur e gjuhës), ndërsa një fshatar do të përdorë më tepër fjalë që kanë lidhje me tokën, bagëtinë dhe veprimtarinë e tij të përditshme. Gjithashtu, sipas krahinave prej nga vijnë, njerëz të ndryshëm do të përdorin më shumë fjalë apo shprehje gramatikore që përkojnë me ato anë - dialektin. Megjithatë, përdorimi që i bën secili nuk ka përse të dëmtojë të tjerën. Nga ana tjetër, asnjë njeri i veçantë nuk mund të jetë në gjendje të përdorë aktivisht të gjitha fjalët që përmban leksiku i gjuhës shqipe. Kjo është praktikisht e pamundur (Arben Kallamata, Dialekte dhe standarde, në: <http://arbenkallamata.blogspot.com>).

Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Në çfarë variantesh shfaqet gjuha shqipe?
2. Në cilat periudha kohore kemi ilirishten, shqipen e vjetër, arbërishten dhe shqipen e re?
3. Çfarë e karakterizon periudhën Parakombëtare të shqipes dhe çfarë periudhën Kombëtare?
4. A kemi variante territoriale të shqipes? Pse dallohen të folmet shqipe në shtrirjen hapësinore?
5. Çfarë mund të thoni për ligjërimin e shkujdesur?
6. Çfarë është ligjërimi bisedor?

7. Ç'është ligjërimi libror?
8. Sa stile funksionale dallohen në shqipen dhe cilat janë ato?
9. Lexojeni fragmentin e mëposhtëm të "Mesharit" të Gjon Buzukut.

U Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gja të ndigluom n së Shkruomit shenjtë, n së dashunit së botësë sanë desha me u fëdigunë, për sa mujta me ditunë, me zditunë pak mendetë e atyne qi të ndiglonjinë, përse ata të mundë mernë sa i naltë e i mujtunë e i përmishëriershim ashtë Zotynë atyne qi ta duonë m gjithë zemërë. U lus mbas sodi ma shpesh të vini m klishë, përse ju kini me gjegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atë në mbarofshi, Zotynë të ketë mishërier mbi ju. E ata qi u monduonë djerie tash, ma mos u mondonjënë. E ju t'ini të zgiedhunitë e Tinëzot. E përherë Zotynë ka me klenë me ju, ju tue ndjekunë të dërejtënë e tue lanë të shtrembënë. E këta ju tue bam, Zotynë ka me shtuom ndër ju, se të korëtë taj të nglatëtë djerie n së vjelash, e të vjelëtë djerie n së mbjellash. E u ma duo të mbaronj vepërënë teme, Tinëzot tue pëlqyem. Ndë vjetët M.D.L.IV. njëzet dit ndë mars zuna nfill, e mbarova ndë vjetët një M.D.L.V. ndë kallënduor V dit. E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend fejyem, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë nde e mir. Përse nukë çuditëm se në paça fejyem, këjo tue klenë ma e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë.

Përse ata qi shtamponjinë kishnë të madhe fëdigë, e aqë nukë mundë qëllonjinë se faj të mos banjinë, përse përherë ndaj ta nuk mundë jeshë; u tue mbajtunë një klishë, mbë të dy anët më duhe me sherbyem. E tash u jam n falë gjithëve, e lutëni Tënëzonë ende për muo.

ÇABEJ (1968), 387

Fjalorth:

të ndigluom - të kuptueshme
n së dashunit - prej dashurisë
u fëdigunë - u lodhën, u munduan
atyne - për ata
klishë - kishë
të korëtë - të korrat
të nglatëtë - të zgjatet
në keshë - në paça
fejyem - gabuam
fajtë - aty ku të jetë faji
nde e mirë - në të mirë
tue klenë - duke qenë
ndaj ta - ndaj tyre

10. Në kolonën e parë janë dhënë disa fjalë e grupe fjalësh nga teksti i mëparshëm. Në kolonën e dytë shënoni formën e fjalës të të folmes tënde dhe në kolonën e tretë formën standarde.

gjuha e Buzukut	e folmja ime	gjuha standarde
tue u kujtuom		
gluha		
me ditunë		
me zditunë		
mendetë		
atyne		
qi të ndiglonjinë		
ta duonë		
kini me gjegjunë		
ka me klenë me ju		
tue ndjekunë		
tue bam		
vepërënë teme		
ndë kallënduor		
mbë gluhët tanë		

1.3. SHQIPJA STANDARDE, SHQIPJA DIALEKTORE DHE GJUHA E LETËRSISË

Gjuha është elementi kryesor dallues i kombit.- Çdo komb që respekton vetveten, duhet të ketë një gjuhë të njësuar, një gjuhë letrare kombëtare. Prej më se 40 e sa vjetësh (nga Kongresi i Drejtshkrimit, mbajtur në Tiranë, më vitin 1972) e deri më tani shqiptarët i bashkon *gjuha standarde shqipe* ose gjuha letrare kombëtare e njësuar.

Gjuha standarde mund të përkufizohet si *variant i kodifikuar i një gjuhe* që u shërben nevojave të shumta dhe të ndërlikuara komunikative të një bashkësie gjuhësore që ka krijuar shtetin e vet kombëtar. Veçori themelore e gjuhës standarde është karakteri i saj *normativ*, d.m.th. prania e trajtave normative, të cilat janë të detyrueshme për t'u përdorur nga gjithë folësit e asaj gjuhe. Krahas formave të detyrueshme (sidomos fonetike e morfologjike), ka edhe forma të këshillueshme (veçmas leksikore e sintaksore).

Gjuha standarde është formë gjuhësore mbikrahinore, gojore dhe e shkruar, e ligjësuar historikisht dhe e institucionalizuar, që i nënshtrohet gjerësisht normimit dhe përhapet nga institucionet e nga mediet publike.

Gjuha popullore, që jeton përmes dialekteve, është ajo që i jep jetë e gjallëri standardit, që e freskon dhe e njom, e përtërin, dhe e këndell, duke e mbrojtur nga shterpësia e thatësira dhe nga krijimet me gjedhe të huaja. Sidomos standardi i shqipes, që është i ri, ka nevojë për pasurinë e dialekteve, për krijimet popullore, që mund të gjenden në të folmet e popullit. Nëse e përbashkëta

e krijuar, gjuha standarde, shkëputet nga baza e vet prej së cilës ka dalë, ajo rrezikon të shterpëzohet e të dobësohet, duke u ushqyer jo më me gjakun e vet, por me gjak të huaj (Kolec Topalli, Dialektet dhe standardi në kushtet e globalizmit, në <http://www.voal-online.ch>).

Gjuha e ruajtur në gojën e popullit është një enciklopedi e gjithë jetës së popullit tonë. Thëniet e gdhendura të kanuneve, krijimtaria gojore popullore janë shfaqje e mirëfilltë e përpunimit stilistik të shqipes.

Gjuha jeton përmes dialekteve, që janë limfa e jetës së saj. Kjo e vërtetë megjithatë shpesh harrohet dhe dialektet shihen si një shfaqje „historike“ dhe e tepërt, që njeriut modern nuk i duhet. Sidomos në kohën tonë të globalizimit dhe masmediave, dialektet shumëkund janë në tkurrje dhe shuarje të plotë. Në rast se, në globin tonë çdo dy javë shuhet një gjuhë, sikundër e nxirrte një studim amerikan i para disa muajve, dialektet ndoshta mund të trefren dita-ditës. E prapëseprapë askush nuk mund të thotë se ka rënë kambana e dialekteve ose të folmeve të veçanta dhe se njeriu modern nuk do t'i rikthehet edhe në këtë pikë asaj çka i kanë lënë trashëgim shekujt.

Me sa duket është një tharm i fortë që s'ka për të vdekur asnjëherë. Aq më shumë kur njerëzit ta kuptojnë dalëngadalë se përdorimi i një dialekti nuk tregon as prapambetje e as injorancë, por mbart jetë dhe ngrohtësi njerëzore si shumë pak tjetër gjë e kësaj bote (Ardian Klosi).

Dihet se krijimi i standardit të një gjuhe, si mjet komunikimi mbarëkombëtar, nuk përjashton ekzistencën e dialekteve. Ato vijojnë jetën e tyre duke pësuar ndryshime në përshtatje me vetë zhvillimin e krahinës ku fliten dhe në marrëdhënie me standardin. Rastet e gjuhëve të mëdha të Evropës, si anglishtes, frëngjishtes, italishtes etj., që kanë krijuar standardin e tyre prej disa shekujsh duke ruajtur edhe dialektet, janë një shembull i qartë për këtë. E njëjta gjë mund të thuhet për gjuhën shqipe, e cila, ndryshe nga gjuhët e mësipërme, ka një standard të ri, të krijuar prej jo më shumë se një gjysmë shekulli; por dialektet e saj gjëllin duke hyrë në marrëdhënie të ndërsjella me të: nga njëra anë, standardi ushtron ndikimin e vet mbi dialektet duke futur elemente të modernizimit të gjuhës, fjalë të reja që lidhen me mënyrën e re të jetesës dhe ndryshimet e mëdha ekonomike e shoqërore; nga ana tjetër, dialektet derdhen vazhdimisht pasurinë e tyre leksikore e frazeologjike në gjuhën standarde. Për këtë arsye çdo nënvleftësim i fuqisë krijuese të dialekteve sjell dobësim e varfërim jo vetëm të dialektit por edhe të vetë standardit.

Siç dihet, *gjuha standarde e normuar përcaktohet nga kodifikimi*, d.m.th., duke përzgjedhur midis variacionit bëhet e njësuar; ndërsa *teksti letrar është heterogjen nga ana gjuhësore*. Në faqet letrare, të gjitha përdorimet gjuhësore kanë rrugë të hapur, deri edhe shtrembërimet individuale. Në letërsi shfrytëzohen të gjitha mundësitë shprehëse të shqipes, qoftë edhe ato që dalin jashtë normës letrare, si: ligjërimet historike, krahinore, vetjake, shoqërore, kulturore etj. Kështu, për të bërë tipizimin e gjuhës së një personazhi të pashkolluar kosovar në një vepër letrare, shkrimtari përdor: paskajoren (me punu:), pjesoren e cunguar të foljeve (lidh), ë-n-]-në midis dy zanoresh (sÿni), mosshqiptimin e zanores -ë në fund të fjalës (mo:ll), disa fjalë krahinore a dialektore të gegërishtes (çi:k, tamël, tlyn) etj., apo në gjuhën e një personazhi të gegërishtes qendrore do të shënojë diftongimin e zanoreve ëi] dhe ëu] të theksuara (shpâi, nâuse), qiellzorizimin e ëg]-së në ëgj] (gjisht, gjur) etj.

Marrëdhëniet e gjuhës së letërsisë sonë artistike me shqipen janë mjaft të ndërlikuara. Në letërsi gjen shfaqje më të qartë e më të qenësishme natyra kombëtare e gjuhës. Krahas

funksioneve të tjera, *letërsia ka edhe funksionin e ruajtjes e të zhvillimit të kulturës gjuhësore të kombit*. Shkrimtari rritet e ushqehet me gjeninë e gjuhës amtare dhe është vegël e saj për ta mbajtur atë me gjallëri të pashuar, për ta përtërirë e për ta çuar më tej.

Kultura gjuhësore e letërsisë artistike ndikon në evoluimin e gjuhës në tërësi. Ngulitja e normës, standardizimi do të thotë në një kuptim ngadalësim i zhvillimit të vetvetishëm gjuhësor. Letërsia dhe gjuha e gjallë e folur e kompensojnë këtë shmangie nga ecuria spontane. Letërsia luan rol të veçantë për *marrëdhëniet e gjuhës së normuar me format e tjera, sidomos jostandarde*, të trajtës së shkruar me trajtën e folur. Njëpër një letërsisë artistike jo vetëm zgjerohen mundësitë shprehëse të shqipes, por edhe përtërihen ato, shtjellohen më tej ose edhe krijohet diçka e re. Një vepër letrare është edhe një qëndrim ndaj gjuhës për kohën e vet, të parë me syrin e artistit të fjalës. *Letërsia shfrytëzon të gjitha mundësitë e organizimit të gjuhës në stile*.

Gjuha e letërsisë artistike është shumë më e gjerë sesa gjuha standarde. Fjalët në letërsinë artistike mund të zhvishen nga kuptimi themelor dhe të risemantizohen përmes motivimit tekstor. P.sh. Rasini vetëm me 2000 fjalë na ka lënë drama të një shkalle të lartë artistike, aq sa edhe Shekspiri që ka përdorur mbi 20.000 fjalë. **Shkrimtari ka liri të madhe në përdorimin e gjuhës:** ai ka nevojë për një elasticitet dhe zgjerim gjuhësor, për fond të madh fjalësh e zgjerime kuptimore të tyre, për ndërtime të shumta gjuhësore, për një sintaksë shumë fleksibile; pra për një kod shumë më të hapët sesa korniza e gjuhës standarde.

Arsyeja e kapërcimit të konvencioneve gjuhësore në letërsi është motivimi artistik.- Shkelja e normave të shqipes standarde në letërsinë artistike pa motivim artistik sjell të meta stilistike, duke e bërë të papëlqyeshme gjuhën për lexuesin. Motivimi artistik u lejon shkrimtarëve ta kapërcejnë rrethin normativ. P.sh. një vepër mund të shkruhet edhe në gjuhën e pesë shekujve më parë, ose edhe në një dialekt me synime të veçanta, ashtu siç ka shkrimtarë që shkruajnë në dy gjuhë njëherësh (arbëreshët e Italisë, p.sh. botojnë poezi në dy gjuhë paralelisht shqip - italisht). Në rastin e fundit kemi të bëjmë me marrëdhëniet e letrarit me auditorin (lexuesit) dhe jo me gjuhën standarde shqipe.

Megjithëkëtë, krahas lirisë së madhe gjuhësore të shkrimtarëve, laramania në gjuhën e letërsisë artistike është e nevojshme që të ketë një forcë bashkuese, që të mos lejojë të lindë ndonjë efekt i padëshirueshëm shpërbërës gjuhësor e kombëtar. Njëjtësia sigurohet në gjuhën e autorit si rrëfyës. Edhe në prirjet natyraliste, për të dhënë gjuhën ashtu siç përdoret, edhe po të shkruhet në dialekt etj., shkrimtarët bëjnë një përpunim letrar artistik. Letërsia ka përpunuar një varg formash të rrëfimit, të monologut e të dialogut, mënyra të ndërthurjes së ligjëratave etj., të cilat janë përpunime e pasurime të gjuhës shqipe me vlera të veçanta. Ajo e ka rritur shijen artistike të lexuesve edhe për gjuhën shqipe përgjithësisht.

Vepra letrare është edhe krijim artistik edhe krijim gjuhësor, një eksplorim i mundësive të shqipes. Kjo prirje krijuese gjuhësore e shkrimtarëve nuk lidhet vetëm me krijimin e fjalëve të reja, sepse shumica e tyre janë neologjizma stilistike, por edhe me të gjitha fushat e tjera të gjuhës.

Shkrimtarët ndikojnë me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e fjalëve, me kuptimin e ngjyrimet e reja, me dendurinë e ndryshuar të përdorimit, me sintaksën e shndërruar, me organizime dytësore të elementeve të gjuhës që ngjallin efekte estetike, me vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të shpehshmërisë së figurshme e simbolizuese (ironike) dhe deri të lojës gjuhësore.

Natyrisht, krijimtaria letrare niset nga funksioni themelor i mjeteve gjuhësore, por edhe punon për t'u dhënë atyre rol shprehës e artistik. Të gjitha këto arrihen jo me fjalë e forma të veçanta, por më tepër me mënyra tërthore, që mishërohen në organizimin dytësor. Rezultati që arrihet është një ndikim i fuqishëm mbi ndjeshmërinë e lexuesit, mbi përfytyrimin e shijen e tij, duke e bërë ta pranojë vetvetiu se diçka është thënë më bukur sesa do ta thoshte ai vetë.

Veprat letrare nuk bëjnë çmos që të shkëputen nga përdorimi i ngulitur i gjuhës; por, përkundrazi, pasuria e gjuhës kombëtare mbetet një visar i pashtershëm për të arritur efekte shprehëse artistike, me këtë edhe vetë letërsia shtresohet në vlerat kulturore të shqipes.

Në letërsi riprodhohet vetë gjuha.- Letërsia jep procesin e komunikimit gjuhësor, tipat e ligjërimit, gjuhën e grupeve shoqërore, profesionale, të moshave të ndryshme, variantet krahinore e letrare. Të gjitha këto varen nga drejtimet artistike: sa më realiste është letërsia, aq më afër synon të japë realitetin gjuhësor dhe anasjelltas, sa më tepër largohet letërsia nga realizmi, aq më tepër edhe gjuha largohet nga riprodhimi i përdorimit real. Prandaj, teatrit absurd i përgjigjet edhe absurditeti i fjalive. Romantizmit i përgjigjet gjuha romantike: ligjërimit ka emocionalitet të theksuar, priret nga tropet dhe parapëlqen subjektivitetin.

Shkrimtarët mbajnë qëndrim vlerësues ndaj ligjërimit, i çmojnë ose i përçmojnë fjalët e tipat e shprehjes, përkrahin një shije a modë gjuhësore ose e satirizojnë atë. Nga kjo pikëpamje, shkrimtarët janë “gjuhëtarë” të një tipi të veçantë, vëzhgues, regjistruer e vlerësues të gjuhës. Nuk është e rastit, që vlerësimet më të shpeshta e më të goditura për gjuhën i japin letrarët. Bie fjala, shkrimtarët janë të parët që e kanë përhapur idenë se shqipja është gjuhë e ëmbël dhe e bukur.

Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Ç'është gjuha standarde shqipe dhe kur u formua ajo?
2. Çfarë dallimi ka ndërmjet gjuhës së letërsisë artistike dhe gjuhës standarde shqipe?
3. Sa zbatohen normat e shqipes standarde në letërsinë artistike që është krijuar pas Kongresit të drejtshkrimit?
4. A janë të lejueshme tani format jostandarde në gjuhën e veprave letrare, si p.sh. fjalë që i përdor populli por të cilat nuk janë pjesë e leksikut të shqipes së normuar, fjalë të vjetruara, fjalë të huaja etj.
5. Për ç'arsye shkrimtari ndonjëherë nuk i respekton rregullat e drejtshkrimit?
6. Analizojeni gjuhën në fragmentin e nxjerrë nga “Besa-besë” e Çajupit. A mund të hetoni shmangie nga norma e sotme e shqipes standarde dhe si i shpjegoni ato?

Volteri tha: “Allfabeti ka qenë isvori i gjithë të njohuravet njeriut edhe i gjithë paramendimëve tij”. Dyke zgjedhurë allfabetnë turqishte, shqipëtarët nuku do të bëjnë tjetër për veç të dëftohen të pamençmë. Mbetëtë të flasim për allfabetnë greqisht. As ay nuku bën për të shkruarë gjuhënë tonë. Është vërtet që ay ka shkruarë një gjuhë, së cilës bot' e qytetëruarë detyron shumë të shkruara të mëdha, nga të cilatë është e çuditurë dhe e dashurë sot. Po këjo gjë nuku duhetë vënë re në të zgjedhurit e allfabetit. Grekomanët thonë se gjuha tonë nuk' është tjetër gjë veçse një dialekt i gjuhës greqishte, e cila thon' ata: e ëma. Po edhe njerjë në thënçinë, fjal' e tyre

është gjithaqë gënjeshtër, bërë me qëllim të keq për nevojat që kanë për dëm të kombësisë tonë që kërkojnë ta shuajnë me gjithë sejt ndë fitim të tyre ...

1.4. KOMUNIKIMI VERBAL DHE JOVERBAL

Në fillim njerëzit merreshin vesh me anë të *gjuhës vizuale* (pamore, okulare), përkatësisht përmes lëvizjes së disa pjesëve të trupit: gjesteve dhe mimikës, ndërsa më vonë janë marrë vesh edhe me anë të vizatimeve, simboleve etj.

Edhe sot e kësaj dite njeriu përdor lloje të ndryshme komunikimi. Të gjitha mjetet e marrëveshjes ndahen në dy grupe:

- a) në *komunikim verbal* dhe
- b) në *komunikim joverbal*;

Komunikimi joverbal realizohet pa fjalë, por me mjete të tjera, i quajtur edhe komunikim kinetik a gjestikulativ. Lëvizjet me duar ose me kokë quhen gjeste. Porosi mund të jepen edhe me lëvizjen e buzëve, syve apo qepallave. Kjo mënyrë e emetimit të porosive quhet mimikë. Pra, mimikë quhet tërësia e lëvizjeve të pjesëve të fytyrës me të cilat shoqërohet të folurit ose shprehen ndjenja të ndryshme a një gjendje e caktuar. Por, mimikë është edhe mjeshtëria e të shprehurit të ndjenjave vetëm me anë të lëvizjeve të pjesëve të fytyrës; shprehja e gjendjes shpirtërore në këtë mënyrë. P.sh. *Mimika e një aktori. Mimika e një të sëmuri.*

Gjestikulacion quhet lëvizja e duarve a e kokës për t'i njoftuar dikujt me shenjë diçka ose që shoqëron të folurit e njeriut. *Gjest miratues (përçmues, fyes, mospërfillës). Gjest pohimi (pranimi, pëlqimi, mohimi). Gjuha e gjesteve. Bën gjeste. Flet me shumë gjeste.*

Kështu, me mbylljen e syrit mund ta paralajmërojmë dikë që të heshtë; me lëvizjen e dorës mund ta ftojme dikë që të vijë nga ne ose që të largohet; me lëvizjen e kokës në drejtim lart-poshtë pohojmë diçka, ndërsa majtas-djathtas mohojmë diçka; buzëqeshja jonë gjatë takimit me dikë shpreh gëzimin tonë që jemi takuar etj.

Edhe nga shpjegimi i mësipërm mund të përfundohet se mimika dhe gjestikulacioni shprehin diçka edhe kur përdoren më vete, pa folur fare. Këto janë mjete shprehëse të jashtme. Mirëpo, në jetën e përditshme shpeshherë edhe flasim edhe lëvizim ndonjë pjesë të trupit, pra mimika dhe gjestet janë shoqërues të të folurit.

Sistemi i shenjave dhe i simboleve shfrytëzohet edhe tani në trafikun rrugor, detar e ajror; në ushtri; në kimi (simbolet kimike), në matematikë (simbolet e matematikës); alfabeti i Morzeut që përdoret në telegrafi, abëcëja e Brajtit - për nevojat e shurdhmemecëve e posaçërisht e të verbërve etj.

Komunikimi verbal jetësohet me fjalë, me anë të gjuhës së folur dhe të shkruar. Kjo është mënyra më e plotë, më e saktë, më e përparuar e marrëveshjes midis njerëzve. Komunikimi

joverbal në shkencën e gjuhësisë llogaritet për dytësor, sepse parësor është ligjërimi. Komunikimi kinetik a gjestikulativ e ndihmon dhe e plotëson të folurit e nyjëtuar.

Në gjuhën popullore, kuptimi i thënies (bisedës) përveç fjalëve, ka si mjet sqarimi dhe saktësimi edhe gjestet e mimikën, me anën e të cilave theksohet, përcaktohet ose kompletohet mendimi, ndjenja e ideja e shprehur me fjalë.

Në prozën artistike mimika dhe gjestikulacioni, si mjete shprehëse të jashtme, ndërthuren me fjalët, duke krijuar kështu një pamje filmike. Në gjininë e dramës, qofshin ato komedi ose tragjedi, në kllapa jepen shpjegime për lëvizjet, karakterin, emocionet e personazhit, por edhe shfaqjen e jashtme të tyre. Pa këto të dhëna, as që do të mund të viheshin në skenë këto vepra dramatike.

Mimika dhe gjestet kanë rëndësi të madhe në gjininë e dramës dhe në artin teatral. Nëpërmjet tyre aktori mund të shprehë çdo ndjenjë: gëzim, pikëllim, urrejtje, dashuri, zemërim, dhembje, ironi etj. ndaj ngjarjeve ose njerëzve me të cilët ka marrëdhënie të ndryshme. Çdo lëvizje e aktorit duhet të jetë sa më e natyrshme dhe sa më bindshëm të shprehë qëndrimin e tij. Sa për ilustrim po shkëpusim pjesë nga komedia “Pas vdekjes” e Çajupit:

Zeneli (*duke qeshur nën buzë*): Më ndje, zotëni, po ... (*duke ulur kryet*) më ndje, doktor Adham-Uti!

Vurkua (*duke qeshur*): Lot a qesh, o Zenel? ç’farë emër ky, më qafsh?

Adham-Uti (*i vërenjtur*): Duket s’të pëlqen! ...

Vurkua (*i habitur*): I ka miq ...

Vurkua (*duke qeshur pak*): Mjaft janë këto që fole zotëni! Tani t’u ngjatë jeta! Lamtumirë doktor efendi! ... (*del jashtë me vrap*)...

Adham-Uti (*i kënaqur*): Mos qesh me mua! ...

Lulushe (*e tmeruarë*): Lugar dhe kuvëntoka! (*bën kryq*)...


Adham-Uti (*i egërsuar*): Kështu shkruan për mua?...

Pyetje dhe detyra:

1. Ç’janë mimika dhe gjestikulacioni?
2. Ku dhe pse i përdor njeriu?

1.5. MARRËDHËNIET E DIALEKTEVE ME GJUHËN STANDARDE

Gjuha dhe dialektet janë në lidhje të krahasueshme me atë të rrënjës me trungun e degët e një peme, d.m.th. degëzimeve të mëdha, të përbëra nga degëza e filiza a bisqe më të holla, deri tek njësia më e vogël apo më e imët e mundshme, që është e folmja e individit apo idiolekti (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 2003, f. 26).



Dialektet janë pjesë e gjallë e gjuhës dhe prania e tyre lidhet me larminë dhe pasurinë e ligjërimeve e të dallimeve gjuhësore sipas krahinave, porse ato, gjithmonë kanë qenë e mbeten pjesë përbërëse e gjuhës shqipe, me bazë të gjerë të përbashkët. Baza e njëjtë dhe e përbashkët e shqipes duhet mbrojtur, ruajtur e përkrahur edhe më tej, sepse përbën treguesin themelor të përbashkësisë shpirtërore dhe kombëtare të shqiptarëve kudo që ndodhen, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në trojet e veta ballkanike dhe në diasporat arbëreshe e shqiptare kudo në botë.

Fig. 2. Variantet territoriale + gjuha standarde = gjuha kombëtare.

Gjuha shqipe kombëtare = shqipja dialektore + shqipja standarde

Gjuha standarde shërben për dialektet si një ombrellë. Çdo gjuhë standarde mbulon dialektet e veta. Dialektet e veta i bashkon, kurse dialektet e huaja që fliten në territorin e saj, i asimilon. Në këtë funksion, shqipja standarde mbulon dialektet e veta të trojeve etnike dhe të folmet shqipe të diasporës, duke i ruajtur këto të fundit nga asimilimi (Memushaj, 2009 : 12).

Nga pikëpamja gjuhësore dialekti nuk ka dallime nga gjuha: *secili dialekt i shqipes, i marrë në vetvete, qoftë gegërishtja, qoftë toskërishtja, mund të quhet gjuhë shqipe*. Vetë gjuha standarde nuk është tjetër veçse një dialekt që është përkrahur dhe është ngritur në përdorim nga i gjithë kombi, nga e gjithë bashkësia shoqërore përkatëse. Fjala vjen, frëngjishtja standarde është ngritur mbi të folmen e Parisit (kryesisht i të folmes së Il dë Francës), i cili për hir të forcës qendëruese të kryeqytetit, u shtri dalëngadalë në gjithë territorin e Francës. Maqedonishtja standarde ka për bazë të folmet e maqedonishtes qendrore, ndërsa bazë dialektore e shqipes standarde është toskërishtja veriore ose siç e thonë disa gjuhëtarë toskërishtja letrare e ngritur në standard (prof. Rami Memushaj, prof. dr. David Luka në [http:// www. forumishqiptar.com](http://www.forumishqiptar.com)).


Me gjuhë shqipe kombëtare nënkuptojmë tërësinë (shumësinë) e të gjitha ligjërimeve të mundshme të saj: *shqipen e letërsisë që nga dokumentet e shkrimet para të saj e deri në shkrimet e letërsisë bashkëkohore e në tekstet e çfarëdo lloji qofshin, shqipen dialektore: dialektet, nëndialektet e të folmet me vazhdimësi tokësore e gjuhësore dhe ato të diasporës si dhe shqipen standarde me të gjitha variantet stilistike*. Pra, dialekt = gjuha e një krahine apo e disa krahinave së bashku; gjuha = tërësia e dialekteve dhe e varianteve të tjera gjuhësore të mbarë një populli, kombi.

Gjuha është një sistem i ndërlikuar mjetesh komunikative që përdoren në një bashkësi a kolektiv të dhënë shoqëror për të gjitha llojet e format e komunikimit, kurse *dialekti është vetëm një nga varietetet e shfaqjes së këtij sistemi e që kufizohet e përcaktohet nga tri aspekte*: aspekti gjeografik e shoqëror, aspekti funksional dhe aspekti strukturor (J. Gjinari - Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 2003, f. 43-44).

Prirja e hapërimit të ligjëritit krahinor drejt një varianti të përbashkët kombëtar. Me shkollimin në masë të shqiptarëve, me ndikimin gjithnjë e më të fuqishëm të mediave, me lëvizjen tonë brendakombëtare gjithnjë e më të shpeshtë, me përzierje popullate krahinash të ndryshme, veçmas në qytete të mëdha, me pushimet e verës të shqiptarëve të Kosovës e Maqedonisë gjithnjë e më të shpeshta në bregdetin e Shqipërisë, me shkollimin e jo pak të rinjve jashtë krahinës (të Kosovës e Maqedonisë në Shqipëri e anasjelltas), me aktivitete tregtare e ekonomike brendakombëtare, me lidhje miqësore e martesore krahinash të ndryshme etj. gjithnjë e më tepër po intensifikohet procesi rrafshues i dallimeve dialektore.

Çhundurëzimi i zanoreve, zbehja e vlerës fonologjike të zanoreve të gjata, zvogëlimi i nuancave tingullore (alofoneve) të fonemave të njëjta, monoftongimi i diftongjeve dytësore në të folmet e gegërishtes qendrore, zëvendësimi i formave morfologjike vendore (lokale) me format e shqipes standarde si dhe shumë zhvillime të tjera rrafshuese, bashkë me ngritjen e përgjithshme të kulturës gjuhësore ndër ne (duke lënë anash disa thyerje të normës letrare në praktikën tonë gjuhësore), janë tregues të mirë se dialektet dhe gjuha shqipe përgjithësisht po ecën me hapa të

shpejtë drejt njësimi gjuhësor kombëtar. Ky konvergjim i dialekteve të gjuhës sonë çdo ditë e më tepër po intensifikohet.



Ndikimet e huaja shfaqen sidomos në leksik dhe në ndërtimet sintaksore, por me punë të organizuar shkencore e hulumtuese ato mund të mënjanohen nga përdorimi. Leksiku i shqipes standarde karakterizohet edhe me prirjen për pastrimin nga fjalët e huaja. Kështu, janë nxjerrë nga përdorimi shumë fjalë me origjinë orientale, greke, sllave etj. Është ngushtuar edhe veprimi i prapashitesave e parashtesave të huaja me zëvendësimin e tyre me ato të shqipes (si, *-xhi*, *-çi*, *-llëk*, *anti-* etj., p.sh. *furrxhi* – *furrtar*, *sahatçi* – *orëndreqës*, *dembellëk* – *dembeli*, *përtaci*; *antitank* – *kundërtank*).

Në Evropën e Bashkuar, ky synojmë të hyjmë, gjuhët kombëtare duhet të bëhen të pajtueshme në nivelin e aftësive shënjuese e komunikuese. Duhet përcaktuar se si do të quhen në gjuhën shqipe shumë nocione dhe sende të botës së sotme, qoftë me fjalë shqipe ose të ndonjë burimi tjetër.

Planifikimi gjuhësor duhet bërë me ndërgjegje të plotë, për arsye se ndërtimet e huaja gramatikore prekin strukturën e gjuhës, por edhe kur fjalët e huaja përdoren për një kohë më të gjatë dhe më shpesh, ato çrrënjosen më me vështirësi. Pasurimi i gjuhës sonë letrare me fjalë, shprehje e frazeologjizma të reja nga të folmet tona jep ndihmesë të madhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes standarde nga ndikimet e huaja, duke përfshirë edhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të gurrës shqipe. Gjithsesi edhe fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë janë të dobishme për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës standarde shqipe.

Pyetje, detyra e ushtrime:

Shkruaj një artikull në temë: Marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde.

1.6. BAZA DIALEKTORE E SHQIPES STANDARDE

Në nëntor të vitit 1972 u mbledh Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, tubim me përmasa kombëtare ku morën pjesë studiues e përfaqësues të shkencës dhe të kulturës nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe nga arbëreshët e Italisë. Në të u mbështet dhe u miratua vija përbashkuese e ndjekur për drejtshkrimin dhe, pas këtij akti formal të ndërmarrë në një kongres shkencor, gjuha letrare shqipe e njësuar mbi bazën e variantit dialektor të toskërishtes (apo variantit letrar toskë) mori përhapjen e plotë kudo ku flitet e shkruhet shqip.

Në dhjetë vitet e fundit ndër temat më të nxehta, më të shpeshta, më të diskutueshme me larmi mendimesh e qëndrimesh, shpeshherë kundërtënjese janë: Cila është baza dialektore e shqipes standarde? Duhet apo nuk duhet të përmirësohet e të pasurohet standardi? Ky standard është vendim politik i kohës apo zgjidhje jopolitike e drejtë? Kush duhet bërë planifikimin gjuhësor e politikën gjuhësore? Çfarë duhet bërë që të përmirësohet niveli i zbatimit të standardit? A duhet shqiptarët të kenë dy standarde gjuhësore? etj. etj.

Në këto tema janë përfshirë të gjithë: gjuhëtarë, gazetarë, shkrimtarë, pedagogë e njerëz të gjitha profesioneve të tjera. Trajtesa të çështjeve të këtilla e të ngjashme mund të gjeni të postuara në Internet, në mjetet e informimit publik (në formë të shkruar e të folur), në referime konferencash etj.

Në këtë leksion, nuk e marrim përsipër të japim as që mund të japim përgjigjen e duhur çështjeve madhore si këto që u parashtruan më parë, por për nevojat e këtij teksti mësimor duam të sigurojmë pak të dhëna për bazën dialektore të shqipes standarde. Për të pasur një pasqyrë të bazës dialektore të shqipes standarde, pa i përfshirë elementet e përbashkëta të të dy dialekteve në shqipen e normuar, po paraqesim në mënyrë tabelore disa nga veçoritë kryesore të gegërishtes e të toskërishtes në fonetikë e fonologji, morfologji e leksik, duke i krahasuar me shqipen standarde:

<i>Gegërishtja</i>	<i>Toskërishtja</i>	<i>Shqipja standarde</i>
Në fonologji e fonetikë:		
1. ka zanore gojore dhe hundore (kam ~ kã:m)	ka vetëm zanore gojore (kam - këmbë)	nuk ka zanore hundore (kam - këmbë)
2. ka zanore të gjata me vlerë fonologjike (plak ~ pla:k)	nuk ka të tilla (plak – plakë)	gjatësia nuk ka vlerë fonologjike (plak – plakë)
3. /ã/-së hundore të theksuar (zã, nãn, hã:n)	i përgjigjet /ë/-ja gojore e theksuar (zë, nënë, hënë)	/ë/ gojore të theksuar (zë, nënë, hënë)
4. mungesa e /ë/-së së theksuar dhe përdorimi i rrallë i të patheksuarës	prania e /ë/-së së theksuar dhe përdorimi shumë i dendur i të patheksuarës	prania e /ë/-së së theksuar dhe përdorimi i dendur i të patheksuarës
5. grupi <i>ue</i> (u:) – <i>grue</i>	grupi <i>ua</i> (grua)	<i>ua</i> dhe <i>ue</i> (grua, mësues)
6. grupi nistor <i>vo</i> (voj,	grupi nistor <i>va</i> (vaj, vatër)	grupi nistor <i>va</i> (vaj, vatër)

votër)		
7. fjalë me /-n-/ ndërzanore (rāna, vēna, s̄yni)	fjalë me /-r-/ ndërzanore (rēra, vera, syri)	shumë fjalë me /-r-/ ndërzanore dhe pak me /-n-/
8. përngjashmimi i togjeve mb > m, nd > n, ng > ŋ	ruajtja e tyre (mbush, nderoj, ngas)	ruajtja e tyre (mbush, nderoj, ngas)
9. mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshmeve në fund të fjalës	shurdhimi i të zëshmeve (i madh – i math, vend – vënt)	mosshurdhimi i të zëshmeve në fund të fjalës
10. ruajtja e kundërvënies fonologjike /r ~ rr/ (ruaj ~ rruaj, ara ~ arra)	mospërdorimi i /rr/-së (ruaj, ara)	ruajtja e kundërvënies fonologjike /r ~ rr/ (ruaj ~ rruaj, ara ~ arra)
11. [nj] > [j] ose [n] (rrānja > rrāja, një > ni)	ruajtja e [nj]-së (rrēnja, një)	ruajtja e [nj]-së (rrēnja, një)
12. ruajtja e ëh]-së (hāna)	mosshqiptimi i ëh]-së (ēna)	ruajtja e ëh]-së (hēna)
13. disa orientalizma përdoren me theks në rrokjen parafundore (kāfe, tenéqe)	të njëjtat shqiptohen me theks fundor (kafé, teneqé)	ato shqiptohen me theks fundor (kafé, teneqé)
Në morfologji (në format gramatikore të fjalëve):		
1. plak-i, breg-i, krah-i	plak-u, breg-u, krah-u	plak-u, breg-u, krah-u
2. e hecmja, e shkrumja	të ecurit, të shkruarit	të ecurit, të shkruarit
3. i la:m, e lame	i larë, e larë	i larë, e larë
4. ka përemra vetvetorë (vetë, vetja, vetvetja)	nuk ka përemra të tillë	ka përemra vetvetorë (vetë, vetja, vetvetja)
5. ka pjesore të reduktuara, pa mbaresa (la:, ha:p)	ka pjesore të plota me mbaresa (larë, hapur)	pjesore të plota me mbaresa (larë, hapur)
6. e pakryera veprorë është sigmatike (punojsa)	e pakryera veprorë është asigmatike (puno-ja, -nja)	e pakryera veprorë është asigmatike (punoja)
7. e pakryera pësore është analitike (u lajshna)	e pakryera pësore është sintetike (lahesha)	e pakryera pësore është sintetike (lahesha)
8. gegërishtja ka paskajoren geqe (me punue)	ka lidhoren (të punoj) ose paskajoren toske (për të punuar)	këtë e shpreh me lidhoren (të punoj) ose paskajoren (për të punuar)
9. ekzistojnë forma të dyta të së shkuarës (kam, kisha, pata + pas + punu)	nuk përdoren forma të tilla të dyta (por: kam, kisha, pata + punuar)	nuk përdoren forma të tilla të dyta (por: kam, kisha, pata + punuar)
Në leksik (fjalë të ndryshme që përdoren për një send, një frymor etj.):		
katun	fshat	fshat, katund
tamël	qumësht	qumësht
dhelapën	skile	dhelapër
gjā, hajvan	kafshë	kafshë
u:dh	rrugë	rrugë, udhë
krye	kokë	kokë, krye
katërdhet	dyzet	dyzet
tly:n	gjalpë	gjalpë, tëlyen

tinëz	fshehurazi	fshehurazi
rrej	gënjej	gënjej

Tiparet fonologjike, fonetike, morfologjike e leksikore midis dy dialekteve të shqipes krahasuar me shqipen standarde

Është fakt i pamohueshëm që varianti standard i shqipes është ngritur mbi bazën e fonetikë-fonologjisë e të morfologjisë së variantit toskë (apo variantit letrar toskë), por në fazën e tanishme të zhvillimit shqipja standarde përfaqëson variantin më të përpunuar për shumë vjet nga gjithë shqiptarët dhe tani ajo është shumëfish më e pasur, më e gjerë dhe ka kapërcyer jo vetëm bazën dialektore toske, por gjithë shqipen dialektore; e ngritur në nivel të lartë që të përmbushë të gjitha nevojat e shoqërisë shqiptare në të gjitha veprimtaritë shoqërore, si në arsim, në shkencë, në kulturë, në art, në teknikë e në çdo pore të jetës dhe e denjë të përballet me gjuhët më të lëvruara të Evropës.

Me fjalë të tjera, **vetëm baza nyjëtimore e shumica e formave morfologjike të shqipes standarde janë toske**, por kjo bazë është mbindërtuar në të gjitha fushat e tjera, si p.sh. në leksik (janë krijuar fjalë të reja, janë huazuar terme, fjalë e frazeologjizma librorë; janë pranuar shumë fjalë e shprehje nga gegërishtja e nga krijimtaria letrare etj.), në sintaksë etj. Dialektet realizohen vetëm në formën e folur, kryesisht në stilin e shkujdesur dhe në stilin bisedor; ndërsa varianti standard realizohet përveç në formën e folur edhe në formën e shkruar, përveç në ligjërimin bisedor edhe në ligjërimin libror nëpërmjet stileve funksionale. Në shqipen standarde janë përvijuar pesë stile funksionale: a) stili i veprimtarisë shkencore e teknike; b) stili i veprimtarisë shtetërore e administrative; c) stili i veprimtarisë shoqërore e politike; ç) stili i veprimtarisë letrare artistike; d) stili i veprimtarisë fetare.

Natyrisht në këtë gjuhë standarde kombëtare të njësuar kanë hyrë dhe do të hyjnë vijimisht edhe jo pak elemente të gegërishtes, dhe ky është proces i pashmangshëm i bashkëveprimit dhe i shndërrimeve të bashkësisë shoqërore shqiptare në kushtet e reja gjeopolitike, historike, kulturore, demografike, përbashkuese e globalizuese. Do të na duhet një standard që di të vërë në punë të gjitha forcat e brendshme, për t'u rigjeneruar vazhdimisht e për të ofruar një larushi formash shprehëse, si mekanizëm mbrojtës ndaj ndikimeve të jashtme të gjuhëve të huaja.

Shqipja standarde duhet të ushqehet, të vishet, të lahet, të krihet e të jetë sa më afër e nën mbrojtjen, ngrohtësinë dhe përkujdesin amnor të mëmës së saj (toskërishtes) dhe tezës së saj (gegërishtes), meqë si njëra si tjetra do t'i japin më të mirën që kanë nga vetja, deri sa të shkrihen në bijën e tyre dhe nuk do ta tjetërsojnë kurrë. Në fakt nuk mund të kemi pasurim të vërtetë të standardit e as jetëgjatësi të standardit (rrjedhimisht edhe të shqipes) nëse nuk do ta ushqejmë atë nga rrënja e saj, por nga gjethet (gjuhët e huaja). Nga ana tjetër, standardin duhet ta përdorin të gjithë: mësuesi, mjeku, politikani, bujku... Nëse standardi do të largohet shumë nga nëna e saj, nga gjuha popullore, atëherë do të krijohet një gjuhë artificiale, e rëndë për ta zbatuar në veprimtarinë e në jetën tonë të përditshme, dhe kjo mund të sjellë pasoja të padëshirueshme, të dëmshme për ekzistencën e shqipes e të shqiptarëve.

Çdo element dialektor, toskë apo gegë është shumë më i mirë e më i padëmshëm për shqipen standarde sesa cilido element i huaj. Kjo mund të jetë e krahasueshme edhe me gjuhët sllave: maqedonishtja, bie fjala, ka huazuar e huazon vazhdimisht fjalë nga serbishtja, rusishtja, bullgarishtja e nga gjuhët e tjera simotra, por ato përshtaten aq mirë me sistemin gjuhësor të

gjuhës marrëse saqë elementet e huaja leksikore nuk hetohen fare se janë trup i huaj. Në këtë pikëpamje, gegërishtja e toskërishtja, përfshirë edhe të gjitha shkrimet e deritashme në dialekte, janë shumë më të afërta e më të përshtatshme për t'u normuar, sesa futja e elementeve të gjuhëve të huaja (anglishtes, frëngjishtes, italishtes) në variantin standard të shqipes. Elementet e njëjta, të ngjashme a të përafërta që i shtohen një tërësie e ruajnë dhe nuk e prishin identitetin e saj, ndërsa elementet e huaja të shumta mund të ndërrojnë edhe identitetin e diçkaje. Kjo i ngjan edhe arnimit: për të zgjatur jetën rrobave, gjyshet e nënat tona qepnin arnin në vendin përkatës me ngjyrë më të përafërt me rrobën e grisur.

1.7. PLANIFIKIMI I SHQIPES DHE POLITIKA GJUHËSORE

Planifikimi gjuhësor si çështje sociolinguistike nënkupton alfabetizimin e gjuhëve, problemet e caktimit të gjuhëve zyrtare, standardizimin e gjuhëve kombëtare dhe modernizimin e tyre. I fundit vjen stadi i modernizimit, që karakterizohet nga përpjekjet për ta bërë gjuhën tashmë të standardizuar të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës.

Në përmbajtjen e planifikimit gjuhësor E. Haugeni, i cili e ka krijuar këtë term, përfshin “punën normëzuese të akademive dhe komiteteve gjuhësore, të gjitha format e kultivimit të gjuhës dhe gjithë propozimet për reformën ose standardizimin e gjuhës”.

Planifikimi gjuhësor duhet parë si pjesë e planifikimit shoqëror. Ashtu si planifikimi shoqëror, që në përgjithësi është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave të zhvillimit për një shtet të caktuar, edhe planifikimi gjuhësor është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave gjuhësore për një bashkësi të dhënë.¹

Kujdesi i vazhdueshëm i shoqërisë sonë për zhvillimin e shqipes standarde dhe për zbatimin e normave të saj ka marrë një hov të ri sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor 1972).² Pas Kongresit të Drejtshkrimit e deri më tani gjuhësia shqiptare ka zhvilluar një veprimtari të dendur për të krijuar vepra gjuhësore normative, si “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, “Fjalori drejtshkrimor”, “Gramatika e gjuhës shqipe” në dy vëllime, “Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe”, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” dhe “Fjalori i shqipes së sotme”, “Rregullat e pikësimit të gjuhës shqipe”, “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe”, “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”, “Fjalor enciklopedik shqiptar” si dhe një varg fjalorësh terminologjikë dhe veprash të tjera për shqipen e sotme e për kulturën gjuhësore, ndër të cilat edhe një numër tekstesh mësimore universitare.³

¹ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 325-326.

² Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë (elemente të normës së sotme letrare kombëtare)*, Tiranë, 1976, f. 3.

³ Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” (mbajtur në Tiranë, 11 dhe 12 nëntor 2002), *Studime filologjike* 3-4, 2002, Tiranë, f. 6.

Në kuadër të projektit “Gjuha shqipe dhe kompjuteri” me përkrahje materiale të Qeverisë së Kosovës dhe i mbështetur nga gjuhëtarët më të shquar shqiptarë, në fillim të vitit 2005 u mundësua zbatimi i një program kompjuterik për drejtshkrimin e shqipes AS 2.0. Me këtë program të rëndësishëm edhe gjuha shqipe u fut në mesin e gjuhëve të kompjuterizuara. Kjo shënon një epokë të re për gjuhën shqipe, i bazuar në përvojat që kanë pasur gjuhët e kombeve të zhvilluara.

Me programin për drejtshkrimin e shqipes mund të korrigjohen mbi një milion fjalë e trajta fjalësh, përkatësisht rreth katër milion trajta të përsëritshme. Shfrytëzuesit nuk i duhet trajnim i veçantë për përdorimin e këtij programi, mjaftojnë pesë minuta për përvetësimin e tij. Me përdorimin e këtij programi, ju nuk do të jeni më vëzhgues të rëndomtë të bastardimit të gjuhës amtare, por do të kontribuoni në ngritjen e nivelit të saj çdo ditë e më shumë.

Qëndrueshmëri të përjetshme, absolute nuk ka as në gjuhë, pra as në drejtshkrim. Normat e çdo gjuhe janë të gjalla e në lëvizje. Mbyllja vetëm në “guaskën” e asaj që është parashikuar si normë qysh para 40 vitesh, mbështetur në treguesit e atëhershëm, sot, në dritën e disa trysnive që na sjellin zbatimet (në fakt moszbatimet) e ditëpërditshme do të ishte jodobiprurëse. Le të kujtojmë, ndër të tjera, betejën e humbur të dallimit të numërorit *tre/tri* sipas gjinisë. Të gjithë po e shikojmë se si, pas bjerrjes së plotë të dallimit të *dy* (me zanore të shkurtër, për gjininë mashkullore) dhe *dy*: (me zanore të gjatë, për gjin. fem.) që ka mbetur vetëm në gegërishte, po tretet si kripa në ujë edhe dallimi *tre* (për meshkujt) dhe *tri* (për femrat). Sot pothuajse gjithandej thuhet *tre* ose *tri* për të dy gjinitë. Kësaj bjerrjeje i ndihmon shumë edhe ndikimi prej gjuhëve të huaja që nuk e kanë një dallim të tillë në morfologjinë e tyre. Kjo do të ishte një trysni mirëfilli toske, në thelb e pamirë, por detyrimisht e përfillshme sepse po përgjithësohet.

Nga ana tjetër, nuk mund të mos i bëjmë udhë shtimit të shumësit me *-a* (*mësuesja, studenta, profesora, shofera, oficera* etj.), që vjen nga arealja gege, por që po gjen përdorim të gjerë e po pëlqehet si një shumës më i qartë ndaj formave përkatëse me *-ë*, që këshillon norma e sotme morfologjike e drejtshkrimore. Edhe më e qartë del kjo trysni gegizuese për të mos e shqiptuar [-ë]-në e patheksuar fundore, ndonjëherë edhe në mes të fjalës. Tashti edhe toskët nuk i shqiptojnë më me *-ë* disa fjalë, që sipas rregullave duhet të shkruhen ende me <ë>, prandaj edhe në praktikën shkrimore të sotme, gjithandej po shtohen “gabimet” drejtshkrimore pikërisht në përdorimin e [ë]-së.

Mund të diskutohet e të përmirësohet edhe norma drejtshkrimore e ndonjë përjashtim që nuk duket se ka qenë dorëmbarë, si p.sh. *i gjerë* (ndërsa pritej dhe duhej të ishte shkruar: *i gjërë*, sipas tipit përkatës: *bana > bëra, ranë > rërë*); po kështu mund të krasiteshin jo pak raste të *ë-së* fundore, si dhe të *-ë-së* mbështetëse që sot duken si hipertoskizma dhe askush nuk i shqipton më. Ka edhe dukuri të tjera që, sigurisht, koha do ta bjerë të diskutohen nga specialistët e gjuhësisë, duke shqyrtuar e parë jo vetëm ç’është thënë e zgjidhur mirë, po edhe ndonjë gjë që duhet rishikuar për të gjetur zgjidhje më të mirë. Sigurisht, diskutime të tilla duhet të bëhen dhe koha ka ardhur të bëhen, porse ato nuk kanë të bëjnë më me themelin e gjuhës letrare të njësuar e të vetme për të gjithë.⁴

Procesi i globalizimit (që nga forcat e mëdha çmohet si shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të lirë dhe për shoqërinë e hapur, për zbatimin e parimeve të demokracisë dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përpjesëtime botërore), po bëhet rrezik për kulturat dhe

⁴ Gjovalin Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2, 2000, Tiranë, f. 39-40.

gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë edhe më tej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Ajo edhe tani si gjuhë zyrtare ose gjysmëzyrtare përdoret në më shumë se 60 shtete, kurse vend të posaçëm zë edhe në 20 vende të tjera. E gjithë bota e kulturuar kujdeset të mësojë anglishten; nga sasia e përgjithshme e informatave në kujtesën e sistemeve elektronike, 80% janë në anglisht. Nën ndikimin e anglishtes shkombëzohen gjuhë amtare. Mund të parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël.⁵

Sot probleme të mëdha nuk janë aq hollësitë e drejtshkrimit e të normës morfologjike (p.sh. a do të shkruhen me -ë fundore emrat mashkullorë si *ballë, djalë, ujë* etj.), por qenësore është ballafaqimi i gjuhës shqipe me gjuhët e mëdha, veçanërisht me anglishten, në rrafshin leksikor e terminologjik. Në Evropën e Bashkuar, ku synojmë të hyjmë, gjuhët kombëtare duhet të bëhen të pajtueshme në nivelin e aftësive shenjuese e komunikuese. Neve na duhet të përcaktojmë si do të quhen në gjuhën shqipe shumë nocione dhe sende të botës së sotme, qoftë me fjalë shqipe, qoftë me huazime dhe ato të përfshihen në fjalorin e ri normativ pa paragjykitime për burimin, por duke mbajtur parasysh vlerën shenjuese dhe përdorimin.⁶

Për t'u përballuar sfidave të mospërfilljes së normave, madje edhe të kontestimit të përgjithshëm të shqipes së sotme standarde⁷ dhe të globalizimit, gjuha standarde shqipe nuk duhet të lihet në mëshirën e fatit, por nevojitet një planifikim gjithëkombëtar gjuhësor me ndërhyrje të institucioneve shkencore e shtetërore në zhvillimin e saj. Mbështetjen kryesore duhet ta ketë në gjuhën e gjallë popullore, sepse thesari i saj është i pashtershëm.

Në vazhden e këtij planifikimi gjuhësor, më 11 dhe 12 nëntor 2002, me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, në Tiranë u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot". Studiues dhe pedagogë të gjuhës shqipe nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, si edhe albanologë nga diaspora arbëreshe, Italia, ShBA, Hungaria e Bullgaria u mbledhën në këtë Konferencë shkencore për të parashtruar arritjet e studimeve të tyre dhe për të rrahur mendime për çështje të përgjithshme e të veçanta të shqipes standarde, për të sotmen dhe të ardhmen e saj.

"Në Konferencë u shpreh me theks të veçantë shqetësimi për nivelin e pakënaqshëm të kulturës gjuhësore, sidomos në media dhe në përdorimet publike, sepse shpeshherë hetohen: gabime drejtshkrimore, luhatje të theksuara në shqiptimin letrar, përdorime formash gramatikore jonormative, ndërtime jo të rregullta të fjalive. Në mënyrë të veçantë u shpreh shqetësim për përdorimin e tepruar të fjalëve të huaja të panevojshme dhe për ndikime të huaja në ndërtimin e fjalisë, që dhunojnë strukturën sintaksore të shqipes dhe veçantinë kombëtare të saj ..."

Konferenca vërejti se në rrafsh të ndryshme të strukturës së shqipes standarde kanë dalë edhe një varg problemesh të normës, që u bënë objekt i një shqyrtimi të vëmendshëm shkencor në

⁵ Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 31-36.

⁶ Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 20.

⁷ Në këto rrethana, mendimi i shprehur nga disa intelektualë për t'u kthyer prapa në gjendjen e dikurshme të dy varianteve letrare të gjuhës shqipe, del i papërligjur e, për më tepër, do të ngjallte frymën e përçarjes në një kohë, kur kombi shqiptar ka nevojë më shumë se kurrë për bashkim. Shih: Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 38-42.

kumtesat e në diskutimet e kësaj konference me synim që të gjejnë pasqyrim të përshtatshëm në veprat normative përkatëse dhe të gjallërojnë më tej diskutimin shkencor në fushën e teorisë dhe të praktikës së planifikimit gjuhësor të shqipes.

Në fund të punimeve të saj, Konferenca iu drejtua me një thirrje opinionit shoqëror e intelektual shqiptar, institucioneve akademike, universitare e shtetërore. Konferenca shpreh besimin se kjo thirrje do të gjejë miratim e përkrahje të plotë dhe do të nxitë gjithë intelektualët, pedagogët, studiuesit e gjuhës shqipe, shkrimtarët e gazetarët, që me veprimtarinë e tyre ta zhvillojnë, ta pasurojnë dhe ta ngrenë më lart gjuhën shqipe, thesarin më të madh kulturor të popullit shqiptar. Duke u nisur nga konstatimet e sjella, Konferenca u bën thirrje:⁸

Epoka jonë është epokë e ngritjes historike të popullit shqiptar, e pasurimit dhe e forcimit të identitetit kombëtar e gjuhësor. Ta ruajmë e ta modernizojmë gjuhën tonë standarde, sepse ashtu do ta ruajmë e do ta pasurojmë identitetin kombëtar në këtë botë të globalizimit, që aq fort i kërcënon të veçantat etnike kulturore, që, megjithatë, përfaqësojnë pasurinë e planetit.⁹

Në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës të mbajtur më 27 tetor 2004 në Tiranë, në vijim të këshillimeve paraprake dhe në mbështetje të Thirrjes së Konferencës “Gjuha standarde shqipe dhe bota shqiptare sot”, u themelua *Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe*.

Të dy Akademitë, duke pasur parasysh se gjuha shqipe është tipari kryesor i kombësisë shqiptare, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore midis hapësirave e vendeve që flasin shqip përtej ndarjeve administrative-politike, me krijimin e këtij Këshilli synojnë institucionalizimin mbarëkombëtar të kujdesit për shqipen standarde. Ai merret me të gjitha çështjet që dalin në fushën e gjuhës standarde dhe të përdorimit të saj.

Shqipja standarde është varietet mbirajonal, e mirë e përbashkët q[çdo folës i gjuhës shqipe duhet të synojë ta përvetësojë, mjet i domosdoshëm për jetën e qytetëruar në shoqëri demokratike. Zotërimi i saj duhet të jetë objektiv themelor i mësimdhënies dhe synim kryesor i politikës së integriteteve.

Për të qenë të sigurt për zhvillimin e mëtejshëm dhe rolin e saj në jetën dhe kulturën kombëtare në këtë kohë procesesh shoqërore dinamike, politika e përgjithshme ndaj gjuhës shqipe duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet e jetës së saj: rolin afrues shoqëror e kombëtar, përshtatshmërinë optimale për çdo hapësirë shoqërore, begatimin me krijime të reja, hapjen e saj ndaj varieteteve të ndryshme, zhvillimin në kuadër të teknologjive të reja, si dhe raportet ndaj gjuhëve të tjera.

Nevoja e përmirësimit dhe e përditësimit të standardit

Asgjë në botë nuk është absolute, e paprekshme, e papërmirësueshme, e pandryshueshme. Pikërisht edhe zhvillimi i teknikës e i teknologjisë, i shkencës dhe i njerëzimit në përgjithësi mbështetet në përpjekjet që të arriturat e brezave të mëparshëm të përsosë, të përkryejë, të mbindërtojë e të përditësojë gjërat. Çdo herë njeriu ka qenë, është dhe do të jetë në kërkimin e së mirës, së përkryerës, së dobishmes. Nëse gjërat që jepen një herë, nuk ndryshohen kurrë, atëherë jeta dhe çdo veprimtari e njeriut do të ishte e pakuptimtë.

⁸ Thirrje e pjesëmarrësve të Konferencës Shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 12. 11. 2002; Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 6-7.

⁹ Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, SF nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 36.

Fatmirësisht shqipja është një gjuhë e gjallë, në lëvizje e në zhvillim, e aftë t'i plotësojë nevojat e kombit, por që duhet bërë përpjekje ta bëjmë edhe më të aftë të përballet me gjuhët më të zhvilluara të botës. Rrjedhimisht, edhe normat e standardit të saj nuk duhet të jenë “rreptësisht të ndaluara”. Vetëm për gjuhët e vdekura nuk ka nevojë të harmonizohet norma me stadin e zhvillimit të saj, sepse tek ato më nuk ka lëvizje.

Koha ka dëshmuar se zgjidhjet e Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1972) përgjithësisht janë të pranueshme nga shqiptarët. Ka ardhur koha që të diskutohen normat e shqipes standarde nga specialistët e gjuhësisë, duke shqyrtuar e parë jo vetëm ç'është thënë e zgjidhur mirë, po edhe ndonjë gjë që duhet rishikuar për të gjetur zgjidhje më të mirë, porse ato nuk kanë të bëjnë më me themelin e gjuhës letrare të njësuar e të vetme për të gjithë.¹⁰

Në Parimin e 5-të të përgjithshëm të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (Prishtinë, 1974, f. 36) shkruan: “*Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe kurorëzon një etapë të gjatë përpjekjesh për formimin e një gjuhe letrare të vetme e të përbashkët për gjithë popullin shqiptar dhe çel rrugën për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare.*”¹¹

Në parim problemet kudo që hetohen, duhet zgjidhur me dashamirësi, me mençuri, qetë e shtruar. Po të anashkalohen e të mos zgjidhen në kohën dhe në mënyrën e duhur, ato do të shtohen aq shumë saqë çdo përpjekje për zgjidhjen e përnjëhershme “me shkopin magjik” të të gjitha problemeve të grumbulluara prej vitesh mund të dështojë.

Pikësnyimi ynë duhet të jetë që shqipen standarde ta bëjmë të pranueshme e të lehtë për gjithë shqiptarët, pavarësisht nga përkatësia territoriale. Atë duhet ta përvetësojnë me lehtësi jo vetëm gjuhëtarët, por edhe mësuesit, gazetarët, nëpunësit, politikanët, nxënësit e moshave të ndryshme etj. Do të duhej ta bëjmë të lehtë e joshëse për ta mësuar edhe të huajt. Në këtë kuptim, nuk kemi nevojë të përmbysim atë që është arritur deri më tani e të fillojmë nga e para, por të shohim mundësinë e përmirësimit të saj, duke vënë re sidomos problemet e zbatimit, në fakt të moszbatimit të normës.

Në Rezolutën e miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit (Tiranë, 1972) pohohet: “*Kongresi porositi që, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura*”.

“*Kongresi shpreh besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahët me entuziazëm dhe do të frymëzojë arsimtarët, shkrimtarët, punojnësit e shkencës dhe të kulturës, gjithë inteligjencën dhe të gjitha masat punonjëse, që me veprimtarinë e tyre krijuese ta zhvillojnë, ta pasurojnë e ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën tonë letrare kombëtare.*”¹²

Prirja për gegëzimin e shqipes standarde nga njëra anë dhe për hipertoskëzimin e standardit nga ana tjetër janë dy kahe të kundërta, të dëmshme, prapakthyese e të rrezikshme për unitetin e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar.

Shumica e intelektualëve shqiptarë përkrahin mendimin se duhet bërë përmirësimin e mëtejshëm të Rregullave të Drejtshkrimit, duke synuar sidomos mënjanimin e përjashtimeve jo të

¹⁰ Gjovalin Shkurtaj, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2, 2000, Tiranë, f. 39-40.

¹¹ Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 35-36.

¹² *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 27.

pakta, që shoqërojnë shpesh rregullat e përgjithshme.¹³ E dëshirueshme është që rregullat e Drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, sa më përgjithësuese e sa më të lehta në përdorim, që nuk kërkojnë shumë mund e energji në përvetësim.

Duke ndjerë nevojën e vrojtimit profesional e mbarëkombëtar të kësaj çështjeje, më 15-17 dhjetor 2010 në Durrës u mbajt Konferenca Shkencore “*Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*”, e organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike me seli në Tiranë.

Konferenca arriti në përfundimet e mëposhtme:

1) Megjithëse u vendos në një epokë të ngarkuar me ideologji dhe me mungesë të lirisë shkencore, standardi gjatë gjithë këtyre viteve e ka dëshmuar vlefshmërinë e tij.

2) Praktika e përdorimit të shqipes standarde në këto dyzet vjet dëshmon se shqipja, ashtu si të gjitha gjuhët e lëvruara, ka nevojë që t’i nënshtrohet periodikisht një shqyrtimi shkencor lidhur me funksionimin e sistemit në të gjitha segmentet.

3) Është e nevojshme që të shqyrtohen më tej disa rregulla të drejtshkrimit, me qëllim njësimin e tyre dhe shmangien e konflikteve të krijuara si pasojë e zbatimit të dy parimeve të ndryshme njëherësh (atij fonetik dhe atij morfologjik). Në mënyrë të veçantë, drejtshkrimi i zanores -ë ka nevojë për rishqyrtim.

4) Të rishikohet përdorimi i shkronjës së madhe, drejtshkrimi i emrave të huaj të përveçëm, si dhe drejtshkrimi i toponimeve.

5) Leksiku i standardit të shqipes të jetë i hapur ndaj prurjeve nga dialektet, sidomos nga dialekti gegë dhe nga autorët e traditës letrare në këtë dialekt. Të vazhdojë puna për pasurimin e leksikut me krijime të reja sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, si dhe për pastërtinë ndaj huazimeve të panevojshme.

6) Të thellohet puna për begatimin, njësimin dhe kodifikimin e terminologjisë në të gjitha fushat.

7) Në sistemin morfologjik, të rishqyrtohet formimi i shumësit të emrave, për një saktësim të mëtejshëm paradigmatic, duke synuar njësimin dhe shmangien e përjashtimeve të shumta.

8) Të studiohet mundësia e integritit të paskajores gege në standardin e shqipes.

9) Studimet dhe hulumtimet të jenë të hapura edhe në fushën e sintaksës.

10) Nxënja e shqipes në shkollë, në të gjithë hapësirën shqiptare, ka shfaqur vështirësi dhe probleme, ndaj propozohet përmirësimi i kurrikulave, i teksteve, i metodave të mësimdhënies, si dhe aftësimi i mëtejshëm i mësuesve të gjuhës amtare.

11) Në konferencë u shfaqën edhe shumë mendime e teza të veçanta lidhur me standardin dhe me përdorimin e shqipes. Konferenca dëshmon se debati për çështjet e normës së shqipes dhe të përdorimit të saj është një debat pjellor, i cili e pasuron mendimin gjuhësor shqiptar dhe hap perspektiva studimore e kërkimore të domosdoshme për etapën e sotme të zhvillimit të shqipes.

12) Krijimi i Këshillit Mbarëshqiptar për Gjuhën, me statusin e personit publik, mund të jetë një rrugë e mirë për t’u gjetur zgjidhje çështjeve të rëndësishme të politikave gjuhësore, të planifikimit të gjuhës, dhe të strategjisë për zhvillimin dhe mbrojtjen e shqipes.

¹³ Këtë mendim e shprehën të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” mbajtur në Tiranë më 11 dhe 12 nëntër 2002, si: Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve të shqipes standarde*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 41; Emil Lafe, Gjovalin Shkurtaç, Enver Hysa etj.

Komisioni Shkencor i Konferencës vlerëson se në perspektivën e përfundimeve më sipër, duhet vijuar me studime të thelluara për çështje të veçanta, si dhe duhen gjetur mënyrat dhe mundësitë që puna e nisur të vazhdojë në mënyrë periodike, në përputhje edhe me porosinë e dalë nga Kongresi i Drejtshkkrimit, në të cilin u sanksionua kodi normativ i shqipes: “*Struktura e sotme e gjuhës letrare është e hapët e do të mbetet e tillë. Përndryshe zhvillimi i gjuhës letrare do të ndërpritej. Ai që ne quajmë “kristalizimi përfundimtar i normës” në të vërtetë nuk është kurrë përfundimtar, i përjetshëm, statik; ai duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset*”.¹⁴

Siç thotë studiuesja Shefkije Islamaj “konteksti ku funksionon shqipja standarde sot është i ri dhe shumë më i gjerë se dje. Ballafaqimi i kulturës shqiptare me kultura të tjera ka vënë para saj sprovën e vetëqëndrueshmërisë, në të vërtetë ndikimi i drejtpërdrejtë i gjuhëve e i kulturave të fuqishme për të paraqet sfidë të madhe, në rend të parë për leksikon e saj. Pasurimi i leksikut sot paraqitet si njëri ndër problemet kryesore të saj dhe parakupton edhe modernizimin e saj. Ky modernizim duhet të jetë më i madh dhe duhet të jetë i “drejtuar”. Shqipja standarde duhet të modernizohet sepse dhe vetë shqiptarët e shoqëria shqiptare në përgjithësi po modernizohen. Duke qenë ose duke synuar të jetë gjuhë e një kulture të hapur, ajo, duhet të gjejë mënyrat si t’i bëjë ballë kësaj sfide, në të vërtetë, si ta ruajë *identitetin* e saj. Bota moderne, qytetërimi evropian, edhe ndër shqiptarët, hyn përmes gjuhës, përmes elementeve të gjuhës, përmes leksikut të saj”.¹⁵

Leksiku i shqipes standarde është i hapur ndaj prurjeve nga dialektet, sidomos nga dialekti gegë dhe nga autorët e traditës letrare në këtë dialekt. Duhet të vazhdojë puna për pasurimin e leksikut me krijime të reja sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, si dhe për pastërtinë ndaj huazimeve të panevojshme.

Të thellohet puna për pasurimin, njësimin dhe kodifikimin e terminologjisë në të gjitha fushat. Në sistemin morfologjik, të rishqyrtohet formimi i shumësit të emrave, për një saktësim të mëtejshëm paradigmatic, duke synuar njësimin dhe shmangien e përjashtimeve të shumta.

Në nxënien e shqipes në shkollë, në të gjithë hapësirën shqiptare, po shfaqen vështirësi dhe probleme, ndaj gjithandej propozohet të ngritet kultura e gjuhës, të përmirësohen programet mësimore, tekstet shkollore, të përdoren metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të bëhet aftësimi i mëtejshëm i mësuesve të gjuhës amtare etj.

1.8. SHQIPJA NË PROCESIN E GLOBALIZIMIT

Ç’është globalizimi?

¹⁴ Referatet, kumtesat dhe informatat e tjera për këtë Konferencë mund t’i gjeni në faqen elektronike të internetit: <http://albanologjia.com>

¹⁵ Shefkije Islamaj, *Shqipja standarde dhe modernizimi i saj*, Gjuha shqipe 3/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.

Globalizimi si term ka filluar të përdoret qysh nga viti 1944, mirëpo ekonomistët kanë filluar ta përdorin aty nga viti 1981. Disa autorë në vend të termit globalizim parapëlqejnë termin internacionalizim. Termi *globalizim* është përfutur nga emri *glob-i* që ka kuptimin e përmes rruzulli i tokës, lëmshi tokësor, bota. Fjala global (si mbiemër) ka kuptimin: i përgjithshëm, që përfshin gjithçka, tërësor, i plotë. Pra, me globalizim, mund të kuptojmë ndërlidhjen shoqërore, ndërvarësinë, integrimin, ndërveprimin, kontrollimin dhe koordinimin e të gjitha veprimtarive njerëzore në rruzullin tokësor, veçmas në nivelin ekonomik, kulturor, teknik e juridik. Thjesht, globalizimi nënkupton “një botë pa kufi”, që çon botën drejt homogjenizimit, drejt një kulture të vetme globale, ku njerëzit në të katër anët e botës jetojnë, punojnë e mendojnë në mënyrë të ngjashme. Ka autorë që mendojnë se globalizimi është duke krijuar një përzierje midis asaj që është globale (universale) dhe asaj që është lokale (të posaçmes). Shtytjen kryesore dukurisë së globalizimit i dha zhvillimi i teknologjisë, sidomos zhvillimi i teknologjisë së komunikimit dhe informimit. Lëshimi në përdorim i Internetit në fillim të viteve ‘90 të shekullit XX, bëri që bota ta ketë në dorë mjetin me të cilin njerëzit në të katër anët e botës ishin më afër se kurrë më parë me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, bota u bë një hapësirë e vetme për shkëmbime ekonomike, sociokulturore dhe gjuhësore.¹⁶

Në literaturën shkencore janë dhënë përkufizime të ndryshme për globalizimin si dukuri shumëdimensionale. Në enciklopedinë www.wikipedia.org globalizimi (ang. globalization) përkufizohet si: “proces i transformimit të gjërave ose të dukurive lokale a regionale në dukuri globale. Mund të përkufizohet edhe si proces, në bazë të të cilit popujt e botës janë identifikuar në një shoqëri të vetme dhe funksionojnë bashkërisht. Ky proces është kombinim i forcave ekonomike, teknologjike, sociokulturore e politike.”

Në <https://sq.wikipedia.org/wiki/Globalizimi> gjejmë këtë përkufizim për globalizimin: Globalizimi i referohet një dukurie shumëplanëshe ekonomike dhe shoqërore që nisi diku në fillim të viteve '90-të. Termi u fut shpejt në fjalorin e përgjithshëm, duke treguar lidhjen gjithnjë e më të ngushtë midis shteteve nëpërmjet tregtisë në rritje, investimeve, shkëmbimit të informacionit, turizmit, ndikimit kulturor nëpërmjet mediave etj. Globalizimi ka edhe ndikim politik mbi vendet të cilat janë në integrimet ekonomike kryesore në bote, siç janë: Unioni Evropian (EU), Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC), etj.

Ekzistojnë tri forma globalizimi:

1. *Globalizimi i ekonomisë*. Shtetet hapin kufijtë në mënyrë që tregtia dhe investimet midis tyre të rriten.

2. *Globalizimi i kulturës*. Mediat moderne dhe marketingu bëjnë që njerëzit të shohin vazhdimisht të njëjtat programe televizive, të veshin rroba të së njëjtës markë, të dëgjojnë të njëjtën muzikë dhe të rrojnë me të njëjtat ideale në gjithë botën.

3. *Globalizimi politik dhe juridik*. Shteti lidhet gjithnjë e më shumë së bashku në një bashkëpunim politik të detyruar. Jo më pak, rrjeti i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rregullat juridike kujdesen që tregtia e lirë tradicionale të kufizohet.

Ideja për globalizim është e kamotshme, mirëpo për të flitet intensivisht dhe sistematikisht që nga vitet e ‘90-ta të shekullit të kaluar, pra pas falimentimit të sistemit monist të vendeve socialiste të Evropës Lindore. Globalizimi, si pikënisje dhe si bazë, ka konkurrencën dhe

¹⁶ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 17.

mbështetet në shoqërinë demokratike pluraliste, ekonominë e hapur dhe të tregut, duke respektuar edhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Globalizimi zvogëlon rolin e kufijve shtetërorë dhe bashkon tregjet kombëtare në një treg të përbashkët dhe unik botëror. Globalizimi është fenomen kompleks i cili ka efekte të dyanshme. Nga njëra anë, globalizimi është një integrim i kapitalit, i teknologjisë dhe i informatave përtej kufijve shtetëror, me qëllim që të krijohet një treg i madh në botë. Pra, ky fenomen përmban në vete procese të cilat çojnë drejt zvogëlimit të rolit të kufijve shtetërorë dhe të bashkimit të tregjeve kombëtare (shtetërore) në një treg të vetmin global (botëror). Nga ana tjetër, globalizimi akuzohet si një burim i sëmundjeve të ndryshme të shoqërisë bashkëkohore.

Karakteristikat kryesore të globalizimit janë rritja e tregtisë ndërkombëtare, rritja dhe koncentrimi i kapitalit ndërkombëtar, migrimi i popullatës, zhvillimi i teknikës dhe i teknologjisë dhe industrializimi.

Shumë analistë në botë, kur flasin për globalizimin, shpesh potencojnë se globalizimi është një proces human me perspektivë dhe si i tillë është i pashmangshëm. Mirëpo, si çdo fenomen i madh, edhe ai ka dobësitë dhe problemet e veta, që i kategorizon njerëzit në përkrahës dhe kundërshtarë të globalizimit.¹⁷

Përkrahësit, globalizimin e konsiderojnë si një proces të paevitueshëm dhe të pakthyeshëm, dhe që do t'i përfshijë të gjitha vendet dhe të tëra fushat e jetës në bote. Kundërshtarët e globalizimit janë kryesisht nga vendet në zhvillim, ithtarë të proteksionizmit dhe të intervencionizmit. Brenda tyre veçohen disa kategori njerëzore, si për shembull, ekologjistë, feministë, anarkistë, të gjelbrit, neokomunistë, etj. Kundërshtarët, globalizimin e shikojnë meskepticizëm dhe dyshojnë në zhvillimin e ardhshëm ekonomik botëror. Madje, globalizimin ata e konsiderojnë si shkaktarin kryesor të pabarazisë dhe të thellimit të hendekut midis shteteve të zhvilluara dhe të atyre në zhvillim, pastaj të shfaqjes së varfërisë, të papunësisë, të sëmundjeve epidemike dhe të ndotjes së ambientit. 18

Shqipja në rrafshin global

Pas ndryshimeve ekonomike dhe politike që ndodhën në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni në fillim të viteve '90 të shekullit XX, pozita e shqiptarëve ka shkuar drejt përparimit. Pas viti 1991, Shqipëria u fut në procesin e tranzicionit ekonomik dhe politik... Në po të njëjtat procese janë futur edhe shqiptarët e Kosovës dhe ata të Maqedonisë. Por, gjatë viteve '90 të shekullit XX, Kosova është dashur të përfshihet në luftën çlirimtare për liri dhe për krijimin e shtetit, synim i cili u realizua përfundimisht më 17 Shkurt 2008, me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Rrethanat e reja të krijuara në hapësirat shqiptare në Ballkan kanë mundësuar që shoqëria shqiptare të hapet ndaj dukurive të globalizimit dhe të proceseve të tjera të integritimeve evropiane dhe në NATO. Hapja e tregut shqiptar dhe futja e investimeve të huaja, si dhe zhvillimi marramendës i teknologjisë së prodhimit, i medieve dhe i teknologjisë informative kanë krijuar hapësira për përparime cilësore në kuadër të bashkësisë shqiptare. Heqja e barrierave dhe e kufijve, si dhe përmirësimi i infrastrukturës së transportit, po krijon hapësira për komunikim më të afërt midis shqiptarëve. Rritja e komunikimit mund të ndikojë që të futen në përdorim

¹⁷ Dr. Skender Berisha, *Procesi i globalizimit*, në <http://www.scribd.com/doc/12982581/Procesi-i-Globalizimit>.

¹⁸ Dr. Skender Berisha, *Procesi i globalizimit*, në <http://www.scribd.com/doc/12982581/Procesi-i-Globalizimit>.

forma të caktuara gjuhësore, të cilat do të konsiderohen si forma të përbashkëta, apo edhe forma kompromisi, për të gjithë shqiptarët në kuadër të stileve të caktuara të komunikimit, sidomos në kuadër të stileve formale. Bashkëpunimi ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës, ndonëse në nivele jo të kënaqshme, po vjen duke u shtuar gradualisht. Bashkëpunimi në kulturë, në art dhe në shkencë është po ashtu në nivele që lënë për të dëshiruar. Ndoshta përjashtim bëjnë mediat. Digjitalizimi i programeve televizive dhe Interneti kanë krijuar hapësira të përbashkëta për transmetime televizive të programeve në gjuhën shqipe. Pakoja e programeve televizive DigitAlb tashmë është shtrirë në të gjithë hapësirën fizike shqiptare në Ballkan, por edhe në diasporë përmes transmetimeve satelitore.

Nga ana tjetër, shqiptarët dhe institucionet e tyre qeveritare, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë e në Maqedoni, janë duke kaluar nëpër procese të njëjta të integritimeve në BE dhe në NATO. Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, pa përjashtim, u nënshtrohen programeve ekonomike dhe monitorimeve nga FMN-ja, Banka Botërore e Komisioni Evropian... Mund të themi lirisht që edhe shtetet shqiptare janë futur në një proces të rishkallëzimit ose të ripërshtatjes edhe në nivel global, edhe në nivel makrorajonal. Tani do të shohim se si janë duke ndikuar rrethanat e reja në gjuhën shqipe dhe në varietetet e saj dhe cili mund të jetë ndikimi i proceseve të globalizimit në gjuhën shqipe.¹⁹

Një prej dukurive kryesore, e cila lidhet me procesin e globalizimit është rrezikshmëria e gjuhëve për t'u zhdukur. Globalizimi dhe përhapja e anglishtes rrezikojnë shumë kultura dhe gjuhë të popujve të vegjël që të zhduken. Shumë autorë dhe organizata ndërkombëtare botërore, si UNESCO, janë ngritur në mbrojtje të gjuhëve të rrezikuara, duke theksuar se të gjitha gjuhët janë të vlefshme dhe të barabarta dhe që diversiteti gjuhësor është vlerë më vete, ngjashëm me biodiversitetin. Sipas tyre, gjuhët e kanë rëndësinë e tyre të veçantë për njerëzit dhe popujt që i flasin, sepse këto gjuhë janë të lidhura me identitetin, me kulturën dhe me memorien e këtyre popujve dhe çdo përpjekje për t'i shtypur këto gjuhë do të paraqiste gjenocid kulturor, apo "linguicid".

Mbrojtja e gjuhëve të rrezikuara dhe gjuhëve minoritare është bërë politikë gjuhësore edhe në Bashkimin Evropian. Përparimi i teknologjisë së informacionit shihet si një mundësi e mirë që do të ndihmonte në ruajtjen e diversitetit gjuhësor.²⁰

Shqipja që flitet në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni aktualisht nuk është futur në grupin e gjuhëve të rrezikuara. Përjashtim bëjnë variantet arvanitase në Greqi, të cilat në "Librin e kuq të UNESCO-s për gjuhët e rrezikuara" janë futur në kategorinë e "gjuhëve pothuajse të shuara" dhe variantet e arbëreshëve të Italisë, të cilat konsiderohen si gjuhë të rrezikuara. Sa u përket varianteve arvanitase, mund të ndodhë që vendosja e emigrantëve shqiptarë në Greqi, pas vitit 1991, dhe kontaktet e popullatës arvanitase me ta, si dhe përparimi i medieve dhe i Internetit, të kenë ndikim pozitiv në proceset gjuhësore dhe të ndihmojë në ruajtjen e varieteteve arvanitase nga shuarja. **Fakti që shqipja vazhdon të ketë folës të bollshëm burimorë është tregues i qartë se gjuha shqipe nuk ka rrezik që të zhduket.**²¹

Një tjetër dukuri që është e lidhur ngushtë me përhapjen e proceseve globalizuese është Interneti. Mund të thuhet se Interneti ka krijuar një hapësirë të re virtuale, në të cilën është reflektuar i tërë diversiteti dhe variacioni gjuhësor që ekziston në botën reale, ndërkohë që ky

¹⁹ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 25-26.

²⁰ Po aty, f. 42.

²¹ Po aty, f. 26-27.

ndikim shkon edhe më tej, në kuptim të krijimit të formave të reja komunikuese, të cilat nuk janë të pranishme në botën reale. Ndonëse nuk dihen saktësisht se sa gjuhë janë të pranishme në Internet, Crystal-i ka arritur të gjejë mbi 1000.²²

Edhe pse Interneti, nga shumë autorë konsiderohet si mjeti kryesor për përhapjen e anglishtes si gjuhë globale dhe për ndikimin e saj në gjuhët e tjera, megjithatë Interneti ka krijuar domene të reja për përdorimin e shqipes. Komunikimi në rrafshin global ka marrë përmasa të gjera dhe bota shqiptare, e izoluar dikur, tashmë është hapur ndaj vetvetes dhe ndaj pjesës tjetër të botës. Tani nëpërmjet Internetit shqiptarët në cilindo vend të botës që janë po komunikojnë shpesh ndërmjet veti në shqip, por edhe me popuj të tjerë të botës në gjuhë të huaja. Shqipja sot është gjuhë e shumë uebfaqeve në gjuhën shqipe, e e-mail-ave, e forumeve dhe e blog-ave të ndryshëm në Internet, si dhe e rrjeteve sociale, siç janë Facebook dhe Twinter, në të cilat shqipja del në format e saja të shkruara, herë në formë standarde, herë në forma të varieteteve të tjera të shqipes. Shqipja është gjithashtu gjuhë e bisedave e dhomave virtuale (ang. chat rooms), e mesazheve për komunikim të çastit (ang. instance messages) në Skype, Hangouts e Snapchat, e statuseve dhe tweet-ëve (cicërrima në Twinter), te të cilat format e të folurit realizohen aty për aty përmes shkrimit. Përdorimi i shqipes në Internet mbetet një fushë pothuajse plotësisht e paprekur dhe çdo kontribut në këtë drejtim do ta pasurojnë shumë këtë fushë studimore.²³

Përgjithësisht është pranuar se Interneti shihet si një nga mjetet kryesore për përhapjen e proceseve të globalizimit, por edhe të përhapjes së anglishtes si gjuhë globale. Por, nga anat tjetër, Interneti promovon sot një mirëseardhje të gjerë globale për të gjitha gjuhët dhe, mbase, është edhe mjeti kryesor për ruajtjen dhe për përhapjen e diversitetit kulturor e gjuhësor në botë.

Shoqëria shqiptare në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni është duke kaluar nëpër procesin e integrimi lokale, makrorajonale e globale. Rishkallëzimi ose ripërshtatja në fushën politike, ekonomike, por edhe gjuhësore, është proces që vërehet edhe në hapësirat shqiptare. Ky proces karakterizohet nga përpjekjet për promovimin e ekonomisë së tregut të lirë, për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe për integrimet evropiane dhe në NATO. Procesi i rishkallëzimit ose i ripërshtatjes reflekton edhe një prej aspekteve kryesore të ndikimit të globalizimit në proceset gjuhësore. Gjuha shqipe, në përgjithësi, dhe shqipja standarde, në veçanti, janë futur në një proces të rishkallëzimit në kontekste të ndryshme politike, ekonomike e kulturore. Ky rishkallëzim ose ripërshtatje gjuhësore ndodh në tri rrafshje:

- a) në rrafshin vendor, si përshtatje e shqipes me rrethanat e reja shoqërore dhe kulturore;
- b) në rrafshin makrorajonal, si përshtatje e shqipes me integrimet evropiane dhe, në përgjithësi;
- c) në rrafshin global, si përshtatje e shqipes me dukuritë dhe me proceset globalizuese.²⁴

Ndikimi i globalizimit në shqipe nuk mund të shihet ngushtë si ndikim i anglishtes në shqipe që shprehet përmes huazimeve kulturore në formë të huazimeve të drejtpërdrejta, të kalkeve e të huazimeve hibride. Forma kryesore e ndikimit të proceseve të globalizimit dhe të integrimin në shqipe manifestohet me ndryshimin e diskurseve publike, të zhanreve dhe të stileve... Mjafton të analizohen deklaratat e politikanëve, të biznesmenëve, të bankierëve, të përfaqësuesve të medieve dhe në to do të gjejmë përplot fjalë e togfjalësha ...

²² Po aty, f. 68-69.

²³ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 27-28.

²⁴ Po aty, f. 28-29.

1.9. GJUHA SHQIPE NË INTERNET

Interneti në shqipen ka po të njëjtin ndikim, sikurse edhe në gjuhët e tjera. Krahas ndikimit të fuqishëm të anglishtes, ai ka hapur rrugë përdorimit të të gjitha variacioneve gjuhësore standarde, gjysmëstandarde e jostandarde të shqipes. Pra, në Internet gjejmë të gjitha variacionet e shqipes e sotme:

- a) të gjitha ligjërimet e mundshme (formën e folur dhe të shkruar): letrar, bisedor e ligjërimin e shkujdesur;
 - b) të gjitha variantet stilistike: stilin shkencor, administrativ, shoqëror e politik, letrar artistik e stilin fetar;
 - c) të gjitha variantet shoqërore: ligjërimin e grupmoshave e të njerëzve me profesione të ndryshme.
- ç) të gjitha larmitë dialektore, krahinore e lokale e individuale, ndonjëherë edhe në variantin gjysmëdialektor ose një hibrid gjuhësor me një shqipe gjysmake dhe një gjuhe të huaj.

Në përgjithësi, shqipja e Internetit mbushullon me tekste të ligjërimin të shkujdesur, me prirjen e përgjithshme të ekonomisë së gjuhës dhe lehtësimin të ligjërimin (për tiparet e ligjërimin të shkujdesur rilexo tekstin përkatës në leksionin: Ligjërimi i shkujdesur, bisedor dhe ligjërimi libror). Veçmas të rinjtë në shkrimet e tyre elektronike përdorin shkurtesat e tipit: ok = mirë, në rregull; flm = faleminderit, sps = s'ka përse, klm = kalofsh mirë, ntm = natën e mirë etj.

I mbetet shoqërisë shqiptare dhe institucioneve që të fillojnë të mendojnë për politikat gjuhësore, të cilat do të jenë në funksion të rregullimit të këtij procesi të rishkallëzimit ose ripërshtatjes së shqipes në shkallë globale e makrorajonale. Kjo veprimtari do të ishte në funksion të kultivimit të vitalitetit dhe të elasticitetit të normës së shqipes dhe do ta bënte shqipen më të aftë për t'i kryer funksionet e saja komunikuese dhe kulturore në rrethanat e globalizimit.²⁵

Siç dihet, anglishtja është gjuha më dominuese në botë. Globalizimi është rezultat i zhvillimit industrial dhe teknologjik i vendeve perëndimore, sidomos i ShBA-së. Epërsia politike, ekonomike dhe kulturore e ShBA-së, por edhe e Britanisë së Madhe, ka bërë që anglishtja të imponohet si gjuhë e komunikimit masiv në nivel botëror, pra të bëhet një *lingua franca* botërore, ngjashëm me latinishten dikur. Por, për dallim nga kjo e fundit, për shkak të mundësive reale e virtuale për komunikim në rrafshin global, shtrirja e anglishtes i tejkalon përmasat e shtrirjes që kishte latinishtja, apo çfarëdo gjuhe tjetër dikur. Anglishtja është bërë gjuhë kryesore e komunikimit përmes Internetit si dhe midis folësve që për gjuhë amtare kanë gjuhë të tjera.²⁶ Përhapja e anglishtes në katër anët e botës ka për rrjedhojë lindjen e larushive territoriale të anglishtes. Këto “anglishte të reja” janë sikurse dialektet, të cilat i njohim në vendet tona, por që këto “anglishte të reja” janë në shkallë ndërkombëtare, dhe kanë të bëjnë me vende dhe rajone të tëra.

Procesin e përhapjes së anglishtes në dëm të shqipes në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni po e ndihmojmë dhe po e përshpejtojmë edhe vetë ne. Fatkeqësisht, gjithnjë e më tepër

²⁵ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 31.

²⁶ Po aty, f. 33.

po e bjerrim gjuhën e kulturën shqiptare dhe po vrapojmë pas të huajës. Si duket, ne shqiptarët jemi të parët në Ballkan për adhurimin e të huajës. Bie fjala, mjafton të shëtisim nëpër Tiranë apo Prishtinë e të vërejmë e numërojmë sa tabela e mbishkrime lokalesh afariste janë shkruar shqip e sa anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër. Në konkurset për zbulimin e talenteve të rinj në këndim, veçmas në Shqipëri rrallëherë mund të dëgjojmë ndonjë këngë shqipe, meqë shumica janë anglisht ose italisht. Jo pak konferenca albanologjike gjuhë pune, përveç shqipes kanë edhe anglishten. Madje, disa parapëlqejnë që kumtesat e tyre edhe në revistat kombëtare t'i botojnë vetëm në anglisht. Në kriteret e zgjedhjes në tituj mësimorë në universitetet tona, një artikull i botuar në anglisht (me pak faqe, 7-8) në ndonjërin nga revistat ndërkombëtare me faktorin impakt mbivlerësohet aq shumë sa që llogaritet më shumë sesa një monografi a studim i thelluar (prej 200-300 faqesh) të shkruara në shqip.

Një pjesë e konsiderueshme e anglicizmave po futen në shqipe si pjesë e proceseve të globalizimit, ndërsa mediat po shërbejnë si mekanizma kryesorë për futjen e tyre. Anglishtja është duke ndikuar pa përjashtim në të gjitha fushat dhe si rrjedhojë anglicizmat hasen dendur në të gjitha terminologjitë që mbulojnë fushat përkatëse. Teknologjia e informacionit, ekonomia, financat, politika, diplomacia, legjislacioni, sporti, kuzhina, moda, etj. janë vetëm disa nga fushat në të cilat huazimet nga anglishtja janë duke depërtuar në masë të madhe.²⁷ Për çdo vit në shtypin ditor në Kosovë hyjnë mesatarisht rreth gjashtëdhjetë anglicizma.²⁸ Interneti mund të ndihmojë edhe për ruajtjen e varieteteve të rrezikuara të shqipes, siç janë arvanitishtja dhe arbërishtja.

Ja disa anglicizma më të përdorshëm: *bord, grant, inkorporim, menaxhim, subvencion, tender, transparencë, instruksion, auditor, aset, alokim, donacion* etj.

Përkthimi dhe përshtatja nga anglishtja në shqip është njëra nga rrugët e ndikimit të anglishtes në shqipen.

Duhet pasur një politikë të qartë gjuhësore lidhur me mbrojtjen e shqipes nga ndikimi i gjuhëve të huaja, sidomos nga ndikimi që vjen nëpërmjet procesit të komunikimit global. Është e pamundur t'u iket krejtësisht ndikimeve të huaja gjuhësore që vijnë nga gjuhët superiore, sidomos nga anglishtja si gjuhë globale, por mund të merren masa që këto ndikime të jenë të kufizuara, të mos depërtojnë në strukturën e shqipes dhe në njëfarë mënyre të jenë të kontrolluara nëpërmjet mekanizmave të tillë sociolinguistikë, siç janë politika dhe planifikimi gjuhësor.²⁹

²⁷ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 50-56.

²⁸ Shukrane Gërmizaj, *Sfidat dhe rezultatet e kontakteve të shqipes me anglishten*, Studime 20, ASHAK, Prishtinë, 2013.

²⁹ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 172.

KREU II

2. STILET FUNKSIONALE NË GJUHËN SHQIPE

2.1. Ç'ËSHTË STILI E STILISTIKA?

Nocioni qendror i stilistikës është stili. Në traditën e lashtë mijëvjeçare fjala *stil* (gr. *stylos*, lat. *stilus*) ka pasur kuptime të ndryshme. Në lashtësi kjo fjalë shënonte një shkop të vogël që shërbente për të shkruar mbi tabelëzat prej dylli ose në ndonjë material tjetër. Me kohë kuptimi i kësaj fjale ka ndryshuar: nga mjete me të cilin shkruhej (lapsi) kuptimi u bart në materialin që shkruhej (dorëshkrim), ndërsa më vonë e mori edhe kuptimin e mënyrës së të shkruarit.

Sot fjala *stil* përdoret dendur në të gjitha veprimtaritë njerëzore: në të gjitha artet, në gjuhësi, në arkitekturë, në sport, në jetën e përditshme etj. dhe ka shumë kuptime, varësisht nga fusha e përdorimit. Stili emërton një **veçanti** të çfarëdo veprimtarie, që kryhet në trajta të ndryshme. P.sh. *stili i veshjes*, *stili në punë*, *stili i notit*, *stili i të shprehurit* etj. Me termin stil emërtohet veçantia e organizimit të mjeteve të shprehjes: me fjalë (në letërsi e gjuhë), me ngjyra (në artin figurativ), me materie (në artet plastike, arkitekturë), me tone (në muzikë) etj. Thjesht, stili është mënyrë e veçantë: e të folurit, e të shkruarit, e të veshurit, e të kënduarit etj. të një grupi njerëzish apo të një njeriu.

Në art e letërsi stili është përkufizuar si tërësi e veçorive themelore artistike, e mjeteve dhe e mënyrave të shprehjes, që bien në sy në krijimtarinë e një shkrimtari, të një artisti, të një rryme a të një epoke dhe që përsëriten pak a shumë në një sërë veprash. P.sh. *Stili romantik. Stili realist. Stili i arkitekturës popullore. Stili i Naim Frashërit (i Çajupit, i Migjenit etj.)*.

Stili shfaqet si sistem gjuhësor vetjak i një vepre ose i një grupi veprash. Syri vëzhgues arrin të dallojë pikërisht atë *tipar të veçantë*, që është i përbashkët për të gjitha veprat e një autori. Me stil kuptojmë edhe *tiparin e përbashkët*, stilin mbizotërues, që përsëritet në vepra të autorëve të ndryshëm brenda një periudhe latrare. Historia e letërsisë numëron një sërë stilesh, që i përkasin *antikitetit, Rilindjes, romantizmit, modernizmit etj.*

Në gjuhësi me stil nënkuptohet zgjedhja dhe ndërthurja e mjeteve të gjuhës (e mjeteve fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore) në përputhje me kërkesat e një fushe të veprimtarisë. P.sh. *stil bisedor, libror, zyrtar, shkencor, publicistik; stil asnjans; stil i lartë; stil i plotë i shqiptimit etj.*

Stili i të shprehurit është i ndërlikuar jo vetëm se me te del në shesh përkatësia shoqërore, mjedisi ku jeton bartësi i tij, por edhe se me të shfaqen vetitë psikofizike dhe përdorimi i ligjëritimit në fusha të shumta. Stili është i ndërlikuar edhe në të gjitha fushat gramatikore-leksikore si dhe në aspektin stilistik-afektiv. Pra, thëniet kanë vlerë kuptimore dhe vlerë stilistike. Vlerat e tilla mund të tregohen në çdo thënie. Si shembull do të marrim një fjali të shkurtër nga stili bisedor: *Do të vi sonte*.

a) Për të kuptuar këtë fjali na ndihmojnë lidhja e shenjës (përbërjes fonematike) me të shenjuarin (sendin, objektin, nocionin e vëtrët), me ndihmën e tipareve dalluese të fonemave: se $U+n+ë\ d+o\ t+ë\ v+i$ e jo dikush tjetër (ti do të vish; ai, ajo do të vijë, ...) etj. Kështu vijmë te vlera logjike e thënies.

b) Në këtë fjali janë të pranishme edhe tregues fonetiko-morfologjikë të atij që jep këtë informatë. Këto janë vlera ekspresive të thënies. Një pjesëtar i gegërishtes verilindore, të njëjtën fjali do ta thoshte: *Kam me ardh sante*, ose për të shprehur një siguri më të madhe *Erdha sante* (përdor kohën e tashme për të ardhmen); një pjesëtar i gegërishtes qendrore do të thoshte: *Do vaj sonte*; një që belbëzon: *D...d...o...o\ t'..t' v..i..i\ s...o...o... nte* etj.

c) Të njëjtën fjali mund ta themi me qëllim që të ndikojmë te dëgjuesi, që të ngjallim impresion. Çdo thënie ka intensitet, ritëm, melodi dhe intonacion të caktuar. Ritmi dhe intonacioni mund të ndërrohen në pajtueshmëri me gjendjen emocionale dhe me qëllimin e atij që e thotë mendimin. Shprehjen *Do të vi sonte* mund ta themi me zë të lartë, me gjysmë zëri ose me pëshpëritje, derisa edhe me mimikë e gjestikulacion. Theksi i fjalisë mund të qëndrojë në fjalën *do të vi*, por mundet edhe në fjalën *sonte*. Në rastin e parë vihet në pah veprimi, ndërsa në të dytin koha.

Fjalët e kësaj fjalie mund të shqiptohen përnjëherë: *Dot'visonte*; me një pushim (pauzë) në mes: *Dot'vi / sonte*; me pushime të vogla ose të mëdha pas çdo fjale: *Do / të / vi / sonte, Do // të // vi // sonte //* Në çdo fjali fitojmë variant të ri impresiv. Intonacioni ngjites e bën këtë fjali pyetëse: *Do të vi sonte?*, ndërsa intonacioni në fjalët e para zbritës: *Do të vi* e në fjalën e fundit ngjites: *sonte!*, ose anasjelltas e shndërron thënien e njëjtë në fjali thirrmore: *Do të vi sonte!*

Me zgjatjen e zanoreve *Do të viii soonte* mund të arrijmë të tregojmë butësi ose dëshirë të madhe për të ardhur, por edhe ironi.

Shembujt e këtyre tregojnë se çdo thënie (fjalët, fjalitë, periudhat) ka tri vlera:

a) *vlerë kuptimore (logjike apo objektive)*;

b) *vlerë shprehëse (ekspresive)*, dhe

c) *vlerë impresive* (të ngjallim efekte; që të ndikojmë tek ai/ajo që i drejtohem: në mënyrë etike, estetike, humoristike, satirike e të ngjashme, me intensitet, ritëm, melodikë dhe intonacion të caktuar.

Ç'është stilistika dhe si degëzohet ajo?.- Me vlerën logjike a objektive të ligjërimit merret gjuhësia me degët e saja (fonetikën e fonologjinë, morfologjinë, sintaksën, leksikologjinë), *ndërsa me vlerën shprehëse dhe me vlerën emocionale të ligjërimit merret stilistika.*


Gjuha është një oqean i pafund me pasuri e mundësi të pashterrshme, mirëpo aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie te njerëzit është e shumëllojshme. Këto lloje të veçanta të të folurit ose të të shkruarit përbëjnë stilin.

Kumtimin mund ta themi në mënyra të ndryshme. Mënyra se si është transmetuar një kumtim (në bisedat e përditshme, në krijimtarinë popullore, në veprat letrare) mundëson ekzistencën e stilit dhe të stilistikës.

Stilistika (lat. *stilistica*) është disiplinë shkencore që merret me studimin e stilit. Kjo është degë e shkencës së letërsisë, që quhet **stilistikë letrare** dhe degë e gjuhësisë, që quhet **stilistikë gjuhësore**. Këto dy lloje stilistikash kanë ndërmjet veti shumë gjëra të përbashkëta, sepse objekt studimi i të dyjave është *gjuha*, përkatësisht variacioni gjuhësor i ligjërimit. Një përpjekje për të shkruar stilistikën letrare dhe gjuhësore është poetika. Lidhje të ngushtë stilistika ka edhe me retorikën, semiotikën, teorinë e letërsisë, sociolinguistikën, teorinë e komunikimit, psikologjinë, estetikën etj.

Stilistika letrare studion formën e veprave letrare, e vështron gjuhën si mjetin që ndërton formën artistike, shqyrton vlerat dhe funksionet e figurshme, shprehëse, vlerat estetike të gjuhës në përputhje me përmbajtjen e veprës, me gjininë letrare, me botëkuptimin e autorit etj. Stilistika letrare ka si fushë studimi gjuhën e letërsisë artistike; pra, vetëm njërin nga stilet funksionale të gjuhës.

Stilistika gjuhësore studion gjithë ligjërimet (ligjërimin e folur dhe të shkruar; ligjërimin letrar, bisedor dhe të shkujdesur) dhe stilet funksionale të gjuhës (stilin letrar, shkencor, administrativ, politik, shoqëror, fetar etj.), vlerat stilistike të këtyre mjeteve. Stilistika gjuhësore i sheh mjetet e gjuhës nga ana funksionale e shprehëse, duke përfshirë këtu mjetet e gjithë nënsistemeve të gjuhës: të fonetikës e fonologjisë, të gramatikës, të leksikut e të fjalëformimit.



Me fjalë të tjera, në stilistikën letrare gjuha vështrohet si mjet artistik, ndërsa në stilistikën gjuhësore si mjet komunikimi. Sipas stilistit të shquar shqiptar Xhevat Lloshi “fare shkurt do të thuhej se *stilistika gjuhësore studion artin e gjuhës, ndërsa stilistika letrare sheh gjuhën e artit*”. Objekti është po ai, kur është puna për tekstet e letërsisë artistike, vetëm se stilistika letrare duhet të shkojë më tej, domethënë e mbështetur në analizën gjuhësore, do të kalojë te veçantia e ndërtimit të veprës...

Pra, stilistika gjuhësore merret me *organizimin parësor të gjuhës*, si shprehje kolektive; ndërsa stilistika letrare shqyrton *organizimin e dytë gjuhësor* (që ndërtohet mbi organizimin parësor, pa e ndryshuar thelbin e saj), si përdorim individual në veprën letrare, duke fituar gjuha disa cilësi plotësuese shprehëse e emocionale, mbi të cilat ndërtohen modele të caktuara. Këto modele ndryshojnë vazhdimisht

nëpërmjet individualitetit të autorit, që mundësojnë dallimin e stileve. Stili shihet si mënyrë e veçantë shprehjeje që u kundërvihet llojeve ose mënyrave të tjera të shprehjes gjuhësore.

Stilistika letrare synon të shpjegojë funksionin stilistik, duke u mbështetur në fushat e letërsisë: teorinë e letërsisë, veçanërisht në poetikë, metrikë, teorinë e gjinive dhe të llojeve letrare etj.; ndërsa stilistika gjuhësore funksionin stilistik e sheh në këndvështrimin gjuhësor: fonetik, morfologjik, leksikor, semantik e sintaksor, duke krijuar në këto rrafshë njësi bazë të quajtura stilema dhe disiplina të ndërmjetme, si fonostilistikë, morfostilistikë, leksikostilistikë, semantostilistikë dhe sintaksostilistikë.

Rëndësia e stilistikës.- Stilistika e zbatuar ose praktike i përdor arritjet e kësaj disipline për nevojat e kulturës së gjuhës, përkthimit, redaktimit, arsimit, praktikës së përditshme dhe në veçanti për hartimin e fjalorëve.

Aftësia e përdorimit stilistik të gjuhës është pjesë e kulturës dhe e sjelljes së njeriut në shoqëri. Stilistika ka vend të gjerë në punën mësimore. Shkolla jep normën standarde, por ajo duhet plotësuar me punën për të edukuar shijen stilistike, për të njohur visaret shprehëse të shqipes, për të shkruar e folur në përputhje me kërkesat e fushave të caktuara, me rrethanat, me qëndrimin ndaj të tjerëve.

Komenti letrar në shkollë ka nevojë të përmirësohet, duke përfshirë vështrimin e sotëm stilistik, që të zbulohen vlerat artistike të letërsisë shqiptare si arti i fjalës. Stilistika pedagogjike jep një mjet mësimor për gjuhën dhe letërsinë në shkollë. Me një vështrim përgjithësues, stilistika mund të quhet një ndër mjetet për njohjen dhe përvetësimin e arritjeve të kulturës kombëtare në gjuhën shqipe dhe për të punuar e krijuar vetë me mjeshtri.


Pyetje dhe detyra:



1. Ç'është stili?
2. A dallohen nxënësit e klasës suaj për mënyrën e të folurit, e të shkruarit, për veshjen e tyre. Thoni disa tipare të veçanta të tyre!
3. Bëjeni një hartim me shkrim për një temë të caktuar dhe pastaj krahasoni e analizoni stilet e të shkruarit.
4. Të gjithë nxënësit e klasës suaj lexojeni të njëjtën vepër letrare ose shikojeni një dramë apo një film dhe pastaj ritregojeni. A ka secili stil të veçantë të rrëfimit? Në bazë të veçorive të përbashkëta, këtë laramani stilesh përpikuni ta përgjithësoni dhe ta degëzoni në disa grupe.
5. Çfarë vlerash kanë thëniet (fjalët, fjalitë, periudhat)?
6. Çka studion stilistika dhe si degëzohet ajo?
7. Me çka merret stilistika letrare dhe me çka stilistika gjuhësore?
8. Çfarë rëndësie ka stilistika?

2. 2. KARAKTERISTIKAT STILISTIKE TË SHQIPES SË SHKRUAR GJATË ZHVILLIMIT HISTORIK

Në gjuhën shqipe tani është formuar një sistem i plotë stilistik.



Shqipja kishte nisur të përpunohej që në mesjetë. Shkallë të lartë arriti në krijimtarinë popullore, sidomos me këngët epike. Në letërsinë e shkruar mbizotëroi stili popullor, por hetohet edhe një stil i ndikuar nga gjuhët e tjera me traditë të gjatë shkrimi. Përveç veprave në gjuhën e atëhershme shqipe, janë përdorur edhe gjuhë të tjera: ose e tërë vepra është shkruar në një gjuhë më me prestigj ose huazimet (nga latinishtja, greqishtja, turqishtja, italishtja, gjuhët sllave etj.) janë shfrytëzuar si mjete stilistike. Latinishtja mbeti si gjuhë e administratës afërsisht deri në shek. VII, më pas u zëvendësua nga greqishtja e mesme dhe në shek. XII në disa vise edhe nga sllavishtja. Feja ushtrohej latinisht e greqisht, sipas konfesionit të bashkësive fetare. Shkrimet e para shqipe të principatave të Arbrit dilnin nga pena e klerikëve.

Me pushtimin osman u krijua gjendje e re. Autorët e vjetër flasin qartë për nevojën që të ruhet shqipja dhe me veprat e tyre i shërbyen këtij qëllimi. Vijoi edhe përdorimi i gjuhëve të huaja. Për Marin Barletin gjuhë e shkencës si kudo në Evropë ishte latinishtja, ashtu si më pas për Frang Bardhin; kurse për Teodor Kavaliotin gjuhë e shkencës ishte greqishtja. Por, me Gjon Buzukun kemi një përpjekje serioze për të përdorur shqipen në shërbesat fetare.

Rryma e bejtexhinjve shquhet për një amalgamë stilistike, përzierje të shqipes me orientalizma të shumtë. Gjuha dhe poezia popullore dallohej dukshëm nga veprat e tyre për pastërti. Për ruajtjen e pastërtisë së shqipes e ngritën zërin Naimi dhe bashkëkohësit e të tij, që të zinte vend fjala shqipe edhe në shtresën poetike, meqë ajo ishte e aftë për vlera artistike.

a) Veçoria e parë e sistemit stilistik të shqipes së shkruar është se nuk ka trashëguar drejtpërdrejt ndonjë stil nga nëna e saj (siç kishte ndjekur italishtja traditën latine, gjuhët sllave traditën e sllavishtes kishtare; greqishtja e re dhe e mesme nga greqishtja e vjetër etj.).

Në shekullin XIX nisi përpunimi i vetëdijshëm i varianteve letrare. Gjatë Rilindjes u zbuluan mundësitë e mëdha shprehëse të shqipes. Në këtë periudhë kemi larmi shkrimesh: a) dialektore, b) shkrime të përpunuara me përzierje dialektore, si dhe c) një gjuhë të folur të përpunuar.

b) Veçori e dytë është se me Rilindjen zë fill një gjuhë e re nga pikëpamja stilistike. Po ata rilindës shkruanin vepra letrare, publicistike, libra shkollorë e vepra fetare. Përpunohet stili i veprimtarisë shoqërore e politike, nis letërsia kombëtare, bëhen përpjekjet e para diturore.

c) Tipari i tretë i rëndësishëm i sistemit stilistik të shqipes është se ai u formua si rrjedhojë e proceseve të brendshme gjatë shekujve XIX e XX dhe vazhdon edhe sot. Hap pas hapi u zgjeruan edhe kontaktet me gjuhët e tjera të përpunuara.

ç) Karakteristikë tjetër është se përpunimi i stileve ka ecur përpara. Pas Pavarësisë së Shqipërisë (1912) u përpunua stili zyrtar, e sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Më 1908 u përcaktua alfabeti i sotëm i shqipes, më 1972 u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të shqipes etj.

d) Një tjetër tipar i sistemit stilistik të gjuhës shqipe është se, ndryshe nga disa gjuhë të tjera (si në frëngjishte, rumanishte etj.), në shqipen nuk ka pasur ndonjë shkëputje të madhe ndërmjet gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar.

Dallimi i stileve dhe i ligjërimeve është degëzim i gjuhës për ta bërë më të aftë që t'u përgjigjet kërkesave të shumanshme të kombit.



Pyetje dhe detyra:


1. Çka studion stilistika letrare?
2. Cilat janë karakteristikat stilistike të shqipes së shkruar gjatë zhvillimit historik?
3. Lexoni fragmentet e mëposhtme letrare dhe vëreni organizimin individual të gjuhës së shkrimtarëve:

“Një muaj pas kësaj bisede, të cilën ne e riprodhuam tërësisht, Koçua ishte vluar dhe martuar. Me sa duket, përpjekjet e zonjës Tanë nuk qenë kush e di çë, mbasi asnjë vështirësi apo kundërshtim nuk i erdhi asaj prej çiftit të ri, të cilin në Shqipëri s’e pyet njeri fare për bashkimin e tyre e as i merr mendimin, as ngatërresa pati për punë të pajës, që është krejt e huaj për zakonet e vendit. Këtu gjëria martojnë bijat e tyre për të punuar nd’arë, ashtu si gjetkë i martojnë vetëm e vetëm për para. Në asnjë vend njerëzit nuk martohen vetëm për t’u martuar. Të kërkosh këtu dashurinë e vërtetë është njësoj sikur të kërkosh yjet në mesditë ...” (Çajupi “Besa-besë”)

“Nata kësi hovi po ikën shpejt. Tepër shpejt. E rrugëdalja ende s’po gjendet ... Ç’duhet bërë. – Nga ana tjetër, njerëzit të lodhur, të stërlodhur. Shumë prej tyre, veç sa bëjnë hije. Pos kësaj – halucinacionet! Ato ende nuk prajnë. Por ç’është më zi, marrin një hov edhe më të shqetësueshëm: luftarët prej në strajcat dhe përtypin copat duke i marrë si gjëra për ushqim – ngrohen kinse pranë kaçubave të ngrira – renditen nëpër shtëpi të imagjinuara – ndajnë ushqimin prej kazanëve që kurrkund s’janë ...” (Hivzi Sulejmani “Era dhe kolona”)

“Një çikës më vonë, vuri re se fytyra e saj e pastër si një shkëlqim mëngjesor, rrezatonte mirësi ëngjellore, sytë i llamburisnin hijshëm, i tërë shpirti kishte dalur në trupin e saj. Në zërin e vet ndjeu turp. Edhe tash vërejti se syçkat e saj të shplara nga çdo djallëzi me një palë rrezesh gazmore rrihni shlirshëm karshi qiellit. Fshiu tullën me dylben të bardhë dhe foli:

- Ta marrë e mira, të flamosurën, hëm! Kundër fatit gërmues vihesh në pozitë të luftosh me shpirtin tënd të pastër si drita e ditës, hëm! – arsyetoi ai ndjenjën e nervozizmit të tërbuar para Afshës, e cila vinte për të vënë kontakt me sheh Sadikun, lidhur me rrethanat tragjike të kalendarit të shpallur “Kriminel të dyfishtë”. Sikur ma ndjeu zemra këtu në gji rishtakimin, hirdashur! – ndërroi pllakën Kasum Sahiti dhe mbi harkun e dhëmbëve të fortë e të gjatë si të peshqenit, përgjysmë artificiale, ranë dy buzët e tij me një fill të ftohtë të gazit. – Unë me zemër, të tjerët me topa, zonjushë! Atij që ia jep gishtin, ta rrëmben dorën! Në daçi të dini, e mirëz, tash s’jam as në tokë as në qiell! – vazhdoi ai edhe pse një bisedë e këtillë s’kishte vend ...” (Murat Isaku “Rrengu”)



2.3. STILISTIKA GJUHËSORE

Stilistika gjuhësore studion gjithë ligjërimet (ligjërimin e folur dhe të shkruar; ligjërimin letrar, bisedor dhe të shkujdesur), stilet funksionale të gjuhës (stilin letrar, shkencor, administrativ,

politik, shoqëror, fetar etj.) dhe vlerat stilistike të mjeteve gjuhësore. Stilistika gjuhësore i sheh mjetet e gjuhës nga ana funksionale e shprehëse, duke përfshirë këtu mjetet e gjithë nënsistemeve të gjuhës: të fonetikës e fonologjisë, të gramatikës, të leksikut e të fjalëformimit.

Stilistika gjuhësore tani është shumëdegëshe, përbëhet nga tri pjesë të lidhura midis tyre: 1) *stilistika e përgjithshme*, 2) *stilistika përshkruese* dhe 3) *stilistika krahasuese*.

Stilistika e përgjithshme studion natyrën stilistike të gjuhës në përgjithësi, kushtet gjuhësore e jashtëgjuhësore të stileve të gjuhës etj. Stilistika përshkruese paraqet anën stilistike të një gjuhe konkrete dhe të teksteve në atë gjuhë. Ajo përfshin a) *stilistikën e shprehësisë*, b) *stilistikën funksionale* dhe c) *stilistikën e tekstit*.

Stilistika e shprehësisë studion mjetet stilistike të gjuhës në të gjitha nivelet e saj: mjetet fonetike (që i studion fonostilistika), mjetet morfologjike (morfostilistika), sintaksore (sintaksostilistika), mjetet e leksikut (leksikostilistika) dhe mjetet kuptimore (semantostilistika). Për këto u bë fjalë në krerët përkatës.

Stilistika funksionale studion sistemin e ligjërimeve (ligjërimin e folur e të shkruar), sistemin e stileve (stilin shkencor, administrativ, politiko-shoqëror, publicistik, artistik-letrar, fetar, stilin bisedor) dhe regjistrin e gjuhës.

Stilistika e tekstit studion thëniet e plota me shkrim ose me gojë, ndërsa *stilistika krahasuese* merret me studimin krahasimtar të organizimit dytësor të gjuhëve të ndryshme.

Në këtë kapitull do të bëjmë fjalë për disa çështje themelore të **stilistikës funksionale**. Stilistika funksionale në plan të parë i vë stilet funksionale, të cilat në fillim vështroheshin si shprehje strukturore e funksionimit të gjuhës (komunikative, estetike etj.), ndërsa më vonë si variante gjuhësore të kushtëzuara nga specifikat e aktivitetit dhe të komunikimit në një fushë të veçantë shoqërore (në jetën e përditshme, në art, në shkencë, në jetën shoqërore-politike e të ngjashme). Gjuha ka mjete shprehëse të pakufizuara që na mundësojnë të merremi vesh me njerëzit e tjerë varësisht nga situatat, rrethanat në të cilat gjendemi dhe në pajtueshmëri me qëllimin tonë.




Pyetje dhe detyra:

1. Cila është lënda e stilistikës gjuhësore?
2. Si degëzohet stilistika gjuhësore?
3. Cilat janë degët e stilistikës përshkruese dhe thoni çka studiojnë ato?


2.4. SHQIPJA STANDARDE DHE SISTEMI I STILEVE

Gjuha shqipe tashmë është formuar si gjuhë letrare kombëtare e njësuar ose si standard i përgjithshëm me norma të ngulitura në të gjitha nënsistemet e saj. Ajo ka arritur në këtë shkallë në një rrugë të vështirë e të gjatë, duke i bërë ballë ndikimit të huaj asimilues, duke



kapërcyer ndarjen dialektore dhe duke zhvilluar trajtat e saj të përbashkëta.

Gramatika përshtuese e sotme për standarde (letrare) në përdorimin asnjës, gjuhësore dhe normat themelore që marrëdhëniet e tyre; ndërsa stilistika shumta gjuhësore, larushitë gjuhësore, Ngulitja e gjuhës standarde, që ka një të kodifikuar, ka mundësuar që të dallohen stileve: ngjyrimet e konotacionet, historikja, norma standarde nga krahinorja nga të shkruarit. Kemi një shumësi të gjuhësore që janë pasuri shprehëse të përdoren për sajimin e stileve.



objekt studimi ka gjuhën d.m.th. gjithë mjetet përcaktojnë studion realizimet e përkatësisht stilet. rrafsh të gjerë asnjës më qartë sistemi i bashkëkohorja nga e zhargonet, të folurit madhe burimesh shqipes dhe që mund të

Njëjtësia dhe variacioni

sotme është një tërësi variantesh historike, territoriale e shoqërore. Gjuha standarde (letrare) është varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të civilizimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar. Ajo është bërthamë me strukturë të qëndrueshme, ndërsa realizimet e saj historike e të sotme janë variante. Variacioni është i nevojshëm për vetë ekzistencën e gjuhës. Tipat e varianteve dallohen për arsye të ndryshme.

gjuhësor.- Shqipja e

a) Arsyeja e parë e laramanisë është **ndryshimi historik** i gjuhës në rrjedhë të kohës: ilirishtja – shqipja e vjetër – shqipja e mesme – shqipja e re. Kështu, shqipja arkaike ose protoshqipja njëjtësohet me ilirishten. Shqipja e vjetër vjen deri në shek. VIII-IX, kur ishin degëzuar dy dialektet e saj kryesore. Shqipja e mesme vjen deri në shek. XVII dhe quhet arbërishte. Me librin e Gjon Buzukut më 1555 na shfaqet si variant kryesor gjuha e autorëve të vjetër. Shqipja e re nga shek. XVIII e deri në ditët tona tashmë njihet me emrin gjuha shqipe, ku dallohen tri faza: 1) faza e pararilindjes, 2) ajo e Rilindjes (afërsisht periudha midis viteve 1820-1920) dhe 3) faza e shqipes së sotme (pas vitit 1920 e deri më sot). Shqipja mund të degëzohet edhe në periudhën parakombëtare (që nga Buzuku – shek. XVI) dhe në periudhën kombëtare (nga Rilindja e këtej).

b) Arsyeja e dytë e variacionit gjuhësor është **përhapja gjeografike**: degëzimi dialektor i gjuhës. Variantet krahinore ose dialektet e shqipes kanë ndryshime kryesisht në fushën e fonetikës e të fonologjisë, pjesërisht në gramatikë e në leksik. Arbërishtja e shqiptarëve të Italisë në këtë vështrim është variant gjeografik e historik. Gjuha letrare është një variant kundrejt dialekteve. Dialektet përballë gjuhës standarde janë të papërpunuara në shkallë normative e kulturore.

Në rrethanat e lëvizjeve të mëdha ose të jetesës në mjedise shumëgjuhësore lindin edhe ndërndikime (interferenca) gjuhësore. Sot ka larushi të shqipes, të ndikuar nga gjuha joshqipe e mjedisit (shqipja në Greqi, Itali, Turqi, ShBA, Rumani, në ish-Jugosllavi etj.).

c) Arsyeja e tretë për variacion gjuhësor është **forma e folur** dhe **e shkruar e gjuhës**. Gjuha lind dhe jeton në radhë të parë si gjuhë e folur, në trajtën gojore. Në një shkallë të caktuar zhvillimi të kulturës lind shkrimi, kështu që krahas variantit të folur, krijohet edhe varianti i shkruar i gjuhës.

ç) Arsyeja e katërt e larmisë gjuhësore lidhet me faktin se ka **grupe të ndryshme shoqërore e profesionale**, që dallohen nga përdorimi i gjuhës. Përveç përdorimeve të përgjithshme, ka edhe *variazione individuale* (idiolekte).



Ligjërimi nuk është aktualizim i thjeshtë i sistemit të gjuhës, por ai realizohet në kohë, në hapësirë e në kushte të caktuara historike-shoqërore nga individët. Ai është i shumëllojtë. Në të pasqyrohen: përkatësia shoqërore, mjedisi gjeografik, shkalla e arsimimit, temperamentit, karakteri, dëshira, d.m.th. një sërë faktorësh shoqërorë e psikofizikë që ndikojnë në të folurit tonë. Një njeri flet sot shqip: ose në gjuhën standarde, ose në dialekt, ose në gjysmëdialekt në një fushë veprimtarie (në biseda të zakonshme, në shkencë, në letërsi, në politikë, në fe etj.) me njerëz të ndryshëm (me anëtarë të familjes, shokë, nxënës, shkencëtarë, administratorë etj.) për ndonjë qëllim të caktuar.

Sot gjuha standarde shqipe, - si varianti më i plotë, më i përpunuar dhe me prestigjin më të lartë kulturor e shoqëror, - del në rrafshin mbarëkombëtar, ka përhapje në tërë kombin, ajo përdoret si nga shqiptarët brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë kufijve të saj.

Njëjtësimi gjithëkombëtar i gjuhës është i domosdoshëm. Prania e këtyre dy prirjeve të kundërta: *njëjtësisë* dhe *variacionit* është forcë lëvizëse e zhvillimit dhe e lëvrimit të gjuhës. Gjuha standarde merr përsipër rolin historik për t'iu përgjigjur kërkesave të unitetit e të variacionit. Nga njëra anë, ajo synon një normë sa më të ngulitur e më të përgjithshme; nga ana tjetër, ajo shfaqet me një sistem tërësor variantesh ligjërimore e funksionale. Vendosija e normës standarde sjell ngadalësimin e ndryshimeve strukturore, sidomos në fonetikë e morfologji. Ndryshimi e pasurimi bëhen sidomos në leksik, fjalëformim, semantikë e sintaksë; por këto përcaktohen nga kërkesat e stileve.

Para përgjithësimit të shqipes standarde kishin rëndësi raportet ndërdialektore, përkatësisht variantet letrare mbi bazën e dialekteve. Në etapën e sotme, kur kemi një gjuhë të njësuar standarde në gjithë kombin, rëndësi më të madhe kanë *shtresimi social e stilistik i gjuhës* (arsyeja e katërt e larushisë gjuhësore).

Sistemi stilistik si arsye kryesore e laramanisë së shqipes.- Sistemi stilistik është sot shfaqja themelore e **variacionit** të gjuhës dhe atij i përket e ardhmja, si zgjidhja më e përshtatshme për laramaninë gjuhësore. Përpyekjet për të krijuar përsëri gjendjen me shumë variante letrare janë prapakthyese (regresive).

Siç dihet, të gjitha mjetet që zotëron gjuha nuk kanë të njëjtën vlerë për tërë shoqërinë: disa mjete janë të përgjithshme e përdoren prej kujtdo e në çdo veprimtari, mjete të tjera janë më të kufizuara, përdoren në fusha të caktuara. Le të krahasojmë disa copa (sipas Xhevat Lloshit, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999):

a) “Këto *sekrete na ranë në dorë* dhe ne, në kundërshtim me tradhtarin, i japim të drejtë çdo qytetari t’i mësojë dhe t’i gjejkojë. Por më parë se *ta vëmë në korrent publikun* për këto sekrete, duhet t’i themi se qëllimet e tradhtarit në *konferencë* janë një gjë dhe *natyra e sekreteve* është një gjë tjetër. Qëllimet e tradhtarit të gjithë i dinë, dhe këto mund të përmbliidhen kështu: Tradhtari, *vegël e ndyrë*, përpiqet të përçajë popullin, që po bëhet kërcënues për armikun, për tradhtarin dhe për tradhtarët ...” (Shtypi)

b) “Nga kreshta e lartë e Tomorit u derdhën mbi lëndinat e Myzeqesë rrezet e vakëta të diellit vjeshtuk. Marinëzat, anës tragës së qerres, që pikëlonin vesë mbi tokën qull, filluan të avullonin e të fshiheshin nëpër avujt e tyre. Ugaret e shplodhur tërë atë natë vjeshte morën frymë thellë dhe firoma e brazdave i dha jetë fushës së përgjumur... (J. Xoxa)

c) “Ishte mos na ish, na qe një njeri, na dolli një ditë për gja, tek gjuante na vrau një sorkadhe. Si e vrau, i rrjepi lëkurën edhe na e mori edhe mishtë e sorkadhes e futi në një gllofkë dhe e mbuloi me fletëra, që të vinte tjetër herë ta marrë...” (Folklor shqiptar)

ç) “Marrëdhëniet e punës së punëtorit në punë te njerëzit punonjës, të cilët e kryejnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë me punë personale, me mjete në pronësinë e qytetarëve dhe të personave të tjerë fizikë dhe civilo-juridikë (më tutje: punëdhënësi), rregullohen me kontratën kolektive në pajtim me këtë ligj dhe me merrvëshjen shoqërore.” (neni 3 nga Ligji mbi marrëdhëniet e punës)

Pasi i lexojmë këto copa, jemi në gjendje t’i dallojmë jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga gjuha: nga fushat e veprimtarisë që u përkasin dhe nga stili. Kështu, copa a) është pjesë nga një pamflet politik, ku goditet figura e tradhtarit; copa b) është një përshkrim letrar, fragmenti c) është pjesë e folklorit, kurse teksti ç) është nen i shkëputur nga një ligj mbi marrëdhëniet e punës.

Siç shihet edhe nga fragmentet e sjella, ai që flet ose që shkruan zgjedh nga gjithë pasuria gjuhësore ato që janë më të përshtatshme për fushën e veprimtarisë. Nuk duhet menduar që këto mjete janë krejt të veçanta e të ndryshme, që gjuha e një romani, p.sh., nuk ka asgjë të përbashkët me gjuhën e një veprë shkencore.

Përkundrazi, **pjesa kryesore e mjeteve gjuhësore është e përbashkët për të gjitha fushat**, për të gjithë folësit e dëgjuesit, pra është *stilistikisht asnjansë*. Kështu, sistemi i tingujve, shumica e fjalëve dhe e formave, llojet kryesore të fjalive etj. janë të përbashkëta si për letërsinë artistike, ashtu edhe për fushën politiko-shoqërore, si për shkresat zyrtare, ashtu edhe për ligjërimin bisedor.

Sistemi i mjeteve, të zgjedhura nga përmbajtja e nga vlera shprehëse dhe të përdorura në përshtatje me fusha të caktuara të veprimtarisë shoqërore, përbëjnë *stilin gjuhësor*. Ky quhet edhe *stil funksional*, sepse është shfaqje e funksionit të veçantë që merr gjuha standarde në një fushë të caktuar.

Për të kuptuar degëzimet dhe funksionet shoqërore të gjuhës standarde (letrare) është e nevojshme të studiohen tri çështje: 1) mjetet me vlerë stilistike në gjuhën shqipe (për to u bë fjalë në disa tema të mëparshme), 2) ligjërimet në gjuhën shqipe dhe 3) stilet funksionale në gjuhën shqipe.

Zhvillimi dhe përpunimi i ligjërimeve e i stileve është drejtimi kryesor i përparimit dhe i lëvritit të gjuhës shqipe. Stilet janë shfaqje e kulturës kombëtare, pasqyrojnë kompleksitetin shoqëror dhe ndihmesën e të gjithëve, brenda e jashtë Shqipërisë, që nga folësit e rëndomtë e deri te lëvruarit dhe mjeshtrit e shquar. Lindja e përpunimi i stileve bëhet i mundur në kornizën e variacionit të përgjithshëm gjuhësor.

2.5. PËRDORIMI I SHQIPES NË LIGJËRIME

Në modelimet gjuhësore veprojnë shumë faktorë jashtëgjuhësorë (kushtet e komunikimit, format e komunikimit, sferat e veprimtarisë shoqërore etj.) dhe faktorë gjuhësorë (funksioni mbizotërues i komunikimit, norma ose qëndrueshmëria e përdorimit të gjuhës etj.). Këta faktorë mundësojnë ndarjen e parë të madhe në:

I. stile ligjërimore ose ligjërime, dhe

II. stile funksionale.

I. Ligjërimet kanë dy variante kryesore: **ligjërimin e folur** dhe **ligjërimin e shkruar**. Varësisht nga shkalla e zbatimit të normave standarde, dallohen:

- 1) *ligjërimi libror*, si shkalla më e rreptë e zbatimit të normës;
- 2) *ligjërimi bisedor*, në gjuhën e folur me respektimin relativ të normës standarde, dhe
- 3) *ligjërimi i shkujdesur (ligjërimi i thjeshtë)*, që del jashtë normës, sepse e shkel dhe e shtrembëron atë.

II. Funkcioni dhe përshtatja e ligjërimin sipas veprimtarive njerëzore është kriter për dallimin e pesë **stileve funksionale**:

2.5.1. LIGJËRIMI I FOLUR

Të folurit dhe shkrimi janë dy forma të veçanta të realizimit të një gjuhe të vetme. Ato nuk respektojnë kurdoherë rregulla të njëjta, që do të thotë se gjuha e shkruar nuk është paraqitje besnike e gjuhës së folur. Të folurit rëndom është i lidhur me kohën (momentin e të folurit), me mjedisin natyror në të cilin zhvillohet si dhe me pjesëmarrësit në komunikim. Ai nismën e ka në trurin e njeriut, ku konceptet e realitetit lidhen me imazhin tingullor.

Gjuha e folur përbëhet nga elementet tingullore (fonemat), theksi i fjalës dhe i fjalisë, rrokja, ritmi, intonacioni, pauzat, melodia etj. Njerëzit kanë filluar të flasin qyshkur ekzistojnë, por më vonë kanë filluar të shkruajnë. Gjuha e shkruar ka filluar me vizatime, me gdhendje në gurë, në pllaka argjili ose në lëvore drunjsh etj.

Gjuha e folur ka qenë dhe është parësore për gjuhët e gjalla. Para ngulitjes së normës standarde mbizotëron të folurit dialektor. Variantet e mëparshme letrare të shqipes mbi bazë dialektore janë tërhequr. Edhe para formimit të gjuhës letrare janë lëvruar mjetet shprehëse në komunikimin shoqëror. Gjuha e ruajtur në gojën e popullit është një enciklopedi e gjithë jetës së popullit tonë. Thëniet e gdhendura të kanuneve, krijimtaria gojore popullore janë shfaqje e mirëfilltë e përpunimit stilistik. Shkrimet mbidialektore paraprijnë kërkesën për një gjuhë unike. Formimi i gjuhës standarde krijon një gjendje të re, por nuk e njëtrajtëson përfundimisht gjuhën.

Forma themelore e kumtimit gojor të drejtpërdrejtë është *dialogu*. Komunikimi bëhet i njëkohshëm, i drejtpërdrejtë dhe zhvillohet ndërmjet dy ose disa bashkëbiseduesve. Sa më i njëkohshëm është komunikimi, aq më tepër merr natyrë bisedore, dhe anasjelltas, sa më e larguar të jetë dhënia nga marrja, aq më tepër shkojmë drejt ligjërimin libror. Folësit zakonisht janë pak veta: sa më tepër rritet numri i tyre, aq më tepër forcohet prirja drejt normës së përgjithshme. Në të folur njerëzit shfrytëzojnë gjestet, mimikën, intonacionin, tonin e zërit si mjete ndihmëse të komunikimit.


Folësi hyn në bisedë zakonisht pa përgatitje paraprake. Koha për të formuluar thëniet ose përgjigjet është e shkurtër. Ai duhet të jetë i kuptueshëm aty për aty. Gabimet, paqartësitë e ngatërrimet mund të ndreqen po aty. Folësi përpiket ta tërheqë vëmendjen e bashkëbiseduesit. Ky është një komunikim i plotë dhe spontan.

Rrjedhojë e gjithë kësaj është se në këto rrethana nuk ndjehet nevoja për përpikëri të lartë aktualizimi të normës gjuhësore. Norma zbatohet në mënyrë elastike, me disa lëkundje, pa kufizime të ngushta. Ligjërimi i folur është plot me ton emocional dhe me vlerësime subjektive, por ka edhe përpjekje për të arritur epërsi përmes fjalës, si në një ndeshje.

2.5.2. LIGJËRIMI I SHKRUAR

Ndryshe nga shoqëritë primitive, të cilat kanë si mjet komunikimi vetëm gjuhën e folur, shoqëritë e qytetëruara kanë në dispozicion edhe një mjet tjetër për shkëmbimin e masazheve verbale: shkrimin. Shkrimi është mënyrë e paraqitjes vizuale e të folurit. Për dallim nga të folurit, shkrimi është statik dhe ka karakter të qëndrueshëm. Ai është sistem i organizuar shenjash grafike për shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave të njerëzve. Gjuha e shkruar ka jetë të gjatë, lë gjurmë dhe kjo gjë mundëson që asaj t'i qasemi kur të duam e si të duam.

Përparësia e gjuhës së folur nuk duhet të shpjerë në përfundimin se shkrimi është i parëndësishëm. Kujtesa njerëzore nuk është e përjetshme dhe nxënësia e trurit është e kufizuar. Këto kufizime i ka shmangur shkrimi, duke kapërcyer hapësirat dhe kohërat. Edhe mjetet e sotme për regjistrimin dhe transmetimin e gjuhës së folur, si filmi, radioja, magnetofoni dhe televizori, nuk e kanë zbehur aspak rolin e shkrimit në shoqërinë moderne. Me anë të shkrimit që nga fillimi, tani e në të ardhmen përvoja e njerëzimit, dituria, arti etj. barten e zhvillohen pandërprerë. Shumë më vonë sesa shkrimi, mjetet e ndryshme audioteknike (si magnetofoni, kasetofoni etj.) kanë mundur që edhe gjuha tingullore të ketë vlerë të qëndrueshme kohore dhe mundësi për përdorim të shumëhershëm. Por, në radhë të parë, qëndrueshmëria e gjuhës së shkruar mundëson të njihemi me kulturën dhe me trashëgiminë e shkruar të njerëzimit dhe popujve të ndryshëm gjatë historisë.



Në dallim nga ligjërimi i folur, komunikimi nëpërmjet shkrimit nuk është as i njëkohshëm e as i drejtpërdrejtë. Shkruesi mund t'i drejtohet një njeriu, po edhe një numri të pacaktuar marrësish, që nuk janë aty. Edhe te ligjëruesi edhe te marrësi mungojnë reagimet e drejtpërdrejta, nuk mund të shfrytëzojnë as gjestet e as mimikën. Të gjitha këto mungesa duhet të kompensohen me mënyra gjuhësore.

Në ligjërimin e shkruar ka kohë të gjatë të mendohet ajo që thuhet, të zgjidhet forma e shprehjes, të rishikohet ajo që është thënë, të ndreqet e të rregullohet.

Shkrimi në thelb është një monolog.- Ligjëruesi detyrohet t'i thotë gjërat në mënyrë të renditur mirë, pa gabime, që të mos e kuptojnë ndryshe. Nga ana tjetër, ai e di se teksti do të lexohet nga një

tjetër me vëmendje më të madhe sesa kur dëgjon diçka të folur. Marrësi është më kritik, mund t'i rikthehet leximit, madje t'i shfrytëzojë të metat e shkrimit. Pra, si nga dhënësi, ashtu edhe nga marrësi në ligjërimin e shkruar i kushtohet vëmendje e veçantë formës së shprehjes, përpunimit të saj.

Ne të gjithë flasim gjithë ditën e për tema të ndryshme, ndonjëherë të parëndësishme, por nuk shkruajmë të gjithë e më rrallë shkruajmë sesa flasim. Shkruajmë për gjëra më me rëndësi dhe më të ndërlikuara. Emocionet tona në të shkruarit janë të përmbajtura, nën kontrollin e arsyes.

E gjithë kjo kërkon një përpikëri më të lartë të zbatimit të normës gjuhësore. Prandaj, procesin e kristalizimit të normës gjuhësore e udhëheq kurdoherë gjuha e shkrimit. Gjuha e shkruar detyrohet t'i japë në mënyrë grafike anët e pasura të gjuhës së gjallë. Detyra e një aktori, p.sh., është ta rigjallërojë tekstin e shkruar me atë që ka humbur kur është hedhur në letër.

Shkalla më e lartë e shfaqjes së gjuhës së shkruar është ligjërimi libror. Në këtë ligjërim, norma letrare ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera: karakterizohet me trajta të plota, me ndërtime të ndërlikuara dhe me mendime të arsyetuara e të thelluara.

Ligjërimi i shkruar në trajtën e tij më të lëvruar përfaqësohet në tekstet shkencore dhe në një pjesë të letërsisë artistike e të publicistikës. Në tekstet mësimore, në shkrimet për kulturën e përgjithshme, në tekstet shtetërore-administrative, po edhe në publicistikë, letërsi etj. për nga zbatimi i normës standarde gjejmë shkrime që i përkasin ligjërimin libror, por ka të tilla që i përkasin ndonjë ligjërimi më të ulët. Ngritja e nivelit gjuhësor të tyre do të ndihmonin për shtrirjen e gjuhës standarde shqipe.

Gjuha e folur për shkak të prirjes për të shkurtuar kohën dhe për të rritur gjallërimin e ligjërimin, pëlqen mjete gjuhësore të shkurtra; përkundrazi, gjuha e shkruar përdor zakonisht trajta më të plota, më të zgjeruara. Le të krahasojmë shembujt:

<i>Ligjërimi i folur</i>	<i>Ligjërimi i shkruar</i>
s'	nuk
ish, kish	ishte, kishte
ndaj	prandaj
ç'	çfarë
veç	veçse
e	edhe
pas	sipas
si	ashtu si
që	me qëllim që
se	për shkak se
që	i cili, e cila etj.

Në ligjërimin e shkruar zbatimi i rreptë nis me drejtshkrimin dhe pikësimin. Në shqiptim kemi stilin e plotë, që synon të ndjekë drejtshkrimin. Fonemat shkruhen e shqiptohen pa u rrëgjuar, [ë]-ja shkruhet e shqiptohet edhe kur është në rrokje të patheksuar, nuk rrudhen togjet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve etj.

Me përpikëri ndiqen trajtat morfologjike të përcaktuara nga kodifikimi gramatikor. Gjatë fjalëformimit ndiqen modelet e shqipes. Përmbajtja u nënshtrohet rregullave të logjikës e të gramatikës. Gjithë



teksti është i lidhur e i sistemuar. Sintaksës i kushtohet vëmendje e madhe për rrjedhshmërinë dhe ndërlihdjen e fjalive. Mendimet kanë rrjedhshmëri jo vetëm në fjali e periudha, por edhe në tërësi më të mëdha, si në paragrafë, nëntituj, tituj e kapituj, që veprën e bëjnë të përfunduar e të formësuar. Pra, me korrektësi zbatohen të gjitha rregullat e gramatikës normative.

Në ligjërimin e shkruar, përkatësisht në ligjërimin libror edhe fjalët përdoren me përpikëri që të mos lihet shteg për keqkuptime. Për nevojat e veta çdo fushë e specializuar (si mjekësia, gjuhësia, letërsia, ekonomia, politika, jurispondenca, sporti, feja, ..., po edhe nëndegët e tyre), përveç leksikut të përgjithshëm që përdorin, kanë krijuar terma të tjera të duhura. Burimet për ta plotësuar këtë kërkesë janë të shumta: me brumin e shqipes janë krijuar fjalë të reja, janë kalkuar fjalë, përdoren mjaft ndërkombëtarizma e fjalë të huaja (sidomos nga gjuhët neolatine e anglishtja) etj. Ndonjëherë hetohet edhe ndikimi i gjuhëve të huaja në ndërtimet sintaksore.

Ana emocionale-vlerësuese e normës librore është e përmbajtur. Mbizotërojnë arsyeshmëria, konceptet, faktet, argumentet, bindja etj. Kur shfaqet mospëlqimi, zemërimi e përbuzja, sidomos në polemika, ato shprehen në mënyrë të tërthortë e të kulturuar.

Shtresimi stilistik i jep visarit gjuhësor ngjyrat që të vizatohen tablotë e jetës. Ligjëruesi i shfrytëzon këto mundësi për një komunikim shumëfunksional.

Ligjërimet në gjuhën shqipe. Të folurit sot përmbledh një larmi përdorimesh. Gjuha letrare ka trajtën e saj të shkruar dhe gojore, kjo e fundit mbizotëron në kumtimet publike. Dialektet e të folmet vendore ende gjallojnë, por janë përfutur edhe disa forma gjysmëdialektore, sidomos nëpër qytete për shkak të proceseve demografike e kulturore.

Ligjërimet e gjuhës sonë në dy variantet e saj (të shkruar e të folur) janë:

- a) **ligjërimi i shkujdesur,**
- b) **ligjërimi bisedor** dhe
- c) **ligjërimi libror.**

2.5.3. LIGJËRIMI I SHKUJDESUR

Ligjërimi i shkujdesur (apo ligjërimi i thjeshtë, thjeshtligjërimi) është ligjërimi i përditshëm i njerëzve të profesioneve e të krahinave të ndryshme, që nuk i përmbahen në të folur normës standarde, e shkelin ose e shtrembërojnë atë. Norma shkelet ose shtrembërohet në skajshmëri, saqë ky lloj ligjërimi del jashtë gjuhës letrare. Kjo është shkalla më e ulët e respektimit të normës letrare. Ndikimi dialektor në këtë ligjërim është i madh, por dallohet nga e folmja krahinore a vendore.

Rastet më të shpeshta të ligjërimin të shkujdesur paraqiten në mjediset me përzjerje të folmesh të ndryshme, te njerëzit e paarsimuar ose analfabetë. Liria e fjalës shpërdorohet edhe nga disa individë të pakulturuar që flasin ose shkruajnë fjalë të ndyra, fyese e fjalë të pahijshme shqiptohen me zë të lartë në rrugë, autobus e në lokale publike. Fjalë të huaja të panevojshme ose të ndyra ndonjëherë përdoren edhe në fjalosjet e njerëzve, në zënkat e politikanëve, polemikat e botuara në shtyp, në disa përkthime etj. Një ligjërim të shkujdesur përdorin edhe ata që hedhin poshtë tërësisht gjuhën standarde.

Në komunikimin e përditshëm norma shkelet edhe kur ka prirje për t'u veçuar si grup, duke e ulur qëllimisht nivelin e mirësjelljes e të komunikimit. Të tilla kanë qenë të folmet sociale

e argotë (dogançja, purishtja, dalipbebcja), si: *Sa e ke qepën?* me kuptimin “Sa e ke orën”. Edhe sot ka grupe shoqërore me profesion të njëjtë që e ulin nivelin e të folurit deri në ligjërimin e shkujdesur, si disa punëtorë krahu, tregtarë, sportistë, ushtarë, nxënës, studentë etj.

Shumica e fjalëve të huaja që nuk kanë përhapje të gjerë dialektore, por përdoren vetëm në disa të folme ose në ndonjë krahinë, janë pasojë e ligjërimin të shkujdesur, sepse në fillim janë përdorur nga një grup njerëzish e pastaj janë përgjithësuar edhe te shumë të tjerë. Pra, orientalizmat, sllavizmat, italianizmat e barbarizmat e tjerë të panevojshëm në gjuhën shqipe janë pjesë e ligjërimin të shkujdesur, si *allahile, askerllëk, jazëk, hazër, hallall, hasret, helbete; struj, grejalic, reshenje, potvërd, izvod, uverenje, liçna kartë, dozvollë* etj.; *Kah shkon e merr me veti prekolicën (rimorkion)* në vend të thotë bashkëshorten. *Stallno, ni dajm vjen te une. Gjith ditën çistat e radit...*

Në ligjërimin e shkujdesur bëjnë pjesë çdo fjalë e fjali e shtrembëruar ose e përdorur pa vend. Kjo dukuri hetohet shpesh në shpalljet publike, në reklama, ftesa, në mbishkrimet e shitoreve, po edhe në disa mjete informative etj. P.sh. *Shpia shitet. Fëmit mos i lani 3 jav mbasi kan bër vaksinën e tuberkulozit. Më jep dy ashtu. Ai nuk e frekuenton rakinë. Unë nuk e aplikoj qepën. Sa ashtu që je. Sapun me rahat.*

Në këtë grup hyjnë edhe të gjitha sharjet, fjalët e shprehjet e rënda fyese, që nuk janë pjesë e normës letrare.

Shformimet në nivele të ndryshme, universalizimi i përdorimit, barbarizmat, kalkimi dhe renditja e fjalëve sipas gjedhës së huaj janë shprehje e nivelit të ulët të kulturës së folësit, rrjedhimisht edhe e kulturës gjuhësore të tij.

2.5.4. LIGJËRIMI BISEDOR

Ligjërimi bisedor afrohet me ligjërimin e thjeshtë, se edhe këtu kemi lëkundje të normës letrare. Në jetën e përditshme, në familje e punë, në tregti, argëtim, lojëra, udhëtime etj. në komunikim të drejtpërdrejtë gjatë çfarëdo bisede përdorim ligjërimin bisedor. Pra, ligjërimi bisedor është varianti që merr gjuha letrare kur përdoret në të folur e biseda të lira, kur norma nuk ruhet plotësisht. Brenda ligjërimin bisedor mund të hetohen disa nënshtresa: gjysmëdialektet (nëpër qytete me kompaktësi gjuhësore, p.sh. në Dibër) dhe interdialektet (e folmja e qyteteve të mëdha gjuhësisht heterogjene, si në Elbasan, Prishtinë, Shkodër, Shkup etj.). Njeriu i njëjtë varësisht nga rrethanat, mund të përdorë herë ligjërimin libror e herë ligjërimin bisedor. Bie fjala, në një mbledhje pune pjesëmarrësit priren drejt të folurit letrar, po të njëjtit njerëz pas mbledhjes duke pirë kafe rëndom flasin në ligjërimin bisedor.

Ligjërimi bisedor, sikurse thjeshtligjërimi, është spontan dhe organizohet aty për aty. Përdoret nga kushdo që është shkëputur nga norma dialektore dhe ndodhet nën ndikimin e normës standarde. Por, te shumica e folësve të shqipes ende vërehet një mbetje e së folmes krahinore, sidomos në fonetikë e në disa trajta morfologjike. Thjesht, ky ligjërim është përzierje elementesh e të folmes vendore me ato të gjuhës letrare. Mbizotërojnë temat e jetës së përditshme, por flitet edhe për çështje të tjera që u interesojnë bashkëbiseduesve.

Ligjërimi bisedor zbaton shumë parimin e ekonomizimit të gjuhës dhe prirjen për lehtësimin e shqiptimit. Ai udhëhiqet nga parimi “sa më pak mund”, sipas të cilit me sa më pak mund synohet të arrihen efektet e duhura.

Parapëlqehen trajtat më të thjeshta, më të shkurtra: ndërtohen fjali të shkurtra e shpeshherë të paplota, me mbisundim të bashkërenditjes, me renditje të lirë fjalësh, duke nxjerrë në krye pjesën më të rëndësishme; kuptimet e fjalëve nuk kanë ndonjë përpikëri të lartë, fjalët përdoren me ngarkesa emocionale dhe shprehje përforcuese. Kështu, *nga ana fonetike* përdoren lloje të ndryshme intonacioni (i rrafshhtë, ngjitës, zbritës ose i kombinuar), ndeshen tinguj të panyjëtuar qartë, [ë]-ja e patheksuar zakonisht nuk shqiptohet, tingujt këmbehen njëri me tjetrin, përngjashmohen (asimilohen) tingujt e grupet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve, fjalët dhe emrat e përveçëm cungohen, përdoren forma metatetike (me inverzion), shpesh ligjërimi ndërpritet. Nën ndikimin e emocioneve, për përkëdheli ose për përçmim ndodhin ndërrime të gjatësisë së zanoreve, ndërrime theksore etj.

Lëkundje të *trajtave morfologjike* vërehen në kohët e foljeve, në rasiat, në shumësin e emrave etj. Në aspektin *sintaksor* fjalitë janë të thjeshta, kanë pak gjymtyrë, emri nuk merr dy e tre përcaktorë; dalin ndërtime të paplota, të papërfunduara. Renditja e fjalëve i nënshtrohet logjikës afektive, me zhvendosje sintaksore, sipas rëndësisë vihen në dukje disa kulme. Shpesh ka përsëritje për t'ia imponuar dëgjuesit qëndrimin. Përgjithësisht, ka një kondensim sintaksor e semantik. Në bisedën shqipe zënë vend të madh frazeologjizmat, pasthirrat, përshtëndetjet, mallkimet, urimet etj.

Leksiku bisedor karakterizohet me fjalët e jetës së përditshme, që emërtojnë gjëra konkrete (materiale). Fjalët përdoren me kuptimet e zakonshme, por shpeshherë marrin shumë kuptime dhe kuptim figurativ. Përdoren krahinorizma, huazime, sinonime, antonime; trope e figura stilistike (më shpesh krahasimi, epiteti, hiperbola, perifraza, ironia, sarkazmi, numërimi, apostrofa etj.). Të shpeshta janë edhe frazeologjizmat.

2.5.5. LIGJËRIMI LIBROR

Ligjërimi libror (letrar) është më i përpunuari në pikëpamje të normës. Në këtë ligjërim norma letrare ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera, prandaj çdo shkelje e saj hetohet menjëherë. Ky në përgjithësi zbatohet në gjuhën e shkruar, por ka edhe variantin e folur.

Përdorimi i ligjërimin libror kërkon një përgatitje paraprake arsimore e kulturore si dhe një përvojë të nevojshme gjuhësore. Formës së shprehjes i kushtohet kujdes i veçantë, ndërsa përmbajtja jepet në imtësi, duke u mënjanuar përsëritjet dhe çdo gjë që është e panevojshme. Interpretimi i fakteve është logjik dhe i saktë, duke mos lejuar mundësi për keqkuptime. Ky lloj ligjërimi ka një prirje të përgjithshme për të përdorur trajta më të plota e më të zgjeruara, me fjali e periudha më të ndërlikuara. Mendimet ndërtohen me periudha që kanë fjali me marrëdhënie bashkërenditëse e nënrenditëse të shkallëve të ndryshme. Ky ligjërim kërkon shqiptim të saktë të zanoreve e të bashkëtingëlloreve si dhe të grupeve të tyre. Edhe rregullat gramatikore zbatohen me një rreptësi të dukshme, ku ruhen format normative të fjalëformimit.

Nevojat e ligjërimin libror shpeshherë plotësohen me anë të fjalëve të reja të krijuara (neologjizmave) si dhe huazimeve. P.sh. *brendashkruaj, nëndetëse, jashtëmartesor, i shumëkuptimshëm, gjysmërrafsh, keqtingëllim, përngjashmim* etj. Shumë fjalë e shprehje të leksikut abstrakt që karakterizojnë këtë ligjërim, përdoren edhe si terma në fusha të ndryshme të shkencës. Si rrjedhim, në këtë grup ka edhe fjalë të huaja e ndërkombëtare, si termat e teknikës, të mjekësisë, të filozofisë, të gjuhësisë etj. Në leksikonin e ligjërimin libror nuk zënë vend

krahinorizmat e arkaizmat, as fjalët e zhargoneve ose mjetet e tjera që nuk pajtohen me normën letrare.



Pyetje dhe detyra:

1. Ç'është ligjërimi i folur? Ç'mund të thoni për të?
2. Sa lloje ligjërimesh kemi dhe cilat janë ato?
3. Thuaj veçoritë e ligjërimit të shkujdesur!
4. Ç'është ligjërimi bisedor. Me se dallohet ai?
5. Ç'dini për ligjërimit libror?
6. Ç'lloj ligjërimit është ky:
 - *Dritani*: Tungjatjeta Besa!
 - *Besa*: Tungjatjeta Dritan!
 - *Dritani*: Ku po shkon?
 - *Besa*: Në bibliotekë.
 - *Dritani*: Rregullisht shkon aty?
 - *Besa*: Rregullisht.
 - *Dritani*: Ke ndonjë provim?
 - *Besa*: Jo, por gjithnjë mësoj në bibliotekë.
 - *Dritani*: Shumë mirë. Sukses!
 - *Besa*: Faleminderit!

2.6. STILET FUNKSIONALE NË GJUHËN SHQIPE

Siç u tha edhe më parë, funksioni dhe përshtatja e ligjërimit sipas veprimtarive njerëzore është kriter për dallimin e pesë **stileve funksionale**:

- 1) *stili i veprimtarisë shkencore e teknike*, ku funksion mbizotërues është kumtimi;
- 2) *stili i veprimtarisë shtetërore e administrative*, ku funksioni i kumtimit bashkohet me funksionin parashkrues;
- 3) *stili i veprimtarisë shoqërore e politike*, ku funksioni i kumtimit gërshetohet me atë ndikues;
- 4) *stili i veprimtarisë letrare artistike*, ku mbizotëron funksioni estetik;
- 5) *stili i veprimtarisë fetare*, ku funksioni mbizotërues është sugjestiv: të binden njerëzit se ka Perëndi, se ekzistojnë gjëra të shenjta, hyjnore, të mbinatyrshme, të përjetshme. (Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999).

Gjuha letrare, si forma më e lartë që i përpunon dhe i përsos mjetet e marrëveshjes e të shprehjes gjuhësore, përdoret në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, porse secila fushë i zgjedh, i përpunon e i përdor këto mjete sipas kërkesave të veta. *Ky sistem mjetesh gjuhësore, të zgjedhura e të përdorura në përshtatje me përmbajtjen e kërkesat e një fushe të caktuar të veprimtarisë shoqërore, përbën stilin funksional*. Shkurt, stili funksional është trajta që merr gjuha standarde e përdorur në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore. Gjuha standarde jeton e vepron në trajtën e stileve funksionale.

Në gjuhën e sotme standarde shqipe tashmë janë bërë të qarta vijat kryesore të stileve funksionale: **stilit shkencor**, **stilit shtetëror-administrativ**, **stilit politiko-shoqëror**, **stilit të**

letërsisë artistike dhe stilit fetar. Vetë kristalizimi i stileve është shenjë e përsosjes së gjuhës standarde dhe fuqisë shprehëse të saj. Sigurisht, nuk mund të ketë kufi krejt të prerë në mes të stileve të ndryshme, sepse disa elemente të një stili mund të përsëriten në një tjetër. Këtu po trajtojmë stilin shkencor, stilin shtetëror-administrativ dhe stilin politiko-shoqëror. Stilit të letërsisë artistike (në përputhshmëri me programin mësimor) i kemi kushtuar një pjesë të madhe të këtij teksti mësimor, me temat: gjuha e letërsisë artistike - gjuha e prozës, gjuha e poezisë, figurshmëria e gjuhës - figurat e sintaksës, figurat e leksikut; mjetet shprehëse fonetiko-fonologjike, mjetet morfologjike dhe mjetet shprehëse sintaksore.



Pyetje dhe detyra:

1. Ç'është ligjërimi i shkruar?
2. Çka e dallon ligjërimin e shkruar nga ligjërimi i folur?
3. Cilat janë veçoritë e ligjërimin të shkruar?
4. Ç'janë stilet funksionale, cilat janë ato?

2.6.1. STILI SHKENCOR

Në shkencë shprehet më së miri aftësia e njeriut për të vëzhguar, për të analizuar dhe për të gjykuar (menduar). Ky stil përdoret në botimet shkencore (në libra, revista, artikuj, punime) dhe në kumtimet gojore (në konferenca, sesione, simpoziume, leksione, diskutime etj.).

Stili shkencor përdoret në fushën e veprimtarisë shkencore, si në: gjuhësi, histori, etnologji, etnografi, arkeologji, matematikë, kimi, fizikë, biologji, mjekësi, bujqësi, teknikë, astronomi, në artin figurativ e muzikor etj.

Stili shkencor karakterizohet nga të shprehurit e drejtë logjik, nga saktësia e përdorimit të termave, nga qartësia e thënies etj. Termat, fjalët dhe shprehjet në këtë stil përdoren kurdoherë në kuptimin e tyre të parë (në kuptimin themelor), pa kuptime figurative e pa ngjyime emocionale.

Funksioni stilistik i ligjërimin këtu është kumtues. Në qendër është informimi objektiv e i vërtetë. Informacioni synohet të jepet sa më saktë dhe i ngjeshur. Thëniet nuk kanë kuptime të dyta. Përqendrimi tek ana racionale, te qartësia e vërtetësia mënjanon qëndrimin subjektiv e emocional. Stili shkencor largohet nga gjuha e zakonshme dhe përpunon një gjuhë të posaçme, duke u bërë e njëjtë për të gjithë popujt; gjuhë e specializuar, përplot me simbole logjike (në kimi, matematikë, fizikë etj.). P.sh. H_2O është uji për të gjithë, HCl është acidi klorhidrik, formula $P = a + b + c$ është e njëjtë për të gjithë popujt dhe ka kuptimin: Perimetri i trekëndëshit është i barabartë me shumën e gjatësisë së brinjëve të tij.

Këto procese e ngrenë shkallën e lëvrimit të gjuhës, prandaj stili shkencor shpreh më së miri tiparet e ligjërimin libror dhe jep modele të gjuhës letrare të shkruar.

Sistemi i dijeve mund të shpjegohet e të shtjellohet: a) me anë të gjuhës përkatëse shkencore, b) në mënyrë të kuptueshme për t'u përhapur në popull ose c) me një gjuhë të përshtatshme për aftësitë psiko-fizike të nxënësit. Në bazë të kësaj, stili shkencor mund të degëzohet në tri nënstile, në:

- a) *stilin e mirëfilltë shkencor,*
- b) *stilin shkencor-popullor dhe*
- c) *stilin shkencor-mësimor.*

a) Stili i mirëfilltë shkencor jetësohet në tekstet e shkruara nga specialistët e fushave të caktuara, për njerëzit e profesionit të njëjtë: monografi, disertacion, referat, punim etj. Tekstet ndërtohen nga dy pjesë: 1) nga rrëfimi - me përkufizime, klasifikime, teza e hipoteza, përfundim, shenja e simbole dhe 2) nga pjesa plotësuese - me referime, bibliografi, shënime, ilustrime, harta, skica, grafikë etj.

b) Stili shkencor-popullor, përveç funksionit kryesor shkencor (paraqitjen e njohurive shkencore), ka edhe një funksion të dytë: përvetësimin e tyre nga një masë e gjerë jospecialistësh. Autori shpjegon e shtjellon në mënyrë të kuptueshme për të gjithë rezultatet e studimeve në fushën e shkencës e të teknikës për t'i përhapur ato në masat popullore. Me ligjërimin e tij përpiqet të zgjojë interesimin e shumë të tjerëve që nuk janë të këtij profesioni, prandaj duhet t'i shpjegojë termat, të bëjë përzgjedhjen e materies dhe të gjejë mënyrë të përshtatshme, më të gjallë të paraqitjes së tyre. Të tilla janë libri, doracaku, ligjërata etj.

c) Stili shkencor-mësimor karakterizohet me gjuhën e profesionistit që i drejtohet joprofesionistëve në tekstet shkollore. Këtu gjerësia e lëndës kufizohet nga programi mësimor i asaj lënde, ndërsa mënyra e të shprehurit duhet të përshtatet me moshën dhe dituritë e mëparshme të nxënësve, apo të shfrytëzuesve të tekstit mësimor (p.sh. të kursistëve). Në këtë stil shkruhen tekstet dhe mjetet mësimore, doracakët; mbahen ligjëratat etj.

Siç dihet, ka shumë fusha shkencore, të cilat ndahen në *shkenca shoqërore* (humanitare: gjuhësia, shkenca e letërsisë, historia, filozofia, logjika, psikologjia, jurisipodencia etj.), *shkenca matematiko-natyrore* (fizika, kimia, gjeografia, biologjia, matematika etj.) dhe *shkenca teknike* (makineria, arkitektura, elektronika etj.) dhe çdo shkencë ka një nënstil shkencor të vet.

Veçoritë kryesore të stilit shkencor përfaqësohen në tekstet e mirëfillta shkencore. Tipike për të janë informacioni, logjika, objektiviteti dhe saktësia.

Stili shkencor në të gjitha fushat mbështetet te gjuha letrare e shkruar. Pjesa e leksikut të përgjithshëm mund të bjerë deri përgjysmë. Gjysma tjetër i takon leksikut shkencor. Bërthamën e leksikut shkencor e përbëjnë *termat*. Ato kanë dallime nga fjalët e zakonshme, pasi në vend të kuptimeve (kuptimet janë një përgjithësim nga përvoja njerëzore dhe përcaktohen brenda sistemit gjuhësor) shënojnë nocione (nocionet janë rezultat i njohjes shkencore dhe përcaktohen në sistemin e secilës disiplinë). Fjalët e përgjithshme, kur kthehen në terma, ripërkufizohen, si p.sh. *uji* për gjeologjinë është *mineral i lëngët, vetëtimat ose rrufetë* në gjuhën teknike njihen me termin *shkarkim elektrik*, shfaqje të elektricitetit; *ngjeshja* apo *fërkimi* i trupit në mjekësi njihet me *masazhë, verdhëza* në mjekësi emërtohet me *hepatit C, ndezja e mushkërive* me *bronhit e asmë, dhëmbi* në mjekësi njihet me termin *dentes, buzët janë labia*, në mjekësi thuhet *i sëmurë psikik* dhe në asnjë mënyrë *i çmendur, spital neuropsikiatrik* dhe jo *çmendinë* etj. Një pjesë e madhe e termave janë nga terminologjia ndërkombëtare.



Në fushën e morfologjisë, mbizotërojnë trajtat pësore të foljeve (*Trupat bymehen nga të nxehtit* dhe nuk del: *Të nxehtit i bymen trupat*), përdoret veta e tretë njëjës e shumësit të foljeve, nuk ka vetë të dytë e rrallë vetë të parë shumës (sepse autori veten e paraqet në vetën e parë shumës). Më shpesh përdoret mënyra dëftore, koha e tashme. Për të shmangur pohimet absolute, pasi realiteti është tepër i ndërlikuar, shfrytëzohen foljet modale (*mund, duhet*) dhe të ndërmjetme (*përveç kësaj, në radhë të parë, dihet se, siç dihet*). Në këtë stil shumë më tepër përdoren emrat dhe mbiemrat sesa foljet, prandaj thuhet se ky stil ka karakter emëror.

Sintaksa e këtyre teksteve është komplekse, fjalitë kanë shumë gjymtyrë, bashkohen shumë fjali me nënrenditje shumëshkallëshe. E domosdoshme del paraqitja logjike e gjërave, fjalitë janë konstatuese ose supozuese. Fjalët në fjali kanë renditje të rregullt, por ka fjali edhe me renditje të anasjelltë, jo për qëllime stilistike, por kuptimore. Forma kryesore e stilit shkencor është ligjërimi i shkruar. Trajta e folur e stilit shkencor është e prejardhur nga gjuha e shkruar.



Pyetje dhe detyra:

1. Ku përdoret stili shkencor dhe si degëzohet ai?
2. Cilat janë karakteristikat e përgjithshme të stilit shkencor?
3. Ç'mund të thoni për stilin shkencor të mirëfilltë, stilin shkencor-popullor dhe stilin shkencor-mësimor?
4. A mund t'i dalloni cili fragment cilit stil i përket: stilit shkencor të mirëfilltë, stilit shkencor-popullor ose stilit shkencor-mësimor:

1. “Temperatura e ajrit matet me termometër. Ai është gyp prej qelqi, i mbushur me zhivë. Zhiva gjatë nxehtjes zgjerohet dhe ngritet në gyp. Gjatë ftohjes, zhiva përsëri tkurret dhe zbret në pjesën e poshtme të gypit...”

2. “Gjuha ruhet atje ku shkruhet – thotë një fjalë e urtë e popullit tonë. Në kritikën dhe literaturën tonë gjuhësore është pranuar se Samiu ka krijuar, përkthyer e përshtatur afro 100 terma themelorë gjuhësorë, nga të cilët vetëm 50 kanë mbetur në përdorim, si *folje, folje e rregullt, e parregullt, mbiemër, emër, nyjë, rrokje* etj.”

3. “... Po t'i hedhim një vështrim historisë së gjuhës shqipe, dy gjëra të kundërta na bien në sy në këtë lëmë: me një anë një gjuhë e dëshmuar me shkrim mjaft vonë, më anë tjetër një popull i lashtë, autokton në këto vise të Ballkanit që në kohët e mugëta të prehistorisë. Historikisht shqiptarët bashkë me grekët janë populli më i vjetër i Gadishullit. Ky popull në këto rreth 3000 vjet që po rron në këto anë, ka pasur sigurisht historinë e tij; ka folur gjithashtu brez pas brezi gjuhën e tij, të cilën, me ndërrimet që ka pësuar me kohë, e flasin sot stërnipët e atyre të parëve ...”

2.6.2. STILI SHTETËROR-ADMINISTRATIV

Stili shtetëror-administrativ përfshin fusha të ndryshme të veprimtarive shtetërore (me shkrim e me gojë), si: gjuhën që përdoret në administratë, në ekonomi e tregti, në diplomaci si dhe në ushtri. Me të shkruhen dokumentet shtetërore, duke filluar nga Kushtetuta, ligjet, rregulloret, statutet, vendimet, lutjet, kërkesat, ankesat, procesverbalet, raportet e deri te

formularët më të thjeshtë postarë. Pasi gjuha u nënshtrohet të njëjtave kërkesa, në stilin administrativ-shtetëror përfshihet edhe veprimtaria administrative, tregtare dhe ekonomike joshitetërore.

Pra, ky stil me shkrim e me gojë përdoret në veprimtarinë ligjvënese, ekzekutive e gjyqësore të të gjitha organizmave përkatës dhe administratës së tyre. Ka disa lloje tekstesh që shkruhen në këtë stil: *tekste ligjore* (ligj, dekret, vendim, urdhëresë, urdhër, kod, udhëzim, rregullore); *shkresa* (vërtetim, deklaratë, autorizim, kërkesë, përgjigje, akt, fletë qarkore, letër administrative, relacion, procesverbal); *akte ekonomike-tregtare* (kontratë, marrëveshje, raport, bilanc); *formularët*; *aktet diplomatike* (notë, letër, mesazh, protestë, peticion) etj.

Stili shtetëror-administrativ i përngjet stilit shkencor. Fjalët dhe shprehjet kurdoherë përdoren vetëm në kuptimin themelor e kurrsezi në atë figurativ. Megjithëkëtë, ky stil dallohet nga stili shkencor (që ka funksion kumtues). Funksioni i këtij ligjërimi është kumtues dhe parashkrues, d.m.th. jo vetëm thuhet me fjalë diçka, por edhe tregohet a urdhërohet çfarë duhet bërë.

Çdo përmbajtje e këtij stili u nënshtrohet disa kërkesave. Kërkesë parësore është se gjithçka që paraqitet, thuhet në emër të shtetit; rrjedhimisht shmanget shprehja e drejtpërdrejtë e ndjenjave të ligjëruesit. Këtu nuk kemi stil individual, madje ka raste kur dikush e harton, ndërsa e nënshkruan dikush tjetër.

Kërkesë tjetër është që paraqitja gjuhësore duhet të bëhet jo vetëm me përpikëri, por edhe të përfshijë të gjitha rastet e mundshme, imtësitë e rrethanat, me qëllim që të mos marrin interpretim të gabuar. Tekstet ligjore shkruhen duke u kujdesur më shumë që të mos keqkuptohen, sesa që të kuptohen. Po kështu, synohet që tekstet të mos ndryshohen brenda periudhave të shkurtra kohore, prandaj ky mund të quhet stil konservator.

Duke i plotësuar këto kërkesa, ky stil është varianti më pak komunikativ, më larg gjuhës së gjallë të folur, shumë homogjen nga ana stilistike dhe me paraqitje të njëtrajtshme. Toni është i përmbajtur, korrekt, i ftohtë ose me mirësjellje formale. Mungojnë ngjyrimi subjektiv, stilemat emocionale e shprehëse. Po sjellim më poshtë një tablo të rëndë, si shembull për këtë stil (sipas stilistit tonë më të njohur, Xhevat Lloshit, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 201):

“Në vendin ku ishte shtrirë viktima, në jastëkun e fjetjes u gjend një copë xhami me prejardhje nga dritarja. Copëtimi i plotë i kokës, shpërndarja e trurit dhe e gjakut në muret u shpjeguan shkencërisht nga eksperti mjeko-ligjor dhe eksperti kriminalist. Konkluzioni i tyre ishte se, kur qitja bëhet në distancë të afërt, kalimi i plumbit në kokë sjell me vete shkatërrimin e saj, ndarjen e kafkës në disa pjesë dhe shpërndarjen e lëndës së trurit në vende të ndryshme” (*Drejtësia popullore*, 1975, nr. 5).

Tekstet ndërtohen në mënyrë stereotipe. Rëndësi të veçantë marrin modelet: shkresat bëhen sipas modeleve. Fletë të kësaj natyre për zyrat shtypen dhe modelet jepen të gatshme (tashmë edhe me kompjuterë). Në formularët parashkruhet pjesa më e madhe e tekstit, që duhet vetëm të plotësohen sipas kërkesave. Shumë dokumente përdorin kolonat; ligjet ndahen në nene; procesverbalet jepen me pika të rendit të ditës.

Aty ku kemi tekste të plota, siç janë nenet e kushtetutave, të ligjeve e të rregulloreve ka thënie të plota, pa emocionalitet e shprehësi, me sintaksë të ndërlikuar që i afrohet mjaft stilit shkencor. Po sjellim një nen nga Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998:

Neni 3: Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia

kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

Tri shtresat kryesore të leksikut në fushën shtetërore-administrative janë: leksiku i përgjithshëm letrar, leksiku terminologjik dhe leksiku i emërtesës (nomenklaturës). Në tekstet zyrtare disa fjalë të leksikut të përgjithshëm pësojnë ndryshime, ndërsa një pjesë janë ndikim i gjuhëve të huaja. Kjo mund të shihet po të krahasohen disa shprehje në stilin shtetëror-administrativ dhe në ligjërimin bisedor: *nuk figuronte në listë - nuk ishte në listë, bashkëshorti - i shoqi, çfarë disponojnë aty - çfarë kanë aty, i akordoi bursë - i dha bursë, pajisen me biletë - marrin biletë* etj.

Leksiku terminologjik varet nga nënstili, përkatësisht fusha e veprimtarisë, siç janë drejtësia, ushtria, ekonomia, si *juridiksion, hetuesi, kundërvajtje, fletarrest, fletanketë, fletëdalje, fletëdorëzim, ratifikim, padi, aktakuzë, fletëdetyrim, fletëpagesë, fletëthirrje* etj. P.sh. në diplomaci përdoren komplimentet e klishtë e njohura, si *Është kënaqësi për mua, që në emër të ...si dhe në emrin tim personal t'Ju dërgoj Juve dhe popullit mik të vendit Tuaj përshëndetjet më të përzemërta ... Kam nderin t'Ju transmetoj ... Zgjedhja Juaj në funksionin e lartë të Kryetarit të Republikës më jep rastin e kënaqshëm t'Ju dërgoj ...Falënderoj me gjithë zemër Shkëlqesinë Tuaj* ...

Pjesën më karakteristike të fjalëve në këtë stil e përbën emërtesa. Nomenklatura është mënyrë e veçantë e emërimit të sendeve, të dukurive, të proceseve, të detyrave e të njerëzve, d.m.th. emërtim sipas përshkrimit, paraqitja në mënyrë të hollësishme të sendeve e të njerëzve. P.sh. njeriu quhet *individ*: i përmendet emri, emri i babait e mbiemri, si kërkesë shtetërore. Tiparet e emërtesës shihen më së miri në emërtimet e proceseve të punës, të prodhimeve dhe kur përshkruhet inventari.

Për procesin e punës dhe materialin që kanë shfrytëzuar, mjeshtrit japin fletëdëshmi. Ja një pjesë të tekstit nga një punishte për ndreqjen e televizorëve: *Konstatim e riparim këputje qarku ose e elementeve të tij. Rregullim sipas skemës dhe ndryshim skeme. Çmontim, montim, thurje transformator parafinal. Konstatim i fijeve të altoparlantit, zëvendësim e adaptim. Këputje fijesh në stadin e F.U.* Pas secilit emërtim vihet numri i copëve dhe çmimi.

Ja edhe pjesë nga inventari i një zyre: *Tavolinë mesj. Tavolinë me tre sirtarë nga e djathta. Kolltuk stofj. Kolltuk stofj vendi. Karrike. Karrike e veshur. Karrike me një këmbë të thyer. Perde doku çift.* (Sipas Xhevat Lloshit, "Stilistika dhe pragmatika").



Pyetje dhe detyra:

1. Në cilat veprimtari njeriu përdor stilin shtetëror-administrativ?
2. Cilat janë veçoritë e stilit shtetëror-administrativ?
3. Dalloni stilin e dy tekstet e mëposhtme:

a) Në bazë të nenit 110, pikës 5 të Ligjit për arsimin fillor ("Fl. zyrtare e RM nr. 52/2002") dhe vendimit nr. 02-19/2 të marrë më 13.02.2004, Pleqësia e shkollës "Naim Frashëri" publikon:

Shpallje publike

për emërimin e drejtorit të shkollës

1. Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësojë edhe këto kushte të veçanta:

- të ketë arsimim përkatës dhe t'i plotësojë kushtet për mësues, arsimtar, pedagog ose psikolog;

- të ketë 5 vjet përvojë pune në procesin edukativ-arsimor;

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;

- të jetë psiko-fizikisht i shëndoshë;

- ta njohë gjuhën shqipe dhe maqedonase;

- të mos jetë i gjykuar me vendim të plotfuqishëm në gjykatën për vepra penale.

b) “... Burimet që na kanë mbetur prej gjuhës ilire, te të cilat do të kapemi për të pasur një ide se si mund të ketë qenë struktura e kësaj gjuhe, janë tepër të varfra. Vijnë këtu në vështrim në radhë të parë emrat e vendeve e të personave, mbledhur sistematikisht prej Hans Krahes. Vijnë pastaj disa glosa, d.m.th. disa fjalë që na kanë lënë shkrimtarët e vjetër, bashkë me kuptimet përkatëse greke e latine. Mbishkrime nga ilirishtja e Ballkanit gjer më sot kemi. Më mirë paraqitet për nga ana e burimeve ilirishtja e Italisë, sepse kemi mbishkrimet e Mesapëve në Apuli...”

2.6.3. STILI POLITIKO-SHOQËROR

Në këtë stil përfshihen botimet e organizatave shoqërore e politike (libra, broshura, thirrje, traktate, fletushka), veprimtaritë e tyre (mbledhje, konferenca, kongrese, mitingje, takime), mjetet e komunikimit masiv (shtypi, radiotelevizioni, filmi dokumentar, videokasetat) dhe propagandat e reklammat.

Sipas kushteve e veçorive të komunikimit, dallohen këto ndarje të mëdha, që përbëjnë edhe nënstilët: publicistika, format gojore publike, shtypi, radioja, televizioni, agjitacioni e propaganda. Secili nënstil ka tiparet e veta, por në publicistikë dalin më të plota anët kryesore të gjuhës së kësaj fushe.



Nëse doni të dini më shumë

Format gojore publike përfshijnë fjalimin, diskutimin dhe bisedën politike. Fjala përpara auditorit (që është disa llojesh, si ligjëratë, polemikë, apologji, panegjirik, parashtrim, thirrje, fjalë e përmortshme, përshëndetje festive) është lëvruar qëmoti nga gojëtaria (oratoria). Që të flitet bukur, R. Qosja përmend disa kërkesa: gojëtari duhet të ketë njohuri dhe kulturë të përgjithshme, ta mendojë që më parë atë për të cilën do të flasë dhe të përgatitet, t'i besojë vetë asaj që thotë, ta njohë çështjen që shtjellon, të komunikojë me auditorin duke e nderuar atë, si dhe të zotërojë mirë gjuhën shqipe, pasuritë e saj e mjeshtërinë stilistike. Duke pasur parasysh këtë, shumë njerëz i parapërgatitin fjalimet. P.sh. U. Çerçilli i ushtronte fjalimet e veta parlamentare në kopshtin e shtëpisë. Sh. de Goli i përgatiste diskutimet para pasqyrës, siç përgatisin rolet artistët. Me një specialist si regjisor ka punuar një muaj Xh. Bushi për fushatën elektorale kur do të rizgjidhej. Gojëtaria kërkon ndikimin si me forcën e logjikës, të argumentit e të faktit, ashtu edhe me emocionalitetin e shqiptimit, duke e përvetësuar auditorin edhe me artin e fjalës.

Përgjithësisht, *funkcioni stilistik i ligjërimit shoqëror e politik është kumtues e ndikues*. Funkcioni kumtues do të thotë se jepet informacion, paraqiten fakte, ngjarje, të dhëna, njohuri nga politika, ekonomia, kultura, shkenca, arti, sportet etj., zakonisht të ditës, të kohëve të fundit. Funkcioni ndikues nënkupton se me mendimet, ngjarjet e qëndrimet e paraqitura synohet të ndikohet mbi lexuesit a dëgjuesit, të merret qëndrim për diçka, të nguliten bindje politike. Këtu shpeshherë bien ndesh pikëpamjet dhe interesat e një grupimi shoqëror-politik me një tjetër. Zakonisht, shtypi anon nga partia ose nga koalicioni i partive politike në pushtet. Forca vepruese ka për rrjedhojë cilësimin e shtypit si “pushteti i katërt” (pas pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor).

Në stilin shoqëror e politik ka një larmi të madhe leksikore, varësisht nga tema që shtjellohet. Temat shoqërore-politike mbizotërojnë, rrjedhimisht edhe leksiku i kësaj fushe: *parti, plenum, komitet, kongres, kuvend, ministri (dikaster), qeveri, gjyq, mbledhje, anëtar, ekonomi e tregut, demokraci, periudhë e tranzicionit, miting, zgjedhje, votim, e majta, e djathta, pozitë, opozitë, konsensus, korrupsion, stabilizim, çarmatosje, marrëveshje, destabilizim, plan, projekt, institucion, amnisti, dëshmor, krizë, të përndjekur politik, partneritet për paqe, reforma demokratike* etj.

Nga **tiparet morfologjike** të këtij stili po përmendim se përdoren më dendur emrat sesa foljet. Më shpesh përdoret mënyra dëftore e kohës së tashme, por nuk mungojnë edhe mënyrat e tjera (dëshirorja, lidhorja, habitorja, kushtorja, urdhërorja) si dhe format e pashtjelluara të foljeve (pjesorja, paskajorja e përcjellorja).

Sintaksa është e larmishme: krahas fjalive e periudhave të ndërlikuara, ndeshen edhe fjali me pak gjymtyrë. Renditja e fjalëve është e llojllojshme, me prirje për të vënë në krye të fjalisë pjesën që çmohet si më e rëndësishme.


Ky stil përfaqësohet më së shumti në mjetet e informimit publik: në gazeta, në radio e televizion, në formën e shkruar (që merret si kryesore) dhe në formën gojore.

Publicistika përbën një nënstil më vete të stilit politiko-shoqëror dhe ka dy funksione kryesore: a) informative dhe b) ndikuese apo motivuese, përkatësisht propaganduese, sepse me të formohet mendimi publik i një shoqërie. Përfshin çdo shkrim ose fjalë me temë shoqërore-politike nga aktualiteti (fjalët publike e shkrimet në shtyp, libra, broshura, artikuj, pamflete etj.).

Gjuha e këtij stili është koncize, e qartë, e rrjedhshme; fjalitë janë të shkurtra, mendimet të përmbledhura, nuk përdoren shumë fjalë e shprehje figurative e me emocione. Por, shpeshherë gjuha e publicistikës është përplot me fjalë të huaja të panevojshme dhe ndikime sintaksore të papranueshme për shqipen.

Shtypi (gazetat dhe revistat), që i kushtohen aktualitetit të përditshëm, lexohen nga masa e gjerë popullore me shkallë të ndryshme arsimimi. Gazetaria ditë për ditë e paraqet me shkrim rrjedhën e ngjarjeve në vend dhe në botë. Gazeta përgatitet shpejt dhe lexohet shpejt (brenda ditës). Ai që punon aty ka kohë të kufizuar për t’u marrë me përpunimin e tekstit. Gazetën e shkruajnë shumë veta, prandaj aty gjejmë stile të ndryshme. Kryesisht shkrimet gazetareske janë monolog, por në intervista me njerëz të jetës politike e shoqërore përdoret dialogu me pyetje e përgjigje.

Për transmetimin e shpejtë të informatave, por edhe për ta tërhequr vëmendjen e lexuesve, rol të madh luajnë titujt e nëntitujt si dhe ana grafike e tekstit. Gjuha e tyre respekton (ose duhet të respektojë) normat standarde. Por, për shkak të shpejtësisë me të cilën përgatiten tekstet, ndënjëherë edhe për shkak të pakujdesisë,



shpeshherë lëshohen gabime të ndryshme gjuhësore, duke filluar nga shmangiet drejtshkrimore, morfologjike, fjalëformuese, leksikore e deri tek ato sintaksore. Hetohen edhe ndikime nga gjuhët e huaja, sidomos në tekstet e përkthyer. Të metat e këtilla lidhen me rënien e kulturës qytetare dhe gjuhësore në një pjesë të shtypit.

Tekstet publicistike janë heterogjene, me veçori të stilit individual të gazetarëve, që përshkohet me qëndrimin e shprehur subjektiv e emocional ndaj ngjarjeve e dukurive të kohës. Por, përgjithësisht edhe aty shprehet mjeshtëria e fjalës: ndërthuren mjetet e gjuhës letrare, zbatohet norma standarde (ndonjëherë me shmangie) dhe shfrytëzohen mjetet shprehëse.

Agjitacioni e propaganda shfrytëzojnë fjalën si mjet për agjitacion e propagandë, si parullat, traktatet, broshurat, mbishkrimet (grafitet), bisedat etj. Ato përbëjnë shkallën më të ulët të ligjërimit. Në demokracinë shumëpartiake, këto mjete shfrytëzohen sidomos gjatë fushatave parazgjedhore. Shpesh janë shfrytëzuar shpifjet, fyerjet dhe fjalori i pakulturuar i ligjërimit të shkujdesur.

Radioja për një periudhë ka qenë gazetari e folur. Emisionet përgatiteshin me shkrim dhe lexoheshin, si rrjedhim, i përkisnin ligjërimit libror. Të folurit në radio ka ushtruar ndikim për ngulitjen e gjuhës letrare. Roli i radios u ndryshua me depërtimin e gjerë të televizionit.

Televizioni në fillim lindi si gazetari pamore, e filmuar. Folësit lexonin tekstin, lënda ishte e njëjtë me gazetatat dhe radion, madje për shumë kohë programet censuroheshin. Me vendosjen e pluralizmit dhe krijimin e televizioneve private, edhe televizioni publik u detyrua të bëjë disa ndryshime. Paraqitje e drejtpërdrejtë, pa redaktim paraprak dhe bisedat, intervistat, diskutimet kanë sjellë në ekran më shumë gjuhën e gjallë.

Marrë në tërësi, norma e shqipes standarde dukshëm po zbatohet edhe te ne në mjetet e informimit publik. Megjithatë, jemi dëshmitarë se në praktikën gjuhësore shpeshherë po thyhen normat e shqipes standarde në të gjitha rrafshet, si në rrafshin leksikor e sintaksor (si pjesë më të lëvizshme të gjuhës e që më së shumti u nënshtrohen ndikimeve të huaja), ashtu edhe në rrafshin morfologjik, fonetik e fonologjik etj. Po përmendim në këtë rast: përdorimin e panevojshëm të fjalëve të huaja, të cilat do të ishte e udhës të zëvendësoheshin me fjalë të gurrës shqipe; krijimin e papranueshëm të disa kalkeve që nuk përkojnë me natyrën e shqipes, renditjen e fjalëve e të fjalive sipas sintaksës së huaj, përdorimin e gabueshëm të disa fjalëformave, të disa fonemave (në të shkruar: shkronjave), diksioni i huaj, ndarja e gabueshme e fjalëve në fund të rreshtit etj.

Ndonjëherë, duke dashur të respektojë me një korrektësi të tepruar formën e shkruar, ndonjë folës nuk i respekton rregullat e fonetikës sintaksore, por bën shqiptim të fjalëpërfjalshëm, pa i bashkëlidhur si duhet ato në njësi më të mëdha.

Një dukuri shumë e përhapur në gjuhën e mjeteve të informimit në Maqedoni është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i disa fjalëve, togfjalëshave e shprehjeve, me fjalë e shprehje sipas gjedhës së huaj.

Përgjegjësia e kësaj fushe është mjaft e madhe për kulturën e përgjithshme të kombit, përfshirë edhe kulturën gjuhësore, prandaj duhet bërë përpjekje që edhe fjala publike të thuhet a të shkruhet në frymën e shqipes dhe të mundësive të shumta shprehëse të saj.



Pyetje dhe detyra:

1. Ku përdoret stili politiko-shoqëror?
2. Cilat janë kërkesat e të folurit të bukur?

3. Ç'funktion ka dhe cilat janë tiparet gjuhësore të stilit politiko-shoqëror?
4. Ç'mund të thoni për gjuhën dhe stilin e mediave në gjuhën shqipe?
5. Sa zbatohet norma e shqipes standarde në mjetet e informimit publik te ne?
6. Shkruani gabimet gjuhësore nga ndonjë gazetë dhe bëni një punim për to!

2.6.4. GJUHA E LETËRSISË ARTISTIKE

Me termin **letërsi** kuptojmë të gjitha krijimet artistike gojore e të shkruara: folklorin dhe shkrimet e letërsisë së kultivuar. Letërsia është një formë e veçantë e pasqyimit të jetës nëpërmjet figurave artistike, të mishëruara me lëndën gjuhësore. Duke u radhitur me artet e tjera, ajo shquhet për gjerësinë e funksioneve të saj, sepse luan edhe rol njohës, kombëtar, moral, psikologjik etj. Ndërkaq, ndikimi estetik dhe emocional mbeten tiparet themelore për një vepër artistike.

Gjuha që përdoret në letërsi është gjuhë e letërsisë artistike. Gjuha është materiali që përdor artisti letrar, ashtu siç janë ngjyrat për piktorin; argjila, mermeri etj. për skulptorin, materiali ndërtimor për arkitektin etj. Por, siç dihet, me anën e gjuhës krijohen edhe vepra që nuk janë art letrar, si librat nga mjekësia, historia, kimia, sporti, agronomia etj. Në çdo vepër letrare shkrimtari bën zgjedhje të ligjërimit nga pafundshmëria e gjuhës. Pikërisht gjuha është veçori kryesore që e dallon veprën letrare nga vepra joletrare.

Meqë kjo gjuhë dallohet nga gjuha që përdorin njerëzit në fushat e tjera të veprimtarisë shoqërore (në jetën e përditshme, në shkencë, në administratë etj.) gjuha e letërsisë artistike ka krijuar një stil të veçantë, që dallohet nga të gjitha stilet e tjera. Edhe nga përvoja juaj e deritashme lexuese e keni të njohur se, p.sh., gjuha e një romani, novele, tregimi, poeme, përralle, drame, poezie etj. dallohet nga gjuha e një libri të matematikës, biologjisë, gjeografisë, historisë etj.

Forca shprehëse e gjuhës në letërsi.- *Gjuha e letërsisë është një shndërrim specifik i gjuhës së përditshme në gjuhën e artit letrar.* Ajo ndonjëherë mund t'u shmanget rregullave të ngurosura gjuhësore. Tiparet kryesore të kësaj shmangieje nga normat gjuhësore kanë të bëjnë me aftësinë e saj që të shprehet në mënyrë të figurshme – tërthorazi (shpesh thuhet një gjë e nënkuptohet një gjë tjetër), në aftësinë e të shprehurit me emocion, në aftësinë e gjuhës për shprehje imagjinative, të bukur; në aftësinë për të sajuar rimën, harmoninë e këndshme tingullore me plot muzikalitet. Këtë mundësi dhe aftësi të pashtershme të gjuhës si mjet shprehës, shkrimtari duhet ta njohë dhe me mjeshtri ta shfrytëzojë.

Dihet se çdo njeri është në gjendje ta rrëfejë një ngjarje para të tjerëve, t'u përcjellë një informatë. Mirëpo, disa këtë punë e bëjnë më bukur, më shkathët e disa më dobët. Dikush mund ta ketë përjetuar një ngjarje dhe kjo t'i ketë bërë përshtypje të madhe, ta ketë emocionuar deri në afekt, por ai mund të mos jetë në gjendje ta shprehë këtë përjetim as me një përqindje të vogël. Dikush tjetër, me mjeshtërinë dhe aftësinë e vet, arrin që edhe ngjarjet e rëndomta t'i përjetojë e t'i shprehë estetikisht, kështu që rrëfimi i tij bëhet më interesant. Atëherë themi se njeriu i tillë është artist i fjalës.

Fjalët e gjuhës së përgjithshme, në komunikimin joletrar zakonisht përdoren me kuptimin e vet themelor a kryesor, por në artin letrar ato zgjerohen me kuptime të tjera leksikore, marrin domethënie të re që e nxisin dhe e emocionojnë lexuesin. Zotërimi i fjalës, i fshehtësisë dhe i mundësisë së çdo fjale për të shprehur kuptime të ndryshme figurative, përveç kuptimit të tyre të përmendur, është parakusht i domosdoshëm për shkrimtarin. Fjala duhet ta emocionojë lexuesin, duke i sjellë përfytyrime të ndryshme. Shkrimtari duhet të jetë mjeshtër i fjalës dhe ta shfrytëzojë atë si gurrë të pashtershme për shumëkuptimësi. Pra, varësisht nga konteksti ku shkrimtari do ta vendosë fjalën, ajo duhet të ofrojë kuptime të ndryshme, porosi të ndryshme, vlera të ndryshme. Kjo do të thotë se çdo ngjarje e rrëfyer nuk mund të ketë vlerë artistike dhe nuk mund të quhet letërsi artistike.

Si shembull për të dalluar gjuhën e letërsisë artistike nga gjuha joartistike mund të shërbejë çdo vepër letrare. Bie fjala, pas leximit të novelës (rrëfimit të shkurtër) *Luli i Vocërr* të Migjenit në ne radhiten përshtypjet, përfytyrimet, informacionet për një nxënës të varfër, me skena trishtuese, ku me mjeshtëri Migjeni pasqyron mjerimin e botës shqiptare gjatë viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar. Për gjendjen e atëhershme shoqërore, politike, arsimore etj., sot kemi plot të dhëna të sakta e të mjaftueshme nga shkrimet e shkencave shoqërore, si nga historia, statistika, ekonomia, sociologjia etj., por këto shkrime japin një pamje neutrale për këtë gjendje të mjerueshme: jepet numri i lypsave, numri i atyre që lëngonin apo vdisnin nga uria, numri i të papunëve, i atyre që nuk kishin toka, si dhe i atyre që zotëronin tërë pasurinë. Në pikëpamje gjuhësore këto shënime nuk e emocionojnë lexuesin, ashtu siç do ta emociononin ato në një vepër letrare.

Letërsia artistike (në rastin tonë novelëza *Luli i Vocërr*) vetëm përmes një detaji të shkurtër, përmes një figure, një lypësi apo rrëfimit të dramës së një familjeje (Bukuria që vret) etj. shpreh fuqishëm një segment të gjendjes së përgjithshme ekonomike, shoqërore e arsimore të asaj kohe. Por, figura, personazhi, rrëfimi artistik ka fuqi përgjithësuese, sepse *Luli* dhe familja e tij kanë pësuar të njëjtat vuajtje si gjithë shtresa shqiptare e varfër e asaj kohe. Kjo arrihet përmes angazhimit intelektual dhe emocional të shkrimtarit.

Sociologët apo historianët rëndom janë indiferentë në paraqitjen e fakteve, ndërsa shkrimtari u jep ngjyrën emocionale këtyre pamjeve dhe të dhënave, ngjyrën e vet imagjinate dhe morale. Prandaj, me të drejtë thuhet se letërsia artistike, në krahasim me shkrimet e shkencave të tjera shoqërore, disponon *tepricë informacioni*, ofron më shumë informim, të cilin nuk mund ta kenë shkrimet e disiplinave të tjera. Rrjedhimisht, për realitetin shoqëror lexuesi më shumë mund të mësojë nga veprat letrare sesa nga të dhënat që ofrojnë shkencat shoqërore, që e kanë objekt kryesor këtë informim (Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999).

Gjuha e letërsisë artistike dallohet nga gjuha e një teksti joartistik me këto tipare kryesore:

- a) *gjuha ka funksion estetik,*
- b) *ajo është e figurshme,*
- c) *shprehet me emocione,*
- ç) *ka karakter imagjativ, dhe*
- d) *ka natyrë ritmike a bukurtingëlluese (në poezi).*

a) **Gjuha e letërsisë artistike ka funksion estetik.**- Letërsia është e këndshme dhe e dobishme. Kënaqësia që lind nga leximi i veprës letrare është e një shkalle të lartë, që lidhet me përshtypjen artistike, ku marrin pjesë ndjeshmëria dhe intelektu. Prandaj thuhet se funksioni parësor i letërsisë është funksioni estetik (nga greq. *asthetikos* – ndjenjë), që do të thotë të ngjallë te lexuesi ndjenjën e *së bukurës*. E bukura në art qëndron më lart se e bukura në natyrë, pasi në art ajo na jepet e plotësuar me anën shpirtërore të krijuesit.

Gjuha në letërsinë artistike jo vetëm mishëron një përmbajtje, jo vetëm kumton një informacion letrar, por edhe synon të ketë ndikim estetik, të ngjallë ndjenjën e së bukurës. Prej këtej rrjedhin një varg karakteristikash, që e dallojnë ligjërimin artistik deri në atë shkallë, sa është pohuar që këtu kemi të bëjmë me një gjuhë tjetër. Para së gjithash, kjo do të thotë se shkrimtari, së bashku me idealin e vet artistik, ka edhe idealin gjuhësor.

Letërsia është arti i fjalës në kuptimin e një pune mjeshtrërore me visarin gjuhësor. Artisti i fjalës krijon e derdh objekte estetike gjuhësore. Letërsia na jep modelet e gjuhës më të lëvruar, modelet më të bukura të ligjërimin, ajo përbën *shfaqjen estetike të shqipes*. Zbulimi i fuqive shprehëse të shqipes përbën një nga ndihmesat e shkrimtarëve tanë për kulturën shqiptare. Veprat letrare nuk shkruhen që të ndikojnë drejtpërdrejt mbi të folurit e njerëzve. Ato shkruhen për t'u përkapur (perceptuar) si një tërësi të një bote letrare dhe jo si modele për t'i ndjekur në jetën e përditshme. Ndikimi është i tërthortë. Duke qenë krijime artistike me lëndë gjuhësore, ato i japin lexuesit një pasuri të brendshme, i ngulitin modele eprore, që i shërbejnë si kuota krahasimi për nivelin e vet. Në këtë kuptim, letërsia është edhe një *shkollë e gjuhës*, një nga mjetet kryesore për edukimin me kulturë të lartë të shprehjes dhe të shijes estetike, sidomos për t'i dhënë brezit të ri qysh herët format më të çmueshme të përvojës gjuhësore që ka grumbulluar tradita shqiptare.

b) **Gjuha e letërsisë artistike është e figurshme.**- Gjuha e çfarëdo teksti shkencor, pra e një teksti joartistik e joletrar, synon të vërë komunikim të drejtpërdrejtë e të saktë me lexuesin, t'ia përcjellë atij informacionet duke e ruajtur kuptimin e parë të fjalës. Gjuha e artit letrar, përkundrazi, synon komunikim të tërthortë me lexuesin, mëton të flasë me aluzion, por që mund të nënkuptohet a të merret me mend. Përgjithësisht, gjuha në veprën joletrare është e drejtpërdrejtë, ruan kuptimin e pamë të fjalëve; ndërsa gjuha në veprën letrare është e tërthortë, fjalët i përdor në kuptimet figurative. Shumëkuptimësia e fjalëve shfrytëzohet më së miri në artin letrar, për dallim nga veprat joletrare. Figurat mund të përdoren edhe në stile të tjera, por në tekstet letrare ka një denduri shumë më të madhe të figurave.

Edhe në artin letrar, fjalitë që radhiten njëra pas tjetrës kanë kuptimet e zakonshme të shqipes (për ta perceptuar lexuesi përmbajtjen letrare), por ato kanë edhe *domethënien letrare artistike*. Teksti letrar ka të paktën dy rrafshë kuptimore, ndërsa disa herë edhe më shumë. Këtu fshihet *mundësia e disa interpretimeve të një veprë*, e disa mënyrave të ndryshme të të kuptuarit të saj nga njerëz të ndryshëm (sipas përvojës e kulturës së tyre) dhe nga epoka të ndryshme.



Shpjegim:

Aftësia për shprehje të tërthortë të mendimeve dhe të ndjenjave në artin letrar (sidomos në lirikë) e ka origjinën që nga lashtësia, në periudhën e animizmit. Njeriu i atëhershëm, duke mos ditur t'i kuptojë dhe shpjegojë drejt sendet dhe fenomenet e ndryshme të natyrës, u mvishte atyre veti të njeriut të gjallë. Kështu, duke i mveshur lumit veti

dhe veprime të njëjta me ato të njeriut, si ecjen, zhurmën, këngën etj. ne hasim në gjurmët e para të aftësisë mendore të njeriut për përfytyrime krahasuese në jetën e përditshme. Lëvizjet e reve, bie fjala, ai i kuptonte si lëvizje të një krijese të gjallë, prandaj i quan *ecje* të reve, ngjashëm me ecjen e njeriut. Me kohë njeriu përgjithësisht, e shkrimtari posaçërisht, këtë formë të lashtë të kuptuarit të sendeve dhe të fenomeneve të natyrës, e vë në funksion të shprehjes së figurshme në artin letrar.

Kur Migjeni thotë se tollumbat e Lulit të vocërr do ta hanë mësuesin, ai në fakt shprehet tërthorazi, përmes figurës, simbolit të mjerimit; në vend që të thotë drejtpërdrejt se dhembja e mësuesit që shkakton mjerimi i Lulit është aq e fuqishme, sa fare lehtë mund të shkaktojë, të nxisë sëmundje vdekjeprurëse (ashtu siç ngjau me tuberkulozin e Migjenit). Ose në vend që shkrimtari ta qortojë dhe ta akuzojë drejtpërdrejt pushtetin antipopullor dhe çnjerëzor të atëhershëm, meqë është burim kryesor i mjerimit, përmes një shprehjeje të tërthortë, kësaj here përmes aluzionit dhe ironisë, thotë se për mjerimin e Lulit sigurisht do të kujdesen këta apostuj, këta pushtetmbajtës. Lexuesi me këtë rast nuk e ka aspak të vështirë ta kuptojë drejt thënien e tërthortë, e në këtë rast të kundërtën që del nga kuptimi parësor i tekstit: përkundrazi, pushteti i atëhershëm do të kujdesej që Luli dhe shokët e tij të jetojnë në gjendje sa më të mjerueshme.

Prandaj mund të themi se shkrimet e teksteve shkencore e shprehin realitetin përmes përgjithësimesh logjike në forma konceptesh racionale, përmes ligjesh e kategorish etj., ndërsa vepra letrare këtë përgjithësim e bën nëpërmjet figurës konkrete, individuale. Shkencëtari në veprën e vet dëshmon të dhënat me tregues matematikorë, eksperimentime, fakte, argumente etj., ndërsa shkrimtari e koncepton realitetin përmes figurave dhe nuk ndjen nevojën e demonstrimit dhe të provës.

Të gjitha tiparet e një kohe a mjedisi shkrimtari i përqendron në një pikë, në një personazh që merr karakter përgjithësues. Maksim Gorki për këtë çështje, me një rast thotë: “Shkrimtari, duke njohur dhe studiuar, ta zëmë, njëzet apo pesëdhjetë shitës, nëpunës, punëtorë, nxjerr nga ata veçoritë më të përgjithshme të karaktereve të tyre, të pikëpamjeve, të zakoneve, shijeve, sjelljeve, bestytnive e kështu me radhë. Pastaj merr dhe i vendos ata te një shitës, te një nëpunës etj., duke na dhënë kështu tipin (që ka fuqi përgjithësuese) dhe ky është art.

Nazmi Rrahmani në romanin e tij *Rruga e shtëpisë sime*, tërë botën shpirtërore, vuajtjet dhe dramën e njeriut që e braktis tokën, vatrën e vet dhe arratiset në shkretëtirat e Anadollit (dramë kjo që e përjetuan shumë individë), e jep përmes dramës së një individi, a një familjeje, siç është ajo e Sylës. Duke lexuar romanin në fjalë, hasim në diçka që nuk mund ta gjejmë si informacion te shkencat shoqërore, te veprat nga sociologjia dhe historia; depërtojmë në botën shpirtërore të këtyre njerëzve, komunikojmë drejtpërdrejt me të gjitha fshehtësitë e shpirtit dhe të mendjes së këtyre njerëzve dhe ne si lexues përjetojmë çaste të fuqishme emocionale, që është një veçori tjetër e artit letrar. Kjo vlen për të gjitha veprat letrare.

c) **Letërsia artistike ka karakter emocional.**- Figurat dhe shprehjet e figurshme, me anën e të cilave shkrimtari e shpreh realitetin, na mundësojnë të bëjmë përgjithësime dhe ta ndjejmë thellë atë realitet. Ato shprehin njëkohësisht edhe botën e brendshme të vetë shkrimtarit, karakterin, psikologjinë dhe personalitetin e tij të përgjithshëm. Shkrimtari nuk është indiferent ndaj realitetit dhe botës që e rrethon, ndaj të mirës dhe të keqes në shoqëri. Përkundrazi, ai e përkrah dhe e adhuron të mirën, ndërsa e lufton dhe e urren atë që është e shëmtuar dhe jonjerëzore. Ky emocion i fuqishëm i shkrimtarit gjithsesi është i pranishëm edhe në veprën e tij konkrete dhe patjetër ky dimension i artit letrar përcillet edhe te lexuesit. Bie fjala, nuk është e

rastit dhembja që shkakton fati i Pilo Shpiragut në romanin “Lumi i vdekur”. Lexuesi ndjen simpati të fuqishme ndaj Adilit dhe Vitës dhe e urren Suat beun, për shkak se shkrimtari krijon qëndrim emocional ndaj ngjarjeve dhe personazheve, të cilin e përcjell te lexuesi. Ndjenjat dhe emocionet e veta Jakov Xoxa nuk i shpreh drejtpërdrejt - me informata, komente dhe vlerësime, por tërthorazi - nëpërmjet gojës dhe veprimit të personazheve.

Ligjërimi i letrarëve është **të folur i emocionuar me përpunim artistik**. Autori kurdoherë përpiqet që nëpërmjet organizimit stilistik të japë një përshtypje, një atmosferë, një ndjenjë dhe të arrijë një efekt.

Nuk është kurrfarë rastisje që ne, gjatë leximit të një vepre letrare, duke ndjekur fatin e një personazhi, dëshpërohemi, pikëllohemi, revoltrohemi deri në atë masë sa jemi në gjendje të ndërmarrim veprime konkrete, pa e kursyer fare veten. Shembuj të këtillë që e emocionojnë lexuesin ka në secilën letërsi kombëtare. Poezia jonë e Rilindjes Kombëtare, dukshëm dhe me sukses është inkuadruar në rrjedhat demokratike për mobilizimin e masave të gjera popullore drejt çlirimit dhe pavarësisë kombëtare. Kjo forcë mobilizuese shpesh ka qenë shumë më efikase sesa shkrimet, thirrjet dhe apelet e drejtpërdrejta politike dhe luftarake drejtuar popullit.

ç) **Letërsia ka karakteri imagjativ**.- Karakteri figurativ, emocional e imagjativ i letërsisë artistike përbëjnë një unitet pa të cilin nuk mund të sajohet arti letrar. Shqyrtimi veç e veç i këtyre aspekteve të artit letrar bëhet vetëm për qëllime praktike.

Veçori e natyrës së njeriut është që të ëndërrojë, të imagjinojë e të fantazojë. Kjo aftësi shprehet sidomos në punën krijuese të shkrimtarit. Shkrimtari zgjedh një personazh dhe rrëfen historinë a dramën e tij jetësore. Por, ky individ nuk është njeri konkret që ka ekzistuar plotësisht si i tillë. Shkrimtari, duke njohur mirë jetën, shpirtin dhe botën e njeriut përgjithësisht, sajton figura të reja sipas imagjinatës vetanake. Natyrisht, kjo figurë pjesërisht apo tërësisht e imagjinuar, do të shprehte veçoritë themelore të atij mjedisi, të atij grupi njerëzish, të asaj klase. Prandaj, nuk është fare e rëndësishme se a ka ekzistuar me të vërtetë një Pilo Shpiragu, ashtu siç e paraqet shkrimtari në romanin *Lumi i vdekur*, a ka pasur këtë emër apo këtë familje, por me rëndësi është mënyra si ai e shpreh gjendjen e përgjithshme të fshatarësisë së asaj kohe. Nuk do mend se këtë personazh shkrimtari e ka krijuar përmes imagjinatës së lirë krijuese, e cila mbështetet dhe ushqehet thellësisht nga realiteti i jetës së sotme a të dikurshme të shoqërisë.

Nga kjo që u tha mund të nxirret përfundim se arti letrar nuk është kopje besnike e realitetit objektiv, por është pjellë e fantazisë krijuese të shkrimtarit, është një realitet artistik. Megjithatë, për letërsinë artistike nuk ka rëndësi a ka ndodhur diçka e tillë apo jo, por ka rëndësi mënyra e paraqitjes artistike të ngjarjeve dhe personazheve, që nuk e vë në dyshim bindjen e lexuesit. Gjatë hartimit të veprës letrare, shkrimtari shërbehet me imagjinatën e vet, sajton dhe shpik momente, ngjarje dhe figura; por ajo imagjinatë e tij duhet të ketë dhe ka gjithnjë për bazë të mundshmen reale. Pa këtë mbështetje ajo nuk mund të ngrihet në nivelin e vlerave të vërteta artistike letrare.

Ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet një romani historik dhe një libri historie. Trillimi artistik dhe fantazia e shkrimtarit bëjnë që një personazh të ndryshojë nga një figurë historike ose një figurë në jetën reale. Mbi të njëjtën ngjarje apo fakt historik ai i ofron lexuesit një lloj tjetër njohjeje dhe ndjeshmërie. Le të marrim si shembull cilindo roman të zhanrit historik dhe do të bindemi lehtë për rolin e imagjinatës krijuese në punën e shkrimtarit. Për shembull, romanet që shtjellojnë ngjarje nga historia jonë e lavdishme kombëtare e shekullit XV, siç janë *Historia e jetës dhe të bëmave të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut* e Marin Barletit, *Kështjella* e Ismail Kadarese, *Skënderbeu* e Sabri Godos etj., të cilat po të krahasohen me të dhënat historike,

veprat letrare nuk pasqyrojnë me besnikëri historinë, të dhënat, ngjarjet e kësaj epoke dhe figurën e Skënderbeut.

Dallimi qëndron pikërisht në mënyrën e komunikimit ndërmjet letërsisë si art dhe historisë si shkencë shoqërore. Te romanet që përmendëm, jepet bota e gjallë mendore dhe shpirtërore e Skënderbeut dhe e njerëzve të kohës së tij, të cilën shkrimtarët e kanë krijuar në saje të imagjinatës së tyre. Shkrimtari ka mundur të depërtojë në botën shpirtërore, në ndjenjat, në ëndrrat më intime të Skënderbeut vetëm në bazë të njohurive të thella historike për atë figurë dhe atë kohë të lavdishme.

Sabri Godoja në romanin e vet për Skënderbeun, siç dihet, solli edhe personazhe që nuk përkojnë me të vërtetën historike, por që në art janë po aq të rëndësishëm sa edhe heronjtë e vërtetë, sepse lexuesi nuk dyshon për asnjë çast në vërtetësinë e tyre, për shkak se paraqitja, sjelljet, mendimet, bindjet e tyre janë plotësisht në përputhje me të mundshmen brenda atij realiteti historik (sipas stilistit më të madh shqiptar Xhevat Lloshit, Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999).

d) **Letërsia artistike ka natyrë ritmike-bukurtingëlluese.**- Ato krijime letrare që realizohen nëpërmjet vargut, shfrytëzojnë natyrën dhe mundësinë e tingullit, të fjalës për të sajuar ritëm, harmoni ritmike, bukurtingëllimin (eufoninë) dhe muzikalitetin e zërit. Jo vetëm në veprat letrare që shkruhen në vargje, siç janë vjershat e shkurtra, por edhe gjatë të folurit të zakonshëm organizimi a sistemimi i rregullt i fjalëve dhe fjalive, shqiptimi i qartë e melodik i tyre, e bën ligjërimin tonë më të gjallë dhe më tërheqës për ata që e dëgjojnë.

Te veprat në vargje, natyra ritmike shprehet dukshëm dhe luan rol të rëndësishëm në vlerën e përgjithshme të veprës. Prandaj, organizimi dhe sistemimi harmonik i njësive të gjuhës: i tingujve, i rrokjeve të theksuara e të patheksuara, morfemave, fjalëve, fjalive dhe vargjeve, është anë e rëndësishme e vlerës së përgjithshme të veprës letrare. Kur shkrimtari të gjitha këto efekte të natyrës bukurtingëlluese arrin t'i orkestrojë me përmbajtjen, porosinë kuptimore të fjalës, të vargut dhe të vjershës në tërësi, për të arritur efekte më të fuqishme emocionale, kuptimore e imagjinative, atëherë themi se ato janë në funksion të vlerave artistike.



Pyetje dhe detyra:

1. Me cilat tipare dallohet gjuha e letërsisë artistike nga gjuha e teksteve joartistike dhe si i shpjegoni ato?
2. Nga pjesët e shkëputura, cilat i përkasin letërsisë artistike e cilat janë tekste joartistike:

“Koha gjithnjë e më tepër turbullohej dhe vargu i fëmijëve vazhdoi udhën e vet gjarpëruese. U suall andej-këndeje nëpër rrugë e rrugica e pastaj prapë u ndal. Kësi hovi përpara kafehanes së kafexhiut të njohur si grindavec të pashoq. Por ata nuk u ndalën për këtë cilësi të karakterit të tij. Vëmendjen e tyre e tërheqnin petkat e tij të larme e jo të zakonshme për këtë krahinë. Petkat egzotike dhe të stolisura për mrekulli. Kësaj here edhe për një gjë tjetër u ndalën para derës së tij. Donin të shihnin se si duket njeriu të cilit i ka ikur gruaja, për çka flitej nëpër mëhallë. Në kryet e tyre kushedi se sa fantastike u pasqyrohej kjo ngjarje...”

“Njeriu është qenia e gjallë më e përsosur. Trurin e ka aq të zhvilluar sa që mund të mendojë, të mbajë mend, të lexojë, të shkruajë etj. Te njeriu është zhvilluar edhe të folurit si mjet

për t'u kuptuar dhe për t'u marrë vesh me të tjerët. Prej kur ekziston njeriu, ai jeton në bashkësi me njerëzit e tjerë...”

“Kriteret mbi bazë të të cilave zgjidhet një variacion për bazë të një gjuhe standarde janë gjithmonë relative. Si shembull po marrim një fjali: *Po shkoj me punue*. dhe *Po shkoj të punoj*. S’ka arsye për të cilat këto dy fjali gjuhësisht do të duhej të kishin status të ndryshëm në shqipen standarde. Nga aspekti i sistemit të shqipes, kjo qëndron, porse nga aspekti i normës thuhet se fjalia e parë nuk është e shqipes letrare për shkak se paskajorja e tipit *me punue* i mungon dialektit bazë të gjuhës letrare, edhe pse si zor se mund të zëvendësohen të gjitha funksionet e saj, kur kemi parasysh rrafshin e realizimeve të ndryshme stilistike e sociokulturore...”

“Plaç o jeta ime, plaç, kam klithur sa e sa herë, plaç o ëndërr e gjatë e pafund! Sa herë e kisha sosur t’i ulem dhembjes sime dhe t’i dal me krye duke e bërë atë, dritë ... E kisha bërë poezi, rrëfenjë, groteskë, roman, parabolë, dramë, ëndërr të mistershme, udhëkryq, labirinth, humnerë, terr, tmerr e ferr (për lakejtë për shembull), e kisha sosur ta përkëdhel si dregëz, e kisha nisur, prekur e kruar, kurse krejt kjo përherë e më shumë po më shndërrohej në një plagë që në vend që të më mbyllej veç hapej e zgjerohej, hapej e zgjerohej dhe i merrte tiparet e një plage që do të merrte të tërin, po bëhej dregëz-plagë-varrë që prej meje kërkonte ta shprehte edhe atë që unë s’e kisha dhe objektivisht ishte e pamundur ta posedoja ...”

“Gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane. Karakteri indoevropian vërehet në të gjitha sistemet gjuhësore: në leksik, fonetikë e gramatikë. Përkatësisht, të kësaj lëndeje të lashtë i.e. janë ato elemente që kanë analogji në gjuhët e tjera i.e. Kështu, rreth dy mijë fjalë të shqipes janë me origjinë indoevropiane: *ujk*, *natë*, *dimër*, *dhëndër*, *bir*, *bijë*, *vjehërr*, *motër*, *ballë*; *përemrat ti*, *mua*, *imi*, *ky*, *kjo etj.*; *foljet bie*, *jam*, *rri*, *shoh*, *mbjell*, *djeg*, *mbledh*, *marr*, *bëj*, *bind etj.* Pesë zanoret e shqipes /a, e, o, u, i/ janë të trashëguara, ndërsa zanoret /y, ë/ janë krijuar më vonë. Numri më i madh i bashkëtingëlloreve janë trashëguar nga një fazë e hershme i.e. Në strukturën gramatikore është trashëguar sistemi trigjinish, lakimi dhe zgjedhimi me anë mbaresash të posaçme, supletivizimi (ndërtimi i formave foljore nga tema rrënjësh të ndryshme, si *jam – qeshë*, *kam-pata*) etj. Mirëpo, duhet pasur parasysh se jo e gjithë pasuria leksikore e format gramatikore janë të trashëguara. Gjuha shqipe ka pasur rrugë të mëvetësishme evoluimi. Ka krijuar fjalë të reja, ka huazuar dhe ka krijuar me gjuhët e tjera të arealit një lidhje gjuhësore ballkanike.

Ajo është gjuhë ballkanike dhe nuk ka lidhje birërie me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane, por formon një degë më vete. Është gjuhë flektive sintetike-analitike. I përket grupit të gjuhëve flektive sepse bën lakimin e pjesëve emërore dhe zgjedhimin e foljeve. Gjuhët sintetike kuptimet gramatikore dhe lidhjet sintaksore midis gjymtyrëve të fjalisë i shprehin me anë formash gramatikore sintetike (me një formë unike), që ndërtohen nëpërmjet mbaresave (rasore ose vetore), nëpërmjet ndërrimeve morfologjike dhe supletivizimit. Në gjuhët analitike lidhjet sintaksore midis gjymtyrëve të fjalisë shprehen me fjalë shërbyese (sidomos me parafjalë) që përdoren para një pjese emërore. Gjuhë tipike analitike është maqedonishtja. Gjuha shqipe për të shprehur raporte sintaksore krahas formave sintetike, përdor edhe forma analitike: ajo ka një sistem rasor mjaft të zhvilluar, por përdor edhe parafjalë e fjalë të tjera shërbyese. Edhe në sistemin foljor përveç formave foljore sintetike (*punoj*, *punoja*, *punova*, *punuakam*) përdor edhe forma analitike (*kam punuar*, *kisha punuar*, *pata punuar*; do të *punoj*, të *punoj etj.*)”

2.6.4.1. GJUHA E PROZËS

Veçoritë e jashtme dhe të brendshme të gjuhës së prozës.- Vepër letrare mund ta quajmë edhe një poezi të shkurtër prej tre-katër vargjesh, njësoj si edhe një roman vëllimor. Format dhe llojet letrare janë të shumta. Krijimet letrare kanë dy forma kryesore: prozën dhe poezinë. Ndarja e letërsisë në prozë e në poezi bëhet në bazë të veçorive të tyre të jashtme dhe të brendshme. Tipar i jashtëm (pamor, vizuel) është se proza shkruhet në tërë faqen, me rreshta të ngjeshur, me fjali të njëpasnjëshme e periudha të gjata.

Veçori e brendshme është se proza i shtjellon gjërat shtruar (gjerë e gjatë), aty flet edhe autori edhe personazhet. Në gjuhën e prozës ndërthuren rrëfimi, monologu dhe dialogu. Aty kemi përshkrim të hollësishëm të një ngjarjeje me disa personazhe, përmes të cilëve shkrimtari rrëfen në vetën e tretë dhe në kohën e shkuar. Raporti i shkrimtarit ndaj realitetit është objektiv, i përmbajtur, me një nuancë subjektive e emocionale. Shkrimtari përcakton jo vetëm karakteret, ngjarjet, mjedisin etj., që do ta paraqesë, por edhe formën se si do të tregojë për to: kohën, rendin kronologjik të paraqitjes së ngjarjeve apo rendin jokronologjik, bën paraqitje të qartë ose të mjegulluar etj.

Me pak fjalë mund të thuhet se *në prozë mbizotëron objektiviteti i shkrimtarit, me ngjyrim subjektiv; ndërsa në poezi (lirike) mbizotëron forma e shprehjes subjektive, bota e brendshme intime.*

Në gjuhën e prozës shkrimtari nuk shprehet përmes formës subjektive apo emocioneve, por mbizotëron karakteri epik, realiteti shprehet përmes rrëfimit të gjithanshëm objektiv. Por, shkrimtari i veprave në prozë edhe pse shpreh realitetin në mënyrë objektive (pra edhe pse nuk rrëfen në emër të vet, por përmes personazheve), ai përsëri, në secilën vepër, qoftë roman, tregim, novelë apo ep, shpreh njëkohësisht edhe qëndrimin e vet subjektiv. Shkrimtari i një romani duke e rrëfyer ngjarjen, njësoj si lexuesi, simpatizon dhe adhuron një kategori njerëzish dhe i urren të tjerët, negativët. Pra, edhe ai shpreh qëndrimin e vet subjektiv lidhur me botën e veprës, por këtë e bën tërthorazi, përmes gojës dhe veprës së personazheve. Megjithatë, ana subjektive, emocioni i drejtpërdrejtë në prozë nuk është veçori kryesore, siç është te poezitë lirike.

Proza është e organizuar në mënyrë më të çlirët gjuhësore se poezia.- Proza është një tip ligjërimi letrar, që vjen nga përpunimi artistik i rrëfimit dhe i monologut. Aty ndërthuren të gjitha format e tjera të gjuhës së shkruar e të folur. Prozatori punon për ndërtimin e realitetit letrar, duke pasur në dorë lëndën gjuhësore, mjetet dhe mundësitë shprehëse.

Gjuha e prozës është shumë afër komunikimit të përditshëm. Shpesh kuptimi shprehet me shumë fjali, fraza të tëra, madje nganjëherë edhe me tekste të plota. Edhe proza mbështetet në zgjedhjen dhe përdorimin e figurshëm të fjalëve, në shumëllojshmërinë e tyre, të frazeologjisë e të krahinorizmave, përdor spektrin e gjerë të karakterizimit të gjuhës së personazheve etj.

Në organizimin gjuhësor të prozës u kushtohet më pak rëndësi njësisive të vogla, fjalëve dhe tingujve, prandaj proza përkthehet shumë më lehtë se poezia. Në prozë njeriu ka përqendruar botëkuptimin e tij, besimin, filozofinë jetësore, përvojën e brezave, duke u dhënë kuptim dukurive të botës që e rrethon. Krijime të tilla janë ruajtur edhe në trajtën gojore (përralla, mite, legjenda) dhe kanë përcjellë përvojën e tyre brez pas brezi.

Mënyra epike e tregimit në prozën e zakonshme letrare është ndërthurje e gjuhës së shkrimtarit, gjuhës së autorit, gjuhës së personazheve dhe gjuhës së rrëfimitarit. *Gjuha e*

shkrimtarit përfshin gjithçka që ai ka shkruar, nga rreshti i parë e deri në rreshtin e fundit të një vepre. *Gjuha e autorit* përfshin pjesën e tekstit pa fjalët e personazheve. *Gjuha e personazheve* përfshin pjesën e tekstit që e shqiptojnë ose e mendojnë personazhet e veprës, ndërsa *gjuha e rrëfimitarit* janë fjalitë që i përkasin një figure, e cila merr përsipër të tregojë në vend të autorit. Rolin e rrëfimitarit, që flet në vetën e parë, mund ta marrin përsipër personazhe të ndryshme.

Siç shihet, prozatori ka një gamë të gjerë mënyrash për organizimin gjuhësor dhe për ndërthurjen e tyre, të cilat japin mundësi të mëdha për larminë stilistike. Gjuha shndërrohet në objekt të riprodhimit artistik dhe kjo është një dëshmi tjetër e rolit të shkrimtarëve në përpunimin e gjuhës.

Poezinë është vështirë ta themi me fjalët tona, sepse kuptimi i saj del vetëm në trajtën që është dhënë, kurse proza kuptohet dhe tregohet më lehtë. Në prozë ndërhyjnë gjerësisht vetë autori në rolin e tregimitarit, që shprehet me ligjëratë të zhdrejtë, teksti i të cilit zakonisht jepet vetëm në vetën e tretë ose në vetën e parë. Fjalët e personazheve përbëjnë monologun dhe dialogun e prozës dhe jepet në ligjëratë të drejtë.

Edhe pse dallimet ndërmjet gjuhës së prozës dhe të poezisë janë të dukshme, ka raste kur është vështirë të dallosh një prozë nga poezia, në veprat që thyejnë rregullat e organizimit të tyre, siç ndodh me prozën e shkurtër moderne, që është e ngjashme me prozën.



Pyetje dhe detyra:

1. Cilat janë tiparet e gjuhës së prozës?
2. Lexojeni një krijim letrar në prozë dhe një poezi. Shpjegojeni përmbajtjen (syzheun) e tyre.
3. Përkthejeni një fragment të prozës dhe një poezi!
4. Nga tekstet e mëposhtme letrare në prozë dalloni gjuhën e autorit dhe gjuhën e personazheve:

“Më kot bujtinari qe përpjekur ta qetësonte duke ia shpjeguar punën. Ai qe tërbuar më keq: domethënë të tilla lemerira bëkan ata me zërat e lahutarëve. Ata janë zëra djalli e jo njeriu. Dhe ti lejon që kjo hata të bëhet mu në bujtinën tënde. Turp për ty, Shtjefën.

Që nga rruga, ai i kishte thirrur edhe një herë. Ruhu, Shtjefën! Ke futur djallin në bujtinë, më dëgjon?

Ndonëse bujtinari nuk u tregoi veçse një pjesë të bisedës, ata u mërzhitën. Pastaj e qetësuan veten se në fund të fundit një mosmiratim i tillë i punës së tyre ishte i natyrshëm. Regjistrimi i epeve ashtu si edhe botimi i tyre vite më parë s’kishte qenë veçse një kambanë vdekjeje për rapsodët. Sa vinte ata po bëheshin më të panevojshëm...” (Ismail Kadare, *Dosja H*)

“E kam njohur djaloshin që i ka shkruar këta rreshta, e di që ka pasë ëndërra të çuditshme mbi pavdekësinë dhe nuk mund ta kuptonte se fjalët qenë bërë tepër të rrezikshme. Njerëzit vdisnin sa flisnin. Po kështu i pat ndodhur edhe atij. Fjalët i qenë bërë kryeneqe, shpërthenin nga gjaku i tij i ri dhe me të gjithë pakujdesinë rinore vërviteshin, bëheshin zhurmuese, sigurisht, patën arritur ndër vende të rrezikshme. E di që prej atje qenë kthyer të shndërruara në ushtarë të armatosur dhe e patën marrë me vete djaloshin...” (Zejnullah Rrahmani, *Sheshi i unazës*)

“- Po ti ç’do me kovaçët?

- Hyra në punë tek këta.

- Pse s'erdhe tek ne?
- Është ca larg, - tha Dini dhe e ftoi të ulej.
- Jo, jo, jemi shumë, po presim në këmbë.
- Po Titi s'qenka me ju?
- Tashti duhet të vijë.
- Dhe prapa diellit po të jetë do të vijë, - tha Dulla, cili është ai njeri që s'vjen sot në birrari?
- Mos i jepni më këtij, se e paska kaluar masën, - tha shoferi dhe pasi i shtrëngoi dorën Dinit, - u largua..." (Dhimitër Xhuvani, *Përsëri në këmbë*)

2.6.4.2. GJUHA E POEZISË

Poezia dallohet dukshëm nga proza. Nga ana e jashtme shihet se poezia shkruhet në një pjesë të faqes, zakonisht në mes, në vargje ose në njësi poetike, që vijnë njëri pas tjetrit. Pra, në të shkruar poezia ka pamjen e një kolone në vargje. Proza shkruhet në tërë faqen, me rreshta të ngjeshur, fjali të njëpasnjëshme e periudha të gjata. Veçori e brendshme e poezisë është se ajo zakonisht nuk ka ngjarje, nuk kanë personazhe etj. Raporti i poetit ndaj realitetit është subjektiv dhe poeti aty flet vetë, në vetë të parë dhe në kohën e tashme.

Duhet pasur parasysh se nuk ka gjini e lloje të pastra vetëm lirike ose vetëm epike, meqë edhe te të parat janë të pranishme nuancat epike, siç janë të pranishme nuancat lirike te të dytat. Pohim më i drejtë do të ishte: *te poezitë mbizotëron natyra lirike e të shprehurit të botës, ndërsa te proza mbizotëron karakteri epik.*

Duhet thënë se përpjesëtimi i frymës lirike ndaj epikes varet nga lloji i poezisë. Lloji më tradicional i poezisë është poezia e shkurtër ose e vogël, që zakonisht e quajmë *poezi lirike*, ku shquhet disponimi emocional, intim dhe subjektiv i poetit. *Poezia epike* është më e gjatë, trajton tema më të gjera, me ngjarje e personazhe të ndryshme, ku ka më pak lirizëm dhe ku njërive më të vogla gjuhësore dhe efekteve të tyre u kushtohet më pak vëmendje. Një lloj tjetër poezie është *poezia dramatike*, veçori kryesore e së cilës janë konflikti i tensionuar, dialogu e monologu, vënia e saj në skenë etj.

Organizimi epror i gjuhës së poezisë në të gjitha nivelet.- Poezia është shfaqje më eprore e organizimit dytësor, prandaj ajo edhe në shkrim dallohet nga të gjitha mënyrat e tjera të paraqitjes së gjuhës. Tiparin themelor të ligjëritimit poetik e përbën *organizimi më i mirë i mundshëm i të gjitha niveleve gjuhësore*. Në të marrin vlera të veçanta mjetet fonetike, prozodike, shkrimore, morfematike, leksikore, semantike, sintaksore etj. Elementet kryesore mbi të cilat ndërtohet poezia janë ritmi, rima, theksi, rrokja etj.

Në poezi meqë paraqitja e ndjenjave, e mendimeve, e përjetimeve dhe e përshtypjeve bëhet me afsh, me hov të brendshëm, me pjesëmarrje subjektive, atëherë edhe shtjellimi i veprës lirike duhet t'i drejtohet epiteve, muzikalitetit e melodisë. Parimi drejtues i këtij organizimi është ritmi. Me ritëm nënkuptojmë anën melodike, muzikore të poezisë, d.m.th. harmoninë e brendshme të vargut. Në krijimin e ritmit të vargut marrin pjesë numri i rrokjeve, pauzat dhe masa ritmike e vargut. Masa ritmike përbëhet prej harmonisë së numrit të rrokjeve. Ndër masat më të njohura ritmike janë: *jambi* (që përbëhet prej dy rrokjeve: e para e shkurtër dhe e dyta e gjatë), *trokeu* (po ashtu përbëhet prej dy rrokjeve, porse këtu e para është e gjatë, ndërsa e dyta e

shkurtër), *daktili* (që përbëhet prej tri rrokjeve, nga të cilat e para e gjatë, kurse dy të tjerat të shkurtra).

Në poezinë tradicionale ritmi mishërohet në vargjet, që janë njësi të barasmatshme dhe me theksa pak a shumë të rregullt. Në zhvillimet e mëtejme të poezisë sonë ky parim është zbatuar në qelizat ritmike, të cilat ndërthuren në trajta më të ndërlikuara. Në vargjet e Asdrenit:

*Ardhi koha, ardhi dita,
Iku nata, doli drita,
Ngrihu trima, mos përtoni,
Këtë kohë ta shpëtoni!*

ka simetri të plotë të vargjeve, që përforcohet nga rima.

Ritmi është pikënisja për të arritur harmoninë tingullore të poezisë. Ndërkaq muzikaliteti nuk e përjashton emocionalitetin, prandaj rolin e harmonisë së masave metrike dhe të rimave mund ta marrë intonacioni, që mbështetet në melodikën e qelizave ritmike, ose edhe mund të ndërthuren të dyja mënyrat bashkë.

Që me Migjenin në poezinë shqipe ka zënë vend të qëndrueshëm vargëzimi i mbështetur në ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore, me elemente të rrëfimit lirik.

Mendimi poetik i shkruar në vargje shprehet nëpërmjet organizimeve tingullore në masa ritmike. Ky strukturim ritmik ndërthuret me të gjitha nivelet e tjera të gjuhës, kështu që fonetika, gramatika dhe leksiku janë në marrëdhënie të pandara.

Tiparet e gjuhës së poezisë.- Gjuhën e poezisë e karakterizojnë *sintaksa poetike, leksiku poetik* dhe *figurshmëria*.

Sintaksa e vargjeve ka një liri të madhe poetike, saqë përmban edhe shmangie nga sintaksa e zakonshme. Ajo u nënshtrohet kërkesave që nisin nga rima e theksi e vijnë deri te llojet e strofave. Sintaksa është faktori veprues kryesor në vargjet, sepse bashkërendon elementet e tjera, ndërton grupet e krahasueshme ose paralele, krijon rrethanat ligjërimore që diçka të shquhet. Togjet sintaksore, që shndërrohen në grupe ritmike, sajojnë intonacionet karakteristike të poezisë, ndërsa përsëritja e tyre krijon lëvizjen melodike. Tradita letrare ka zbuluar se simetria, drejtpeshimi i gjymtyrëve, paralelizmi, rimarrja ritmike etj. sjellin muzikalitet dhe ngjallin kënaqësi estetike. Fjala a togu i zhvendosur gjen pikën më me efekt nga ana ndërtimore e, rrjedhimisht, edhe kuptimore. Rasti më i thjeshtë është rima ose asonanca: fjalët në këto marrëdhënie fitojnë edhe lidhje kuptimore.

Fjalët e një vjershe përbëjnë një bashkësi të ndërlikuar, nga e cila përftohet një rrafsh kuptimor i ri. Poezia i jep mundësi fjalës të dalë me gjithë pasurinë kuptimore dhe shumëllojshmërinë e lidhjeve asociative, të përtërijë etimologjinë, fjalëformimin, fushën semantike etj. Me procesin e poetizimit, ku ajo në poezi shenjon, paraqet, shpreh, evokon, sugjeron etj. fjala bëhet mjet i të bukurës, fiton vlera estetike. Krijohen fjalë të reja, sintagma tipash të ndryshëm, shfrytëzohen mundësitë fjalëformuese të shqipes etj. Stilistët kanë vënë re varësinë ndërmjet mënyrës së shtjellimit dhe dendurisë së shfaqjes së fjalëve. Fjalët që kanë lidhje me motivin kryesor që shtjellohet kanë denduri më të madhe përdorimi. Kështu, shqipja me folklorin e pasur dhe me traditën letrare na ka sjellë një mal figurash e shoqërimesh, një leksik poetik.

Figurshmëria është tipar i përhershëm i poezisë. Figurat ose tropet lidhen drejtpërdrejt me imazhin në poezi dhe tërheqin shumë vëmendjen e lexuesve. Figurshmëri gjuhësore ka kurdoherë në çdo tekst letrar, përfshirë këtu edhe prozën; por poezia shquhet më shumë se të

tjerat për shenjzimin e fshehur. Figurat në poezi shërbejnë për të ngjallur ndjenjën estetike, kanë ngarkesë artistike. Poeti mendon me figura, e riprodhon ose e krijon jetën në mënyrë të figurshme.



Pyetje dhe detyra:

1. Cilat janë veçoritë e gjuhës së poezisë?
2. Ç'mund të thoni për sintaksën, leksikun dhe figurshmërinë e gjuhës së poezisë më të njohur simbolike të Lasgush Poradecit:

Vdekja e nositit

Me zjarr ju flas..., me zjarr.
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë-edhe t'j-a mar...

Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zogjtë-e mi,
Dh'u jap ushqim me dashuri –
Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...
Dh'e hap ah!-gjirin më një ças...,
Dh'i nginj ah! zogjtë-e vdes me gas!...

Ahere-helmohet e buçet
Pas mallit t'im liqeri-i shkret,
E rit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.

E shpirtin dyke ma përcjellë,
Më thotë ah! shih sesa 'sht'i fellë
Ky gjir'i em që pat pjellë...

... Me zjarr ju flas, me zjarr.

2.7. STILI I SHKRIMTARIT

Në mënyrë të sforcuar shpesh thuhet se stili i një shkrimtari është po aq i veçantë aq sa edhe gjurma e gishtërinjve të tij. Por, pohimi se stili është karakteristikë themelore e një individi,

që moti është pranuar si i saktë. Shumë përkufizime për stilin lidhen me veçorinë individuale të folësit ose shkruarit, se: stili është veçanti e ligjërimit, që shpreh gjenialitetin dhe talentin e atij që shkruan; stili të shkrimtarit dhe piktorit nuk është çështje e teknikës, por e botëkuptimeve të tyre.

Çdonjëri prej nesh nga përvoja lexuese e di se shumë shkrimtarë kanë realizuar një lloj veçantie stilistike, e cila na mundëson që të identifikojmë lehtë stilin e tyre. Nga kjo pikëpamje, në gjuhësi u bë dallimi ndërmjet gjuhës - si pronë e mbamendjes kolektive të një shoqërie, dhe ligjërimit - si përdorim konkret i gjuhës dhe idiolektit, si ligjërimit i një individi. Stili i një shkrimtari mund të njehet me idiolektin.

Tiparet e stilit të një shkrimtari, si gjuhë individuale, mund të vëzhgohen edhe me metodën statistike: denduria e përdorimit të fjalëve të caktuara të ndonjë shkrimtari, raporti numerik i emrave dhe i foljeve në tekstet e tij, përdorimi i figurave stilistike etj. Analizat e tilla mund të ndriçojnë stilin e një shkrimtari, por edhe të përcaktojnë autorësinë e teksteve të vjetra dhe kohën e shkrimit të tyre.

Me stilin e veprave letrare shihet aftësia krijuese, origjinaliteti dhe natyra shpirtërore e shkrimtarit. Shkrimtari ka rol aktiv ndaj gjuhës që e përdor, ai zgjedh çfarë do të thotë dhe si do ta thotë. Rrjedhimisht, me shprehjen e tij gjuhësore, me stilin e tij gjithnjë legjitimon vetveten. Sipas kësaj, gjithnjë ka ndërlidhje ndërmjet personalitetit të shkrimtarit dhe stilit të tij.

Çdo vepër letrare është krijim individual gjuhësor i një shkrimtari. Autori i një veprë letrare shpesh është cilësuar si njeri i veçantë, i zgjedhur, i cili në çaste të caktuara shpirtërore frymëzohet dhe krijon veprën letrare. Çdo njeri ka mënyrën dhe formën e vet karakteristike të shprehjes, meqë përmes tij shprehet bota e brendshme, psikologjia dhe karakteri i individit, që është i papërsëritshëm. Secila vepër letrare është një tërësi më vete, në qendrën e së cilës gjendet shpirti i krijuesit, që përfaqëson kohezionin e veprës.

Gjuha është anë, mjet dhe formë e veprës letrare.- Mjetet e veçanta gjuhësore-shprehëse përbëjnë stilin individual të shkrimtarit. Zgjedhja dhe funksioni që çdo shkrimtar u jep këtyre shprehjeve në ligjërimitin e vet bëjnë që ai të dallohet nga të tjerët. Sa më me mjeshtëri që shërbehet ai me këto mjete gjuhësore, aq më të përsosur e ka stilin. Kur një shkrimtar e ka formuar stilin vetanë, ne nuk e kemi vështirë ta hetojmë veprën e tij letrare edhe pa ia parë emrin.

Mund të thuhet se stilin e mirë të një shkrimtari e përbëjnë ato mjete shprehëse gjuhësore, që në bazë të mbarështrimit të vet, kur i lexojmë na bëjnë përshtypje të fuqishme. Mundësitë e shumta zgjedhëse që ofron gjuha në të gjitha fushat, duke filluar që nga ana tingullore (fonetikë), nga fjala dhe mundësitë e saj për të dhënë efekte dhe kuptime të shumta (leksikologji, morfologji, semantikë) e deri te renditja e fjalëve dhe thurja e fjalive (sintaksë) përbëjnë burimet për sajimin e stilit të një veprë, të një shkrimtari, të një brezi, të një epoke etj.

Se si do të shërbehet shkrimtari me këto mundësi të pashtershme të gjuhës, në radhë të parë varet nga shkalla e njohjes dhe e zotërimit të asaj gjuhe. Po ashtu, stilin e një ligjërimit letrar të cilitdo shkrimtar e përcakton edhe formimi arsimor e letrar i tij, bindjet, temperamentit, karakteri, përvoja dhe pikëpamjet e tij për botën dhe jetën. Prandaj për dikë thuhet se është më i qartë dhe më i lehtë në të rrëfyer, e për dikë themi se është më i rëndë, më konfuz; për dikë se është me temperament të butë, me emocione të qeta në të shprehur, e për dikë tjetër themi se është më i rrëmbyer, më dinamik, më eksploziv etj.

Meqë natyrën, cilësinë, funksionin e stilit, përveç veçorive individuale, arsimore, psikologjike të shkrimtarit, e përcaktojnë edhe rrethanat kulturore e historike gjegjëse, dallojmë stile të ndryshëm gjatë shekujve dhe periudhave të ndryshme letrare. Kështu, dallon stili i

letërsisë artistike në epokën antike greke nga stili i letërsisë së renesancës, stili i epokës klasiciste nga ai i romantizmit etj. Secila nga këto epoka të mëdha letrare ka veçoritë e veta dalluese në përdorimin e gjuhës dhe ato veçori janë shprehje e botës individuale dhe kolektive të asaj kohe, pasqyrë e rrethanave, e botëkuptimeve, e idealeve, e besimeve etj. Prandaj, me të drejtë mund të thuhet se stili i ligjërimit është pasqyrë e botës shpirtërore dhe intelektuale e njeriut. Pra, stili është vetë njeriu, individualiteti, ekzistenca e tij, mënyra e tij origjinale e të vështruarit të botës.

2.8. KUJDESI QË I KUSHTOJNË SHKRIMTARËT GJUHËS

Shkrimtarët i kushtojnë kujdes të madh gjuhës në veprat e tyre. Ky kujdes është shprehur për bukuri në punën e çdo shkrimtari të madh. Shumëkush pandeh gabimisht se shkrimtarët janë njerëz që kanë prirje të madhe për të shkruar, prandaj nuk hasin në kurrfarë vështirësish gjatë hartimit të veprave të tyre. Mirëpo, ata që kanë pasur mundësi të gjurmojnë punën krijuese të shkrimtarëve, flasin ndryshe. Për kujdesin dhe mundin e tyre dëshmojnë shënime të shumta që na kanë lënë shkrimtarët dhe versionet e shumta të veprave, deri në formën përfundimtare të tyre. Shumica e shkrimtarëve kanë mbajtur shënime në fletore të veçanta, duke regjistruar me kujdes fjalë e fraza të ndryshme, të cilat i kanë dëgjuar në popull ose i kanë gjetur të shkruara nëpër libra, revista, gazeta etj., që dëshmojnë zellin e tyre në lëvrimin e gjuhës. Kështu, siç dihet, Maksim Gorki nuk e kishte dorëzuar një tregim në shtyp në kohën e paraparë derisa iu kujtua një fjalë e nevojshme që assesi nuk i kujtohej. Floberi shkruan se “po mbushet gati një muaj qyshkur po përpiqem të gjej katër fraza të shkreta që po më nevojiten”. Balzaku në një letër pohon se “secilën faqe e kam shkruar nga 50 deri më 60 herë. Nuk ka asnjë tabak shtypi ndër veprat e mia, që të mos e kam korrigjuar nga 17, 18 apo 19 herë“. Gogoli, duke folur për punën e vet krijuese, shprehet se “së pari duhet të hidhen në letër që të gjitha, ashtu siç i bien ndërmend njeriut, qoftë edhe keq, turbull dhe duhet harruar ajo fletore. Pas një a dy muajsh, herë-herë edhe më tepër, lipset të merret dhe të lexohet ajo që është shkruar: do të shihni se shumë gjëra duhet ndryshuar, se ka shumë gjëra të tepërta, e që aty-këtu mungon diçka. Bëni korrigjimet dhe vërejtjet në margjinë dhe përsëri lëreni fletoren. Pas një kohe, këtë version kopjojeni me dorën tuaj. Gjatë kësaj pune vetvetiu do të lindin mendime të reja, shkurtime, shtesa, pastrimi i stilit, ndërmjet fjalëve të mëparshme do të lindin fjalë të reja, të cilat e kanë vendin aty medoemos, por që, nuk e di pse, nuk shfaqen menjëherë. Dhe përsëri largojeni fletoren. Kështu lipset të veprohet, sipas mendimit tim, tetë herë ... “

Stili i shkrimtarit është shprehje e individualitetit të tij brenda kornizave të epokës, drejtimit, gjinisë dhe të llojit letrar. - Çdo shkrimtar ka stilin e vet. Mirëpo, do theksuar se në rrjedhë të moteve mund të hetohet se krijimet letrare e një kohe kanë disa tipare me të cilat dallohen nga letërsia e epokave paraardhëse ose pasardhëse, që do të thotë se në historikun e letërsisë ka zhvillim, që nuk është vetëm lëvizje nga një individualitet në tjetrin, por edhe ndërrim i të shprehurit artistik. Prandaj, edhe stili duhet vështruar jo vetëm si veçori individuale, por edhe si dukuri mbiindividuale, si dukuri historike. Stili, d.m.th. nuk shpreh me besnikëri vetëm autorin, por pasqyron edhe ligjësitë letrare të një periudhe kohore; me të del në shesh, përveç individualitetit të shkrimtarit, edhe rryma letrare që i përket. Ky konstatim i përgjithshëm vlen jo

vetëm për artin e letërsisë, por edhe për artet e tjera, si për pikturën, skulpturën, arkitekturën, muzikën etj.

Pra, stili i shkrimtarit nuk është vetëm pasqyrë e individualitetit të tij, por ky stil përcaktohet edhe nga një varg faktorësh të tjerë joindividualë, si:

a) *nga epoka* (nga ajo se cilës epokë i takon vepra: epokës antike, epokës së mesjetës apo epokës moderne (letërsisë bashkëkohore);

b) *nga drejtimi dhe rryma letrare* (se i përket renesancës, klasicizmit, iluminizmit, romantizmit, realizmit; natyralizmit, simbolizmit, impresionizmit, futurizmit, ekspresionizmit, surealizmit etj.);

c) *nga zhanri letrar* (se vepra është lirike, epike, epiko-lirike apo dramatike), dhe

ç) *nga lloji letrar* (se vepra është himn, odë, ditiramb, epigram, epitaf, idilë, elegji; roman, ep, novelë, tregim; fabul, baladë, poemë; tragjedi, komedi, dramë apo diçka tjetër).

Në letërsi ka larushi stiles.- Me gojën plot mund të thuhet se *në letërsi ka laramani të shumta stiles, për shkak të shumësisë së autorëve, epokave dhe drejtimeve letrare, gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare* etj. Pikërisht për këtë larmi, letërsia paraqet vështirësitë më të mëdha për analiza. Qëndrimet e ndryshme cilësohen si “lexime” të ndryshme të po atij teksti.

Për epokat dhe drejtimet e ndryshme letrare, pasi bëhet analiza e veprave të epokës gjegjëse, sillen përgjithësime. Siç dihet, epokat dhe drejtimet letrare kanë stil të veçantë (për dallimet gjuhësore apo stilistike ndërmjet prozës dhe poezisë u bë fjalë më parë). Veprat letrare artistike të një epoke të caktuar historike dallojnë nga ato të një epoke tjetër, veç tjerash, edhe për veçoritë shprehëse dhe stilistike. Letërsia, gjatë zhvillimit të vet nëpër shekuj, ka shënuar herë kthesa më të mëdha e herë më të vogla në natyrën e vet krijuese. Janë të njohura periudha brenda të cilave zhvillimi i letërsisë përgjithësisht ka qenë homogjen për nga mjetet shprehëse stilistike. Kështu, në periudhën e letërsisë së lashtë greke vërehet qartë se kanë mbizotëruar mjete dhe ligjshmëri të njëjta për shkrimtarët. Të njëjtën mund ta themi edhe për epoka të tjera letrare historike, siç janë: renesanca, klasicizmi, romantizmi, realizmi, natyralizmi etj.

Stili i shkrimtarëve ka pësuar zhvillim historik, sepse gjatë disa epokave letrare janë në fuqi dhe vlejnë disa rregulla e ligje të caktuara për krijimtarinë artistike letrare, në një periudhë tjetër të gjitha ato ose një pjesë e tyre vjetrohen dhe si të tilla zëvendësohen me mjete dhe forma të tjera.

Siç dihet, shkrimtarët e një epoke të caktuar letrare-historike afërsisht shërbehen me mjete shprehëse stilistike, me teknikë dhe formë letrare të njëjtë apo të ngjashme. Mjetet gjuhësore shprehëse stilistike që kanë qenë efikase për të shprehur botën karakteristike të një epoke, nuk kanë mundur të jenë njësoj të përshtatshme për ndonjë epokë tjetër. Kjo nuk është çështje e ndërrimit mekanik a të jashtëm, por është shprehje e brendshme, e domosdoshme, është veçori e natyrës njerëzore – është shprehje e bindjeve dhe e botës shpirtërore e psikologjike të asaj kohe. Bie fjala, Homeri e shprehu gjenialisht botën dhe shpirtin e epokës së lashtë greke, me gërshetimin e fatit të njerëzve dhe të perëndive, duke i parë vullnetet dhe ëndrrat e tyre, edhe zemërimet edhe luftërat. Eskili, për shembull, përmes tragjedive të veta e shprehu botën antike greke edhe me anën e sakrificës së perëndive për t’u ardhur në ndihmë njerëzve, ashtu siç veproi Prometeu në emër të progresit të përgjithshëm njerëzor.

Në shekullin XIX ishte e pamundur që bota dhe shpirti i Evropës të shprehej dhe pikturohej po me ato mjete dhe forma të kohës së Eskilit apo të Homerit. Kështu, në vend të rrëfimeve të gjata në vargje (siç ishin veprat madhore *Iliada* dhe *Odiseja* të Homerit) në shekullin XIX, në kohën e Balzakit dhe të Tolstoit, u imponua rrëfimi i gjatë në prozë, pra në vend të epit dhe epopesë lindi romani. Për të shprehur filozofinë e njeriut të shekullit XIX duheshin edhe

forma edhe mjete të tjera shprehëse. Në vend të gërshetimit dhe kundërshtisë së fateve njerëzore me ato të perëndive (si në kohën antike greke), në romanin realist të shekullit XIX shtrohet nevoja për një pikturim real të botës dhe shpirtit të njeriut.

Por, dihet se gjatë shekujve nuk dolën nga përdorimi të gjitha llojet e lirikës së lashtë, bie fjala, forma e elegjisë vazhdon të jetojë edhe sot. Kështu, epi (rrëfimi i gjatë në vargje) nuk doli nga përdorimi për shkak se aq i zgjati jeta; po për shkak se në një periudhë kohore me kushte të tjera të jetesës njerëzore, nuk ishte në gjendje ta ngërthejë tërë ngarkesën e re psikologjike, filozofike, etike, imagjinative, e emocionale të asaj kohe. Njerëzit e epokave të ndryshme kanë pasur besime të ndryshme, ëndrra të ndryshme, ndryshe e kanë kuptuar dhe përjetuar natyrën, botën, realitetin, gjithësinë; të ndryshme e kanë pasur dashurinë, zemërimet, vdekjet, gëzimet etj. Në përputhje me to janë përdorur edhe mjetet gjuhësore, stilistike me të cilat e kanë shprehur botën e tyre të veçantë.

Kur kemi të bëjmë jo me një, por me disa tekste, atëherë metoda themelore do të jetë krahasimi. Pasi nxirren tiparet e veçanta, shihet se çfarë është e përbashkët për to dhe çfarë përgjithësimi mund të bëhet. Për një shkrimtar do të hetohet se çfarë është e qëndrueshme në stilin e të gjitha veprave të tij. P.sh. në mjaft poezi të Ll. Siliqit jepet menjëherë e drejtpërdrejt detaji i parë, me të cilin vizatohet imazhi, paraqitja dhe vlerësimi bëhen haptas. Në një ligjërime të tillë vjen natyrshëm leksiku retorik i ngritur. Pohimi e mohimi ecin bashkë, ka shpesh fjali mohuese ose kundërshtore.

Pyetje dhe detyra:



1. Nga se varet stili i shkrimtarit?
2. Pse ka larushi të shumta stilesh në letërsi?
3. Çfarë kujdesi i kushtojnë shkrimtarët gjuhës? A japin ndihmesë për lëvrimin e gjuhës shqipe? Shpjegojeni këtë.
4. Ç'mund të thoni për stilin e shkrimeve letrare të mëposhtme:

Jam sot,
Si vjet
Si mot
Si përgjithnjë.

(Lasgush Poradeci, *Përjetësia*)

Eqrem Çabej

Ku ndriçon plisi përthekon guna
Ku buka është bukë e uji ujë
Ku digjet qiriu e tymon una
Rrjedh lumë Drini rrjedh lumë Buna

Hesht Ili Iliri flet vetë Albani
Në valle Lisi ku feston fisi
Merr në thua e bie tirani

Në male të bardha bardhon plisi

Në natën e zezë del para Abeja
Ti thur ballin me kujtime e gjak
Midis krahërorit të shkrep rrufeja
Klithjen e moçme e zgjon në prak...

(Sabri Hamiti, *Leja e njoftimit 1985*)

Hanko Halla

(fragment)

Halla do një nuse si edhe i biri
rrenjëjt prej ergjëndi, degat prej floriri,
me të folur halla, nusja të hap' sytë
“Lepe” fjala e parë, “peqe” fjala e dytë;
edhe asgjë tjetër, vetëm “lepe”, “peqe”,
pasi zemra e Hallës qënka si një qelqe:
po u thye, vajti, e s'ka më: ngjite, qepe,
zogu i plagosur di të kap' me sqepe! ...

(Ali Asllani)

Recital' i malsorit

O, si nuk kam një grusht të fortë
t'i bij' mu në zemër malit që s'bëzanë,
ta dij' dhe ai se ç'do me thanë i dobët –
n'agoni të përdihet si vigan i vramë.

(Migjeni)

KREU III

3. DREJTSHKRIM E DREJTSHQIPTIM

3.1. Ç'ËSHTË DREJTSHKRIMI

Dihet se abëcëja është inventar i shenjave grafike, ndërsa drejtshkrimi (ortografia) është përmbledhje rregullash për kombinimin e këtyre shenjave. Drejtshkrimi, është një sistem rregullash që kodifikon shkrimin e fjalëve në të gjitha trajtat e tyre gramatikore, shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimin e datave, shkurtesave, përdorimin e shkronjave të mëdha, transkriptimin e emrave të huaj dhe përdorimin e shenjave të pikësimit.

Nëse zbatohen normat drejtshkrimore (gjatë shkrimit të fjalëve, të fjalive dhe të periudhave; me kusht që ajo që thuhet të jetë logjike dhe e saktë), atëherë komunikimi me shkrim ndërmjet njerëzve do të realizohet në shkallën më të lartë të mundshme. Alfabeti dhe drejtshkrimi

janë çështje ujdje (marrëveshjeje, pëlqimi) ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë që e flasin dhe e shkruajnë atë gjuhë. Ndonëse për shkrimin e gjuhëve të botës më së shumti përdoret alfabeti latin, por prapëseprapë nuk mund të gjenden dy gjuhë me rregulla drejtshkrimore të njëjta. Kur stabilizohen alfabeti dhe drejtshkrimi, krijohet bazë për konstituimin e gjuhës letrare a standarde.³⁰

Në botë popujt shërbehen me tri lloje drejtshkrimesh: me drejtshkrim fonetik, etimologjik (historik) ose morfologjik. Marrë në përgjithësi, asnjë drejtshkrim i gjuhëve të botës nuk është plotësisht fonetik ose etimologjik. Çdonjëri, krahas elementeve mbizotëruese të një tipi të caktuar, ka edhe elemente të tipave të tjerë drejtshkrimorë.

Drejtshkrim fonetik është ai që për çdo tingull themelor – fonemë ka një shkronjë të veçantë (të thjeshtë ose të përbërë), d.m.th. shkruhet ashtu siç flitet dhe lexohet ashtu siç është shkruar. Etimologjik është ai drejtshkrim që pasqyron format gjuhësore të së kaluarës. Morfologjik është ai drejtshkrim që ka prirje t'i ruajë qartë morfemat dhe kufijtë e fjalës.

Drejtshkrim fonetik sot ka shqipja, maqedonishtja, serbishtja, kroatishtja, sllovenishtja, italishtja, turqishtja etj. Drejtshkrimi i bullgarishtes është i përzier: ai është etimologjiko-fonetik. Drejtshkrimi i rusishtes është morfologjik; ndërsa frëngjishtja, anglishtja, gjermanishtja, greqishtja etj. kanë drejtshkrim etimologjik. Sot përparësi ndaj tipave të tjerë ka drejtshkrimi fonetik, meqë mbështetet mbi shqiptimin bashkëkohor të gjuhëve. Me drejtshkrim fonetik ligjërimi i folur shkruhet më lehtë dhe ai përvetësohet më shpejt.

Drejtshkrimi i shqipes ka rëndësi praktike për gjithë shoqërinë shqiptare dhe përdoruesit e tjerë të shqipes, sepse ndihmon për një këmbim më të shpejtë dhe më të përpiktë të mendimeve në formën e shkruar të gjuhës standarde. Për këtë arsye përvetësimi i normave të drejtshkrimit është në interesin e gjithë kombit. Normat drejtshkrimore janë të detyrueshme për të gjithë dhe askush nuk ka të drejtë t'i shkelë e as të krijojë rregulla të tjera “vetjake”. Përvoja e zbatimit dhe e shkaqeve të moszbatimit praktik të drejtshkrimit në këta 40 e ca vjet ka treguar se rregullat e drejtshkrimit të shqipes mund të thjeshtëzohen e të përmirësohen në tërësi. Hapa duhet bërë në radhë të parë në një afrim më të madh me gegërishten, veçmas në pakësimin e <ë>-ve në pozicione të ndryshme, duke reduktuar kështu një karakteristikë të toskërishtes.

Problemi themelor i drejtshkrimit është marrëdhënia midis formës së folur dhe formës së shkruar të ligjërit. Në këtë marrëdhënie, ligjërimi tingullor është parësor (primar), kurse shkrimi është dytësor (sekondar).³¹

Parimet e përgjithshme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Rregullat e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe ndërtohen mbi dy parime: *parimit fonetik*, në radhë të parë, dhe mbi atë *morfologjik*, ndërsa në pak raste zbatohet edhe parimi *historik-traditional*. Dy boshtet e para nuk i kundërvihen njëri-tjetrit, por kryqëzohen e bashkëveprojnë, duke synuar që drejtshkrimi të jetë sa më sistemor e i qëndrueshëm dhe sa më i thjeshtë. P.sh. shkrimi i fjalëve si *lis, njeri, mal, gur, diell, lexoj, punoj, i ri, dal ...* dhe mijëra fjalëve të tjera, që mbështeten në shqiptimin, ndjek jo vetëm parimin fonetik, por edhe parimin morfologjik, sepse të dy parimet në fjalët e këtilla bashkëpërputhen.

³⁰ Në Kongresin i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, mbajtur në Tiranë prej 20 deri më 25 nëntor 1972 u vendosën rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe standarde.

³¹ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 235-236.

Në tërësinë e leksikut të shqipes, parimi fonetik mbulon mbi 76% të fjalorit bazë të shqipes, ndërsa sfera e veprimit të parimeve të tjera (morfologjik, historik-tradicional, semantik, simbolik etj.) është shumë më i ngushtë – vetëm 23%.³² Parimi semantik e simbolik zënë një vend më të vogël, por jo të papërfillshëm. Parimi semantik zbatohet sidomos për shënimin e fjalëve bashkë, ndaras a me vizë në mes, ndërsa në parimin simbolik mbështetet përdorimi i shkronjave të mëdha, i datave historike etj.

1. Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është **parimi fonetik**: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar. Thelbi i parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes, që mbështetet në një sistem grafik ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis shkronjës dhe tingullit-fonemës, është aspekti fonologjik, domethënë përdorimi shoqëror i tingujve të gjuhës në procesin e marrëdhënieve midis njerëzve.

Parimi fonetik synon vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare. Prandaj, kur në shqiptimin letrar ka variante të lejuara nga norma e sotme, drejtshkrimi mbështetet tek ajo trajtë që është më e përgjithshme dhe që pajtohet me prirjen e zhvillimit të sistemit fonetik të shqipes letrare.

Parimi fonetik zbatohet dendur edhe gjatë trajtëformimit, duke thyer parimin morfologjik në shumë raste, sidomos në rënien e <ë>-së në lakimin e emrave dhe të mbiemrave me *-ël, -ër, -ërr* dhe të emrave që mbarojnë me *-izëm, -azëm*, kur pas këtyre fundoreve vjen një zanore. Në këtë rast ëë]-ja bie, kështu që e njëjta morfemë nuk shkruhet gjithnjë njëlloj, nuk ruhet njëtrajtshmëria grafike e saj: *dimër - dimr-i, dimr-it, dimr-in; vjehërr - vjehrr-i, vjehrr-it, vjehrr-in; i vogël - të vogl-i, të vogl-it, të vogl-in* etj.; në drejtshkrimin e fjalëve të prejardhura: *vepër - veprim, letër - letrar, i sotëm - e sotme, natyrë - i natyrshëm*; te përemrat e pakufishëm, ndajfoljet dhe lidhëzat e përngjitura: *gjithë - gjithçka, kurrë - kurrfarë, kurrgjë*; te fjalët e përbëra të tipit *bashkë+autor - bashkautor*; gjatë fjalëformimit, veçmas në shkrimin e tri varianteve fonetike të të njëjtës parashtesë *sh-/zh-/ç-*: *shfaqje, shfaqjes, zhvendosje, çlodhem*; *s-/z-*: *skuq, zbardh* etj.³³

Pse është bërë e mundur që drejtshkrimi i shqipes të mbështetet në parimin fonetik? Këtë e kanë bërë të mundur disa faktorë: 1. Shkrimet e periudhës së Rilindjes, kur u hodhën bazat e gjuhës letrare shqipe, u mbështetën kryesisht në ligjërimin popullor; 2. Shqipja e periudhës parakombëtare e kombëtare është shkruar me alfabet fonematik (fonetik), ku një tingull themelor (një fonemë) është pasqyruar me një shkronjë; 3. Në aspektin fonematik dy dialektet e shqipes (gegërishtja dhe toskërishtja) si dhe dy variantet letrare të mbështetura në to kanë qenë dhe janë mjaft të afërta.

2. Krahas parimit fonetik, drejtshkrimi i njësuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në **parimin morfologjik**. Parimi morfologjik kërkon që morfemat (rrënjët, parashtesat, prapashtesat, mbaresat) të shkruhen gjithnjë njëlloj, pavarësisht se mund të shqiptohen ndryshe për shkak të ndërrimeve pozicionale dhe kombinatorë të fonemave. Ndërsa parimi fonetik pasqyron marrëdhënien e shkrimit me shqiptimin letrar, parimi morfologjik ka të bëjë me marrëdhënien e shkrimit me strukturën morfologjike të fjalës. Njësimi grafik i morfemave, shkrimi i tyre i njëllojtë arrihet mbi bazën e analogjisë morfologjike, d.m.th. duke krahasuar trajtat e së njëjtës morfemë në fjalë të ndryshme. P.sh. shkruajmë *pjesëtim, përpjesëtim*, sepse shkruajmë *pjesë*:

³² Shih: Prof. Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973, f. 67.

³³ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 240-241.

shkruajmë *gjellëtore*, sepse shkruajmë *gjellë*. Në këto raste zbatohet parimi morfologjik, sepse e njëjta morfemë në fjalë të ndryshme grafikisht paraqitet njëlloj, pavarësisht nga shqiptimi.³⁴

Parimi morfologjik zbatohet kryesisht në ato raste, kur zbatimi i veçuar i parimit fonetik do të çonte në errësimin a në prishjen e strukturës morfologjike e fjalëformuese; ai ndihmon kështu për ta ruajtur sa më të qartë në shkrim këtë strukturë, si edhe njësinë e trajtave. Duke pasur si bazë analogjitë morfologjike, parimi morfologjik lejon rrafshimin e thjeshtimin sa më të madh të rregullave drejtshkrimore të shqipes dhe ndihmon që këto rregulla të pasqyrojnë në mënyrë sa më organike zhvillimin e bashkëlidhur të strukturës fonetike, morfologjike e fjalëformuese të gjuhës sonë letrare. Bie fjala, parimi morfologjik zbatohet në drejtshkrimin e formave rasore të emrave të gjinisë mashkullore, që e formojnë shumësin me *-ë*, tema e shumësit me *-ë*- ruhet në të gjitha format rasore, paraqitet grafikisht njëlloj, pavarësisht se *-ë*-ja në rrokje të hapur zakonisht këtu nuk shqiptohet: fshatar – fshatarë – (i, e) *fshatarëve*, *fshatarësh*; shkrimi i *-ë*-së fundore në vetën e parë dhe të tretë shumës të dëftores dhe të lidhores: (*të*) *thyejmë*, (*të*) *thyejnë*; dallimin e vetës së parë nga veta e tretë e lidhores: (unë) *të punoj* – (ai, ajo) *të punojë* etj.

3. Gërshetimi i parimit fonetik me parimin morfologjik në drejtshkrimin e shqipes plotësohet edhe nga zbatimi i disa parimeve të tjera, siç janë parimi *leksikor-kuptimor*, ai *historik-tradicional* etj. Fushat e zbatimit të këtyre parimeve janë më të ngushta dhe përfshijnë anë të veçanta të drejtshkrimit. Fjalët e shkruara sipas parimit tradicional a historik bazohen: 1) në traditën e shkrimit të gjuhës shqipe të periudhave të mëparshme dhe 2) në disa raste në drejtshkrimin e gjuhëve nga janë huazuar fjalët.

Parimi tradicional zbatohet në drejtshkrimin e disa fjalëve të veçanta, të tilla si: *dëllir*; *i*, *e* *dëllir*, *këqyr*, *mbikëqyr*, *bërryl*, *gërryej*, *kërrusem*, *kërrabë*, *tëharr*, *tëholl* etj. Në këto raste, megjithëse *-ë*-ja është në rrokje të parë, në shqiptimin letrar nuk dëgjohet më. Drejtshkrimi i këtyre fjalëve pasqyron traditën e shkrimit dhe shpjegohet me historinë e gjuhës. Ky parim zbatohet edhe në shkrimin e emrave të gjinisë mashkullore (dikur shumica të gjinisë asnjane) që shkruhen me *-ë* fundore, të tipit: *atë*, *ballë*, *burrë*, *djalë*, *kalë*, *lumë*, *lëmë*. Megjithëse sot këta emra përdoren vetëm në gjininë mashkullore dhe shqiptohen pa *-ë* fundore, drejtshkrimi i tyre me *-ë* është ruajtur kryesisht për hir të traditës.

Po kështu, me *-ë* fundore shkruhen edhe një kategori emrash të gjinisë mashkullore, që tregojnë lëndë: *brumë*, *djathë*, *drithë*, *dyllë*, *dhallë*, *dhjamë*, *gjalpë*, *mjaltë*, *ujë* etj.

Këta emra kanë qenë të gjithë të gjinisë asnjane, por sot përdoren kryesisht në gjininë mashkullore. Në shqiptimin letrar *-ë*-ja fundore këtu nuk shqiptohet, megjithatë drejtshkrimi ka ruajtur traditën e shkrimit të tyre me *-ë*.

Mbështetet në parimin tradicional, historik drejtshkrimi i fjalëve me prejardhje të huaj kur ato kanë *-ia-*, *-ie-*, *-io-*, *-iu-* të patheksuar në trup të tyre ose po të njëjtat grupe zanoresh me theks mbi zanoren e dytë. Grupet e tilla zanoresh shkruhen me *-i-*, por shqiptohen me *-ja-*, *-je-*, *-jo-*, *-ju-*: *australian*, *diagonale*, *financier*, *imperialist*, *material*, *materie*, *aksion*, *bankier*, *malarie*, *kamion* etj. Ky parim zbatohet edhe te fjalët që janë marrë kryesisht nga gjuha latine ose nga gjuhët romane dhe që në këto gjuhë kanë *-rr-*, të cilën e ruajnë edhe në drejtshkrimin e shqipes, megjithëse kjo në një numër fjalësh shqiptohet *-r-*: *irracional*, *korrelacion*, *korrespondencë*,

³⁴ Po aty, f. 251.

tarracë etj. Kështu, pavarësisht nga shqiptimi, në raste të tilla ruhet drejtshkrimi me <rr> i gjuhëve nga janë huazuar fjalët.³⁵

Drejtshkrimi i njëzuar i gjuhës shqipe kurorëzon një etapë të gjatë përpjekjesh për formimin e një gjuhe letrare të vetme e të përbashkët për gjithë popullin shqiptar dhe çel rrugën për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare.³⁶

3.2. Ç'ËSHTË DREJTSHQIPTIMI

Gjuha shqipe standarde ekziston në formën e folur dhe në formën e shkruar. Ajo mbështetet në norma leksikore, gramatikore, drejtshkrimore, por edhe në norma drejtshqiptimore. Gjuha standarde duhet të jetë e njëzuar si në të shkruar ashtu dhe në të folur. Gjuha e shkruar ka normat drejtshkrimore, që rregullojnë mënyrën e njëjtë të të shkruarit për të gjithë. Gjuha e folur ka normat e drejtshqiptimit, që synojnë të njësojnë shqiptimin e gjuhës standarde.

Me fjalën *drejtshqiptim* ose *fonetikë normative* kuptojmë normat e gjuhës së folur që sigurojnë shqiptimin e njëjtë në gjuhën standarde. Pra, drejtshqiptimi është një sistem rregullash që siguron shqiptimin e drejtë dhe të njëjlojtë të fjalëve. Ai përcakton se si duhet të shqiptohen fonemat (tingujt) në pozicione të caktuara fonetike ose kur bashkohen me tinguj të tjerë, si shqiptohen grupe fjalësh ose fjalë të veçanta, ku bie theksi i fjalës, që zakonisht nuk pasqyrohet në të shkruar etj. Norma letrare e shqiptimit përfshin dy aspekte të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin:

- a) përcaktimin e përbërjes fonemore të fjalës që është normative, duke konsideruar të gabuar një përbërje tjetër fonemore, dhe
- b) realizimin e fonemave në pozicione të ndryshme si edhe përcaktimin e vendit të theksit në fjalë.

Drejtshqiptimi mbështetet në shqiptimin më të përgjithshëm letrar dhe jo te shqiptimet e veçanta dialektore. Midis drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe ekziston një lidhje e ngushtë; ata ndikojnë te njëri-tjetri.

Normat e drejtshqiptimit kanë për trajtën e folur të gjuhës standarde po atë rëndësi që kanë normat e drejtshkrimit për trajtën e shkruar të saj. Në fazën e sotme sfera e përdorimit të gjuhës letrare të folur është zgjeruar shumë, prandaj krahas nevojës për vendosjen e normave drejtshkrimore shtrohet edhe nevoja për vendosjen e normave të njëjta drejtshqiptimore.

Drejtshqiptimi është pjesë e kulturës së të folurit dhe pjesë e pandashme e normave të gjuhës letrare. Edhe rregullat e drejtshqiptimit, si edhe ato të drejtshkrimit, kanë vlerë praktike shoqërore. Rëndësia e shqiptimit të njëjtë në shoqëri rritet krahas me sasinë e përhapjes së fjalës publike, domethënë të shkollës, radios, televizionit, mbledhjeve, konferencave, teatrit etj. Të

³⁵ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 256-258.

³⁶ Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 35-36.

gjitha këto forma, ku paraqitet fjala e gjallë, kërkojnë që fjalët të shqiptohen sipas rregullave të gjuhës standarde që të kapen e të kuptohen me lehtësi nga mijëra e qindra mijëra dëgjues.³⁷

Vendosja e normave të njësuara kombëtare bëhet në të gjitha hallkat e sistemit të gjuhës letrare; por, ndërsa për gjuhën e shkruar shqipe pas shumë përpjekjesh dhe pas një pune të vijueshme u arrit që të vendosen e të zbatohen nga të gjithë rregulla të njësuara, që pasqyrohen në “Drejtskrimin e gjuhës shqipe”, në gjuhën e folur normat e shqiptimit letrar po vendosen e po përgjithësohen më ngadalë. Në krahasim me njësimin e shkrimit, njësimi i shqiptimit arrihet më vonë. Ai është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar.

Normat e shqiptimit letrar përgjithësisht janë përcaktuar, megjithëse në hallka të veçanta të tij, vihen re disa lëkundje. Ende nuk kemi një vepër kodifikuese të drejtshqiptimit,³⁸ siç nuk e kanë edhe disa gjuhë të tjera.

Problemet e gjuhës letrare të folur kanë lidhje shumë të ngushtë me kushtet shoqërore të folësve. Zhvillimi i gjuhës dhe zgjerimi i funksioneve të saj varen në një shkallë të madhe nga shkalla e zhvillimit të vetë shoqërisë, i shkencës, kulturës dhe teknikës. Formimi i kombit lidhet ngushtë me krijimin e shtetit kombëtar dhe të gjuhës letrare. Disa popuj kanë pasur fatin që në periudhat e hershme të krijojnë shtetin e vet, ndërsa shqiptarët arritën të formojnë në shekullin e njëzet (më 1912) një shtet në gjysmën e përhapjes së shqiptarëve. Ata që nuk u përfshinë brenda kufirit të Shqipërisë patën kushte më të pavolitshme gjuhësore sesa ata që mbetën brenda kufijve.

Cilët janë faktorët kryesorë të ngecjes prapa në përvetësimin e normës letrare (veçmas të drejtshqiptimit) te shqiptarët e ish-Jugosllavisë? Faktorët e tillë janë të natyrës gjuhësore e jashtëgjuhësore. Në këtë rast po përmendim vetëm disa nga to, që mendojmë se janë më të rëndësishëm:

a) pothuajse të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë janë gegë (në përjashtim të pak pjesëtarëve të të folmeve në Maqedoninë jugore, kanë jetuar kryesisht nëpër fshatra malore, janë marrë me blegtori e bujqësi, një numër i konsiderueshëm kanë punuar nëpër territore të tjera brenda shtetit ose jashtë tij ku nuk është dëgjuar fare shqipja; ata bashkë me gjuhën e tyre kanë qytetarë të dorës së dytë dhe nuk janë përfshirë në institucionet shtetërore);

b) deri vonë ka mbizotëruar analfabetizmi, me një numër të vogël shkollash në gjuhën shqipe; shkollimi i pak njerëzve në gjuhë të huaja dhe cilësimi i tyre si “njerëz të shitur”; diglosia, njohja e një gjuhe letrare sllave në një shkallë më të lartë krahasuar me gjuhën amtare;

c) gjuha shqipe ka pasur përdorim shumë të kufizuar (pothuajse vetëm brenda familjes dhe në mbajtjen e mësimin në pak shkolla);

ç) gjuhët e tjera të prestigjit (serbishtja, maqedonishtja) kanë ndikuar jo vetëm në leksikun e shqipes së folësve gjegjës, por edhe në sintaksë e aty-këtu edhe në morfologji e fonetikë;

d) izolimi shumëvjeçar i shqiptarëve jashtë atdheut me shtetin amë

ç) deri në Kongresin e Drejtshkrimit jemi shërbyer me një gjuhë letrare geqe etj.

³⁷ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 210.

³⁸ Rregullat themelore të drejtshqiptimit janë paraqitur në tre tekstet universitare të *Fonetikës së gjuhës shqipe* (A. Dodi, Prishtinë, 1970 dhe A. Dodi – J. Gjinari (maket), Tiranë, 1983, A. Dodi, Tiranë, 2004) si dhe në doracakun *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976. Por, detyra e vënë nga Kongresi i Drejtshkrimit për hartimin e *Rregullave të drejtshqiptimit* ka mbetur pa u përmbushur. Shih: Emil Lafe, *Gjuha e medias sot – probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë, f. 13.

Historia e zhvillimit të shqiptarëve dhe e gjuhës letrare shqipe përbën një shembull, ku duken qartë ndikimi i fuqishëm i faktorëve shoqërorë mbi fatet e gjuhës letrare.

Ashtu si edhe në vendet e tjera, kryeqyteti, si qendra më e rëndësishme ekonomike-politike dhe kulturore, gëzon një prestigj të njohur lidhur me përhapjen e modelit të gjuhës së folur. Por, edhe në gjuhën e kryeqytetit vihet re edhe komponenti gjysmëdialektor ose dialektor. Siç dihet, Tirana ndodhet në arealin e të folmeve gege, por që kur u caktua kryeqytet, më 1920, popullsia e saj filloi të përzihej edhe me banorë të ardhur nga jugu. Duke pasur popullsi të përzier prej krahinash të ndryshme, Tirana ka shërbyer dhe do të shërbejë si një fonderi, ku shkrihen dhe marrin formë edhe tiparet e gjuhës standarde të folur. Ajo shërben si një qendër për rrezatimin e normës letrare.³⁹

Standardi i drejtshqiptimit po arrihet më fort në mënyrë të vetvetishme, duke lënë mënjane tiparet dialektore, duke e zhveshur formën e folur të gjuhës letrare jo vetëm nga karakteristikat fonetike të dialekteve, po edhe nga timbri dallues i të folmeve.

Shqiptarët sot janë *një* komb, që kanë *një* histori, *një* kulturë dhe *një* gjuhë standarde. Norma gjuhësore, nga pikëpamja e detyrimit për t'u zbatuar, mund të ndahet në dy grupe:

a) **norma kategorike** (të detyrueshme), që paraqiten si varianti i vetëm normativ,

b) **norma të këshillueshme**, kur ka më shumë se një variant të lejueshëm ose të pranueshëm.

E detyrueshme është p.sh. norma drejtshkrimore (fjala *rresht* duhet të shkruhet kështu e vetëm kështu, as *rrjesht*, as *resht*; forma normative janë *kam shkruar*, *shkrova* dhe jo *kam shkruajtur*, *shkrojtur*, *shkruajta* etj.). Në fushën e leksikut norma nuk është tërësisht kategorike (ka sinonime, ka fjalë që sot janë pak të njohura, por nesër bëhen të mirënjohura, ka fjalë të huaja që duket sikur e kanë fituar të drejtën e qytetarisë, ka neologjizma të qëlluar etj.). Në këtë fushë lëvizja është e vijueshme dhe veprat normative nuk kanë fuqi të plotë kodifikuese si drejtshkrimi ose si gramatika.⁴⁰

Duke parë e dëgjuar shpeshherë shkeljen e normave të shkrimit e të shqiptimit letrar, rrugën e nxënies së fonetikës dhe të ndërlihdjes së saj me drejtshkrimin dhe me drejtshqiptimin do ta ndjekim edhe ne në këtë tekst mësimor.

3.3. SHKAQET E THYERJES SË NORMËS GJUHËSORE

Thyerja e normës ka shumë shkaqe. Gabimet rrjedhin ngaqë nuk njihen rregullat drejtshkrimore dhe fjala shkruhet sipas shqiptimit vetjak të individit. Ata që pohojnë pamjaftueshmërinë e strukturës dhe varfërinë leksikore të shqipes standarde, në të vërtetë nuk e njohin atë dhe parapëlqejnë një arsytim të tillë vetjak. Përveç padijes e injorancës, ndër shkaqet kryesore të thyerjes së normës së shkrimit dhe të shqiptimit letrar janë:

a) *veçoritë dialektore të folësit,*

³⁹ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 211-212.

⁴⁰ Emil Lafe, *Gjuha e medias sot – probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë, f. 11.

b) ndikimi i gjuhëve të huaja në leksikon dhe në gramatikën e folësve,

c) ligjërimi i shkujdesur, dhe

ç) shqiptimi shkronjë për shkronjë i fjalëve të shkruara.

Për gjendjen e sotme të shqipes standarde shkaku i parë përbën problemin kryesor për vendosjen e normave të drejtshqiptimit dhe paraqet vështirësi më të mëdha për t'u kapërcyer.

Veçoritë dialektore të shqiptimit folësi zakonisht i mëson që në fëmijëri, prandaj duhet një punë e gjatë dhe këmbëngulëse për të shmangur ato dhe për të përvetësuar shprehitë e shqiptimit letrar. Te shumica e shqiptarëve ndihet nënshtresa e së folmes krahinore; mjerisht disa as që bëjnë përpjekje për të njohur e zbatuar rregullat e shqiptimit letrar.⁴¹ Pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972) e deri më tani u pa shumë qartë se si gjuha standarde shqipe, sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja gege, mëton ta zbatojë gjuhën letrare, porse me një ngjyresë fonike gegizuese (p.sh. shqiptimi i /ë/-së si /ê/: *bêj, nê:n, bêra, rêra, zêri* etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë “qethje” sado të pjesshme të bëra nga “Rregullat e drejtshkrimit”, tërheq nga hipertoskizmi (p.sh. shqiptimi me ëë] të prapme i fjalëve me ëë]: *vënt, kuvënd, mëndje, mëndoj, qëndër, fëmër, zëmër* etj).⁴²

Siç dihet, shtresën kryesore të shqipes standarde e përbëjnë elementet gjuhësore që janë krejt të përbashkëta për të dy dialektet.⁴³ Megjithëkëtë, ajo ka në bazën e vet tiparet fonetike e morfologjike më qenësore të toskërishtes, por nuk përputhet plotësisht me të, sepse ka tipare edhe të gegërishtes jo vetëm në sistemin leksikor, ku ato janë të shumta, por edhe në sistemin morfologjik e fonetik.⁴⁴

Ndryshimet kryesore ndërmjet dialekteve janë në fonetikë e në leksik, ndërsa më pak në fonologji e gramatikë (morfologji e sintaksë). Për të pasur një pasqyrë të ndryshimeve kryesore dialektore, po paraqesim në mënyrë tabelore disa nga to, duke i krahasuar me shqipen standarde:

Nga paraqitja tabelore e dhënë më parë, mund të fitohet **pasqyra e rregullave kryesore të shqiptimit letrar**. Është e vërtetë se *në strukturën fonetike të gjuhës standarde spikat disa nga tiparet themelore të shqiptimit jugor, por kjo bazë mbështetëse është zgjeruar edhe me disa tipare fonetike veriore*.

Përvetësimi i përbërjes fonematike të gjuhës standarde paraqitet më i vështirë sesa përvetësimi i formave morfologjike. Larmia e ndryshme tingullore e fonemave nëpër të folmet shqipe e ka lënë ende të papërcaktuar si duhet drejtshqiptimin e shqipes. Si përfundim, për fazën e sotme të shqipes standarde, timbret dialektore në realizimin e fonemave cilësohen si të tolerueshme, ndërsa mungesa e fonemave të caktuara është e papranueshme. Disa nga rregullat e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit të varianteve themelore të zanoreve e të bashkëtingëlloreve si dhe të togjeve të tyre do të paraqiten në kërkerët përkatës.

Shpeshherë hetohen edhe shkelje të normës gramatikore (morfologjike e sintaksore). Si p.sh., emrat e huaj vetjakë, si *Klinton, Ollbrajt, Bler* etj. po përdoren në formë të ngurosur, edhe pse funksioni i tyre sintaksor kërkon që të jenë në formë të caktuar rasore dhe në trajtën e shquar:

⁴¹ Emil Lafe, Po aty, f. 15.

⁴² Gjovalin Shkurtaj, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë, f. 39.

⁴³ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, I, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 145.

⁴⁴ Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 199.

u takua me Klintonin; përdorimi i formës së shumësit pa /ë/ fundore, si *shqiptar* (në vend *shqiptarë*), *arsimtar* (në vend *arsimtarë*) etj.; në vend të përemrave vetorë *ne, ju* përdoren trajtat e tyre të dhanores *neve, juve* (*neve* kemi punuar, *juve* jeni të zellshëm); gabime në përdorimin e nyjës së rasës gjinore: *Ministri i Punëve të jashtme të Kosovës* (në vend *i Kosovës*); përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën *të* (*do lexoj, do punoj*; në vend *do të lexoj, do të punoj*); ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku pëstjellohet mendimi deri në moskuptim; përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë që e formojnë shumësin me *-e* dhe *-ra* etj.

Shkelje të normave të shqipes standarde paraqet edhe përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja. Siç dihet, varësisht nga shtrirja gjeografike, përkatësia administrative nëpër disa shtete ballkanike, kontakti shumëshekullor përfshirë lidhjet historike, ekonomike, kulturore me gjuhë të tjera etj., ka laramani sasiore të huazimeve leksikore nëpër të folmet shqipe. Thënë ndryshe, si në shqipen me vazhdimësi tokësore e gjuhësore, ashtu edhe në shqipen e diasporës diku ka më pak e diku më shumë fjalë të huaja: greke, turke, sllave, neolatine etj.⁴⁵

Disa nga këto fjalë të huaja janë mishëruar thellë në të folmet dialektore, kanë përhapje të përgjithshme në tërë shqipen dialektore. Një numër i konsiderueshëm fjalësh të tilla janë bërë edhe pjesë e leksikut të gjuhës standarde shqipe. Këto më vështirë zëvendësohen me fjalë të shqipes, edhe pse ekziston një mundësi e tillë. Por, ka edhe të tilla që kanë përhapje të ngushtë territoriale (në një krahinë, në një grup të folmesh, në disa të folme, në një të folme). Fjalët e këtilla nuk janë të pranueshme për normën leksikore letrare. Përveç ndikimit të vijueshëm të italishtes (*sidomos* në Shqipëri), kohët e fundit në shqipen letrare vërehet një ndikim gjithnjë e më i madh i anglishtes. Rritja e numrit të fjalëve angleze dhe në përgjithësi e fjalëve të huaja është thyerje e normës leksikore e stilistikore të shqipes.⁴⁶ Parimisht, sa më pak fjalë të huaja të përdorim në ligjërimin tonë, do të ishte aq më mirë.

Për ta parandaluar përmbytjen e shqipes me fjalë e me gjedhe të huaja, duhet të kushtrimohen të gjithë përdoruesit e kësaj gjuhe, në radhë të parë gazetarët, publicistët, shkrimtarët, shkencëtarët, profesorët, arsimtarët, studentët, nxënësit etj., që t'u vënë pritë fjalëve të huaja të panevojshme dhe formimeve të tjera të çoroditura... Në shqipen e sotme të intelektualizuar veprojnë dy forca çekuilibruese: folësi ka prirje të përdorë sa më shpesh fjalë të huaja dhe të përsërisë të njëjtat fjalë, kurse dëgjuesi si rregull i përgjithshëm, kërkon qartësi sa më të madhe dhe variacion sa më të madh të fjalorit.⁴⁷

Ligjërimi i shkujdesur është karakteristik për ligjërimin bisedor, d.m.th. për të folurit e rëndomtë, kur shqiptimit i kushtohet më pak vëmendje a flasim në mënyrë të shkujdesur. Në këtë

⁴⁵ Të folmet në Shqipëri kanë qenë më fort nën ndikimin e italishtes e të greqishtes, ndërsa të folmet e Kosovës dhe të Maqedonisë nën ndikimin e gjuhëve sllave. Gjuhët neolatine në Shqipëri kanë ndikuar me rrugë të drejtpërdrejtë, ndërsa në shqipen e ish-Jugosllavisë me ndërmjetësimin e serbishtes e të maqedonishtes. Terminologjia teknike në Shqipëri ka shumë huazime nga italishtja e frëngjishtja, kurse në Kosovë e Maqedoni nga gjermanishtja: *khs. ashensor* dhe *lift*, *autostradë* e *autoban*, *celular* e *mobil*, *bagazh* e *gepek* etj. Dallimet e tilla janë të pranishme edhe në gjuhë të shteteve të njësishtme. Në shqipen këto janë rezultat i veçimit të gjatë të shqiptarëve, por dallimet e tilla leksikore gjithnjë e më shumë po zvogëlohen, *sidomos* me mëvetësimin e Kosovës nga Serbia dhe në Maqedoni me sigurimin e mundësisë së shkollimit më të gjerë të shqiptarëve në gjuhën amtare edhe në shkollimin sipëror, me përmirësimin e statusit të shqipes si gjuhë e dytë zyrtare në komunat me mbi 20% shqiptarë.

⁴⁶ Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 92-100

⁴⁷ Më gjerësisht shih: dr. Qemal Murati, *Gramatika e gabimeve – Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*, Shkup, 2000.

stil tingujt shpeshherë rrëgohen, shkurtohen, shkrihen, ndërrohen me ndonjë tingull tjetër apo nuk shqiptohen fare.⁴⁸ Për qëllime të caktuara stilistike (për individualizimin e personazheve), përdoret në raste të veçanta shqiptimi i të folmes së personazhit, ai krahinor a dialektor.

Shkaku tjetër i shmangies nga shqiptimi letrar lidhet me shkrimin. Mendimi se shqiptimi i drejtë përputhet plotësisht me shkrimin dhe rregullat e tij drejtshkrimore nuk është i drejtë. Shkrimi dhe shqiptimi kurrë nuk përputhen në mënyrë absolute. Siç dihet, drejtshkrimi i gjuhës sonë, përveç parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhen siç shqiptohen, mbështetet edhe në parimin morfologjik e historik, kështu që shkrimi nuk përputhet gjithnjë me shqiptimin. P.sh., sipas rregullave të drejtshkrimit shkruajmë *pjesëtoj, ditëlindje, dhjetëvjetor, kallëz, kallëzore* etj., por zanoren ëë] të këtyre fjalëve zakonisht nuk e shqiptojmë. Drejtshkrimi i ëë]-së në këto raste mbështetet në parimin morfologjik dhe historik-tradicional. Nga ana tjetër, të gjitha zanoret, pa marrë parasysh a janë në pozitë të theksuar a të patheksuar, shkruhen njësoj; por ato nuk shqiptohen njësoj. Dihet se zanoret e patheksuara nyjëtohen të rrëgjuara në gjatësi dhe në cilësi. Por edhe te të tillat ka dallim: nga të gjitha zanoret e patheksuara të shqipes rrëgjim më të madh në gjatësi pëson ëë]-ja. Ky rrëgjim shkon gjer në zhdukjen e saj të plotë në shqiptim. P.sh. ëë]-ja e patheksuar fundore dy rrokje larg theksit në shqipen e sotme nuk shqiptohet. Këtë dukuri e ka pasqyruar edhe Drejtshkrimi, që ka vendosur të shkruhet *i hekurt* (por i gurtë), *i katërt* (por i dytë), *pjesëz* (por vezë) etj. Nuk dëgjohet <ë>-ja as në shqiptimin letrar në fjalët e përbëra dhe të përngjitura, si *botëkuptim ëbotëkuptim], pikëpamje ëpikëpamje], mirëdita ëmirdita], mirëmëngjes ëmirmëngjes], bukëpjekës ëbukëpjekës]* etj., megjithëqë drejtshkrimi ndjek parimin morfologjik, d.m.th. i ruan format e fjalëve edhe gjatë bashkimit të tyre për formimin e një fjale të re.

Edhe në disa raste të tjera drejtshkrimi i <ë>-së mbështetet në parimin historik-tradicional. Fjalëformat drejtshkrimore të tilla si *dëllir, këqyr, kërrus, bërryl* etj., nga pikëpamja e normës së sotme të shqiptimit janë historike. Këtu do të përfshiheshin edhe emra të tillë si *atë* (ati), *ballë, djalë, kalë, dyllë, drithë, brumë* etj., ku <ë>-ja fundore nuk dëgjohet fare as në shqiptimin letrar.

Fonema /ë/ në gjuhën shqipe ka shumë larmi timbresh, në rrokje të theksuar nuk e gjejmë në gegërishte, ndërsa në pozicion të patheksuar shtrihet në tërë arealin e shqipes. Në shqiptimin letrar është zanore e mesme gjysmë e hapur. Disa modifikime të saja të nyjëtitimit (pak më e hapur ose pak më e mbyllur) janë të lejueshme. Në shkrim, grafema <ë> sidomos fundore është një shenjë që tregon se zanorja e rrokjes para saj nuk duhet shqiptuar e shkurtër. Kështu, p.sh. shqiptimi i fjalës së shkruar <bukë> si *buk* (me ëu] të shkurtër) cilësohet i papranueshëm, *bu.k* (me ëu] të mesme) i tolerueshëm, ndërsa *buk^ë* do të përfaqësonte shqiptimin normativ.⁴⁹

Për t'u shmangur leximi si një fonemë e vetme (/gj ose nj/), Drejtshkrimi kërkon që fjalët e këtij tipi të shkruhen me <i>, por shqiptohen me /j/, si p.sh.: *djegje ëdjeg-je] lagje ëlag-je], biologia ëbiolog-ja]; kundërthënie ëkundërthënie], parathënie ëparathënie], shkupjania ëshkupjania]* etj. Edhe fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia, -ie, -io, -iu* me /i/ të patheksuar në trup të tyre, shkruhen kështu, por shqiptohen përgjithësisht me *-ja, je, -jo, -ju: material ëmaterial], ambicie ëambicie], agresion ëagresion], studioj ëstudioj]* etj.

⁴⁸ Në gjuhën standarde dallohen dy stile shqiptimi: *stili i plotë* dhe *stili jo i plotë*. Stili i plotë është karakteristik për ligjërimin letrar libror. Përdoret në rastet kur përpiqemi të flasim me përpikëri sipas normave të gjuhës standarde (p.sh. në shkollë, në konferenca, në mjetet e informimit etj.). Ky stil shqiptimi, i cili lidhet drejtpërdrejt me gjuhën e shkruar, karakterizohet nga artikulimi i mirëfilltë i tingujve, nga shqiptimi i tyre i plotë, pa i rrëgjuar, pa i shkurtuar, pa i ndërruar dhe pa i shkrire ata.

⁴⁹ Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 12.

Mospërputhje të normave drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore vërehen edhe në ndërlidhje fjalësh (sand'hi). *Gjuha e folur respekton fonetikën sintaksore*, duke i ndarë fjalët grupe-grupe, sipas ritmikës së fjalisë; ndërsa *drejtshkrimi respekton ndarjen morfologjike të fjalëve*. Gjatë lidhjes së fjalëve në fjali ose gjatë fjalëformimit disa fjalë bëhen të patheksuara (në-shtëpí), ndonjë shqiptohet me theks të dobët (*rrotull* shtëpísë) e ndonjë me theks dytësor (bótë+kuptím=*botëkuptím*). P.sh. shkruhet *E mora librin për të lexuar*, ndërsa thuhet *Emora librin/përtëlexuar*// Kur hyjnë në lidhje të ngushtë me fjalë të tjera për të formuar një sintagmë, zakonisht fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, nyjat, trajtat e shkurtra etj.) e humbin theksin (zanoret rrëgjohen) dhe lidhen me fjalën akcentogjene. Këtyre ndryshimeve u nënshtrohen edhe fjalët emërtuese. Khs. sintagmat *ai djalë ëaidjalë*], *im bir ëimbir*], *një lis ënjëlis*], *mish qengji ëmishqengji*] etj.

Ndonjëherë, duke dashur të respektojë me një korrektësi të tepruar formën e shkruar, ndonjë lexues nuk i respekton rregullat e tilla të fonetikës sintaksore, por bën shqiptim të fjalëpërfjalshëm, pa i bashkëlidhur si duhet ato në njësi më të mëdha.

3.4. PËRDORIMI I DREJTË I ZANOREVE NË SHQIPEN STANDARDE

Në rrjedhën e të folurit (në fjalë e fjali) fonemat zanore realizohen si nuanca fonemash përkatëse. Në fjalë duke u përdorur në afërsi bashkëtingëlloresh ose zanoresh, zanoret mund të modifikojnë radhën, hapjen, shkallën e buzorëzimit; ato mund të hundorëzohen etj., rrjedhimisht ndryshohet edhe struktura formante e tyre. Ndërkaq, në pozitën e izoluar zanoreve nuk u ndryshohen as karakteristikat nyjetimore e as akustike. Në tekstet e fonetikës, variantet e tingujve të nyjetuar në pozitë të izoluar quhen nuanca themelore ose *variante themelore*, ndërsa ato të nyjetuara në rrethe të caktuara fonetike quhen variante *pozicionale* ose *kombinatorë*.⁵⁰ Kurdo që përshkruhet nyjetimi i fonemave zanore, zakonisht merret parasysh *nyjetimi i varianteve themelore* të tyre.⁵¹

3.4.1. Drejtshkrimi e drejtshqiptimi i disa fjalëve të huaja që kanë [i] të patheksuar

Në leksikon e gjuhës sonë, në kohë dhe në rrugë të ndryshme kanë hyrë një numër fjalësh nga gjuhë të tjera ose nga terminologjia ndërkombëtare. Këto fjalë, që i takojnë sidomos terminologjisë tekniko-shkencore, kanë depërtuar në gjuhën shqipe kryesisht nëpërmes gjuhës së shkruar.

⁵⁰ Shih: Zeqir Sadiku, *Fonetika e gjuhës së sotme letrare ruse*, Prishtinë, 1981, f. 32.

⁵¹ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 33.

Zgjidhjet që janë dhënë në “Drejtskrimin e gjuhës shqipe” (kreu i tretë) për shkrimin e fjalëve dhe të emrave të përveçëm me prejardhje të huaj, duhet të shërbejnë si bazë edhe për drejtshqiptimin e këtyre fjalëve.

Këtu po ndalemi te fjalët që në shkrim kanë <i> të patheksuar në trup të tyre, por te të cilat kjo <i> është normë drejtshqiptimore të nyjëtohet si një tingull që qëndron midis ëi]-së dhe ëj]-së.⁵²

Fjalët me prejardhje të huaj që kanë hyrë vonë në gjuhën tonë, në përgjithësi nëpërmjet gjuhës së shkruar, kur në trup të tyre kanë grupet e zanoreve **-ia-**, **-ie-**, **-io-**, **-iu-** me /i/ të patheksuar, si rregull, këto togje zanoresh shkruhen me <i> dhe zanoren pasuese, por shqiptohen me ëi] të konsonantizuar, të përfaqëruar me nyjëtimin e ëj]-së. P.sh.:

-ia-: *australian, austriak, aviator, aziatik, ballkaniadë, brazilian, diabet, diagnozë, diagonale, diagramë, dialekt, dialog, diamant, diametër, diapazon, diatezë; dhiatë, elegjiak, financiar, gjenial, imperialist, industrial, material, miliard, olimpiadë, pediatër, piano, psikiatër, racial, special, variant* etj;

-ie-: *ambicie, bankier, dietë, hierarki, hieroglif, higjienë, kantier, karrierë, karrocier, magazinier, malarie, materie, minierë, pionier* etj.;

-io-: *agresion, aksion, aluzion, ambicioz, antibiotik, aviacion, bakteriolog, batalion, bibliotekë, delegacion, komunikacion, mision, recension, sanksion, seksion, sesion, stacion, studio, televizion, version* etj.;

-iu-: *akuarium, barium, helium, herbarium, iridium, kalcium, kalium; kolokuium, simpozium, stadium* etj.⁵³

3.4.2. Përdorimi i drejtë i zanoreve /i/ dhe /y/

Shkruhen dhe shqiptohen me /i/ dhe jo me /y/ fjalët:

ai, bilbil, direk, fishek, frikë, gjilpërë, hipi, krimb, krip, kripë, kripore, qilim, qime, rrip, sirtar, shpirt, shqip, shqipëroj, shqiptoj etj. Shqiptimi i këtyre fjalëve me ëy] (*ay, bylbyl, dyrek, fyshek, gjylpan, hypi, krymb, kryp, krypë, krypore, qylm, rryp, shpyrt, shyp* etj.) është në kundërshtim me normën e sotme letrare.

Përdoren, përkundrazi, me /y/ fjalët: *byzlyk, çyryk, dysHEME, gjym, (i, e) gjymtë, gjymtoj, gjysmë, gjysmak, lyp, lypës, tym, vyshket, zymbyl* etj.

3.4.3. Drejtpërdorimi i zanores /u/

Për shkak të shprehisë dialektore të nyjëtimin, folësit gegë kanë prirje që ta këmbejnë zanoren ëu] të patheksuar me ëë]-në, sidomos në grupin *-ull, -ur*: si *akëll, kukëll, petëll, shpatëll, mashkëll; flutër, hekër, lepër* etj. Normative është të përdoren (në shkrim e në shqiptim) me /u/ në të gjitha rasat emrat dhe mbiemrat, që mbarojnë më *-ull, -ur*, si edhe fjalët e formuara prej tyre:

⁵² Komisioni hartues: Prof. Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli -*Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare), Tiranë, 1976, f. 282.

⁵³ IAP, *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 90-91.

akull, akulli, akullit, akullin, akullore; kukull, kukulle, kukulla, kukullës, kukullën, kukullat, kukullave, kukullash; kumbull, mjegull, nofull, petull, vetull, sqetull, vjedull, kungull, nofull, rrotull, shembull, i pashembullt,⁵⁴ shpatull, tingull, tingullimitues⁵⁵ etj.; (ujë) amull, amulli, mashkull, mashkullor-e etj.; flutur, hekur, lepur etj.

Duhet të përdoren me /u/ (dhe jo me /y/) fjalët:

bufe, bulmet, bulmetore, burokrat, duel, fruta (pemë), grunjëra, (i, e) grunjtë, gjurmë, gjurmoj, kurbet, parashutë, qurra, qurrash, sfungjer, temperaturë, tunel, turk, turqisht etj.

Shkruhen dhe shqiptohen me /y/ (e jo me /u/, as me /i/) fjalët:

bërryl, bylyk, byrazer, byrek, byro, dybek, dyqan, dyshek, fryt,⁵⁶ i frytshëm, frytdhënës, gjynah, mysafir, mysliman, myshteri, natyrë, qymyr, (dhi) shytë, trysni, tyrbe, yndyrë, virtyt, xhybe etj.

3.4.4. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i zanores /e/

a) Zanorja /e/ e theksuar

Shkruhen dhe shqiptohen me /e/ (dhe jo me /ë/) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (**m, n, nj**).

Me /e/ përdoren gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit:

(më) dhemb, dhembje, emër, emëror, femër, femërore, gjemb, gjembaç, e premtë, rremb, shemb, shembull, shembullor, i pashembullt, i shtrembër, shtrembëroj, tremb, thembër, zemër, zemëroj, i përzemërt etj.

argjend, argjendar, brenda, brendi, i brendshëm, cenoj, çmend, (i, e) çmendur, (i, e) dendur, deng, dhen, end, gjendje, kuvend, kuvendoj, mend, mendje, mendoj, mendim, përmend, përmendore, parmendë, pendë, qen, qendër, qendror, (kam) qenë, qenie, qenësi, qengj, shpend, tendë, vend, vendës, zëvendës, zëvendësoj etj.;

e enjte, gështenjë, penj-të, shenjë (por shënoj, shënim), (i, e) shenjtë, (i, e) shtrenjtë, shtrenjtoj, (i, e) vrenjtur; dre, fle, fre, (i, e) nderë, ngre, pe etj.

b) Zanorja /e/ e patheksuar

⁵⁴ Në pajtim me shqiptimin e ngulitur prej kohësh fjala *shembëllej* dhe formimet prej saj, si edhe fjala *shembëlltyrë* shkruhen me -ë- (DGjSh, 60).

⁵⁵ Në pajtim me shqiptimin e ngulitur prej kohësh fjalët *tingëlloj, tingëllim, tingëllimë, bashkëtingëllore*, të formuara nga fjala *tingull* duke u shpërngulur theksi nga -i-ja e temës, shkruhen e shqiptohen me -ë- (DGjSh, 60).

⁵⁶ Duhet dalluar si në shqiptim ashtu edhe në shkrim emri *frutë, fruta* me kuptimin “pemë” nga *fryt, -i* me kuptim abstrakt “*fryti* i punës”.

Tek emrat femërorë, të cilët kanë një /-e/ fundore të patheksuar në trajtën e pashquar të njëjësit, vetëm në emëroren e shquar bie /e/-ja (khs. *artiste - artistja, lule - lulja, nxënëse - nxënësjja, çështje - çështja, ...*), ndërsa në rasat e tjera ajo shkruhet dhe shqiptohet, si p.sh.:

Trajta e pashquar (numri njëjës)

Emërore:	<i>(një) artiste</i>	<i>lule</i>	<i>nxënëse</i>	<i>çështje</i>
Gjinore:	<i>i, e (një) artisteje</i>	<i>i luleje</i>	<i>i nxënëseje</i>	<i>i çështjeje</i>
Dhanore:	<i>(një) artisteje</i>	<i>luleje</i>	<i>nxënëseje</i>	<i>çështjeje</i>
Kallëzore:	<i>(një) artiste</i>	<i>lule</i>	<i>nxënëse</i>	<i>çështje</i>
Rrjedhore:	<i>(prej) (një) artisteje</i>	<i>luleje</i>	<i>nxënëseje</i>	<i>çështjeje</i>

Trajta e shquar (numri njëjës)

Emërore:	<i>artistja</i>	<i>lulja</i>	<i>nxënësjja</i>	<i>çështja</i>
Gjinore:	<i>i, e artistes</i>	<i>i lules</i>	<i>i nxënëses</i>	<i>i çështjes</i>
Dhanore:	<i>artistes</i>	<i>lules</i>	<i>nxënëses</i>	<i>çështjes</i>
Kallëzore:	<i>artisten</i>	<i>lulen</i>	<i>nxënësen</i>	<i>çështjen</i>
Rrjedhore:	<i>(prej) artistes</i>	<i>lules</i>	<i>nxënëses</i>	<i>çështjes</i>

Të tillë janë edhe emrat: *fitore - fitorja, fitoreje; lulishte - lulishtja, lulishteje; mësuese - mësuesja, mësueseje; perde, perdja, perdeje; qytetare - qytetarja, qytetareje; studente - studentja, studenteje; shishe - shishja, shisheje etj.;*

*anije - anija, anijeje; ardhje - ardhja, ardhjeje; familje - familja, familjeje; korrje - korrja, korrjeje; nisje - nisja, nisjeje; pyetje - pyetja, pyetjeje; rrokje - rrokja, rrokjeje; ulje - ulja, uljeje etj.*⁵⁷

3.4.5. PËRDORIMI I DREJTË I ZANORES /Ë/

Zanorja /ë/ në shqipen standarde mund të gjendet në pozitë të theksuar ose të patheksuar. Në shqiptimin e tyre ka dallim. Kur është e theksuar, zanorja /ë/ shqiptohet me forcë më të madhe, është më e qartë dhe më e gjatë sesa kur është e patheksuar. Vetëkuptohet se /ë/-ja e patheksuar shqiptohet si më e dobët, më e errët dhe më e shkurtër.

Një nga problemet më të ndërlikuara të drejtshqiptimit (po edhe të drejtshkrimit) të gjuhës sonë paraqet zanorja /ë/ e patheksuar. Sipas studimeve që kanë bërë gjuhëtarët tanë në fushën e fonetikës së sotme të shqipes, /ë/-ja e patheksuar është e shkurtër, e reduktuar (e quajtur edhe gjysmëzanore); gjysmë e hapur, qendrore dhe hyn në grupin e zanoreve që quhen të lëvizshme, të paqëndrueshme. Në pozitë të theksuar, kjo zanore ruhet mirë. Por, kur është e patheksuar, në përgjithësi ruhet deri diku në ligjërimin libror dhe në të folurit e ngadalshëm, ndërsa në ligjërimin bisedor dhe në të folurit e shpejtë rrudhet (tkurret, reduktohet) në shkallë të ndryshme.⁵⁸

⁵⁷ IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 39-40.

⁵⁸ Kjo zanore ka denduri përdorimi shumë të madhe në dialektin jugor, ndërsa përdorim të rrallë në dialektin verior. Kjo shprehë shqiptimore dialektore pasqyrohet jo vetëm në ligjërimin e shkujdeshtëm, por shpeshherë edhe në ligjërimin libror të pjesëtarëve të të dy dialekteve të shqipes.

/Ë/-ja e patheksuar dobësohet në shkallë të ndryshme, sipas pozicionit në të cilin ndodhet. Ky dobësim ka çuar në disa raste (kur /ë/-ja fundore ka qenë dy rrokje larg theksit, si tek *flútur(ë)*, *dáshur(ë)*, *bótën(ë)* etj. që ajo të mos shqiptohet fare dhe kjo gjë të pasqyrohet edhe në normën e sotme drejtshkrimore.

Zanorja /ë/ e theksuar

Shkruhen dhe shqiptohen me /ë/ të gjitha fjalët të cilat kjo zanore e theksuar i përgjigjet historikisht një /a/-je të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore. Me /ë/ përdoren edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra, të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit:⁵⁹

bëj, çështje, dëm, dëmtoj, dhëmb, dhëmballë, dhëndër, (kam) dhënë, dhënie, e ëma, (i, e) ëmbël, ëmbëlsi, ëndërr, ëndje, frëngjisht, gërshërë, gojëdhënë, gjë, gjëmë, gjëndër, hënë, këmbë, këmbësor, kënd, i këndshëm, këngë, këngëtar, lë, lëmë, lëndë, lëng, llërë, mbrëmje, më (pak), (s' dua) më, mëngë, mëz, nëmë, nëntë, nëntor, (kam) ngrënë, nxë, nxënës, një, (i, e) njëjtë, njëri, njëra, njëri - tjetri, njësi, përzë, (i, e) rëndë, rëndo, (kam) rënë, rrënjë, rrëzë, shkëmb, shtatzënë, shullë, (i, e) tërë, tërësi, tërshërë, (shtëpinë) tënde, (kam) thënë, thëllëzë, zë (zëri), (kam) zënë etj.

Duhet pasur kujdes, sidomos folësit gegë për fjalët: (unë) *lë, një, njëjës, i njëjtë, njëri, njëra, njësi*, (unë) *vë, (unë) zë etj.*, të cilat shpeshherë shqiptohen gabimisht me [ë], [ëa] ose [ëi] në vend të [ëë]-së (*le, nji a nja, njëjës a njëjës, i njëjtë a i njëjtë, njëri, njëra a njëri, njëra; ve, ze*).⁶⁰

Përdoren me /ë/ edhe fjalët me prapashtesën *-llëk*: *bollëk, budallallëk, gomarllëk, hamallëk, pazarllëk etj.*⁶¹

Zanorja /ë/ e patheksuar

Zanorja /ë/ e patheksuar mund të ndodhet para rrokjes së theksuar, si p.sh. *anëtar, ftohtësi* etj. ose pas rrokjes së theksuar (në trup a në fund të fjalës), p.sh. *punë, dasmë, vëgël, (i, e) paster, (disa) shqiptarë etj.*

a) Zanorja /ë/ paratheksore

Sipas rregullave drejtshkrimore, /ë/-ja paratheksore shkruhet në këto raste:

a) në fjalët e parme e në të gjitha fjalët ku ajo i takon rrokjes së parë, si edhe në fjalët e formuara prej tyre:

argëtoj, bagëti, bërryl, dëgjoj, dënesë, dëshirë, fëlliq, fëmijë, gërryey, gëzof, gëzhojë, gjëmoj, hingëllin, këlysh, këmishë, kënaq, këndellem, këndo, këpucë, këpucar, këput, të këqij, kërcëj, kërrusem, këshill, kushëri, lëkurë, lëmoshë, mallëngjej, të mëdhenj, mëkat, mënyrë, mushkëri, ndërroj, ndërresë, shndërroj, pagëzof, pëllëmbë, pëllumb, përrallë, pështjelloj, pështyj, psherëti, rrëfim, psherëti, trashëgoj, thërres, thërrime etj.;

⁵⁹ Nuk përfshihen këtu ato fjalë që në gjuhën letrare kanë hyrë në trajtën me **a**, e cila nuk është më hundore: *dhanore, (i, e) mangët, ranishte, shmang, zanë, zanore etj.*

⁶⁰ Komisioni hartues: Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare)*, Tiranë, 1976, f. 264.

⁶¹ IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 40-41.

dëboj, dëborë, dëlir, dërrasë, kësaj, kësisoj, kësodore, kështu, këta, këtë, këtëj, (i, e) këtillë, lëkund, i lëkundshëm, lëvozhgë, mëditje, mësyj, sëmundje, shpëlaj, tëholl etj.⁶²

b) në fjalë të prejardhura, të formuara nga një temë më /ë/ me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore, dhe në fjalë të përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë më /ë/, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore:

anëtar, anëtarësi (anë); armëtar (armë); atëror, atësi (atë), bardhësi (i bardhë); botëror, botërisht (botë); burrëri, burrëror (burrë); copëtoj, copëzim, copëzoj (copë), drejtësi (i drejtë); frikësoj (frikë); frymëzoj, frymëzim (frymë); gojëtar, gojëtari (gojë); gjellëtoje (gjellë); gjerësi (i gjerë); gjithësi, përgjithësisht (gjithë); gjuhësi, gjuhësor, gjuhëtar (gjuhë); pemëtoje, pemëtari (pemë); pjesëtoje, pjesëtim (pjesë); tokësor, tokëzim (tokë); udhëtar, udhëtim (udhë); valëzoj, valëzim (valë); vështirësi (vështirë); vjershëtoje (vjershë) etj.;

anëshkrim, armëpushim, atëherë, bashkëfjalim, bashkënxënës, bashkëpunoj, bashkëshorte, botëkuptim, bukëpjekës, buzëqesh, çfarëdo, datëlindje, dorëbardhë, dorëheqje, dorëshkrim, dorëzanë, dhjetëvjetor, fletëgjerë, frymëmarrje, gojëdhënë, gojëmjaltë, gjashtëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, i gjithëfuqishëm, gjithëkombëtar, gjuhëgjatë, i jashtëzakonshëm, jetëgjatë, këmbëzbathur, kokëfortë, mbarëvajtje, mirëbërës, mirëbesim, mirëdita, i mirëfilltë, pesëvjeçar, pikënisje, pikëpamje, pjesëmarrje, pulëbardhë, qafëgjatë, shumëkëmbësh, vetëdashje, vetëshërbim, vetëvendosje etj.⁶³

c) po kështu shkruhen me <ë> (si zanore mbështetëse) edhe fjalët e prejardhura, që, megjithëse formohen nga tema më bashkëtingëllore, kanë një strukturë fonetiko-fjalëformuese të ngjashme me atë të fjalëve të mësipërme: *armiqësi (armiq), besnikëri (besnik), bujqësi (bujq); fajësi, pafajësi, shfajësoj (faj); fshatarësi (fshatar); gjakësi, gjakësor (gjak); kombësi, kombëtar, ndërkombëtar (komb); krejtësisht (krejt); vazhdimësi (vazhdim); zdrukthëtar, zdrukthëtari (zdrukth) etj.*

ç) <ë>-ja shkruhet në fjalët e prejardhura, të formuar prej temash më -ër, -ërr, -ël, -ës, -ëz, me anë prapashtesash që fillojnë me zanore, si p.sh.:

arbëror, arbëresh (arbër), ashpëroj (i ashpër), breshëri (breshër), çiltëri (i çiltër); dimëroj, dimëror, dimërim (dimër), dhelpëri (dhelpër); emëroj, emërore, emërues (emër); gjarpëroj, gjarpërushe, gjarpërinj (gjarpër); urdhëresë, urdhëroj, urdhërore (urdhër) etj.; ëndërrim, ëndërroj (ëndërr), picërroj (picërr) etj.; vegjëli, zvogëloj, zvogëlim (i vogël) etj.; nëpunësi (nëpunës), përgjegjësi (përgjegjës), rrobaqepësi (rrobaqepës) etj.; bulëzoj (bulëz); njerëzi, njerëzor (njerëz) etj.

⁶² Shkruhen pa <ë> fjalët *arsye, arsim, arsimtar* dhe ato që formohen prej tyre.

⁶³ Sh ë n i m 1: Nuk shkruhet ë-ja paratheksore te përemrat e pacaktuar, te ndajfoljet e te lidhëzat e përngjitura që kanë si pjesë të parë fjalët *gjithë* ose *kurrë*: *gjithçka, gjithçmos, gjithfarë, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithkush, gjithmonë, gjithnjë, gjithsaherë, gjithsecili, gjithsekush; kurrfarë, kurrgjë, kurrkund, kurrkush, kurrsesi* etj. Po kështu shkruhet pa -ë pjesa e parë e fjalëve *vetete, vetvetiu* dhe e fjalëve të formuara prej tyre: *vetetor, i vetvetishëm*.

Sh ë n i m 2: Për shkak të ngulitjes prej kohësh, të shqiptimit dhe të shkrimit në gjuhën letrare shkruhen pa -ë- fjalët: *amtar, besnik, fillestar, furratar, kishatar, lojtar, meshtar, nevojtari, nevojtore, ngatërrestar, pishtar, rojtari, zyrtari; atdhe*.

Sh ë n i m 3: Nuk shkruhet ë-ja paratheksore te fjalët e përbëra, kur gjymtyra e dytë fillon me zanore: *bashkatdhetar, bashkautor, bashkudhëtar (bashkë); gojëmbël (gojë); i gjithanshëm (gjithë); kokulur (kokë); i shumanshëm (shumë)* etj. (por *njëanësi, i njëanshëm, zëmbël*, sepse ë-ja fundore te gjymtyra e parë e tyre është e theksuar). Shih: Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 42-44.

/ë/-ja paratheksore në rrokje të hapur, kur ndodhet në rrokjen e parë, shqiptohet qartë, p.sh. *dëshirë, fëmijë, kënetë, këpucar, mënyrë, kërcej, përçues, përfshij, përparoj, ndërkombëtar, ndërmjet, ndërtoj, vërtet, vërtetoj* etj. Megjithatë, në disa fjalë ku pas /ë/-së vjen bashkëtingëllorja /rr/, si p.sh. *bërryl, gërryej, kërrabë, ndërroj, ndërresë, dërrasë, përrallë* etj., /ë/-ja shqiptohet mjaft e rrudhur.

b) /ë/-ja pastheksore

Shkruhet e nyjëtohet /ë/-ja pastheksore:

a) tek emrat femërorë më **-ëz**, tek emrat e mbiemrat mashkullorë më **-ës, -ësh** dhe te femërorët përkatës, në të gjitha trajtat e lakimit të tyre, si:

drejtëz - (i, e një) drejtëze, drejtëza, drejtëzës, drejtëzën, drejtëzat, drejtëzave, drejtëzash; gjuhëz-a ..., këmbëz-a ..., kryqëza-t ..., lidhëz-a ..., pjesëz-a ..., thonjëza-t ...etj.; ardhës-i ..., blerës-i ..., brejtës-i ..., çelës-i ..., gjykatës-i ..., shpikës-i ..., vendës-i ..., zgjedhës-i ..., zgjedhës-e ... etj.

b) te mbiemrat me **-ët** në të gjitha trajtat e lakimit të tyre:

i cekët - (i, e një) të cekëti, të cekët, i cekëti, të cekëtit, të cekëtin, të cekëtish, të cekëtve; (i, e) dobët, (i, e) errët, (i, e) lagët, (i, e) kthjellët, (i, e) ngathët, (i, e) përbashkët, (i, e) shkathët, (i, e) ulët, (i, e) zbrazët etj.

c) te trajta e vetës së dytë njëjës e së tashmes lidhore të foljeve me temë më bashkëtingëllore: *të dalësh, të flasësh, të hapësh, të marrësh, të mbyllësh, të mbledhësh, të ndezësh, të presësh, të prishësh, të zhdukësh* etj.⁶⁴

c) /ë/-ja fundore

/Ë/-ja fundore shkruhet në fjalët që theksin e kanë (ose e kanë pasur) në rrokjen e parafundit, duke u ruajtur ajo (/ë/-ja) edhe në trajtat e fjalëve ku s'është më në pozitë fundore.

Po sjellim disa nga rastet më të shpeshta të shkrimit të <-ë>-së fundore:

⁶⁴ Nuk shkruhet dhe nuk shqiptohet /ë/-ja pastheksore:

a) tek emrat dhe mbiemrat më **-ël, -ër, -ërr** dhe tek emrat mashkullorë më **-izëm, -azëm** gjatë lakimit, kur pas këtyre fundoreve vjen një zanore: *bukël, bukla, pupël - (i, e një) puple, puplës, puplën, puplat, puplave, puplash; vegël, vegla etj.; ajër - ajri, dimër - dimri, drapër - drapri, dhelper - dhelpra, dhëndër - dhëndri, emër - emri, gënjeshtër - gënjeshttra, gjarpër - gjarpri, lakër - lakra, letër - letra, zemër - zemra etj.; ëndërr - ëndrra, kokërr - kokrra, vjehërr - vjehrra etj.; anarkizëm - anarkizmi, ateizëm - ateizmi, çiklizëm - çiklizmi, sarkazëm - sarkazmi etj.; i ëmbël - i ëmbli, i vogël - i vogli, i ashpër - i ashpri, i çiltër - i çiltri, i pastër - i pastri, i shtrembër - i shtrembri, i verbër - i verbri etj.*

b) te mbiemrat më **-ëm** e më **-shëm** gjatë lakimit, kur pas këtyre prapashtesave vjen një zanore ose një **j** si edhe kur emëzohen këta mbiemra, si p.sh.: *i jashtëm - (i, e një) të jashtëmi, i jashtëmi, të jashtëmit, të jashtëmin, të jashtëmësh; i mesëm - i mesmi, i sotëm - i sotmi, i vetëm - i vetmi etj.; i ardhshëm - (i, e një) të ardhshmi, i ardhshmi, të ardhshmit, të ardhshmin, të ardhshmish; i atjeshëm - i atjeshmi, e atjeshmja etj.;*

c) para prapashtesave **-shëm** dhe **-të** në të gjitha trajtat e mbiemrave të formuar prej tyre, si: *i natyrshëm, e natyrshme (natyrë), i përkohshëm, e përkohshme (kohë), i pjesshëm, e pjesshme (pjesë), i përbotshëm, e përbotshme (botë), (i, e) përpiktë (pikë) etj.;*

ç) te gjymtyra e parë e trajtave të përngjitura të habitores: *ardhkam, humbkam, marrkam, paskam, qenkam etj.; paskësha, qenkësha etj.*

a) shkruhen me -ë fundore emrat femërorë në trajtë të pashquar, si *bukë, fjalë, vajzë, mollë, shkollë, fletë, lopë, borë, punë, zhurmë* etj.;

Shkruhen me -ë gjithashtu emrat mashkullorë në trajtën e pashquar, si *babë, dajë, gegë, toskë* etj.; *Kolë, Lekë* etj.;

b) pak emra mashkullorë (disa kanë qenë të gjinisë asnjësore), p.sh.: *atë, burrë, djalë, gjumë, kalë, lëmë, lumë; ballë, brumë, djathë, drithë, dyllë, dhallë, dhjamë, gjalpë, mjaltë, ujë* etj.;

c) mbiemrat dhe ndajfoljet e tipit (*i, e*) *butë - butë, (i, e) ftohtë - ftohtë, (i, e) gjallë - gjallë, (i, e) gjatë - gjatë, (i, e) lehtë - lehtë, (i, e) mirë - mirë, (i, e) ngrohtë - ngrohtë* etj.

Në çiftet e fjalëve më poshtë, mbiemrat shkruhen me -ë, ndajfoljet pa -ë: (*i, e*) *drejtë - drejt, drejtpërdrejt, drejtshkrim; (i, e) fortë - fort, (i, e) kotë - kot, (i, e) lartë - lart, i lartpërmendur; (i, e) lightë - lightë, (i, e) mbrapshtë - mbrapshtë, (i, e) plotë - plot, i plotfuqishëm; (i, e) shpejtë - shpejt, (i, e) thjeshtë - thjeshtë, (i, e) vërtetë - vërtet* etj.

ç) me -ë fundore shkruhen edhe shumica e numërorëve (përveç dy, tre - tri, katër; njëzet, dyzet, qind, milion etj.), si *pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, ..., nëntëmbëdhjetë; mijë* etj. si dhe mbiemrat numërorë ëme përjashtim (*i, e*) *katërtç*, si p.sh.: (*i, e*) *parë, (i, e) dytë, (i, e) tretë, (i, e) pestë ..., (i, e) trembëdhjetë ..., (i, e) njëzetë ..., (i, e) gjashtëdhjetë, (i, e) miliontë* etj.

d) e formojnë shumësin me mbaresën -ë një pjesë e madhe e emrave dhe mbiemrave mashkullorë, si: *shkupjanë, dibranë, shkodranë, fshatarë, arsimtarë, shqiptarë, ushtarë, detarë, shkrimtarë, oficerë, inxhinierë, artistë, afaristë, punëtorë, dasmorë, drejtorë, lakrorë, fjalorë, fishekë, dyshekë, mjekë, brirë, drerë, frerë, rrugaçë, romakë, studentë* etj.

dh) pjesoret e foljeve që mbarojnë me temë në zanore ose me sonoret -l, -ll, -r, -rr dhe disa mbiemra të nyjshëm të formuar prej tyre, si: *mjelë, vjelë, dalë; mbjellë, sjellë; parë, qarë, blerë, bërë, pirë, fryrë; marrë, nxjerrë* etj.; (*i, e*) *bërë, (i, e) pirë, (i, e) mbjellë, (i, e) nxjerrë* etj. Me -ë fundore shkruhen edhe pjesoret e tipit: *dhënë, ngrënë, qenë, thënë, vënë, zënë* etj.⁶⁵

/Ë/-ja e patheksuar fundore në gjuhën shqipe kryen disa funksione: a) ajo mund të shërbejë si tregues gramatikor i gjinisë (*ditë, klasë, punë; plak - plakë, zog - zogë*); b) si tregues i shumësit (*një artist - shumë artistë, një shok - shumë shokë, një patriot - shumë patriotë*); c) për të bërë dallimin kuptimor të disa fjalëve (*kos - kosë, lug - lugë, shpat - shpatë, lajm (emër) - lajmë (folje), ar (metal) - arë (tokë)* etj. Kjo shumësi vlerash e fonemës /ë/ fundore në shkrimin e shqipes standarde është e domosdoshme të ruhet, edhe pse prirja e përgjithshme e shqiptimit të këtij tingulli, sidomos në këtë pozicion, shkon drejt reduktimit të saj në shkallën më të lartë, drejt shkallës zero, duke synuar zhdukjen e saj.⁶⁶

⁶⁵ Të dhënat eksperimentale provojnë që -ë-ja fundore ka prirje të bjerë sidomos në stilin bisedor të gjuhës letrare. Pritej në këtë rast që -ë-ja fundore të sillte zgjatim kompensator të zanores së theksuar para saj, siç ka ndodhur, për shembull, në të folmet e gegërishtes. Në të vërtetë nuk ndodh kështu. Dallimet që vihen re në gjatësinë e zanoreve të theksuara të fjalëve të tipit *plak/plakë* janë të paqëndrueshme dhe aq të vogla sa që nuk mund të lozin rol në kundërvënien e tyre. Ato variojnë në çiftet a analizuar si vijon: /plak/ 'plaku' = 7.8 qs., - /plak/ 'plakë' = 8 qs.; /kos/ 'kosi' = 9 qs. - /kos/ 'kosë' = 10 qs.; /shpat/ 'shpati' = 8 qs. - /shpat/ 'shpatë' = 11 qs.; /shok/ 'shoku' = 8 qs. - /shok/ 'shokë' = 10 qs.; /dit/ 'dita' = 10 qs. - /dit/ 'ditë-t' = 5 qs.; /lek/ 'leku' = 7 qs. - /lek/ 'lekë-t' = 8 qs.; /akrep/ 'akrepi' = 7 qs. - /akrep/ 'akrepë-t' = 8 qs.; /qerpik/ 'qerpik-u' = 8 qs. - /qerpik/ 'qerpikë-t' = 8 qs.; /gur/ 'gur-i' = 16 qs. - /gur/ 'gurë-t' = 21 qs. Shih: Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 105-106.

⁶⁶ Enver Hysa, *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike 3-4, 2000, Tiranë, f. 79.

Për arsye të ndryshme, veçmas nga prirja për një korrektësi të tepruar, kryesisht duke i prapavënë çdo fjaleje nga një ëë] fundore ose nën ndikimin e ligjërimeve dialektore toske (apo të disa varianteve drejtshkrimore të mëparshme), në disa raste shqiptohet dhe shkruhet gabimisht një ëë] e tepërt, e panevojshme. Khs. *Kamë shkuarë në Prishtinë dhe kamë parë një shfaqje në teatrinë...* Kjo ëë] fundore as nuk duhet shqiptuar dhe as nuk duhet shkruar (përveç te fjalët: në, Prishtinë, parë, një, në).

Përveç përdorimit të tepruar të ëë]-së, rëndom duke e shqiptuar atë në fundin e çdo fjale, shkrimi e shqiptimi i gabuar i ëë]-së vihet re edhe:

a) tek emrat që në shumësin e pashquar dalin me bashkëtingëlloret /-q/ ose /-gj/ të prirë nga një zanore, si *zogjë,-t, zogjësh; fiqë,-t, fiqësh; pleqë,-t, pleqëve, pleqësh* etj. ndërsa duhet shkruar e shqiptuar *zogj,-të, zogjsh; fiq,-të, fiqsh; pleq,-të, pleqve, pleqsh* etj.;

b) tek emrat që në shumësin e pashquar dalin më /-j/, /-nj/: nganjëherë shkruhen e shqiptohen gabimisht fjalët *bijë,-t, bijëve, bijësh; ftonjë,-t, ftonjëve, ftonjësh; heronjë,-t, heronjëve, heronjësh; thonjë,-t, thonjëve, thonjësh* etj., kurse duhet shkruar e shqiptuar: *bij,-të, bijve, bijsh; ftonj,-të, ftonjve, ftonjs; heronj,-të, heronjve, heronjsh; thonj,-të, thonjve, thonjsh* etj.;

c) te rrjedhorja e pashquar e shumësit të emrave që mbarojnë me zanore të theksuar: ndonjëherë shkruhen e shqiptohen gabimisht *grashë, shtëpishë, drushë, syshë*; kurse duhet shkruar e shqiptuar pa /ë/ fundore *grash, shtëpish, drush, sysh*;

ç) te një numër emrash e mbiemrash me theks në rrokjen e parafundit: herë-herë gabimisht shkruhet e thuhet *fluturë, kodërë, dhelpërë, rregullë, vetullë, dhëmbëzë, lidhëzë, i hekurtë, i tepërtë, i afërmë, i sipërmë*; ndërsa duhet *flutur, kodër, dhelpër, rregull, vetull, dhëmbëz, lidhëz, i hekurt, i tepërt, i afërm, i sipërm* etj. Ndonjëherë një /ë/ e tepërt përdoret te disa trajta të lakimit të emrave, si *botësë, botënë; këngësë, këngënë ...* në vend të *botës, botën; këngës, këngën, ...*

Nën ndikimin e shqiptimit dialektor, ndonjëherë përdoret një ëëç metatetike: në vend që të përdoret sipas normës me **-të**, përdoret me *-ët*; apo sipas rendit të duhur **-më**, shqiptohet a shkruhet në interverzion me *-ëm*. Shqiptohen dhe shkruhen me **-të** dhe jo me **-ët** në trajtën e shquar emrat: *cjep - cjeptë* (jo *cjepët*), *desh - deshët* (jo *deshët*), *djem - djemtë* (jo *djemët*), *dhen - dhentë* (jo *dhenët*), *qen - qentë* (jo *qenët*) etj. Rasat e zhdrejta të shumësit të emrave të mësipërm shkruhen dhe shqiptohen pa /ë/ fundore, prandaj edhe para mbaresave **-ve** dhe **-sh** te këta emra nuk shkruhet e nuk shqiptohet ndonjë ëë]: *cjep - cjepve, cjepsh* (dhe jo *cjepëve, cjepësh*), *desh - deshve* (jo *deshëve*), por *deshësh*;⁶⁷ *dhen - dhenve, dhensh* (dhe jo *dhenëve, dhenësh*), *qen - qenve, qensh* (dhe jo *qenëve, qenësh*).

Është normative të përdoren me **-më** dhe jo me *-ëm* në trajtën e njëjësit të pashquar emrat femërorë: *basmë* (dhe jo *basëm*), *çezmë* (dhe jo *çezëm, çeshme, çeshëm*), *dasmë* (dhe jo *dasëm, darsëm*), *gjysmë* (dhe jo *gjysëm, gjims, gjimc*), *kazmë* (jo *kazëm*), *krisëmë* (jo *krisëm*) etj.

Edhe emrat që dalin me **-m**, si *film, ngulm, sulm* etj. shqiptohen ashtu siç shkruhen. Përdorimi me ëë]: *filëm, ngulëm, sulëm* është i gabuar.⁶⁸

⁶⁷ Këtu <ë>-ja shkruhet për të shmangur takimin e dy /sh/-ve.

⁶⁸ Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare)*, Tiranë, 1976, f. 271-272.

Në Rezolutën e miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit (Tiranë, 1972) pohohet: Kongresi porositi që, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura.⁶⁹ Pothuajse të gjithë studiuesit shqiptarë përkrahin mendimin se duhet bërë përmirësimin e mëtejshëm të Rregullave të Drejtshkrimit, duke synuar sidomos mënjanimin e përjashtimeve jo të pakta, që shoqërojnë shpesh rregullat e përgjithshme.⁷⁰ E dëshirueshme është që rregullat e Drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, sa më përgjithësuese e sa më të lehta në përdorim, që nuk kërkojnë shumë mund e energji në përvetësim. Në këtë rrugë duhet ecur edhe në shkrimin e zanores <ë> në pozicione të ndryshme.⁷¹ Shumica e tyre shprehin nevojën e rishqyrtimit të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit të ëë]-së së patheksuar, për të ndjekur prirjen e sistemit grafik të shqipes për barazimin ndërmjet shkronjës e tingullit, d.m.th. prirja për të mos pasur shkronja parazitare, siç është ëë]-ja në disa pozita të patheksuara, p.sh. mosshkrimi i [ë]-së fundore tek emrat e gjinisë mashkullore (*djalë, burrë, gjumë, kalë, lëmë, lumë, brumë, djathë, drithë, dyllë, dhjamë, grurë, gjalpë, mjaltë, ujë, ballë, atë* e ndonjë tjetër).

3.4.6. PËRDORIMI I DREJTË I TOGJEVE TË ZANOREVE

Gjuha letrare përmban një varg fjalësh të parme (si *arsye, fyell, lyej, pyes, thyej*) e të prejardhura (sidomos emra të vepruesit dhe mbiemra me *-shëm*) që përmbajnë grupin zanor **-ue-** (*dëgjues, mësues, i palexueshëm, i papajtueshëm, i vazhdueshëm*) ose grupin zanor **-ye-** (*arsyeshëm, i pathyeshëm, ...*).

Në shqiptimin e grupeve të zanoreve në fjalët e këtij tipi, si edhe të togjeve të tjera, vihen re luhajtje të ndryshme, nën ndikimin e shqiptimeve dialektore e të traditës shqiptimore të varianteve letrare të mëparshme: disa i shqiptojnë të plota (*arsye, fyell, krye, lyej, pyes, thyej; dëgjues, mësues, i lexueshëm, i pajtueshëm, i vazhdueshëm; i arsyeshëm, i pathyeshëm* etj.), të tjerët i rrudhin: [ye] > [y:], [ue] > [u:] (përkatësisht në /y/ dhe /u/ të gjata): *arsy:, fy:ll, kry:, ly:j, py:s, thy:j a the:j; dëgju:s, msu:s, i lexu:shëm, i pajtu:shëm, i vazhdu:shëm; i arsy:shëm, i pathy:shëm* etj. Në mjaft raste emrat më **-ues, -yes** dhe mbiemrat më **-ueshëm, -yeshëm** shqiptohen më **-uë** apo **-u:**, **-yë** apo **-y:** (*dëgjuës a dëgju:s, mësues a mësus:s, i lexuëshëm a i lexu:shëm, i pathyëshëm a i pathy:shëm, ...*).


Gegërishtja ka grupin zanor ue (shpeshherë të monoftonguar në **u:**), **ndërsa toskërishtja grupin ua.**

1. Grupet **ua** dhe **ue** janë përfutur nga togu **ou**, që më vonë ka dhënë **uo**, ndërsa nga ky i fundit është zhvilluar grupi **ue** në Veri dhe grupi **ua** në Jug. Vargu i zhvillimit fonetik të grupeve të zanoreve **ua** në toskërishte dhe **ue > u:** në gegërishte është ky:

⁶⁹ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 27.

⁷⁰ Këtë mendim e shprehën të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot" mbajtur në Tiranë më 11 dhe 12 nëntor 2002, si: Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve të shqipes standarde*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 41; Emil Lafe, Gjovalin Shkurtaç, Enver Hysa etj.

⁷¹ Enver Hysa, *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike 3-4, 2000, Tiranë, f. 76-80.



Dy dialektet e gjuhës shqipe dallohen edhe për togjet e zanoreve, sepse gegërishtja përdor togun zanor *ue*, ndërsa toskërishtja togun *ua*. Togun *ue* shpeshherë e dëgjojmë të monoftonguar në *u*: të gjatë. P.sh. (fjalë të njëjta në gegërishte - toskërishte): *grue, gru:* - *grua*; *mue, mu:* - *mua*; *thue, thu:* - *thua*; *ftue, ftu:* - *ftua*; *due, du:* - *dua*; *u gzue, u gzu:* - *u gëzua*; *shkruej, shkruj - shkruaj*; (*kam*) *shkue, shku:* - (*kam*) *shkuar, (jam) msue, msu:* - (*jam*) *mësuar*; *me lexue, me lexu:* - *për të lexuar* etj. (Shih hartat 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve të njëjta me grupin *ua* dhe *ue*, në shqipen standarde normative janë format e fjalëve me *ua* (shih shembujt e mësipërm). Togu zanor *ue* i gegërishtes ka hyrë edhe në gjuhën letrare nëpërmjet fjalëve të veçanta, si *mësues, sulmues, e punueshme, i qëndrueshëm, e pabesueshme, e këshillueshme, e parashikueshme* etj.

Shprehia nyjësore e folësve gegë për të përngjashmuar (asimiluar) grupet e zanoreve, ndërsa e folësve toskë për t'i shqiptuar të plota

Vështruar në planin e përgjithshëm, një dallim tjetër fonetik në rrafshin dialektor paraqet edhe ruajtja e togjeve të zanoreve në të folmet e toskërishtes, përkundër përngjashmimit të tyre në të folmet e gegërishtes (me ndonjë përjashtim). Kjo më së miri hetohet te togjet më të shpeshta të zanoreve *ue, ye, ie*: *dëgjues - dëgju:s, bluej - blu:j, shkruaj - shkru:j, gatues - gatu:s, shkruaj - shkru:j; dyer - dy:r, pyes - py:s, fyell - fy:ll, lyej - ly:j; miell - mi:ll, diell - di:ll, qiell - qi:ll, bie - bi:, ziej - zi:j* etj.

Përgjithësisht, mund të thuhet se **shqipja standarde ka ngritur në normë shkrimin dhe shqiptimin e plotë të togjeve të zanoreve**, d.m.th. duke i ruajtur elementet përbërëse të grupeve, pa i përngjashmuar ose pa i cinguar ato.

Togjet e zanoreve **-ua-**, **-ue-** shkruhen dhe shqiptohen të plota, si në fjalët: *buall, buallicë, dragua, duaj, ftua, grua, hua, huazim, muaj, përrua, thua, bluaj, dua, druaj, quaj, ruaj, rruaj, shkruaj, shuaj, mësuar, punuar, sulmuar; botues-e, dëgjues-e, edukues-e, gatues-e, mësues-e, ndërtues-e, parashikues-e, pastrues-e, përpunues-e; i afrueshëm, i dëgjueshëm, i gëzueshëm, i paharrueshëm, i papërtueshëm, i pazëvendësueshëm, i shoqërueshëm, i vazhdueshëm* etj.⁷²

Togu **-ye-** shkruhet dhe shqiptohet i plotë, si p.sh. *arsye, i arsyeshëm, arsyetoj, dyer, fyej, fyerje, krye, kryesi, kryesor, kryekëput, kryeneç, lyej, përlyej, ngjyey, i pëlqyeshëm, përkthyes, pyes, i rrëmbyeshëm, i shkëlqyeshëm, shqeyj, thyej, thyesë, i pathyeshëm* etj.

Edhe grupi zanor **-ie-** shqiptohet siç shkruhet, me theks në elementin e parë, si *diell, qiell, miell, fier* etj. si edhe fjalët e formuara prej tyre (*diellor, qiellor, fierishtë* etj.).

Me **-ie-** përdoren foljet, tek të cilat ky tog zanor ndiqet nga mbaresa **-j**: *ziej, (kam) zier; përziej, (kam) përzier; ndiej, (kam) ndier; por ndej* (ia fal fajin dikujt), si dhe formimet prej saj: *ndjesë, i ndjeri* etj. Këto folje do të shqiptohen me **-je-** vetëm në trajtat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë të dëftores (*zjeva, zjeve, zjeu; përzjeve, përzjeve, përzjeu; ndjeva, ndjeve, ndjeu*) dhe në

⁷² Shih: IAP, *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 62-66.

trajtat e dëshirores (*zjefsha, zjefsh, zjefhtë, zjefshim, zjefshi, zjefshin; përzjefsha, përzjefsh, përzjefhtë; ndjefsha, ndjefhtë, ndjefshim, ndjefshi, ndjefshin*).⁷³

Trajtat pësore-vetvetore të së tashmes dhe të së pakryerës të këtyre foljeve shkruhen dhe shqiptohen me **-i-**: *zihem, zihet, zihen* etj.; *zihesha...*; *përzihem ...; përzihesha ...; ndihem ...; ndihesha ...* etj.

Përdoren me **-ie-** foljet, te trajta përfaqësuese e të cilave ky tog zanoresh ndodhet në rrokje të hapur, si *bie, biem, bien; shpie ...; shtie ...* Por, në vetën e tretë njëjës të lidhore, në urdhëroren njëjës dhe në trajtat e shumësit të kësaj mënyre, kur bashkohen me trajtat e shkurtra të përemrit vector, këto folje shkruhen e shqiptohen me **-j-**: *të bjerë, të shpjerë, të shtjerë; bjer, shpjer, shtjer; bjermëni, bjeruni, shtjeruni* etj.

Në vetën e dytë shumës të së tashmes dëftore, lidhore dhe urdhërore, në të pakryerën e dëftores dhe të lidhore, si edhe në trajtat pësore-vetvetore, këto folje përdoren me **-i-**, si *(të) bini, (të) shpini, (të) shtini; (të) bija ...; (të) shpija ...; (të) shtija ...; (të) bihet, (të) shpihet, (të) shtihet; (të) bihen, (të) shpihen, (të) shtihen; (të) bihej, (të) shpihej, (të) shtihej; (të) biheshin, (të) shpiheshin, (të) shtiheshin* etj.; *(të) vilni; (të) vilja, të vilje ...; vil; (të) vilet, (të) vilen; (të) vilej, (të) vileshin* etj.; *(të) përcillni; (të) përcillja, (të) përcillje ...; përcill; (të) përcillesh ...; (të) përcillesha, (të) përcilleshe* etj.; *të nxirrni ...* etj.

Shkruhen e shqiptohen me **-je-** foljet me temë më **-l, -ll, -rr,** njësoj si edhe foljet e tjera të këtij tipi me temë më bashkëtingëllore (si *rrjedh, djeg, pjek, rrjep*); si edhe të gjitha fjalët e formuara prej tyre: *mjel, vjel* etj.; *mbështjell, mbjell, përcjell, pjell, sjell, shtjell, vjell* etj.; *nxjerr, tjerr, çjerr* etj. *mjelëse, vjelje* etj.

3.4.7. *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i takimit të dy zanoreve të njëjta*

Kur në formim fjalësh takohen dy zanore të njëjta, ato shkruhen e shqiptohen të dyja: *i paaftë, i paafrueshëm, i paanshëm, paanësi, i paarmatosur, i paarrirë, deetimologjizim, kryeengjell, antiimperialist, autoofiçinë, joobjektiv, joorganik, joorigjinal, mikroorganizëm* etj.⁷⁴

Edhe fjalët e tjera me prejardhje të huaj që shkruhen me <-oo->, si *alkool, kooperativë, kooptoj, koordinatë, zoogjeografi, zoolog, zoomorfizëm, zooteknik* etj., në stilin e plotë libror shqiptohen me [-oo-] dhe jo me [-o-].⁷⁵

3.4.7. PËRDORIMI I DREJTË I BASHKËTINGËLLOREVE

⁷³ Shih: Prof. Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli -*Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare), Tiranë, 1976, f. 273.

⁷⁴ Shih: Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 66-67.

⁷⁵ Shih: Komisioni hartues: prof. Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli -*Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare), Tiranë, 1976, f. 282-283.

Bashkëtingëlloret dallohen qartas nga zanoret në pikëpamje nyjëtimore, akustike dhe funksionale. Ndryshe nga zanoret, bashkëtingëlloret formohen nga pengimi i rrymës së ajrit në një pikë të kanalit të zërit, ato janë zhurma dhe në shqipen nuk kanë aftësi rrokjeformuese. Quhen bashkëtingëllore tingujt që nuk perceptohen mirë pa përfshirjen e një zanoreje parashkuese ose prapashkuese.⁷⁶

Shqipja standarde ka 29 bashkëtingëllore: /b/, /c/, /ç/, /d/, /dh/, /f/, /g/, /gj/, /h/, /j/, /k/, /l/, /ll/, /m/, /n/, /nj/, /p/, /q/, /r/, /rr/, /s/, /sh/, /t/, /th/, /v/, /x/, /xh/, /z/, /zh/. Në klasën e bashkëtingëlloreve përfshihen tingujt mjaft heterogjenë si nga ana nyjëtimore, ashtu edhe nga ana akustike.⁷⁷

Klasifikimi fiziologjik i bashkëtingëlloreve rëndom bëhet duke marrë parasysh: vendin e formimit të pengesës, mënyrën e formimit (llojin e pengesës) dhe punën e tejzave të zërit. Bashkëtingëlloret klasifikohen në bazë të këtyre parimeve:

1. sipas **vendit të formimit**: a) sipas organit aktiv, dhe b) sipas organit pasiv;
2. sipas **mënyrës së formimit të pengesës** (apo sipas llojit të pengesës);
3. sipas **pjesëmarrjes së zërit apo të zhurmës**, dhe
4. sipas **rezonancës hundore**.

Po paraqesim përmbledhtas një pasqyrë të tipareve kryesore nyjëtimore dhe akustike të bashkëtingëlloreve të shqipes standarde:

[p]: dybuzore, mbylltore (shpërthyese), e shurdhët;

[b]: dybuzore, mbylltore (shpërthyese), e zëshme;

[m]: dybuzore, mbylltore (shpërthyese), sonore, hundore;

[f]: buzore-dhëmbore, shtegore, e shurdhët;

[v]: buzore-dhëmbore, shtegore, e zëshme;

[t]: paragjuhore (majegjuhore), alveolare-dhëmbore, mbylltore, e shurdhët;

[d]: paragjuhore (majegjuhore), alveolare-dhëmbore, mbylltore, e zëshme;

[n]: paragjuhore, kulmore (kakuminale), alveolare, mbylltore, sonore, hundore;

[s]: paragjuhore (majore), alveolare, shtegore, fishkëlluese, e shurdhët;

[z]: paragjuhore (majore), alveolare, shtegore, e zëshme;

[sh]: paragjuhore, qiellzore-alveolare, dyvatërshe, shtegore, shushuritëse, e shurdhët, me buzorëzim të dobët;

[zh]: paragjuhore, qiellzore-alveolare, dyvatërshe, shtegore, shushuritëse, e zëshme, me buzorëzim të dobët;

[th]: paragjuhore, ndërhdhëmbore, shtegore (frikative), e shurdhët, jobuzore;

[dh]: paragjuhore, ndërhdhëmbore, shtegore (frikative), e zëshme, jobuzore;

⁷⁶ Shih: Andre Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983, f. 80.

⁷⁷ Indianët dhe grekët e vjetër, prej të cilëve është trashëguar ndarja në zanore dhe bashkëtingëllore, u mbështetën në funksionin rrokjeformues. Tingujt që mund të qëndronin më vete e të formonin rrokje, ata i quajtën zanore (lat. *vocalis*, nga *vox*, -cis “zë”), ndërsa tingujt e tjerë që nuk mund të formonin rrokje dhe që mund të përdreshin vetëm të shoqëruar me zanoret, ata i quajtën bashkëtingëllore (lat. *consonans*, -tis), d.m.th. tinguj që tingëllojnë, që shqiptohen bashkë me zanoret. Shih: R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, f. 74-75.

[**l**]: paragjuhore, alveolare, kulmore, shtegore, anësore, lëngëzore, sonore;
 [**ll**]: paragjuhore, alveolare-dhëmbore, kulmore, shtegore, anësore, lëngëzore, sonore;
 [**c**]: paragjuhore, alveolare, afrikate (shpërthyes-fërkimore), e shurdhët;
 [**x**]: paragjuhore, alveolare, afrikate (shpërthyes-fërkimore), e zëshme;
 [**ç**]: paragjuhore, alveolare, afrikate, e shurdhët;
 [**xh**]: paragjuhore, alveolare, afrikate, e zëshme;
 [**r**]: majegjuhore, alveolare, njëdridhëse, sonore;
 [**rr**]: majegjuhore, alveolare, shumëdridhëse, sonore;
 [**q**]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), mbylltore, e shurdhët;
 [**gj**]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), mbylltore, e zëshme;
 [**nj**]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), mbylltore, sonore, hundore;
 [**j**]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), shtegore, sonore;
 [**kç**]: prapagjuhore, shpinore, velare (postpalatale), mbylltore, e shurdhët;
 [**g**]: prapagjuhore, shpinore, velare, mbylltore, e zëshme;
 [**h**]: glotale, shtegore, e shurdhët (nuk ka korresponduese të zëshme).

Siç dihet, varësisht nga realizimet konkrete të tyre, tingujt shfaqen me nuanca të ndryshme. Mirëpo, nga kjo shumësi laramanish tingullore është e nevojshme të përcaktohet njëri nga ta si variant përfaqësues apo variant bazë, siç thuhet më së shpeshti variant themelor i tingullit. Variant themelor i tingullit konsiderohet njëtimi i tij i veçuar, i izoluar, ai i cili më së paku varet nga faktorët e jashtëm fonetikë. Prandaj, si gjatë klasifikimit dhe përshkrimit të zanoreve, ashtu edhe gjatë klasifikimit dhe përshkrimit të bashkëtingëlloreve mbështetemi në variantin themelor të tingujve.

Shpeshherë në të shkruar e në të folur bëjmë gabime jo vetëm gjatë përdorimit të zanoreve, por edhe të bashkëtingëlloreve. Për qëllime praktike, po sjellim disa rregulla të përdorimit të drejtë të tyre, gjatë përdorimit të të cilave mendojmë se gabohet më shpesh.

Dallimi i të folmeve shqipe në numrin e fonemave bashkëtingëllore është i vogël: të folmet me inventarin më të madh kanë 30 fonema, shumë të tjera kanë 29 dhe disa kanë më pak se 29: disa kanë 27, kurse disa të tjera 26 fonema (Gjinari - Shkurtaç, 1997 : 129).

Shumica e të folmeve të toskërishtes dhe të folmet kalimtare kanë në inventarin e tyre ato 29 fonema bashkëtingëllore që ka edhe gjuha letrare:

Në disa të folme të jugut nuk kemi bashkëtingëllore /h/ si dhe shumëdridhësen /rr/. Rrjedhimisht, në këto të folme na dalin 27 fonema bashkëtingëllore: $29 - 2 (/h, rr/) = 27$.

Në të folmet e gegërishte verilindore (kosovarishtes) fonemat mesgjuhore /q, gj/ janë afrikatizuar në /ç, xh/. Pra, shqiptimi më i përparmë i bashkëtingëlloreve mesgjuhore ëq, gj] në të folmet Veriore deri në shkallën e afrikatizimit të plotë në ëç, xh], si ç*i:ll* ‘qiell’, ç*a:f* ‘qafë’; x*hak* ‘gjak’, x*hu:m* ‘gjumë’ etj. ka për pasojë mungesën e mesgjuhoreve /q, gj/. Mirëpo, këto të folme kanë edhe një bashkëtingëllore prapagjuhore, mbylltore, sonante, hundore /ŋ/ e përfituar nga përngjashmimi i grupit ng, si në fjalët ngat > *ŋat*, cung > *cunŋ*, ngaj > *ŋaj*, ngarkoj > *ŋarkoj*, mëngjes > *mengez* > *meŋe:s*, kungull > *kunŋëll*, bung > *bunŋ*, opangë > *opa:ŋ*, cung > *cunŋ* etj. Nga kjo del se këto të folme kanë $29 - 2 (/q, gj/) = 27 + 1 /ŋ/ = 28$ fonema bashkëtingëllore (Shih hartën 27 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Dallime më të mëdha në sistemin e bashkëtingëlloreve ndërmjet të folmeve shqipe dalin në përndarjen dhe dendurinë e përdorimit.

3.5.1. Përdorimi i bashkëtingëlloreve /s/ dhe /z/ nistore

Fjalët me /s/, /z/ nistore, të ndjekur nga një bashkëtingëllore (disa prej të cilave nyjëtohen ngandonjëherë edhe me ëç] ose ëx]), shkruhen dhe shqiptohen kështu:

a) me /s-/, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët ose e tingullt (m, n, l), si p.sh. *sfungjer, sfurk, skuq, sqepar, squfur; smirë, smirëzi* etj.

b) me /z-/, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme: *zbardh, zbath, zbavit, zbokth, zbraz, zbukuroj, zdrukth, zgavër, zgrip, zgjat, zgjedh, zverdhem, zvogëloj* etj.

3.5.2. Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve sh-/zh-/ç- nistore

Bashkëtingëlloret sh-/zh-/ç- nistore, shpesh në funksion parashtese, duke u përshtatur në zëshmërinë e tingujve që vijnë pas, paraqiten në **tri variante fonetike të të njëjtës fonemë**. Si parashtesë, shërben kryesisht për të formuar folje prej foljesh, duke i dhënë asaj kuptim të kundërt, p.sh. *çarmatos* (armatos), *çënjtem* (ënjtem), *çorganizoj* (organizoj), *çorientoj* (orientoj); *shpalos* (palos), *shqep* (qep), *shthur* (thur); *zhdredh* (dredh), *zhduk*, *zhdukem* (dukem), *zhvendos* (vendos), *zhvesh* (vesh), (*i, e*) *zhdrejtë* (i, e drejtë) etj. Ky tip është produktiv dhe aktiv në shqipen standarde.

Te një numër foljesh, kjo parashtesë shpreh intensitetin e veprimit të shoqëruar edhe me ngjyrimë të reja kuptimore, p.sh. *çliroj* (khs. liroj), *shkëmbej* (khs. këmbëj), *shkëput* (khs. këput), *shndërroj* (ndërroj), *shpërndaj* (khs. përndaj) etj.⁷⁸

Për shkrimin e kësaj foneme me tri variantet e saj, Drejtshkrimi ka dhënë këtë zgjidhje: Shkruhen dhe shqiptohen me /sh/ nistore fjalët kur pas saj vjen një bashkëtingëllore e shurdhët (f, k, p, q, t, th etj. meqë edhe ësh]-ja është e shurdhët), si *shfaq, shfaqje, shfaros, shfryj, shfrytëztoj; shkarkoj, shkatërroj, shkoq, shkreh, shkrep, shkujdesem; shpjegoj, shpif, shpikje, shpoj, shprish, shporr; shqetësoj; shtjelloj, shtrydh* etj.⁷⁹

Me /zh/ nistore përdoren fjalët kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme (b, d, g, gj, v; sepse edhe ëzh]-ja është e zëshme). P.sh. *zhbllokoj, zhbëj; zhdredh, zhdoganoj, zhdëmtoj, zhduk; zhgënjej, zhgërryey; zhgjakësohem; zhgjëndërr; zhvendos, zhvilloj, zhvleftësim* etj.⁸⁰

Normë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore është përdorimi i /ç/-së kur kjo ndiqet nga një zanore ose nga një bashkëtingëllore e tingullt (l, ll, r, rr, m, n, nj, j): *çorientoj, çlodhem,*

⁷⁸ Shih: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, f. 206-207.

⁷⁹ Shkruhen me <sh> fjalët *shmang, shlyej, shndërroj, shndrit* dhe ato që formohen prej tyre.

⁸⁰ Shih: Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 73.

çregjistrim, çrregulloj, çrrënjos, (i, e) çrregullt, çmend, (i, e) çmendur, çmos, çnderoj, çnjerëzor, çjerr etj.⁸¹

3.5.3. Drejtshkrimi i /c/-së

Fjalët me prejardhje të huaj që shkruhen me <c> të ndjekur nga zanorja <i> ose <e>, shqiptohen gjithashtu me /c/ dhe jo me /ç/: *acid, celulë, central, ciklon, cisternë, deficit, elektrikist, incizoj, koncert, koncesion, konciz, proces, recension, recetë, suficit* etj.

Bëjnë përjashtim fjalët *biçikletë, çiklist, çiklizëm, çimento*, shqiptimi dhe shkrimi me /ç/ i të cilave është ngulitur prej kohësh.

3.5.4. Takimi i /t/-së me /sh/-në

Te mbiemrat e formuar me prapashtesën **-shëm** dhe te trajtat e dëshirores, kur **sh**-ja e prapashtesës takohet me **-t**-në e temës, duhet të shkruhen dhe të shqiptohen që të dyja këto bashkëtingëllore (pa u asimiluar në **ç**), si: *i begatshëm, i çuditshëm, i ndritshëm, i përditshëm, i përshatshëm, i sotshëm, i vjetshëm* etj.; *arritsha, arritsh, arritshim, arritshi, arritshin*; po kështu *ditsha, fjetsha, goditsha, gjetsha, këputsha, matsha, mbetsha, pritsha, shëtitsha* etj.

3.5.5. Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores /rr/

Ngjashmëria nyjetimore dhe ngarkesa e vogël funksionale ka mundësuar rrafshimin e kundërvënieve fonologjike të bashkëtingëlloreve /r/ dhe /rr/ në disa të folme tona. Mirëpo, këto bashkëtingëllore në gjuhën shqipe janë dy fonema të veçanta, gjë që provohet me çifte minimale fjalësh të tilla, si *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë, deri ~ derri, rimë ~ rrimë* etj.

Në gjuhën letrare të folur, sidomos te bartësit jugorë dhe te disa pjesëtarë të gegërishtes jugore, vihet re një përzjerje e këtyre bashkëtingëlloreve, me kahje nga /rr/-ja te /r/-ja, përkatësisht të humbjes së opozicionit fonologjik /r/ ~ /rr/. Ndaj, e shohim të udhës të ritheksojmë dallimet kryesore ndërmjet këtyre dy bashkëtingëlloreve, duke sjellë edhe disa fjalë me /rr/.

Fonemat /r/ dhe /rr/ i kundërvihen njëra-tjetrës me dy tipare: 1. *me numrin e dridhjeve të majës së gjuhës*: 1-2 te [r]-ja, 3-4 te [rr]-ja, dhe 2. *me ndemjen* (tendosjen) e organeve të të folurit: [r]-ja shqiptohet pa ndemje, [rr]-ja me ndemje. Tipari i dytë nga pikëpamja fonologjike vlerësohet si më i rëndësishëm. Shpesh /rr/-në e karakterizojmë si të fortë, për të dalluar nga /r/-ja që nuk është e tillë. Kohëzgjatja e nyjetimit të [r]-së është më e vogël, sepse për të nevojiten vetëm 1-2 dridhje të majës së gjuhës, ndërsa për nyjetimin e [rr]-së kalon një kohë më e gjatë, ngase duhen 3-4 dridhje. Ndaj, në sistemin e bashkëtingëlloreve të shqipes i vetmi opozicion fonologjik i gjatësisë (e shkurtër ~ e gjatë) së bashkëtingëlloreve vërehet te fonemat /r/ ~ /rr/.

Një nga parimet bazë të statistikës gjuhësore thotë se sa më komplekse të jenë fonemat në nyjetim, aq më pak përdoren. Statistika gjuhësore jep të dhënat se fonema /r/ ka denduri të madhe përdorimi (6,28%), ndërsa /rr/-ja ka denduri të vogël përdorimi (0,50%); /r/-ja përdoret

⁸¹ Përemri **ç** tek të gjitha fjalët e formuara me pjesëmarrjen e tij, shkruhet i pandryshuar, pavarësisht nga bashkëtingëlloret që e pason: *çdo, çdokush, çdonjëri, çfarë, çfarëdo, i çfarëdoshëm, çka, diçka, gjithçka*. Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 73.

12,56 herë më shumë se /rr/-ja.⁸² Dyfishimi i bashkëtingëllores /r/ që ka krijuar /rr/-në ndonjëherë është bërë për shkaqe ekspresive e afektive të gjuhës, si *derr*, *zjarr*, *tmerr*, *gaforre*, *horr* etj.

Në shqipen standarde, drejtshkrimi me drejtshqiptimin e këtyre dy fonemave njëdridhëse e shumëdridhëse përputhen plotësisht, meqenëse bashkëtingëlloret /r/ dhe /rr/ në ato fjalë ku shqiptohen edhe shkruhen. U tha se bashkëtingëllorja /r/ ka një denduri më të madhe përdorimi sesa /rr/-ja. Megjithkëtë, nuk janë të pakta rastet kur /rr/-ja shqiptohet dhe shkruhet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës:

a) në fillim të fjalës, si: *rrafsh*, *rrahje*, *rrebes*, *rreckë*, *rregull*, *rremb*, *rrepë*, *rresht*, *rreshter*, *rreth*, *rreze*, *rrezik*, *rrëfim*, *rrënjë*, *rrëzë*, *rrip*, *rrjetë*, *rrotë*, *rrudhë*, *rrufe*, *rrugë*, *rrugaç*, *rrush*, *rrymë*, *rruzull*; *rrah*, *rrekem*, *rrej*, *rrëfej*, *rrëgjoj*, *rrëmbej*, *rrëmih*, *rrënoj*, *rrëshqas*, *rrëztoj*, *rri*, *rrit*, *rrjedh*, *rrjep*, *rroj*, *rruaj*, *rrudh*; (i, e) *rrallë*, *rreth e rrotull*, *rrotull* etj.

b) në mes të fjalës: *arrë* (pemë), *barrë*, *bërryl*, *birrë* (pije), *burrë*, *curril*, *ferrë*, *furrë*, *hurrë*, *karrige*, *korrik*, *kurriz*, *mëshqerrë*, *përrallë*, *përrua*, *qerre*, *qurra*, *sorrë*, *sharrë*, *thërrime*, *varrë*, *zorrë*, *sipërmarrje*; *arrij*, *gërryey*, *harroj*, *ndërroj*, *ngatërroj*, *ngurroj*, *urrej*; *kurrë* etj.; disa huazime kryesisht nga gjuhët romane: *arrestim*, *arrogancë*, *barrikadë*, *karrierë*, *korrekt*, *korrekturë*, *korrespondencë*, *korridor*, *korrigjoj*, *territor*, *terror*, *terrorist* etj.

c) në fund të fjalës: *berr*, *curr*, *derr*, *ëndërr*, *gabzherr*, *horr*, *kokërr*, *morr*, *oborr*, *qarr*, *qorr*, *sherr*, *terr*, *tmerr*, *varr*, *vjehërr*, *zjarr*; *bjerr* (por e kryera e thjeshtë *bora*), *çjerr* (por *çora*), *korr*, *marr* (por *mora*), *nxjerr* (por *nxora*), *tjerr* (por *tora*) etj.

3.5.6. Drejtpërdorimi i mesgjuhoreve /q, gj/

Në një numër të madh të të folmeve të gegërishtes, mesgjuhoret mbylltore të zhurmëta [q] dhe [gj] nuk bëjnë pjesë në inventarin e fonemave bashkëtingëllore, sepse aty-këtu këto nyjëtohen si më të përparme, aq sa në shumë të folme plotësisht janë afrikatizuar në paragjuhore afrikate [ç], respektivisht [xh]. Prandaj, duke munguar këto dy bashkëtingëllore mesgjuhore në bazën artikulative të tyre, disa folës të shkujdesshëm këtë e shprehin edhe në ligjërimin letrar. Si kur flasin ashtu edhe kur shkruajnë, bashkëtingëlloren /q/ e afrikatizojnë në /ç/, ndërsa /gj/-në në /xh/, si p.sh.: *qafë* > *çaf*; *qen* > *çen*, *qiri* > *çiri*, *qilim* > *çilim*, *qersh* > *çersh*, *qiell* > *çi:ll*, *qift* > *çift*, *qymyr* > *çymyr*, *qyqe* > *çyçe*; *gjak* > *xhak*, *i gjallë* > *i xha:ll*, *gjarpër* > *xharpër*, *gjashtë* > *xha:shtë*, *gjeth* > *xheth*, *gjysh* > *xhysh* etj. Dihet se rregull drejtshqiptimor dhe drejtshkrimor është përdorimi i këtyre fjalëve me /q/, përkatësisht me /gj/.

3.5.7. Përdorimi i bashkëtingëllores /nj/

Sa i përket përdorimit të këtij tingulli, mund të themi se bashkëtingëllorja sonante mesgjuhore mbylltore hundore /nj/ në të folmet dialektore nuk përdoret kudo njësoj. Kështu, në të folmet gege /nj/-ja ka denduri të rrallë përdorimi (krahasuar me toskërishten dhe shqipen standarde), meqë në të shumtën e rasteve zëvendësohet me [ëj]-në ose më rrallë me [ën]-në, si p.sh. *e zoja* < e zonja, *brîja* < brinja, *ftoj* < ftonj, *hûj* < hunj, *pêj* < penj, *nisoj* < njësoj; *ni* (nyjë e trajtës së pashquar), *njâ* (numëror) < një, *nizet* < njëzet etj. Gjuha standarde shqipe, duke pasur

⁸² Shih: Anastas Dodi, *Shqipja si gjuhë ballkanike në ...*, f. 759-765.

mbështetje përdorimin e këtij tingulli në sistemin gjuhësor dialektor të toskërishtes, e ka ngritur në normë ruajtjen e kësaj bashkëtingëlloreje në të gjitha pozitat e fjalës: në pozitë nistore, mesore dhe fundore.

Në fillim të fjalës, bashkëtingëllorja /nj/ përdoret në rastet si: *një, njëri, njeri, e njoh, i njohur, njoftim, i njomë, njëzet, njollë, nja* (pesë a gjashtë) dhe në fjalë të tjera të formuara prej këtyre.

Në pozicion mesor, d.m.th. në trup të fjalës, bashkëtingëllorja -/nj/- përdoret në rastet, si: *ujkonjë, zonjë, zonjushë, banjë, gështenjë, shkronjë, shenjë, mushkonjë*; mbiemrat (*i, e*) *florinjë, (i, e) drunjë, (i, e) grunjë, (i, e) shenjë, (i, e) shtrenjë* etj.

Në pozicion fundor /nj/-ja përdoret te trajtat e shumësit të disa emrave e mbiemrave, si p.sh.: *arinj, barinj, kallinj, kushërinj, mullinj, sharrëxhinj, turinj, ullinj; heronj, thonj, ftonj, budallenj, drunj, hunj, gjarpinj ose gjarpërinj, përrenj, lëmenj, lumenj, priftërinj, shkëmbinj; (i ri) të rinj, i zi (të zinj)* etj.⁸³

3.5.8. Drejtpërdorimi i bashkëtingëllores /j/

Për shkak të zëshmërisë së madhe të saj dhe shkallës së ngritjes së pjesës së mesme të shpinës së gjuhës drejt qiellzës, bashkëtingëllorja sonore mesgjuhore shtegore ëj] gjendet në një shkallë afrie relativisht të madhe me zanoren e mbyllur ëi]. Prandaj, në shumë raste në të folmet shqipe ndodh që ëi]-ja të zhvendosë bazën nyjëtimore drejt ëj]-së ose të konsonantizohet plotësisht në ëj].⁸⁴ Por, nganjëherë edhe ëj]-ja ndodh që të humbë karakterin bashkëtingëllor dhe të anojë nga zanorja ëi], ose të shndërrohet plotësisht në ëi].

Për shkak të veçorive gjysmëzanore që ka, bashkëtingëllorja ëj] shërben edhe si tingull antihijatizues (bukurtingëllues), që futet midis dy zanoreve për të lehtësuar shqiptimin e tyre.

Pikërisht për shkak të këtyre veçorive të paqëndrueshme, përdorimi i bashkëtingëllores ëj] në të folmet shqipe del i larmishëm. Kjo deri diku e vështirëson normën e drejtshkrimit të saj.

Rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde kanë ngritur në normë shkrimin e bashkëtingëllores /j/ në këto raste:

a) Tek emrat dhe fjalët e formuara prej tyre, ku kjo bashkëtingëllore ndërzanore i përket temës, p.sh.: *anije - anija, anijen, anijet, anijeve, anijesh, anijetar*; po kështu edhe: *batanije, dije, fije, hije, shije, bijë, fëmijë, nyjë, pajis, shkëndijë, ujë, vijë, skaj* etj.

Ndër këta emra, ata që mbarojnë me temë më /-e/ të patheksuar, në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore të pashquar njëjës, përveç /j/-së së temës marrin edhe një -/j/- epentitike midis temës dhe mbaresës, si: (*i, e*) *një anije-j-e, (i, e) një batanije-j-e, (i, e) një dije-j-e, (i, e) një fije-j-e, (i, e) një vetëdije-j-e* etj.

b) Tek emrat femërorë që mbarojnë me zanore të theksuar (përveç me /i/ të theksuar), gjatë trajtave të lakimit, kur zanorja e theksuar ndiqet nga një zanore tjetër. P.sh.: *ide, ide-j-a, ide-j-e; kala-j-a, para-j-a, rrufe-j-a, ve-j-a, gjë-j-a, tablo-j-a, dysHEME-j-a, të dy-j-a, hare-j-a* etj.

⁸³ Bëjnë përjashtim dhe sipas normës drejtshkrimore dalin me -j në shumë këto fjalë: *kufi - kufij, i keq, e keqe - të këqij, të këqija, krua - kroje*.

⁸⁴ Krahaso: *ai > aj, i vëllai > i vëllaj, shkoi > shkoj, punoi > punoj; ndiej por ndjeva* etj.

Bashkëtingëlloren /-j-/ epetentike e marrin në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore të pashquar njëjës edhe emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me temë në /-e/ të patheksuar, si: (i, e) një *lule-j-e*, (i, e) një *zanore-j-e*, (i, e) një *bashkëtingëllore-j-e*, (i, e) një *fletore-j-e*, (i, e) një *dele-j-e* etj.

Por, emrat që mbarojnë me /-i/ të theksuar nuk marrin /-j-/ epetentike midis dy zanoreve, p.sh.: *bukuri, bukuria, bukurie; cilësi, cilësia, cilësie; dashuri, dashuria, dashurie; liri, liria, lirie; parti, partia, partie; rini, rinia, rinie; shtëpi, shtëpia, shtëpie; ministri, ministria, ministrie* etj.

c) Te trajta e shquar e emrave femërorë, të cilët në njëjës in e pashquar para zanores /e/ kanë bashkëtingëlloret mesgjuhore /gj/ apo /q/, p.sh.: *lagje - lagj-ja, (një) lagjeje; ndërgjegje - ndërgjegj-ja, (një) ndërgjegjeje, përgjigje - përgjigjja; paqe - paq-ja, (një) paqeje; shoqe - shoq-ja, (një) shoqeje; burbuqe - burbuq-ja, (një) burbuqeje* etj.

ç) Në gjinore, dhanore e rrjedhore njëjës të pashquar dhe në emërore të shquar njëjës të emrave që mbarojnë me /-o/ të patheksuar: *depo - (i, e) një depo-je, depo-ja; pallto - (i, e) një pallto-je, pallto-ja; radio - (i, e) një radio-je, radio-ja* etj. si dhe në emrat e përveçëm: *Koço-ja, Kristo-ja, Pirro-ja, Kajro-ja, Kongo-ja* etj.

d) Te foljet e zgjedhimit të parë (që dalin me mbaresën /-j/: -aj, -ej, -ëj, -ij, -oj, -uj, -yj, -yej, -uaj) ruhet kjo bashkëtingëllore edhe në mënyrën urdhërore, kur u prapangjiten trajtat e shkurtra të përemrave vetorë -e dhe -i, si:⁸⁵ *arrij - arrije* (shokun), *arriji* (shokët) (dhe jo arrie, arrii); *kërkoj - kërkojeni* (shokun), *kërkojini* (shokët) (dhe jo kërkoeni, kërkoini); *laj - laje* (fytyrën), *laji* (rrobat) (dhe jo lae, lai); *punoj - punoje, punojeni* (tokën) (dhe jo punoe, punoeni).⁸⁶

3.5.9. Drejtpërdorimi i bashkëtingëllores /h/

Në zbatimin e normës së drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit të bashkëtingëlloreve hetohen luhatje edhe në përdorimin e bashkëtingëllores glotale shtegore të shurdhët ëh]. Ajo, siç u tha, në shqipen përgjithësisht shqiptohet me një rrymë mjaft të dobët ajri. Në disa të folme të gegërishtes jugore, veçmas në të folmet e toskërishtes, dëgjohej e rrëgjuar ose vende-vende nuk dëgjohej fare. P.sh. ^h*ëna, ëna* < hëna; ^h*laem, laem* < lahem; ^h*undë, undë* < hundë; ^h*ak, ak* < hak; ^h*ambar, ambar* < hambar etj. Dukuria mosshqiptimit të ëh]-së pasqyrohet edhe në disa emra

⁸⁵ Bashkëtingëlloret /j/ përdoret edhe në format e vetës së parë e të tretë njëjës e shumës të së tashmes lidhore, në formën e së ardhmes, në vetën e parë e të dytë njëjës të së pakryerës dëftore, lidhore e kushtore, si dhe në formën e vetës së dytë njëjës të urdhërores, në rastet kur formës foljore i bashkohen trajtat e shkurtra pastheksore të përemrave vetorë e, i p.sh.: (unë) *laj* - (ne) *lajmë*, (ata, ato) *lajnë*; (unë do të) *laj*, (ai, ajo do të) *lajë*, (ne do të) *lajmë*, (ata, ato do të) *lajnë*; (unë do të) *laja*, (ti do të) *laje; laje!*; si dhe: *mbaj ...; thaj...; bëj ...; arrij ...; fshij ...; vij ...; punoj ...; qëndroj ...; fryj ...; ndiej ...; paguaj ...; shkruaj ...; lyej ...; kryej ...* etj. Por, foljet që në vetën e parë të së tashmes dëftore dalin më zanore, si *ha, fle, lë, nxë, vë, zë, di, pi*, nuk përdoren me -j, p.sh. *ha* - (do të) *hamë*, (do të) *hanë; të ha, të hash; ha!*

⁸⁶ Shih: Komisioni hartues: Prof. A. Kostallari (kryetar), E. Lafe, M. Totoni, N. Cikuli -*Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare), Tiranë, 1976, f. 274-276.

vetjakë ndër ne, si *Alit* < Halit, *Alim* < Halim, *Isen* < Hysen, *Muarem* < Muharrem, *Bejtulla* < Bejtullah etj.⁸⁷

Në kundërshtim me normën është edhe rasti i kundërt, kur, nën ndikimin dialektor, shtohet në fillim të disa fjalëve një ëh] e tepërt, si p.sh. *harritur, hec, hik, hindian, haborr* etj. Këto fjalë duhet shqiptuar dhe shkruar pa ëh]: (kam) *arritur, ec, ik, indian, oborr*.

Duke u mbështetur në shqiptimin letrar dhe në traditën e shkrimit, kjo shtegore e shurdhët është normative të ruhet, si në pozitë nistore, mesore e fundore. P.sh.:

a) në fillim të fjalës: *ha, habit, hap, harabel, hardhi, hardhucë, hark, hartë, harroj, hedh, hënë, hije, hipi, i hollë, hu, hua, hudhër, humb-as, hundë, hyj* etj. Ruhet në shkrim dhe në shqiptim edhe në fjalët me prejardhje të huaj që e kanë ëh]-në në gjuhën dhënëse, si: *haber, hajvan, hak, hall, hallë, hallvë, hamam, hajdut, hajmali, hallkë, hambar, han, haraç, harmoni, harxh, hashash, hava, havan, helen, hemoglobinë, hepatit, hibrid, hidrocentral, higjienë, hipnozë, hipodrom* etj.⁸⁸

b) në fund të fjalës, p.sh. në foljet *deh, fsheh, ftoh, leh, mih, mpreh, ngrëh, nxeh, njoh, shoh, rrah* etj.; në emrat si *ah, gjah, krah, pleh, pah, shah* etj. në të gjitha trajtat e tyre: *krahu, krahut, krahun, krahët, krahëve, krahësh, ...*

c) në mes të fjalës /h/-ja përdoret te format joveprore të foljeve me temë në zanore, si: *lahem, lahesh ...; kthehem ...; bëhem ...; fshihem ...; tregohem ...; mësohem ...* etj; në një numër fjalësh të burimit turk: *aheng, ahur, bahçe, behar, çehre, duhan, mëhallë, rehat, sahan, sahat, sehir, spahi, tahmin, xhevahir* etj.

Herë-herë, nën ndikimin e shqiptimit dialektor, disa fjalë me [h] në pozicion fundor, si p.sh. *ftoh, mpreh, njoh, shoh* etj., si dhe kur [h]-ja gjendet para [t]-së: *ftohhtë, nxehtë, i mprehtë* etj. shqiptohen me ëf]: *ftof, mpref, njof, shof; i ftoft, i nxeft, i mpreft* etj. Shqiptimi dhe shkrimi me ëf] i këtyre fjalëve është një shkelje e normës së sotme drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore. Fjalët e mësipërme duhet të shqiptohen dhe të shkruhen kurdoherë me ëh] dhe jo me ëf].⁸⁹

3.5.10. DREJTPËRDORIMI I BASHKËTINGËLLOREVE TË ZËSHME, GRUPEVE DHE TAKIMEVE TË BASHKËTINGËLLOREVE

Drejtëpërdorimi i bashkëtingëlloreve të zëshme

Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së zërit, bashkëtingëlloret, siç është përmendur edhe më parë, ndahen në të zëshme dhe në të shurdhëta. Bashkëtingëlloret e zëshme /b, d, dh, g,

⁸⁷ Tek emrat vetjakë të shënuar, përveç rënies së /h/-së, vërehen edhe disa dukuri të tjera fonetike, si zhburorëzimi i /y/-së në /i/ dhe këmbimi i /rr/-së në /r/.

⁸⁸ Shih: Prof. A. Kostallari (kryetar), E. Lafe, M. Totoni, N. Cikuli - *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Elemente të normës së sotme letrare kombëtare), Tiranë, 1976, f. 279.

⁸⁹ Bëjnë përjashtim fjalët *njoftoj, njoftim* (nga *njoh*), *letërnjoftim*, të cilat janë ngulitur prej kohësh në gjuhën letrare, në shkrim e në shqiptim, me trajtën më [f]. Shih: Prof. Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli - *Gjuha letrare shqipe për të gjithë ...*, Tiranë, 1976, f. 280.

gj, v, x, xh, z, zh/, kur gjenden në fund të fjalës (në toskërishten) dhe para bashkëtingëlloreve të shurdhëta, në ligjërim kanë prirje të shurdhohen, përkatësisht ta humbin zëshmërinë dhe të kalojnë në përgjegjëset e tyre të pazëshme: [b > p, d > t, dh > th, g > k, gj > q, v > f, x > c, xh > ç, z > s dhe zh > sh].⁹⁰ Këto nuk janë fonema më vete, por variante pozicionale (kur gjenden në fund të fjalës) ose kombinatore (të zëshmet kur gjenden para të shurdhëtave) të të njëjtës fonemë.

Pavarësisht nga pozita në fjalë (në fund, në mes apo në fillim të fjalës), ose nga rrethimi tingullor (përpara apo prapa çdo zanoreje a bashkëtingëlloreje) në ligjërimin letrar përgjithësisht shkruhen si të zëshme, si p.sh.: *elb, gjemb, korb, rob; fund, kënd, standard, shkund, vend; gardh, bredh, ndodh, zbardh, ndrydh; breg, burg, djeg, larg, lëng, i lig, shteg, varg, prag, zog; qengj, mos e digj, ligj, u përgjigj; hov, borxh, bixhoz, brez, çamçakëz, dorëz, filiz, gaz, ndez, njerëz, oriz, pullaz, garazh* etj.

Ja edhe disa forma drejtshkrimore fjalësh kur ndonjëra nga bashkëtingëlloret e zëshme gjendet para të shurdhëtave: *humbte, humbka, humbsha; i elbtë, mundte, mundka, mundsha, i mundshëm; vendqëndrim, vendstrehim, vendkalim; mblihte, lagte, lagka; digjte, ndizte, ndezsha* etj.⁹¹

3.5.11. Togje bashkëtingëlloresh

Përdorimi i një tingulli pranë një tingulli tjetër realizohet në bazë të rregullave fonotaktike. Në gjuhën shqipe disa tinguj mund të përdoren pranë njëri-tjetrit (do të thotë ata janë të bashkëpajtueshëm), kurse disa të tjerë nuk mund të përdoren (do të thotë nuk janë të bashkëpajtueshëm).

Bashkueshmëria e tingujve, grupet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, së bashku me inventarin e fonemave, janë veçori të rëndësishme që përcaktojnë tipologjinë e gjuhës.

Kur dy bashkëtingëllore përdoren dendur njëra pranë tjetrës, formojnë grupe a togje të qëndrueshme bashkëtingëlloresh. Të tilla janë togjet *mb, nd, ng, ngj, pl, pj, fl, fsh, bl, br, vj, shk* etj. Më shpesh përdoren togjet **mb, nd, ng, ngj**.

Grupet e bashkëtingëlloreve përdoren në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Statistika gjuhësore, duke u mbështetur në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) përdëfton se shqipja ka 132 grupe bashkëtingëlloresh nistore, prej të cilave 101 janë grupe dyshe dhe 31 grupe treshe. Disa bashkëtingëllore, p.sh. sonantet anësore /l/, /ll/; dridhëset /r/, /r/; mesgjuhoret /q/, /gj/, /j/, /nj/ nuk përdoren si element i parë i grupeve nistore dyshe. Denduri më të madhe në fillim të fjalës kanë grupet *shtegore + sonante* (56 grupe) dhe grupi *mbylltore + sonante* (47 grupe). Nuk përdoren grupet afrikate + afrikate, mbylltore + afrikate dhe /h/-ja nuk merr pjesë si bashkëtingëllore e parë në grupet e bashkëtingëlloreve nistore.

Grupet e bashkëtingëlloreve fundore dyshe janë më të pakta se grupet nistore. Shqipja ka 89 grupe të ndryshme bashkëtingëlloresh fundore. Grupet fundore me tri bashkëtingëllore janë më të rralla, por ato i gjejmë në fillim të fjalës.⁹²

⁹⁰ Ky ndërrim i tingujve të zëshëm në korresponduesit e tyre të pazëshëm kur gjenden në fund të fjalës është shprehur nyjëtimore e folësve toskë, si *zok* (< zog), *vënt* (< vend), *brek* (< breg) etj.

⁹¹ Shkruhen me -s ndajfoljet e formuara me prapashitesën -as: *baras, barkas, befas, djathtas, majtas, fshehtas, fyntas, haptas, këmbadoras, krahas, rishtas* (por: *barazi, barkazi, fshehtazi, haptazi, rishtazi* etj.).

⁹² Shih: Anastas Dodi, *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e ...*, f. 764.

Shqiptimi i bashkëtingëlloreve dyfishe (geminatave), si /tt/, /ss/, /mm/, /nn/, /ff/ etj., por edhe i togjeve të bashkëtingëlloreve paraqet vështirësi në rrjedhën e ligjëritimit; për këtë arsye priremi t' i shmangim ato me rrugë të ndryshme, si me shkrirjen e dy bashkëtingëlloreve në një të vetme, ndërkaljen e një tingulli zanor ndërmjet dy bashkëtingëlloreve etj.⁹³ Përdorimi i drejtë i grupeve të bashkëtingëlloreve në gjuhën e sotme letrare shqipe del i vështirësuar për arsye se në shumë të folme geqe ato janë përngjashmuar (asimiluar) në bashkëtingëllore të rëndomta, ose ndonjëra nga to është shkrirë në një tingull të vetëm.⁹⁴

Në shqipen standarde është ngritur në normë që togjet e bashkëtingëlloreve të ruhen të plota, si në nyjetim ashtu edhe në shkrim, në të gjitha pozitat: në fillim të fjalës, në mes dhe në fund. P.sh.:

mb: mbaj, mbush, mbaroj, mbesë, mbetem, (për)mbi, mbijë, mbjell, mbyt; dhëmbë, i ëmbël, këmbë, kumbull, thembër; gjemb, humb, shkëmb, krimb, plumb, shkëmb etj.;

nd: ndaj, nder, ndesh, ndër, ndërmarrje, ndërmjetës, ndërtoj, ndihmoj, ndjek, ndjell, ndodhem, ndriçoj; andej, këndej, këndoj, mandej, mundoj, përmendsh, prandaj; fund, kurrkund, kuvend, mend, mund, vend, përmend etj.;

ng: nga, ngacmoj, ngarkesë, (i, e) ngathët, ngel, ngij, (i, e) ngordhur, ngricë, ngroh, ngryset, ngut, ngul, ngushticë; brengë, këngë, kungull, i mangët, mëngë, shtëllungë, trangull; bung, cung, deng, peng, shmang, trung etj.;

ngj: ngjaj, ngjalë, ngjall, i ngjashëm, ngjesh, ngjit, ngjyey, ngjyrë; engjëll, tungjatjeta, thëngjill, ungjill; qengj, ungj etj.⁹⁵

3.5.12. Takime bashkëtingëlloresh

Në rrjedhën e të folurit, ndodh që të përdoren njëra pas tjetrës dy apo tri bashkëtingëllore të ndryshme ose të njëjta. P.sh. mund të takohen /t/-ja me /sh/-në, njëra nga këto: /d/-ja, /s/-ja, /t/-ja ose /z/-ja me /h/-në, /d/-ja me /t/-në, /g/-ja ose /n/-ja me /j/-në; të takohen dy bashkëtingëllore të njëjta e të formojnë bashkëtingëllore dyshe ose geminate, si /dd/, /ss/, /tt/, /shsh/ etj. Këto paraqiten si bashkim i dy fonemave të veçanta.

“Drejtskrimi i gjuhës shqipe” ka ngritur në normë shkrimin e bashkëtingëlloreve edhe kur gjenden në kontakt, përveç rasteve kur takohen <g>-ja ose <n>-ja me <j>-në (sepse në vend të /j/-së shkruhet <i>). T’i shohim rastet veç e veç:

a) Takimi i <g>-së ose i <n>-së me <j>-në

Ka fjalë dhe trajta fjalësh me theks në rrokjen e parafundit, te të cilat takohet /g/-ja ose /n/-ja e temës me /j/-në e prapashtesës a të mbaresës (djeg+je, marrëdhën+je, pedagog+ja etj.).

⁹³ Shih: Kolec Topalli, *Bashkëtingëlloret dyfishe të gjuhës shqipe*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastër, Tiranë, 2004, f. 265-277.

⁹⁴ Kështu, në shumicën e të folmeve të gegërishtes verilindore a kosovarishtes grupi bashkëtingëllor [ng] është shkrirë në një bashkëtingëllore sonore prapagjuhore hundore [ŋ], si p.sh. ngat > ŋat, ngusht > ŋusht etj.

⁹⁵ Shih: IAP, *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 86.

Për drejtshqiptimin, takimi i /g/-së ose i /n/-së me /j/-në nuk paraqet problem: secili tingull ruan mëvetësinë, pra shqiptohet si tingull i vetëm.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, për të mënjeluar shqiptimin e këtyre dy shkronjave si një fonemë të vetme (<gj ose nj>), kërkon që fjalët e këtij tipi të shkruhen me <i> dhe jo me <j>, si p.sh.: *djegje - djegia* (lexohet ëdjeg-ja), *lagje - lagia*, *shmangje - shmangia*, *shtangje - shtangia*; *biologe - biologia*, *filologe - filologia*, *gjeologe - gjeologia*, *kirurge - kirurgia*, *pedagoge - pedagogia*, *radiologe - radiologia* etj. Këto fjalë, pavarësisht nga shkrimi, duhet t'i shqiptojmë me ëj] dhe jo me ëi] (djeg+je, lag+je, shmang+je, shtang+je...). Gjithashtu, shkruhen me <i>, por lexohen me ëj] fjalët: *dhënie, kundërthënie, kundërvënie, marrëdhënie, ngrënie, parathënie, pasthënie, paradhënie, qenie, rënie, thënie* etj.; *shkupjania, dibrania, shkodrania, italiania, indiania* etj.

b) Takimi i <d>-së me <t>-në

Kur në formim fjalësh ose trajtash takohen një <d> me një <t>, shkruhen të dyja këto bashkëtingëllore (dt): (*i, e*) *argjendtë, (i, e) njëmendtë, (i, e) njëqindtë, (i, e) pesëqindtë, i treqindti* etj.; *mendtë, ai po e bindte; po endte; lindte, në lindtë djalë; nuk mundte; në mundtë; rendte; në rendtë; shkundte; në shkundtë; tundte; në tundtë* etj.

c) Takimi i <d>-së, <s>-së, <t>-së ose i <z>-së me <h>-në

Fjalët e prejardhura ose të përbëra, te të cilat takohet <d>-ja, <s>-ja, <t>-ja ose <z>-ja me një <h> që vjen pas tyre, sipas *Drejtshkrimit të gjuhës shqipe* shkruhen pa ndonjë shenjë ndarëse midis pjesëve përbërëse (por ruhet shqiptimi i veçuar i shkronjave të mësipërme), si: *i herëpashershëm, meshollë, moshapje, moshyrje, disharmoni; shtathedhur; brezhumbur, gazhedhëse* etj. Po kështu shkruhen edhe emrat e përveçëm ku ka takime të tilla: *Bethoven, Ethem, Mithat* etj.⁹⁶

ç) Takimi i dy bashkëtingëlloreve të njëjta

Kur në formim fjalësh a trajtash takohen dy shkronja të njëjta, njëra prej të cilave mund të bëjë pjesë në një dyshkronjësh, ato shkruhen të dyja: *kënddrejtë, nëndarje, kundërrevolucionar, kundërreformë, mossulmim, zëvendëssekretar; në arrittë; në mos e godittë; e gjettë e mira; në u mbyttë; ndrittë; i kujdesshëm, passhkrim, i pjesshëm, leshhollë, shpeshherë, mishshitës, veshshkurtër* etj.

Kur takohen shkronjat <r> me <rr>-në, si dhe <l> ose <ll> me <ll>-në, shkruhet vetëm <rr> ose <ll>: *përreth* (për+rreth), *dembellëk* (dembel+llëk), *fodullëk* (fodull+llëk), *hamallëk* (hamall+llëk), *jeshillëk* (jeshil+llëk) etj.⁹⁷

⁹⁶ Shikuar nga këndi i nevojës së rishqyrtimit të disa çështjeve të normës drejtshkrimore, përsosjes, thjeshtimit dhe përcjelljes së zhvillimit të shqipes standarde, mendojmë se për t'u ruajtur shqiptimi i veçuar i pjesëve përbërëse të dyshkronjëshave dhe për t'u shmangur leximit të gabueshëm si njëshkronjësh, ka mundësi që pjesët përbërëse të digrafeve të ndahen me apostrof. Kështu, fjalët e mësipërme do të shkruheshin: *i herëpas'hershëm, mes'hollë, mos'hapje, mos'hyrje, dis'harmoni; shtat'hedhur; brez'humbur, gaz'hedhëse; Bet'hoven, Et'hem, Mit'hat* etj. Por, gjithsesi kjo është çështje e ujdisë së përgjithshme e gjuhëtarëve shqiptarë.

⁹⁷ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 89.



3.6. NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit mbështetet kryesisht në ndarjen e fjalëve në rrokje, por merr parasysh edhe strukturën morfologjike të fjalës si dhe disa parime të tjera. Për ndarjen e fjalëve në rrokje ka disa rregulla:

1. Nuk ndahen më dysh në fund të rreshtit:

- a) fjalët njërrrokëshe, si *jam, lis, dash, dru, qen* etj.;
- b) shkronjat e një dyshkronjëshi: *mo-lla* (jo mol-la), *bre-dhi* (jo bred-hi), *bu-rrri* (jo bur-ri) etj.
- c) fjalët e përbëra të shkurtuara: *RM, ShBA, OSBE, NATO* etj.;
- ç) shkurtimet e tipit *b.f.* (bie fjala), *d.m.th.* (domethënë), *e.r.* (era e re), *p.sh.* (për shembull) etj.;
- d) një shkronjë e vetme nuk mund të qëndrojë as në fund të rreshtit, as në fillim të rreshtit të ri: *bu-ka* (jo b-uka ose buk-a), *mu-ri* (jo m-uri as mur-i) etj. Nuk ndahen as edhe fjalët që përbëhen prej një tingulli, siç është pjesëza e mohimit *s'* dhe përemri pyetës *ç*;
- dh) nuk duhet të ndajmë shkurtimet a shifrat që tregojnë masë nga shifrat që tregojnë sasinë: *2 m², 5 kg, 100%* etj.;
- e) nuk mund të hapen kllapa a thonjëza në fund të rreshtit e as të mbyllen në fillim të rreshtit tjetër. Nuk mund të kalojnë në rreshtin tjetër as shenjat e pikësimit, me përjashtim të vizës.

2. Dy shkronja të njëllojta që takohen në një fjalë, mund të ndahen në fund të rreshtit: *i pa-anshëm, i pa-arsyeshëm, ko-operativë, vaku-um, kundër-revolucion, hesht-te, e gjet-të* (e mira) etj.

3. Në fjalët me dy ose më shumë rrokje, bashkëtingëllorja që gjendet midis dy zanoresh ndahet në fund të rreshtit ashtu që shkruhet me zanoren që vjen pas, si p.sh.: *dru-ri, bo-ta, mi-ku, qe-ni, u-ji, ba-rra, gë-zim, nje-ri-u, bu-ku-ri-a, li-ri-a* etj.

4. Kur ndërmjet dy zanoresh ndodhen dy a më shumë bashkëtingëllore, atëherë njëra bashkëtingëllore shkon me zanoren e parë, ndërsa tjetra apo bashkëtingëllorja e fundit shkruhet me zanoren që pason. Parapëlqehet ndarja që ruan më qartë kufijtë e pjesëve të kuptimshme të fjalës ose kufijtë morfologjikë: *maj-tas, lo-dra* ose *lod-ra, po-sta* ose *pos-ta, i brend-shëm, për-parim* etj.⁹⁸

⁹⁸ Nëse fjalët shumërrrokëshe midis dy zanoresh kanë togjet e bashkëtingëlloreve *dr, dhr, fr, fsh, gl, kr, krr, mb, nd, ng, sp, shk, sht, tr* ndarja në fund të rreshtit është e lirë.

5. Fjalët e përbëra, fjalët e përngjitura si dhe fjalët e prejardhura ndahen në kufirin e pjesës përbërëse të tyre: *hekur-udhë, bukur-shkrim, gjith-monë, tungjat-jeta, bashk-atdhe-tar, i për-kohshëm, zëvendës-drejtor, nën-oficer, shpër-ngul, mbi-shkrim, për-parim, për-mirë-sim, punë-tor* etj.

6. Kur kalon në rreshtin tjetër pjesa e dytë e një fjale a e një emërtimi të përbërë që shkruhet me vizë lidhëse, atëherë në krye të rreshtit përsëritet viza lidhëse, si p.sh.: *copa/-copa, aty/-këtu, vajtje/-ardhje, hyrje/-dalje* etj.⁹⁹

3.7. PARAQITJA GRAFIKE E TEKSTIT (grafematika)

Ngulitja e normës drejtshkrimore u jep fjalëve një pamje shkrimore, si të thuash, një fytyrë. Perceptimi i saj merr vlerë në vetvete, prandaj ndryshimet e drejtshkrimit ngjallin reagime deri emocionale. Trajta shkrimore përbën grafemikën, që e studion grafematika. Për stilistikën kanë rëndësi po njësoj variantet shkrimore dhe organizimet e tyre për shprehësi. Edhe shkrimi ruan gjurmë të historisë së përdorimit gjuhësor, që përbëjnë vlera.

Dallohen dy nivele të grafemikës. I pari ka të bëjë me shkronjat. Dallohen shkronja të mëdha e të vogla; të drejta, të zeza, kursive e të nënvizuara. Në shtypshkrimet ato kanë përmasa të shprehura në pikë tipografike dhe njihen disa qindra lloje sipas karakterit. Në botimet, tabelat, reklamat etj., shfrytëzohen të gjitha ndërthurjet, duke nisur nga shkrimi jo prej të majtës në të djathtë, por nga lart poshtë, me zhvendosje, e deri te ngjyrat dhe stilizimet. Në kohën tonë të një bote imazhesh, tashmë shkronjat janë bërë pjesë e imazheve deri në pikturë e në ekran. Edhe letërsia u drejtohet këtyre përftesave. Ismail Kadareja i nis kapitujt e “Kështjellës” me kursive, për të shënuar zërin e mbrojtësve të kështjellës, të dalluar nga rrëfimi i mëtejshëm prej autorit në vetën e tretë.

Është i zakonshëm përdorimi i shkronjave të mëdha për fjalë të tëra, që të vihet në dukje diçka: *U përpoq ta bindte veten se kështu ishte e thënë dhe ky ishte fati i tij. FATI I TIJ... Ai ishte diçka e pashmangshme.* (N. Papeka, “Gjaku i tokës”, 1985); *Ai nënvizoi: MARR{DHENIET E TYRE AKTUALE. Pastaj nuk i pëlqeu fjala AKTUALE dhe i ra vizë.* (B. Mustafaj, “Një sagë e vogël”, 1995).¹⁰⁰

Shtypi shërbehet me të gjitha mundësitë, që i duhen për efekte. P.sh. shfrytëzon ndarjen e fjalëve në rrokje me kuptim (madje sot gjurmohen rastet kur copëtimi sjell kuptime fyese). P.sh. *Kukësi, apo Ku? Kë? Si?* (“Aleanca”, 30.03.1993). Te “Shkaba” I. Kadareja emrin e një lokali; meqë çdo gjë në vepër ka natyrën e një fluturimi përmbys, e lexon së mbrapshti, pra *Bar Liria* bëhet *Airil Rab*, madje dhe emri *Ana* përmbysset *anA*. Ky është një autor që krijon letërsi grafike, ku kuptimet dhe imazhet lidhen edhe me shkronjën. Në vitet 1990 nisi përdorimi i emërtimit të gazetave vetëm me shkronjat e para të titullit: *RD-ja, ZP-ja*.

Niveli i dytë ka të bëjë me formësimin e përgjithshëm, që u nënshtrohet teknikave të faqosjes, duke nisur nga formati i letërsë dhe duke vazhduar me vendosjen e lëndës, gjerësinë e kolonave, hapësirat, titujt, kornizat e shoqërimit me lëndën ilustruese.

⁹⁹ Viza e pjerrët (/) këtu shënon fundin e rreshtit.

¹⁰⁰ Po aty.

Së fundi, pikësimi ka rol sidomos për të treguar lëvizjen e përgjithshme të frazës, grupet e saj ritmike, shpërndarjen e theksave dhe intonacionin. Në prozën letrare pikësimi lidhet me mënyrat e rrëfimit dhe me evoluimin e tipave të ligjëratës. Thonjëzat që nuk janë vënë për citim, shërbejnë për ironi. Autorët qëllimisht i shkelin rregullat e njohura të pikësimit, ose i përdorin në mënyrë subjektive. P.sh. *Së shpejti, duke çarë mes për mes hapësirën dimërore me avionin-kalë-balash, në dyluftimin e tmerrshëm me perënditë shkurtabiqe të stepës...* (I. Kadare) - përmgjiten fjalët e një sintagme për të dhënë imazhin të shkrirë në një.¹⁰¹

3.8. THEKSIMI NORMATIV I FJALËVE

Tipare të përgjithshme të theksit në gjuhën shqipe

Theksi, në kuptimin më të ngushtë, zakonisht përkufizohet si të spikaturit e një rrokjeje me mjete të ndryshme fonetike. Theksi është të spikaturit e rrokjes me anë të forcës, të gjatësisë dhe të lartësisë së tonit. Rrokja që veçohet nga të tjerat për nga shqiptimi (me fuqi, gjatësi dhe lartësi më të madhe të tonit) është rrokje e theksuar, ndërsa të tjerat janë rrokje të patheksuara. Për shkak se njëra nga rrokjet që ka theksin dallohet nga rrokjet e patheksuara, në renditjen vijore të tingujve krijohet një kontrast fonetik. Tingujt e rrokjes së theksuar, veçmas zanoret, dallohen fonetikiqisht nga tingujt e rrokjeve të patheksuara. Krahasoni zanoret e theksuara nga të patheksuarat në fjalët: *shkóllë, punëtór, përrúa, mësúes, përparimtar, líbër, njerí, lexój, dritáre, studént, pranvérë* etj.

Dihet se theksi i shqipes qëndron i palëvizshëm në procesin e eptimit të fjalëve, duke ruajtur pozicionin e tij të formave përfaqësuese (formave bazë të fjalëve), përkatësisht duke e ruajtur pozitën e tij të rasës emërore numër njëjës në lakimin emëror dhe atë të vetës së parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në zgjedhimin foljor. P.sh.: *mál, máli, i málit, málin, mále, málet, málesh, máleve; flútur, flútura, flúturat, flúture, flúturash, flúturave; qytetár, qytetári, qytetárit, qytetárin, qytetarë, qytetarët, qytetarësh, qytetarëve; láj, lán, lájme, láni, lájne; láva, láve, láu, lája, (kam, jam) lárë; punój, punón, punójme, punóni, punójne; punója, punóje, punónte, punónim, punónit, punónin; punóva, punóve, punói, punúam, punúat, punúan; kam punúar* etj. Te togjet e zanoreve, theksi bie mbi elementin e parë të togut: *i edukúar, grúa, përrúa, thúa, mësúes, i dëgjúeshëm, díell, qíell, fyell, përkthýes* etj. Pra, karakteristikë themelore e gjuhës shqipe është se ajo ka theks të palëvizshëm (të qëndrueshëm), meqenëse gjatë lakimit ose zgjedhimit të fjalëve, theksi mbetet në po atë rrokje.

Tiparet e theksit në gjuhën shqipe janë: intensiteti, lartësia, gjatësia, përqendrimi apo shpërqendrimi dhe qartësia e timbrit, d.m.th., a) zanoret e theksuara shqiptohen me forcë dhe lartësi më të madhe, b) të theksuarat janë më të gjata se të patheksuarat, c) zanoret e patheksuara kanë prirje të bëhen më qendrore, dhe ç) zanoret e theksuara shqiptohen me qartësi më të madhe sesa të patheksuarat.

¹⁰¹ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 63.

Theksi në fjalë leksikalisht të ndryshme mund të bjerë në rrokje të ndryshme, përkatësisht në një rreth nga dy rrokjet e fundit të fjalës (rrallë në rrokjen e tretë). Përkatësisht, në gjuhën shqipe 54% e fjalëve shqiptohen me theks parafundor, 44% me theks fundor dhe vetëm 2% me theks tejfundor.

Theksi përgjithësisht në gjuhën shqipe është i ngulitur. Më të shpeshta janë fjalët me theks fundor (lexój), parafundor (shkóllë) e më të rralla me theks tejfundor (flútura, punúakemi). Në fjalët e prejardhura me prapashtesim (përveç prapashtesave -as, -ës dhe -je), theksi vendoset në prapashtesë (gojëtar), ndërsa në fjalët e përbëra a kompozita (botëkuptím) dhe në fjalët e përngjitura (dalëngadálë) theksi vendoset në elementin e dytë, përkatësisht në elementin e fundit fjalëformues.

Përmbledhtas mund të thuhet se ndër tiparet themelore të theksit të shqipes, të analizuar e të pranuar nga shumë gjuhëtarë, janë:

- a) lidhur me llojin e theksit: *shqipja ka theks dinamik*;
- b) lidhur me lëvizshmërinë e tij: *shqipja ka theks të ngulitur në paradigmën e eptimit*;
- c) lidhur me vendin e theksit brenda fjalës: *shqipja nuk thekson mbaresat dhe ka prirje të theksojë zanoret parafundore*.

Karakteri parafundor i theksit të shqipes duhet pranuar vetëm në aspektin morfologjik, meqenëse shqipja nuk thekson mbaresat; si rrjedhim, duke pasur, përgjithësisht, një mbaresë, krijohen fjalë me theks parafundor (khs. fush-ë, fush-e, fush-a; lis-i, lis-a; ha-më, ha-ni, tha-shë, puno-va etj.). Kështu, karakteri parafundor i theksit të shqipes nuk qëndron për fjalën në vetvete, jashtë treguesve gramatikorë. Këtë e tregojnë fjalët e shumta me theks fundor, si emrat *armik, qersh, shtëpi, bukuri, punëtor, arsimitar, pullaz, ...*, foljet *punoj, mësoj, lexoj, bashkoj, ushqej, lulëzoj, ...* që janë plotësisht në natyrë të shqipes (Kolec Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995, f. 53-57).

Disa huazime leksikore shqipja i ka përshtatur (adaptuar) sipas natyrës së vendit të theksit në shqipen, ndërsa disa të tjera e ruajnë theksin si në gjuhën dhënëse (prej nga vijnë). Pra, përgjithësisht ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor. Rol të rëndësishëm për adaptimin e theksit të fjalëve të huazuara luajnë koha (se a janë huazime të vjetra apo të reja) dhe denduria e përdorimit të tyre. Parimisht, sa më gjatë të jenë në përdorim, aq më tepër janë përshtatur; dhe sa më shpesh që përdoren aq më shumë kanë gjasa të adaptohen e anasjelltas. Shqipja ka prirje ta vendosë theksin e fjalës në rrokjen parafundore. P.sh. te sllavizmat dialektorë në gjuhën shqipe theksi nga rrokja e tretë zhvendoset në rrokjen e dytë, si sll. *névolja* - shq. *nevóje*, sll. *lopata* - shq. *lopátë*, sll. *lédina* - shq. *ledínë* etj., por disa fjalë shqiptohen me theks në rrokjen fundore.

Shprehia njëtimore e folësve gegë për zhvendosjen e theksit te disa orientalizma nga rrokja fundore në rrokjen parafundore

Në karakterin e theksit, shqipja dialektore dhe standarde është mjaft unike: theksi gjithkund është dinamik, i lirë dhe i palëvizshëm. Rregulla e përgjithshme e vendosjes së theksit mund të përcaktohet si vijon: Në gjuhën shqipe letrare e dialektore theksi i fjalës vendoset në zanoren e fundit të parrëgjuar të temës fjalëformuese.

Tipar dallues, tani më i pranuar nga të gjithë gjuhëtarët, ndërmjet dy dialekteve të shqipes është zhvendosja e theksit te disa orientalizma në gegërishte nga rrokja fundore në rrokjen

parafundore. Në karakterin e theksit shqipja dialektore (gege e toske) dhe standarde është mjaft unike: theksi gjithkund është dinamik, i lirë dhe i palëvizshëm. Rregulla e përgjithshme e vendosjes së theksit mund të përcaktohet si vijon: Në gjuhën shqipe letrare e dialektore theksi i fjalës vendoset në zanoren e fundit të parrëgjuar të temës fjalëformuese.

Në shtrirjen dialektore të shqipes, në theks dallohen pak fjalë të tipit: tosk. *njeri* - geg. *njëri*, *një:r*; tosk. *verí* - geg. *véri*, tosk. *qirí* - geg. *qíri*, *çíri* etj., të cilat përgjithësisht në të folmet e toskërishtes shqiptohen me theks fundor, ndërsa në të folmet e gegërshtes me theks parafundor (Shih hartat 130, 131, 132, 133 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Theksimi parafundor përbën modelin karakteristik të skemës theksore të fjalëve të shqipes, prandaj edhe disa fjalë të huazuara nga turqishtja, në të folmet e gegërishtes e rregullojnë theksin sipas natyrës së shqipes me të ashtuquajturin rregullim mekanik të theksit, ndërsa në të folmet e toskërishtes shqiptohen me theks fundor (ashtu si ka qenë në gjuhën nga janë huazuar). Khs. fjalët e njëjta në toskërishte e në gegërishte: *kafé* - *káfe*, *teneqé* - *tenéqe*, *tenxheré* - *tenxhére*, *teqé* - *téqe*, *minaré* - *mináre*, *kadifé* - *kadífe*, *zahiré* - *zahíre*, *penxheré* - *penxhére*, *babá* - *bábë* > *bá:b*, *pashá* - *pásha* > *páshë* > *pá:sh*; *pará* - *páre*, *bakllavá* - *bakllávë* > *bakllá:v*; te disa emra vetjakë me burim oriental *Fatimé* - *Fatíme*, *Hatixhé* - *Hatíxhe*, *Ajshé* - *Ájshe*, *Makfíre* - *Makfíre* etj.

Kjo zhvendosje e theksit në disa orientalizma nga rrokja fundore në rrokjen parafundore trajtohet si dukuri dalluese fonetike ndërmjet dy dialekteve të shqipes. Por, duhet thënë se ka shumë fjalë të huazuara orientale që edhe në dialektin Verior shqiptohen me theks në rrokjen fundore, si p.sh. *sefá*, *belá*, *sevdá*, *e xhumá*, *dynjá*, *hatá*, *xhamí*, *bojaxhí*, *teneqexhí*, *rahmetlí*, *hujlí*, *sheherlí* etj.

Në gjithë shqipen (në gegërishte, në toskërishte e në standard) në fjali rëndom fjalët shërbyese (pjesëzat, lidhëzat, nyjat e përparme, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, parafjalët etj.) bëhen të patheksuara dhe shqiptohen me një theks të vetëm me fjalët emërtuese (emrat, mbiemrat, foljet, përemrat, numërorët, ndajfoljet), si *Një-lépur-i-ri zemërák u-ul nga-máli në-fúshë dhe-hýri në-një-pemíshhtë / ku-gjéti të-gjútha-të-mirat*. Përveç fjalëve të patheksuara, në ligjërim ka edhe fjalë të theksuara dobët (rrötull shtëpísë) e fjalë me theks dytësor (flùturím).

Theksimi në mënyrë të rëndomtë është tipar i ligjërimit asnjans (neutral), ndërsa shpeshherë edhe në ligjërimin dialektor e letrar përdorim theks logjik dhe emocional, me qëllim që të rritet pesha kuptimore a emocionale e thënies në variante të ndryshme. Variantet sjellin me vete ngjyrimë krahinore (*kafé* - *káfe*, *teneqé* - *tenéqe*, *njerí* - *njëri*, *verí* - *véri*), sociale, kulturore, që shfrytëzohen në gojëtarë, humor, teatër, film e më së shumti në poezi.

Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ç'është theksi?
2. Thoni tiparet e përgjithshme të theksit në gjuhën shqipe.
3. Çfarë ngjashmërie dhe çfarë dallimi kanë të folmet shqipe në theksin e fjalës?
4. Si është bërë përshtatja theksore e huazimeve në shqipen?
5. Bëje një punim në temën: *Theksi në të folmen time*.

3.9. USHTRIME DREJTSHKRIMORE

- Tekstet e mëposhtme janë shkruar me plot gabime gjuhësore (të natyrës fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore). Rishkruani në formë të redaktuar gjuhësore.

A.

Dit'e bukur vere. Gjithshka ndriqon nën rezet e dillit dhe lëngon nga vapa përvluse. Megjithatë jeta në qytetin tan është shumë e rëndomt dhe jopërfillse ndaj temperaturave të larta. Gjithçka xhalleron si zakonisht dhe rrugt janë përplot me njerz e vetura të cilat me zhurmën e tyre shurdhuse të nxhallin në nervoz të papërshkrushme.

Kishte kohë që isha ulur në një tavolinë pranë rrugës në kafiterinë tonë të preferuar. Nuk e di pse por ky lokal, e posaqërisht kjo tavolinë, tashmë janë pjesë e jetës time. Sa herë që më bie në mend të dal në qytet së pari mëndoj në këtë kafiteri. Madje ndonjëherë edhe kur jam shumë i lodhur, fare pa menduar u jap përparësi këmbëve dhe ata pa dyshim më sjellin këtu ku jam tani.

Ndoshta sepse këtu e gjej qetsinë dhe shërbimin e përkryer. Apo veçmë jemi adaptuar në këtë atmosferë, pasi nuk jam i vetmi që vij këtu por jemi një shoqëri e gjërë dhe gjitha takimet apo manifestimet e ndryshme i organizojmë në këtë vënd.

Edhe sot si zakonisht, kur hyn në kafiterinë masë "jeme" ishte e zbrazt. Shërbësit që tanimë shoqëroheshin me ne sa më parë më përshëndetën dhe më uruan për diplomimin. Pasi va ktheva përshëndetjet dhe porosita pijet, u ula dhe fillova të sodis jashtë dritare gjithë atë gjallëri me të cilën rridhte jeta në këtë anë të qytetit. Aq shumë më rrëmbeu kjo atmosferë sa që kisha haru se po e pritsha Gjentin.

Ajo lëvizje e rrjedhëshme jashtë xhamit më ndillte mendime pa fund të cilat me laramaninë e tyre kishin aritur të më rrëmbejnë "të gjitha lidhjet" me ambientin ku ndodhesha.

Nga ajo gjendje më zgjoi cingrima e mobilitetit që paralajmërojke arrijtjen e një mesazhi të ri tekstual të dërguar nga Genti, ku thoshte se do vononte për pak kohë sepse kishte një punë urgjente me krye.

B.

Bashkë me të tjerat edhe jetimorja jon kish filluar t'binde dhe në ta nuk kish mbetur më qetëri pos orëndive të vjetra, fëmijëve të mjerë dhe motrave të brengosura. Megjithatë jetimorja nuk ishte mbill. Ajo vazhdojke me funksionin edhe më tutje me ato pak të ardhura që ja falshin njerzët zemërmirë. Ata mure të vjetra vazhdojshin të rrujnin mes vete kujtime pa fun, kujtime për jetëra të filluara e të mbarueme mes atyre mureve.

Qdo santimetër në të paraqitke kujtimin e ndonjanit prej fëmijëve që ishin aty, apo të atyre që ishin këtu para shumë vite. Por megjithatë në ato mure kish akoma shumë vënd për kujtime të reja. Akoma shumë fëmijë të tjerë do vinin aty, për të falur në pjesë të jetës së tyre, atyre mureve të vjetra plot lagështi.

Numri i jetimëve e fëmijve t'lan pas dore po shtohet vazhdimisht. Ata me shumë besim i kthejshin sitë drejt ati objekti, por edhe ai i priste me dyr t'hapuna.

Sa do e shtirë të ishte jeta ati mbrenda, kurr nuk mungojshin dashnia dhe mshira. T'gjith i mirprisnin të posaardhurit derisa ata ndolonin të nihen t'huaj në atë mes.

Fëmiët n'jetimore jan shumë t'ndijshëm sepse intuita e tyne asht e rahur nga erna shumë të fuqishme. Ato kanë shpirt shumë delikat dhe ndjenja shumë t'flakta. I janë adaptuar vujtjes dhe nuk ikin shumë prej saj. Mirëpo,edhepse janë krijesa të lëna pas dore, ata kanë ëndëra,dëshira, ideale .

Androjnë që një ditë do t'bahet ma mirë dhe dëshirojnë që ëndërrat e tyne të bëhen realitet. Por të gjithë sëbashku kanë një ideal t'vetëm, që jetimorja e tyre të mos zhduket asniherë. Ata e duan atë shpi të madhe sepse ati e kanë njohur jetën. Aty i kanë thurrur iluzionet dhe po aty kanë pa se si ato rrenohen, kanë gjetur ngushëllimin dhe kurajon dhe kanë vazhduar ma tutje. Ata në mrendinë e ati objekti ndihen të sigurtë dhe të mbrojtur nga rrebeshet e jetës.

Edhepse jan t'bindur se në ditë do t'u duhet të ikin qëandëj,ata akoma mendojnë se edhe në të ardhmen do të xhejnë strehim nën atë çati, saherë që kanë nevojë. Nuk mund ta paramendojnë atë derë të mbillur me dritë e cila vazhdimisht lejonte të shihej kënaqësia relative me të cilën rridhte jeta aty mrena.

C.

Çë kur e maj men veten time, shumë kujtohet ndonjëher t'kem jetu e lumtun plotsisht. Por xhithni kisha durim të kënaq veten me grimcat që mi falte fati im i mjer, sado që t'vogla e të ralla ishin ata. Shum herë ngushllohesha vetëm me ëndra dhe iluzione të cilat asniher nuk u realizun. Kam kalu shumë qaste të vshtira kur vetëm disa fuçi të mbinatyrëshme nuk më kanë leju t'bëj ndoni marrzi. Eh sa e erët m'dukej bota atëher! Nuk mund të xheja as edhe në grimë ngushllimi, sepse asnjëher nuk i ka interesuar dikujt për mu. Kam njohur shumë njerz dhe me naivitetin tem i kam respektu të gjithë, shumëherë deri në nënshttrim. Dhe nashta pikrisht kjo ka ba që ata në mua të shohin në një çështje njeri, sepse e ka humb vetvlerësimin andaj edhe të tjeret nuk e vlersojnë. Disa m'shikonin si objekt zbavitës, e disa të tjer si djallin e maskum, por të gjith sëbashku besojshin se ishna në mbeturinë e ndyrë që paqetër duhej largu nga faqja e dhevit.

Askujt nuk i shkojke n'men se edhe un ishna në krijes njerzore që fellë në vete ngërthejke menime e ndjenja pa fund, bile më t'fuqishme e më t'flakta se kushdo qetër. Askush nuk e pranojke qi jeta jeme kish ik nga binart pa fain tem dhe t'gjithë munoheshin t'më dënojnë për gabimin që se kisha ba.

Por megjithat, un durova dhe brutalitetit të tine i bana ball me shumë butsi sepse un isha msu me të dhe n'fakt as nuk pritshna ma tepër. Besojsha se ajo ishte jeta ime e çëndisun nga dora madhshtore e fatit dhe unë do t'duhej ta jetoja të tillë, pa ndryshu as edhe në xha t'vogël.

Prjetova shumë disfata dhe tëxhijtha i hodha pas shpine,sepse sinojsha përpara. Por fati jem asniher nuk m'lejoit të arrij çoftë edhe një sukses t'vogël në përpjekjet e mija. Pas qdo tentimi për t'i asgjësua fatkeqsisht e mija , pasojke dështimi dhe une sërish mbetesha ajo e para me shpirtin tem t'mjerë të djegum nga flakat e vetmis.

Ç.

Kur po nxhitesha shkallve, kujdestaria që po e pastrojke koridorin m'tha që kishte qen Genti dhe kishte lënë disa valixhe. Un i tregova që isha taku me të dhe pasi e pyta për rrobat e mia që ia kisha lënë për ti la, hina në banes. Sapo hyra mbrenda dhe pashë që gjithqka ishte në regull, ndjeva një kënaqsi të papërshkrushme bashkë me nevojën për me pushu. U shtriva në divan dhe shumë shpejtë më kishte mar xhumi.

Nuk e di pse, por tani që është koha e pushime, po ndihem shumë pasive. Tani që edhe me studimet mbarova, kurse pushimi vjetorë sapo ka fillu, po e ndjej që më mungon ajo jetë aq shumë e ngarkume me obligime. Sapo kthehesha nga fakullteti, m'duhej të shkojsha në spital për ushtrime praktike, kurse në mbramje më kot kërkojsha kohë të lirë për të dalur me shokët sepse m'prisnin msimet.

Por edhe atë mbrenda koha dot nuk shkonte. Më kot i morra librat për ti lexuar,se nuk kisha interesim për to. Atëherë u shtriva dhe fillova ti përkujtoj nxharjet e asaj dite. Kur mu kujtua Djellza e hidhrume deri në maksimum, fillova të qesh me za. Por kur n'kujtimet e mija i erdh rradha Gentit, ndjeva një keqardhje të madhe.

Ajo që i kish ngja ishte shumë tragjike për ta dhe unë mund ta merrsha me mend se sa vështirë e kishte ai në ato qaste. Teto Liza ishte klientja e parë në karrierën e tij dhe ja si mbaroi puna e saj. Genti e kishte shumë të rëndësishme ç'ështëjën e kësaj grue.

Ai formalisht jo vetëm e mbronte atë,por me gjithë bindjen e tij besojke se ajo ishte e pafajshme dhe padrejtsia që i ishte bërë asja së tepërmi e lëndonte. I kishte premtu se do të bante çmos për ta dëshmuar pafajsinë e saj, por nuk mundi me i ndihmue. Kjo bënte që ai të ndjente veten të pavlefshëm me gjithë dhembshurinë për fatin e zi të teto Lizës.

KREU IV

4. ZBATIMI I NORMAVE MORFOLOGJIKE

Shqipja është gjuhë flektive, sepse fjalët e saj kanë trajta të ndryshme. Vendosija e normës sjell disa variante të quhen krahinore ose të vjetruara. Por edhe brenda fushës së normës ka variante, ka sinonime gramatikore, disa kategori përdoren në vend të njëra-tjetrës, linden shmangie të tjera.

Për nga kuptimi, pjesët e ligjëratës ndahen në tri grupe:

1. në fjalë kuptimplota;
2. në fjalë jokuptimplota, dhe
3. në fjalë thirrmore.

1. Fjalë kuptimplota janë ato që kanë kuptim të plotë dhe të cilat përdoren si gjymtyrë më vete. Në këtë grup hyjnë:

a) **fjalët emërtuese**, d.m.th. fjalët që emërtojnë sende (emrat), cilësi (mbiemrat), veprime (foljet) dhe rrethana (ndajfoljet);

b) **fjalët numëruese**, d.m.th. fjalët me të cilat numërojmë (numërorët);

c) **fjalët treguese**, d.m.th. fjalët që tregojnë sende, cilësi ose sasi (përemrat).

2. **Fjalë jokuptimplota** janë ato që kryejnë funksion shërbyes në fjali, përkatësisht që përdoren bashkë me një fjalë kuptimplote. Të tilla janë:

a) parafjalët,

b) lidhëzat dhe

c) pjesëzat.

3. **Fjalë thirrmore** janë ato që përdoren për të shprehur, në formë thirrjesh, ndjenja të folësit (pasthirrat).

Në bazë të veçorive morfologjike, pjesët e ligjëratës ndahen në:

1. **pjesë të ndryshueshme**, dhe në

2. **pjesë të pandryshueshme**.

Pjesë të ndryshueshme janë fjalët që pësojnë ndryshime gjatë përdorimit (lakimit dhe zgjedhimit). Ato janë: emri, mbiemri, përemri, folja dhe numërori. Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë fjalët që kanë vetëm një formë (as nuk lakohen, as nuk zgjedhohen). Të pandryshueshme janë: ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirra.

Kategoritë gramatikore të emrit

Emër është fjala që emërton ndonjë send konkret ose një gjë abstrakte. Emrat në gjuhën shqipe ndryshojnë jo vetëm në numër, por edhe sipas gjinive, rasave dhe trajtave. Pra, emri në gjuhën shqipe ka kategorinë gramatikore të shquarsisë e të pashquarsisë (trajtës), të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

4.1. PASHQUARSIA, SHQUARSIA DHE GJINIA E EMRIT

Emrat, si në njëjës ashtu edhe në shumës, përdoren në dy trajta:

a) **në trajtën e pashquar** dhe

b) **në trajtën e shquar**.

Emri në trajtën e pashquar tregon qenie, sende ose dukuri në përgjithësi, në mënyrë të papërcaktuar. P.sh.: *një student, një punëtor, një mace, një laps, një mendim* etj. Domethënë, cilindo student të fakultetit tonë, të ndonjë fakulteti tjetër, pra çdo student të botës.

Emri në trajtën e shquar tregon qenie, sende ose dukuri të tjera, të veçuara nga gjërat e tjera të llojit të vet. P.sh.: *studenti, punëtori, mendimi, macja, lapsi* etj. Domethënë, student = ky, ai student; punëtori = ky, ai punëtor; macja = kjo, ajo mace.

Formë përfaqësuese (bazë) e emrit është trajta e pashquar, numri njëjës, rasi emërore: *student, djalë, vajzë, shkollë, lule, letër, njeri, kompjuter, lepur, libër, piano* etj.

Trajta e shquar e emrit formohet duke i shtuar formës përfaqësuese njëjën shquese, përkatësisht mbaresën:

- a) **-i** ose **-u** për emrat e gjinisë mashkullore,
- b) **-a** ose **-ja** për emrat e gjinisë femërore dhe
- c) **-t** (**-të**, **-it**) për emrat e gjinisë asnjëse.

Pra, trajta e shquar e numrit njëjës është treguesi më i mirë i gjinisë gramatikore të emrit. Emrat që në trajtën e shquar njëjës marrin mbaresën **-i** ose **-u** janë të gjinisë mashkullore. P.sh.: *mal-i, laps-i, nxënës-i, artist-i, shitës-i; ujk-u, zog-u, krah-u, ari-u* etj. Emrat që në trajtën e shquar njëjës marrin **-a** ose **-ja** janë të gjinisë femërore. P.sh.: *vajzë - vajza, shkollë - shkolla, motër - motra; lule - lulja, nuse - nusja* etj. Emrat që marrin mbaresën **-t** (**-të**, **-it**) dhe njëjën e përparme **të** janë të gjinisë asnjëse.

Ka disa luhatje të gjinisë për shkak të prejardhjes dialektore të folësit ose të ndryshimeve historike. Të folmet e toskërishtes dhe disa të folme të gegërishtes jugore për trajtën e shquar të emrave mashkulorë kanë mbaresat **-i** ose **-u**. Të folmet veriore të gegërishtes dhe disa të folme të gegërishtes jugore të gjithë emrat mashkulorë (duke përfshirë edhe ata që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret **-k**, **-g**, **-h** dhe zanore të theksuar), shquarsinë e bëjnë me mbaresën **-i**: *miki, plaki, zogi, bregi, krahi, ahi, plehi, ka-v-i, dhe-v-i, shi-v-i, vlla-v-i* etj. Në shembujt e dhënë (si *ka-v-i*) v-ja është epetentike, antihijatizuese.

Dihet se në ndonjë të folme shqipe disa emra përdoren:

- a) në gjininë mashkullore: *mjalti, nderi, programi, grupi, sezoni, kolli, orkestri, sindikati*;
- b) në gjininë femërore: *mjalta, ndera, programa, grupa, sezona, kolla, orkestra, sindikata*.

Janë normative format *mjalti, nderi, programi, grupi, sezoni; kolla, orkestra, sindikata*).

Në shumë të folme të gegërishtes (në dallim nga të folmet toske, disa të folme geqe e shqipja standarde) pak emra përdoren vetëm në trajtën e shquar, si (nji, ni) *kali, guri, shati, deti, bari, firi, umi* etj. dhe asnjëherë në trajtën e pashquar *kalë, gur, shat, det, bar, fier, umb* (plori i vogël i parmendës). Këtyre emrave në disa të folme u mungon trajta e pashquar, prandaj gjuhëtarët i kanë quajtur *emra të gjymtë, emra të mangët*.¹⁰² Ndërkaq, emrat *njeri, veri, qiri* (çiri) në jo pak të folme të gegërishtes përdoren vetëm në trajtën e shquar, jo edhe në trajtën e shquar *njeriu, veriu, qiriri* si në mbarë shqipen. Pjesëtarët e të folmeve që bëjnë përjashtim nga mbarë shqipja me përdorimin e disa emrave vetëm në trajtën e shquar ose të pashquar duhet pasur kujdes që të përdorin drejt format e këtyre emrave në të dy trajtat. Pra, duhet:

102 Mehmet Halimi, *E folmja e Karadakut*, Prishtinë, 2008, f. 231.

trajta e pashquar: *kalë, gur, shat, det, bar, fier, umb; njeri, veri, qiri* dhe

trajta e shquar: *kali, guri, shati, deti, bari, fieri, umbi; njeriu, veriu, qiriri*.

Disa emra me prejardhje turke, si *baba, pasha, dai* ose sllave *xhaxha* në dialektin verior janë të gjinisë femërore: *ba:b - baba, pa:sh - pasha, dai - daia* ose *axh - axha*; kurse në dialektin jugor janë të gjinisë mashkullore: *babai, pashai, daiu, xhaxhai*.

4.2. GJINIA ASNJANËSE E EMRAVE

Mbetje të gjinisë asnjane në të folmet shqipe. – Në të folmet shqipe (gege e toske) emrat shfaqen në dy gjini: në gjininë mashkullore dhe në gjininë femërore, por me mbetje të gjinisë asnjane. Disa emra të cilët historikisht kanë qenë të gjinisë asnjane, si *djathët, brumët, ujët, ballët, dyllët, dhjamët, mjaltët, gjalpët, miellët, mishtë, leshtë, vajtë, grurët* si edhe emrat *burrë, djalë, gjumë, kalë, lëmë, lumë* etj., tani më nuk përdoren si të tillë, por kanë kaluar kryesisht në emra të gjinisë mashkullore. Sot kemi: *djathi, brumi, uji, balli, dylli, dhjami, mjalti* (diku *mjalta*, gj. f.), *gjaldi, mielli, mishi, leshi, vaji; burri, djali, gjumi, kali, lëma* (gj. f.), *lumi; gruni* (në Veri), *gruri* (në Jug).

Gjurmë të gjinisë asnjane hasen edhe tek emrat *ujt, dhallt, kryet* në trajtë të pashquar, por duke iu përshtatur prirjes së përgjithshme për shuarjen e plotë të gjinisë asnjane, këta emra kur shquhen kalojnë në gjininë mashkullore apo femërore, si: *uj-i* e *ujt-i, dhallt-i* (gj. m.); *kryet, krâet, krâ-a* (gj. f., në gegërishten qendrore). P.sh.: M'dhem *kryet*, çojë *kryet* përpje:t. M'dhemb *krâa*, ngrâie *krâen* (në gjininë femërore në shumë të folme të gegërishtes qendrore). M'dhem *kryti* (në Kërçovë, Maqedoni).

Në të folmet e Veriut disa emra prejmbiemërorë përdoren në gjininë asnjane, si: *i ra t'fâikt; m'shkoj t'rit; po m'bje t'pakt!; t'ba:rdht e voes, t'kuqt e voes* (të bardhët e vezës, e bardha e vezës; të verdhët e vezës, e verdha e vezës). Gjithashtu, në gjininë asnjane përdoren edhe dy emra për emërtimin e kemit që përdorej dikur nga gratë për të lyer e zbardhur fytyrën (t'bardht e zhivës) dhe buzëkuqin për femra: *Blema do t'ba:rdh // Ngjite do t'ba:rdh // ose: Blema do t'kuq // Ngjite do t'kuq //* të cilët gjithnjë përdoren në këtë formë dhe asnjëherë nuk kalojnë në gjini tjetër gramatikore.

Emrat prejfoljorë, më saktë emrat prejpjesorë (foljet e substantivuara) të tipit: *të ecurit, të kënduarit, të mësuarit*, të cilat në gjuhën standarde janë të gjinisë asnjane, në të folmet e gegërishtes përdoren në gjininë femërore në formën: *e hecmja, e knumja, e msumja* etj. Pra, marrë në përgjithësi, të folmet shqipe kanë sistem dygjinish, ndërsa shqipja standarde sistem emëror trigjinish.

Shqipja standarde ka emra të gjinisë asnjane . - Po të duam të përgjithësojmë, mund të themi se shqipja dialektore e standarde nuk kanë emra të pammë të gjinisë asnjane. Por, në një fazë më të vonshme të zhvillimit të saj në shqipen standarde janë krijuar emra të prejardhur të gjinisë asnjane nga emërzimi i foljeve (më saktë i pjesoreve) dhe nga emërzimi i mbiemrave. Pra, **emrat e gjinisë asnjane** të ardhur prej foljeve (emrat prejfoljorë, prejpjesorë: të tipit *të lexuarit* nga folja *lexoj*) dhe emrat që vijnë prej emërzimit të mbiemrave (emrat prejmbiemërorë: të tipit *të zitë* nga mbiemri *i zi*) **janë krijime të reja në gjuhën standarde**.

Në shqipen standarde janë të gjinisë asnjane:

- a) Emrat e prejardhur nga foljet. Këta quhen emra të nyjshëm prejfoljorë ose më saktë emra prejpjesorë.
- b) Disa emra të prejardhur nga mbiemrat, që quhen emra prejmbiemërorë. P.sh.:

Çdo pjesore e foljes mund të emërzohet, sipas tipit: pjesore – emër prejpjesor (kam) *ardhur – të ardhur-i-t, ecur – të ecur-i-t, folur – të folur-i-t, menduar – të menduar-i-t, ngrënë – të ngrënë-t* etj.; ndërsa emërzohen vetëm një numër i kufizuar mbiemrash: mbiemër – emër prejmbiemëror: *i errët – të errët-i-t, i ftohtë – të ftohtë-t, i kuq – të kuq-të, i mugët – të mugët-i-t* etj. Në disa togëfjalësha frazeologjike, si *s'ka të sharë, ia dha të qarit* dhe në terminologji: *të folurit, të menduarit* etj. përdorimi i emrave prejpjesorë është i ngulitur.

Me dobësimin e ndjenjës së asnjanesit, krahas emrave dhe mbiemrave prejfoljorë asnjane, në shqipen standarde e në të folmet tona po përdoren edhe formime paralele emrash prejfoljorë të gjinisë femërore, si *e bërtitura, e qeshura*; ndërsa në të folmet e gegërishtes në formën *e bërtitja, e keshmja*. Emrat prejpjesorë të shqipes standarde: *të ecurit, të kënduarit, të mësuarit* etj., që janë të gjinisë asnjane, në të folmet e gegërishtes janë të gjinisë femërore në formën *e hecmja, e knumja, e msumja* etj. P.sh.:

folje	emra prejpjesorë të gjinisë asnjane (në shqipen standarde)	në të folmet e gegërishtes (emra prejfoljorë të gjinisë femërore)
mësoj	të mësuarit	e msumja
këndo	të kënduarit	e knumja
eci	të ecurit	e hecmja
lexoj	të lexuarit	e lexumja
shkruaj	të shkruarit	e shkrumja
dëgjoj	të dëgjuarit	e ngumja
vrapoj	të vrapuarit	e ngamja, e vrapumja

mbiemër	emër prejmbiemëror i gjinisë asnjane	emër prejmbiemëror i gjinisë femërore
i zi	të zitë	e zeza
i kuq	të kuqtë	e kuqja
i verdhë	të verdhët	e verdha
i ftohtë	të ftohtët	e ftohta
i bardhë	të bardhët	e bardha

Në krahasim me dendurinë e përdorimit të emrave të gjinisë mashkullore e femërore, emrat (prejpjesorë e prejmbiemërorë) e gjinisë asnjane në shqipen standarde kanë denduri të vogël përdorimi.

DETYRË: Formoni emra të gjinisë asnjane nga foljet dhe nga mbiemrat e dhënë. Shënoni edhe emrin përkatës të gjinisë femërore në të folmen tuaj. Krahasoni format e emrave.

folje ose mbiemër	emër i gjinisë asnjane	në të folmen time (emër i gjinisë femërore)
harroj		
shikoj		
ftoj		
vallëztoj		
përtoj		
i mirë		
i keq		

DETYRË: Nga foljet dhe nga mbiemrat e dhënë, formoni emra të gjinisë asnjane:

- (mësoj) është i domosdoshëm.
- U ngri nga (i ftohtë).
- (studioj) nuk është aspak i lehtë.
- Hoqi (i zi) e ullirit.
- (eci) është i dobishëm për shëndetin.
- (lexoj) para gjumit ndihmon për gjumë të rehatshëm.
- Ndaj (i bardhë) nga (i verdhë) e vezës.
- (fle) është i dobishëm.

4.3. NUMRI I EMRAVE

Emrat kanë dy numra: njëjës dhe shumës. Emri në numrin njëjës tregon një send të vetëm, një qenie ose dukuri të vetme. P.sh.: (një) *njeri - njeriu, zog - zog, fletore - fletorja, mendim - mendimi* etj. Emri në numër shumës tregon shumë sende, qenie ose dukuri. P.sh.: (shumë, disa, ca) *njerëz - njerëzit, zogj - zogjtë, fletore - fletoret, mendime - mendimet* etj.

Për formimin e shumësit të emrave dallime dialektore shihen pothuajse vetëm tek emrat mashkullorë. Megjithë larushinë e të folmeve shqipe, mund të nxirret një konstatim i përgjithshëm se në të folmet Jugore, si edhe në gjuhën letrare, shumësi i emrave bëhet me prapashtesa trajtëformuese të shumta, si me **-a, -e, -ë, -nj, -ënj, -enj, -inj, -ër, -ra**; ndërsa në ato Veriore shumësi bëhet me më pak prapashtesa, zakonisht me **-a, -n-a, -j**.

Në dialektin verior disa emra shumësin e bëjnë me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve fundore. Kështu, emrat në njëjës shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa në shumës me zanore të gjatë: *vesh ~ ve:sh, dham ~ dha:m, lejlek - lejle:k, fyshek ~ fyshe:k, dyshek ~*

dyshe:k, oxhak ~ oxha:k, baxhanak ~ baxhana:k, dollap ~ dolla:p etj. Në toskërishte e në shqipen standarde te emrat e tillë njëjësi del pa –ë fundore, ndërsa shumësi me –ë fundore:

në njëjësi: *vesh, dhëmb, lejlek, fyshek, dyshek, oxhak, baxhanak, dollap*;
në shumës: *veshë, dhëmbë, lejlekë, fyshekë, dyshekë, oxhakë, baxhanakë, dollapë*;

Si formohet shumësi i emrave në shqipen standarde?

Mjetet për formimin e trajtës së shumësit të emrave në gjuhën shqipe janë të lloj-llojshme. Emrat e gjinisë mashkullore kanë një shumës më të larmishëm në krahasim me emrat e gjinisë femërore.

Nga pikëpamja e ndërtimit të trajtave të numrit shumës, emrat e gjuhës shqipe ndahen në dy grupe:

I. në emra që kanë vetëm një formë (si në njëjësi ashtu edhe në shumës);

II. në emra me formë të veçantë në shumës.

I. emrat që kanë vetëm një formë si në njëjësi ashtu edhe në shumës. Në këtë grup bëjnë pjesë:

a) Emrat e gjinisë femërore që në trajtën e pashquar mbarojnë me **-e** ose **-o** të patheksuar, si dhe me zanore të theksuar (si: **-i, -e, -a, -u, -o**). P.sh.:

njëjësi	shumës	njëjësi	shumës
anije	anije	pallto	pallto
dele	dele (dhen)	radio	radio
faqe	faqe	triko	triko
lagje	lagje	shtëpi	shtëpi
mace	mace	fotografi	fotografi
nuse	nuse	kala	kala
shoqe	shoqe	para	para

b) Gjithë emrat mashkulorë të formuar me prapashtesën **-(ë)s, -ues, -yes** dhe **-as**:

njëjësi	shumës	njëjësi	shumës
blerës	blerës	pastrues	pastrues
nëpunës	nëpunës	ndërtues	ndërtues
nxënës	nxënës	hekurkthyes	hekurkthyes
rrobaqepës	rrobaqepës	përkthyes	përkthyes
shitës	shitës	prizrenas	prizrenas
lexues	lexues	tiranas	tiranas
mësues	mësues	shtetas	shtetas

c) Një pjesë e emrave femërorë që mbarojnë me **-ë** të patheksuar:

njëjësi	shumës	njëjësi	shumës
---------	--------	---------	--------

orë	orë	këngë	këngë
lopë	lopë	lugë	lugë
shtazë	shtazë	mollë	mollë
ditë	ditë	rrënjë	rrënjë
enë	enë	shkallë	shkallë
këmbë	këmbë	udhë	udhë

II. Emrat që kanë formë të veçantë për shumësin, atë e formojnë në dy mënyra:

1. me prapashtesa dhe
2. me ndërrime tingujsh (fonemash).

1. Formimi i shumësit me prapashtesa

Prapashtesat e shumësit janë: **-e, -a, -ë, -nj, -ër, -enj, -inj, -ra.**

a) Disa emra shumësin e bëjnë me prapashtesën **-e**. P.sh.:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
gabim	gabime	stadium	stadiume
qëllim	qëllime	dyqan	dyqane
vendim	vendime	plan	plane
aksion	aksione	kat	kate
stacion	stacione	dokument	dokumente
album	albume	mal	male
akuarium	akuariume	mur	mure
divan	divane	plan	plane
organ	organe	aparate	aparate

b) Një grup emrash të gjinisë mashkullore dhe femërore, shumësin e bëjnë me prapashtesën **-a**. P.sh.:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
arkë	arka	telefon	telefona
fushë	fusha	kumbull	kumbulla
pulë	pula	petull	petulla
vajzë	vajza	flutur	flutura
dorezë	doreza	emër	emra
gjel	gjela	numër	numra
spec	specat	letër	letra
top	topa	motër	motra
bilbil	bilbila	kodër	kodra

c) E formojnë shumësin me **-ë**, emrat e prejardhur me prapashtesat **-ac, -aç, -ak, -an, -jan, -ar, -tar, -ash, -er, -ier, -ist, -it, -iot, -ok, -or, -tor, -uk, -ant, -at, -az, -ent, -ez, -af, -ec, -ek, -et, -ik,** si p.sh.:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
tullac	tullacë	punëtor	punëtorë
rrugaç	rrugaçë	noter	noterë
durrsak	durrsakë	patriot	patriotë
romak	romakë	doktor	doktorë
anëtar	anëtarë	delegat	delegatë
arsimtar	arsimtarë	asistent	asistentë
larash	larashë	fotograf	fotografë
karrocier	karrocierë	fishek	fishekë
artist	artistë	mjek	mjekë
sportist	sportistë	atlet	atletë
gjirokastrit	gjirokastritë	ilir	ilirë
dasmor	dasmorë	arbëresh	arbëreshë
drejtor	drejtorë	polic	policë

ç) Një numër i kufizuar emrash mashkullorë shumësin e bëjnë me prapashtesën **-nj**:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
kalli	kall inj	mulli	mull inj
bari	bar inj	pe	pe inj
dru	dru inj	shalqi	shalq inj
flori	flor inj	turi	tur inj
hero	her onj	thua	tho nj
kushëri	kushëri inj	patkua	patko nj
mi	mi inj	langua	lango nj

d) Një numër i vogël emrash në shumës marrin prapashtesën **-enj**; **-inj**; **-ër**; **-ra**:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
lumë	lume nj	prind	prind ër
përrua	përre nj	kunat	kunet ër
fukara	fukare nj	shtrat	shtret ër
drapër	drapëri nj	vëlla	vëllez ër
gjarpër	gjarpëri nj	bar	bar ëra
shkëmb	shkëmbi nj	erë	er ëra
zotëri	zotëri nj	bulmet	bulmet ra
gisht	gishtëri nj	fshat	fshat ra
mbret	mbret ër	mall	mall ra
nip	nip ër	lojë	lojë ra
princ	princ ër	kohë	koh ëra

II. Me ndërrime fonemash shumësin e formojnë disa emra:

a) me qiellzorizimin e /k/-së në /q/, disa edhe me metafonizimin e /a/-së në /e/ si dhe me prapashtesën -e:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
--------	--------	--------	--------

plak	pleq	turk	turq
armik	armi q	ujk	uj q
bujk	buj q	bark	bar q e
fik	fi q	bllok	bllo q e
peshk	pesh q	park	par q e
mik	mi q	shkak	shka q e

b) me ndërrimin e /g/-së në /gj/, /e/-së në /i/ + e:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
zog	zog j	varg	varg j e
lëng	lëng j e	breg	brig j e
treg	treg j e	shteg	shtig j e

c) me qiellzorizimin (palatalizimin) e /ll/-së ose të /r/-së në /j/ (/a/ > /e/, +e:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
akull	aku j	portokall	portoka j
avull	avu j	shembull	shembu j
buall	bu a j	mashkull	meshku j
grumbull	grumbu j	yll	y j e
ishull	ishu j	bir	bi j
popull	popu j	lepur	lepu j

ç) me ndërrime zanoresh ose me ndërrime zanoresh e bashkëtingëlloresh njëherazi:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
dash	desh	djalë	djem
cjap	cjep	grua	gra
natë	net	kalë	kuaj
rreth	rrathë	derë	dyer
vit	vjet	njeri	njerëz
ka	qe	thes	thasë

4.4. PËRDORIMI I DREJTË I EMRAVE NË RASA

Emri në fjali mund të përdoret si kryefjalë, si pjesë plotësuese e kryefjalës ose e kallëzuesit, kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë, përcaktor, rrethanor, ndajshtim etj. Në varësi nga kjo ndryshon edhe forma e tij. Format e ndryshme që merr emri, duke u lidhur me fjalë të tjera në fjali, quhen rasi. Ndryshimi i emrit nëpër rasi quhet lakim.

Gjuha standarde shqipe ka pesë rasi:

1. emërore (nominativ)
2. gjinore (genitiv)
3. dhanore (dativ)
4. kallëzore (akuzativ)
5. rrjedhore (ablativ)

Është përdëftuar se gjuhët indoevropiane në një fazë të hershme, përveç këtyre pesë rasave, kanë pasur edhe rasën vendore (lokativin), mjetoren (instrumentalin) dhe thirroren (vokativin), pra kanë qenë gjuhë sintetike, meqë funksionin e emrit në fjali e kanë shprehur nëpërmjet formave të veçanta. Shumica e gjuhëve indoevropiane kanë ruajtur sistemin rasor (diku sot ka më shumë e diku më pak rasa), por ka edhe gjuhë që tani më nuk kanë rasa. Gjuhë pa rasa janë italishtja, anglishtja, maqedonishtja etj. Këto gjuhë quhen analitike, meqë funksioni i pjesëve emërore në fjali shprehet nëpërmjet parafjalëve. Në këtë pikëpamje, shqipja është gjuhë sintetike-analitike (gjuhë me rasa dhe me parafjalë) që shkon drejt analitizimit.

Rasa emërore e numrit njëjës të pashquar është formë përfaqësuese, bazë e emrit.

Rasa të drejta janë emërorja dhe kallëzorja, ndërsa rasa të zhdrejta janë gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja.

Të gjitha të folmet e shqipes kanë nga pesë rasa, si edhe gjuha standarde; me dallim se Toskëria Veriore dhe Shqipëria e Mesme, kanë edhe një formë më tepër: **rasën vendore** (lokativin). Rasa vendore përbëhet nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa *t(ë)*, që paraprihen nga parafjalët *në, mbi, nën, nëpër, me ose për: në gropët, në fikt, në malt, në misrit, mbi gurt, nëpër misrit, nëpër lumt, me lugët, me thikët, për bukët* etj. Vendorja nuk është rasë e shqipes standarde.

Edhe në trajtën e pashquar të emrave në numrin shumës në **rasën rrjedhore** hetohet dallim morfologjik ndërmjet dy dialekteve të shqipes: deri sa në të folmet e toskërishtes forma e rrjedhores shumës me **-sh** përdoret shumë rrallë (por është njësuar me formën e shquar, me mbaresën *-ve*), në të folmet e gegërishtes kjo ka përdorim të dendur, si: ka pi: u:j *bretkocash*, kena pas luft *arash*, koçak *pulash*, o:d *burrash* etj.

Rrjedhorja ka përdorim më të dendur në dialektin Verior, ndërsa në dialektin Jugor funksionin e rrjedhores shpeshherë e luan emërorja me parafjalën *nga*, si p.sh. *une jam prej Prizreni - unë jam nga Korça*.

Emri lakohet në njëjës e në shumës, në trajtën e pashquar e në të shquarën. **Shqipja nuk ka forma të veçanta për çdo rasë, por emri na shfaqet jo në më shumë se tetë forma rasore**, si:

laps, lapsi, lapsit, lapsin, lapsa, lapsat, lapsash, lapsave.
vëlla, vëllai, vëllait, vëllanë, vëllezër, vëllezërit, vëllezërish, vëllezërve.
shok, shoku, shokut, shokun, shokë, shokët, shokësh, shokëve.
vajzë, vajze, vajza, vajzën, vajzës, vajzat, vajzash, vajzave.

Për të përdëftuar këtë, po lakojmë emrin *lule*:

	<i>numri njëjës</i>		<i>numri shumës</i>	
<i>rasa</i>	<i>trajta e pashquar</i>	<i>trajta e shquar</i>	<i>trajta e pashquar</i>	<i>trajta e shquar</i>
Emërore	(një) lule	lulja	(disa) lule	lulet
Gjinore	i, e (një) luleje	i, e lules	i, e (disa) luleve	i, e luleve
Dhanore	(një) luleje	lules	(disa) luleve	luleve
Kallëzore	(një) lule	lulen	(disa) lule	lulet
Rrjedhore	prej (një) luleje	(prej) lules	prej (disa) lulesh	(prej) luleve

Të shënojmë të gjitha format e paradigmës së lakimit të këtij emri: lule, luleje, lulja, lules, lulen, lulet, lulesh, luleve.

lule	lule-je	lul-ja	lule-s	lule-n	lule-t	lule-sh	lule-ve
1	2	3	4	5	6	7	8

Rëndom forma e emrit në rasën emërore është e njëjtë me formën e kallëzores, ndërsa rasa gjinore çdo herë është e njëjtë me dhanoren (me përjashtim se në rasën gjinore kemi edhe një të përparme: **i, e, të, së**) e nganjëherë edhe me rrjedhoren.

Rasa emërore zakonisht përdoret pa parafjalë, por shpesh mund të shoqërohet edhe me parafjalët **nga, te, tek**. Kjo rasë gjithnjë gjendet me përemrat pyetës: **kush?; cili?; cila? për njëjës dhe cilët?, cilat?** për numrin shumës.

Rasa gjinore çdo herë është e njëjtë me dhanoren e nganjëherë edhe me rrjedhoren, por dallohet ngase kurdoherë gjinores i paraprin një një të përparme: **i, e, të, së**. Rasa gjinore është çdo herë e varur. Kjo rasë gjendet me pyetjet **i, e kujt?; i, e cilit?; i, e cilës?; i, e cilëve?; i, e cilave?** dhe gjithnjë përdoret pa parafjalë.

4.5. PËRDORIMI I RASAVE ME PARAFJALË DHE PA PARAFJALË

Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që vihet para një emri, përemri a numërori dhe këta i vë në lidhje me fjalë të tjera në një rasë të caktuar.

Parafjalët na ndihmojnë edhe për të gjetur rasat e emrave a të përemrave, sepse çdo parafjalë kërkon një rasë të caktuar. Emrat në rasën gjinore e dhanore nuk kanë parafjalë.

Në vazhdim po japim një pasqyrë të përdorimit ose të mospërdorimit të parafjalëve në rasa:

Emërore // **nga, te, tek, deri te, gjer te.**

Gjinore // -----

Dhanore // -----

Kallëzore // **në, me, mbi, pa, më, nën, për, nëpër, për në, ndër, përmbi** etj.

Rrjedhore // **prej, ndaj, sipas, rreth, buzë, afër, larg, para, pas, prapa, kundër, ndërmjet, poshtë, përmes, përveç, tej, përballë** etj.

Ushtrim: Në vend të pikave vini njërën nga parafjalët: *mbi, gjatë, nga, me, për, pranë, jashtë, në.*

..... rrugës fëmijët këndonin këngë të gëzuara. hotelit ndodhet një librari e madhe. tryezë ka shumë libra. lumin Drin janë ndërtuar disa hidrocentrale. Të rinjtë u kthyen vonë shëtitja. Fëmijët po luanin gëzim bregut të liqenit. Kooperativistët kujdesen shumë bimët, që të marrin rendimente të larta. Sa shumë ndryshon klima qytetin tuaj. qytetit tonë ndodhet një fabrikë cigresh.

Detyrë: Teksti i dhënë më poshtë është shumë i ngatërruar. Rishkruajeni atë në formë të drejtë.

Beni vjeç është 28. Çdo mëngjes ngrihet, vishet dhe del në qytetit e parkun. Nga të parkut deri në hyrje shtëpia ai vrapon me të ngadalshëm tempo. Kur në park arrin, ndalet, thellë merr frymë dhe fillon trupore ushtrimet. Në fillim të kokës bën ushtrime: vë në mes duart dhe lëviz kokën: para, majtas, prapa, djathtas. Pastaj bën të kokës rrotullime nga e djathtë në të majta dhe anasjelltas. Ushtrimet i vazhdon me të trungut përkulje poshtë-prapa, para-majtas, lart-djathtas; derisa djersitet. Ai ushtrime bën edhe për këmbët të tjera, duart, gishtërinjtë etj. Pas minutash 15 rreth, ai parkun lë dhe në shtëpi kthehet. Menjëherë niset për në punë dhe rruhet, lahet.

4.6. SHKRIMI I NYJËS SË PËRPARME

(në rasën gjinore, te mbiemrat e nyjshëm dhe te përemrat pronorë)

Emrat në rasën gjinore shkruhen me nyjë të përparme (**i, e, të, së**): *ndërmarrja e ndërtimit, ndërmarrjes së ndërtimit etj.*; *dyqani i luleve, dyqanit të luleve; rrethi i Tiranës, rrethit të Tiranës; shtëpive të fshatit; ndërmarrjeve të ndërtimit; puseve të naftës; detyrave të ditës; mbjelljeve të vjeshtës etj.*

Kur një emër përcaktohet nga dy a më shumë emra të bashkërenditur të rasës gjinore, të gjithë këta përdoren zakonisht me nyjë të përparme:

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë; ((i, e, të, së) Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë; Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: (i, e, të, së) Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë; Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë; Ministria e Arsimit dhe e Kulturës; (i, e, të, së) Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës; Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës; e drejta e votës, e fjalës, e mbledhjes dhe e shtypit; në interes të popullit e të atdheut; organet e frymëmarrjes dhe të qarkullimit të gjakut etj.

Në rastet kur vijnë njëri pas tjetrit tre a më shumë emra të rasës gjinore të bashkërenditur pa lidhëza, nyja e përparme e emrit të dytë (kur nyja nuk ndryshon) ose të tretë (kur nyja ndryshon nga e në të) dhe e emrave të tjerë pasues shkruhet ose jo, duke u mbështetur në arsye të caktuara kuptimore e stilistike:

prodhimi i drithërave, i duhanit, i pambukut, i perimeve, i patateve, i frutave; zotimet e punonjësve të gjeologjisë, të naftës, të minierave, të degëve të tjera të industrisë e të artizanatit etj.

kishte marrë hov të madh ndërtimi i shtëpive, fabrikave, shkollave, rrugëve, urave; është rritur numri i degëve, katedrave, laboratorëve dhe kabinetëve etj.

Mbiemri i nyjshëm që ndjek një kundrinë të drejtë, të shprehur me një emër në kallëzore të shquar, merr nyjën e, kur është cilësor, dhe nyjën të, kur ka funksion kallëzuesor:

ndaji mollët e mëdha nga të voglat; ngriti dorën e djathtë; përdorini drejt trajtat e shkurtra të përemrit; por: i dua mollët të ëmbla; e ka dorën të mbarë; gënjeshtro i ka këmbët të shkurtra; i ka rrënjët të thella etj.

Mbiemrat e nyjshëm që ndjekin një emër në rrjedhoren e pashquar të shumësit marrin nyjën të e jo së:

(prej) **malesh të larta**; (prej) **lumenjsh të rrëmbyer**; (prej) **kërkimesh të pandërprera**; (prej) **krahinash të largëta**; (prej) **erërash të forta** etj.

Përemrat pronorë **im, ime, yt, jote, ynë, jonë, juaj**, qoftë kur përdoren thjesht si përemra, qoftë kur përcaktojnë një emër, shkruhen pa nyjë të përparme:

libri im; *ky libër është imi*; **puna ime**; *kjo punë është imja*; **djali yt**; **yti** është *ky djalë?*; **shtëpia jote**; *kjo shtëpi është jotja*; **vendi ynë**; *ky vend është yni*; **shkolla jonë**; *kjo shkollë është jona*; **kooperativa jonë** etj.

Përemrat pronorë **e (të) mi, e (të) mia, e (të) tu, e (të) tua, i (e, të) tij, i (e, të) tyre, i (e, të) saj** shkruhen me nyjë të përparme në të gjitha trajtat dhe përdorimet e tyre:

nxënësit e mi; **fletoret e mia**; **djemtë e tu**; **duart e tua**; **shkolla e tij**; **motra e saj**; **fshati i tyre**; **nëna e tyre** etj.

Ushtrim: Shkruani rasën gjinore të emrave në fjalitë e mëposhtme.

- | | |
|---|--|
| - Libri Gëzim..... është i ri. | - Ky është kopshti Linditë..... |
| - Shtëpia Zanë..... është e bukur. | - Ku është fletorja anglishte..... |
| - Dritarja shkollë..... është e madhe. | - Ora muri..... punon mirë. |
| - Stilolapsi Donikë..... është i gjelbër. | - Babai Artë..... është mësues. |

Ushtrim: Plotësoni vendet e zbrazëta, duke formuar rasën gjinore të numrit shumës.

- | | |
|----------------------------|--------------------------------|
| - Dollapi libra..... | - Zhurma makina..... |
| - Dyqani qilima..... | - Klasa nxënës..... |
| - Babai fëmijë..... | - Dita nëna..... |
| - Zëri bilbila..... | - Dhoma miq..... |
| - Tregu lule..... | - Ngjyra trëndafila..... |

Ushtrim: Emrat e dytë vini në rasën gjinore:

- | <i>në numrin njëjës</i> | <i>në numrin shumës</i> |
|---------------------------------|---------------------------------|
| - Ngjyrat trëndafili..... | - Ngjyrat trëndafila..... |
| - Gjethet lule..... | - Gjethet lule..... |
| - Librat nxënësi..... | - Librat nxënës..... |
| - Ditët javë..... | - Këngët zogj..... |
| - Gishtat dorë..... | - Gishtat duar..... |
| - Ditët festë..... | - Ditët festa..... |
| - Pantallonat çuni..... | - Pantallonat çuna..... |
| - Topat fëmijë..... | - Topat fëmijë..... |

Ushtrim: Emrat e shënuar midis vijave vini në rasën gjinore në njëjës ose në shumës.

Zana është shoqja _____ Sokol_____.
 Fustani _____ Besë_____ është i kuq.
 Faqja _____ mur_____ është e bardhë.
 Rrugët _____ Shkup_____ janë të pastra.
 Klasat _____ nxënës_____ janë të mëdha.
 Gomat _____ makinë_____ janë të reja.
 Tregu _____ lule_____ është i mbuluar.
 Stina _____ pranverë_____ është e bukur.
 Këto janë ditët _____ javë_____.
 Kjo është porosia _____ fund_____.

Libri _____ nxënës_____ është i ri.
 Ky nuk është topi _____ Bekim_____.
 Natyra _____ Kosovë_____ është e bukur.
 Dyqani _____ qilim_____ është afër.
 8 Marsi është dita _____ nëna _____.
 Ngjyrat _____ ylber_____ janë të bukura.
 Këto janë fletoret _____ studentë_____ .
 Ky është lapsi _____ Besnik_____.
 Dhoma _____ ditë_____ është e madhe.
 Ajo po rregullon orën _____ dorë_____.

Ushtrim: Vini në rasën gjinore emrat e shënuar ndërmjet pikave dhe vizës.

- Shpjegimi ... mësues _____ është i qartë.
- Këto janë dritaret ... klasë _____.
- Kjo është ora ... xhep _____.
- Oborri ... shkollë _____ është i madh.
- Cilët janë muajt ... pranverë _____?
- Ajo po hap dritaren ... dhomë _____.
- Këtu është shtëpia ... Sokol _____.
- Në mur është fotografia ... Paris _____.
- Vetura ... babai _____ është e re.
- Muajt ... dimri _____ janë: dhjetori, janari dhe shkurti.
- Ky nuk është shoku ... Genc _____, ky është shoku ... Verë _____.
- Stina ... pranver _____ është e bukur.
- Kjo është çanta ... Anilë _____.
- Muajt ... vit _____ janë dymbëdhjetë.
- Kjo është fotografia ... shoqe _____.
- Ai po rregullon orën ... dorë _____.
- Ky është libri ... Dritë _____.
- Këto janë fletoret ... Artan _____.
- Këta janë librat ... student _____.
- Libri ... gjuhë _____ është mbi bankë.

Ushtrim: Emrat në kllapa vini në rasën dhanore.

(Mira) _____ i dhemb koka. Nëna i telefonoi _____ (mjeku). Asaj i erdhën për vizitë _____ (shoqe). Dritani u tregoi _____ (shokët) shumë fotografi. Babai i solli _____ (vajza) një dhuratë të bukur. (Iliri) _____ i dhemb këmba. Toni i telefonoi _____ (Dafina). Dentisti ia mjekoi _____ (Beni) dhëmballën. Edhe _____ (Nora) i dhemb dhëmballa. Po _____ (Linda), çfarë i dhemb. (Zana) _____ i sollën shumë dhurata për ditëlindje. Nëna i bleu _____ (mbesa) një këmishë. Blerta u jep të hanë _____ (mace) dhe _____ (qen).

Ushtrim: Emrat në kllapa, sipas nevojës, vini në rasën gjinore ose dhanore të pashquar.

Kjo është çanta _____ (shoqja). Mbi tryezë është violina _____ (Beni). Ishte shumë i bukur zëri i _____ (këngëtarët). Dritaret _____ (dhomat) janë nga lindja. (Këngëtare) _____ i dhanë një tufë me lule të freskëta. Në majat _____ (malet) ka borë edhe në verë. Po u tregoj _____ (shoqet) fotografitë e familjes. Ai po u lexon _____ (fëmijët) një tregim të bukur. I dhashë _____ (shoku) një libër. I shkrova një letër

_____ (shoqe). I thashë sot. Ia dhashë gazetën _____ (Zanë). I telefonova _____ (nënë). Ç'farë i tha mjeku _____ (Artani)? Kush i ra _____ (zile)? Nëna ia përgatiti _____ (djalë) një supë. _____ (Marku) të vijë

Ushtrim: Emrat në kllapa i vini në rasën rrjedhore, në numrin shumës të pashquar.

- Para disa (vit) kam mbaruar studimet.
- Pas disa (ditë) do të shkoj në pushim.
- Një grup (student) do të shkojnë në shëtitje.
- Sot biseduam me një grup (aktor)
- Një grumbull (njeri) po qëndronin para kinemasë.
- Ky është dollap (libër) apo dollap (rroba)? -
- Autobusi do të vijë pas disa (minutë)
- Këto janë çorape (burra) e jo çorape (gra)
- Sot erdhën një grup (turist)
- Në rrugë dëgjoheshin zëra (fëmijë)
- Këto ditë biblioteka mori një sasi (libër)
- Kjo punë do të mbarojë pas disa (muaj)
- Fëmijët panë një fole (dallëndyshe)

Ushtrim Emrat në kllapa vini në rasën rrjedhore.

- Sot mora një letër prej (djali)
- Ne ishim ulur rreth (zjarr)
- Punën e kam afër (spital)
- Afër (shtëpi) ndodhet një restorant.
- Fëmijët po qëndronin buzë (lumi)
- Në shtëpi arritën afër (mbrëmje)
- Ne do të takohemi para (bibliotekë)
- Përmes (qytet) kalonte një lumë.
- Të kam thënë të ecësh anës (rrugë)
- Posta është e hapur prej (orë) 8 deri në orën 19.
- Përballë (fakultet) është një park i madh.
- Ajo qëndron përpara (pasqyrë) dhe provon pallton.
- Ti rri pranë (baba) , ndërsa unë po rri pranë (nënë)
- Të gjithë ishin ulur rreth (tryezë)

Ushtrime përmbledhëse për përdorimin e drejtë të rasave

Ushtrim: Vini emrat në rasën e duhur.

- Ajo hapi (dritare/dhomë)
- Agimi e pyet shokun për (orar/mësim).
- Drita i shoqëroi (shoqe) deri në (stacion/tren)

- Drini iu përgjigj të gjitha (pyetje) të mësuesit.
- Atij nuk iu kujtua (titull/libër)
- Mësuesi iu afrua (nëna)
- Dje lexova disa orë në (bibliotekë/qytet)
- Ai duhet të kthehet para (orë) dhjetë.
- Artani nuk e gjeti (Beni) në shtëpi.

Detyrë: Teksti i dhënë përveç gabimeve të tjera, ka edhe gabime rasore. Rregullojeni ashtu që të jetë i kuptueshëm dhe pa gabime gramatikore.

Familja i Zana banoj nga Strugë. Babai e saj quhem Tomor. Nëna i saj quhesh Anilës. Zanën ka një vëllai dhe një motra. Vëllait e saj quhet Albani, kurse motrës i saj quhet Nitës. Nitën është i martuar dhe kam një fëmija, një vajza.

Edhe Alban janë gjithashtu e martuar. Grua i tij quhesh Merita. Ata nuk ka asnjë fëmija. Zanë nuk është i martuar. Ajo është i pamartuar, është beqar.

4.7. PËREMRI

Ashtu si edhe në gjuhët e tjera, edhe në gjuhën shqipe përdoren shpesh fjalë që zëvendësojnë emrat, që janë përfaqësues të tyre në fjali. Përdorimi i përemrave bën të mundur që të shmanget përsëritja e të njëjtit emër.

Përemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që tregon në mënyrë të përgjithshme (pa i emërtuar) frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara.

Disa përemra, ashtu si mbiemrat, përdoren pranë emrave dhe përshtaten në gjini, në numër dhe në rasë me ta. Për shembull:

- Gjyshi im ka qenë murator.
- Kjo kullë ka përballuar shumë sulme.

Disa përemra të tjerë nuk përdoren pranë emrave dhe lakohen në njëjës dhe në shumës, ashtu si emrat. P.sh.:

- Unë them të tregojmë të vërtetën në çdo rast.
- Mua më quajnë Tanush.
- Dikush po vjen.
- Hapat e dikujt po dëgjohe në korridor.

Sipas kuptimit që kanë, **dallojmë këto lloje përemrash:**

1. Përemra vetorë (unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato)
2. Përemra vetvetorë (vete, vetvete)
3. Përemra dëftorë (ky, kjo, këta, këto, i tillë...)
4. Përemra pronorë (im, yt, i tij, i saj...)
5. Përemra pyetës (kush? cili? sa? ç'?...)
6. Përemra lidhorë (që, i cili, e cila)
7. Përemra të pacaktuar (cilido, secili, asnjë, ca, asnjëri, kushdo, dikush, çdo...).

Përemrat vetorë të vetës së tretë e kanë si kategorinë e gjinisë, ashtu edhe atë të numrit: ai, ajo - ata, ato ndërsa kategorinë e rasës e kanë të gjithë përemrat vetorë.

Në format e përemrave ka shumë pak dallime midis dialekteve të shqipes dhe gjuhës standarde. Shumica e këtyre dallimeve janë të natyrës fonetike, d.m.th. format përemërore të larmishme janë variante territoriale të të njëjtit përemër. Ndër dallimet më të rëndësishme janë:

Të folmet e gegërishtes kanë **përemra vetvetorë**, që tregojnë vetën që kryen veprimin dhe ky veprim bie mbi të. Të tillë janë *vetja, vetvetja*; të cilët lakohen nëpër rase (vetja, vetes, veten; vetvetja, vetvetes, vetveten). Gjithashtu, gegërishtja ka edhe **përemra pronorë vetvetorë**: *i vet, e vet, t'vet*, si p.sh. *djali i vet, çika e vet, fmit e vet, fmive t'vet* etj., të cilët nuk i ka toskërishtja, por në vend të tyre përdor përemra pronorë: *i tij, e tij; i saj, e saj, të tij, të saj* etj. Përemrat vetvetorë dhe përemrat pronorë vetvetorë, që i ka gegërishtja, ndërsa mungojnë në toskërishte, kanë hyrë në sistemin përemëror të gjuhës standarde shqipe.

Në **përemrat vetorë** nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm, sepse në të shumtën e rasteve dallimet janë të natyrës fonetike. Kështu, në dialektin Verior dhe në atë Jugor kemi këto forma të përemrave vetorë në rasën emërore: *ûne, û:n* ose *û*: - *unë* (forma e vjetër *u*: përdoret ende në të folmet e gegërishtes dhe në Çamërishte); *ti, taî - ti, tinë; aj - ai, ay, aynë; ajo - ajo; na - ne, neve; ju - ju, juve; ata - ata, ato - ato*.

Shënim:

Në të folmet e gegërishtes qendrore dukuria e diftongimit të zanoreve të mbyllura të theksuara /i, y, u/ ka vepruar edhe te përemri *ti*, prandaj kemi variantet e diftonguara të të njëjtit përemër në *ëtaî, tëî, teî*. Në disa të folme të këtij grupi, përemrat vetorë *ata* dhe *ato* nuk dallojnë gjini, prandaj kemi *ata burra - ata gra* ose *ato burra - ato gra*.

Forma *aj* e gegërishtes 'ai' është krijuar nga konsonantizimi i [ëi]-së në [ëj]. Përemrat *neve, juve* që përdoren për rasat e drejta (emëroren dhe kallëzoren; për ne, ju) në disa të folme toske, janë forma analogjike të rasave të zhdrejta (të gjinore, dhanore dhe rrjedhore).

Ndryshime të vogla vërehen edhe për trajtat e **përemrave dëftorë**. Shumica e të folmeve gege (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej variantit standard, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më gjerë) për faktin se përemrat dëftorë shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *qeky/çeky, qekjo/çekjo, qekta/çekta, qaj/çaj, qajo/çajo, qata/çata, qeto/çeto* etj. sesa në formën me shtritje në të dy dialektet *ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato*.

Me forma të këtilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) ‘ja’ dhe një përemër dëftor *ky: çe+ky, çe+kjo* ‘ja+ky, ja kjo’... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem. - Çeky është gjali jem.* ‘Ky është djali im. – Ja, ky është djali im’. *Ajo a:r është ma e mira. – Çajo a:r është ma e mira.* ‘Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.’

4.8. GABIME MË TË SHPESHTA NË PËRDORIMIN E DREJTË TË FOLJEVE

Njohuri të përgjithshme

Folja në gjuhën shqipe karakterizohet me trajta të ndryshme gramatikore. Ajo është pjesa e ligjëratës më e pasura me forma gramatikore. Shumica e foljeve të shqipes, që kanë zgjedhim të plotë vepror dhe jovepror (p.sh. folja *ndaj*), kanë mbi 410 forma të ndryshme me të cilat shprehin kundërvënien kuptimesh të ndryshme gramatikore.¹⁰³ Folja është bërthama e fjalisë.

Është e njohur se folje janë fjalët që tregojnë një veprim ose një gjendje. Kësaj detyre kryesore i shtohen edhe një mori funksionesh të tjera të rëndësishme, d.m.th. bashkë me veprimin ose gjendjen që shpreh folja përcaktohet edhe mënyra, koha, veta, numri e diateza. Gërshetimi i këtyre kategorive gramatikore, të cilat shpesh lidhen edhe me ndërrime leksikore, e bën foljen si pjesën më komplekse të ligjërimit.

Sistemi i foljes në gjuhën shqipe ka ruajtur shumë veçori arkaike indoevropiane të trashëguara nga periudha e hershme. Të tilla janë si për shembull, supletivizmi, apofonia, aoristi sigmatik, kategoritë gramatikore të vetës, mënyrës, kohës etj. Megjithatë, me kalimin e kohës janë krijuar edhe ngjashmëri të përbashkëta me gjuhët e tjera ballkanike, por janë zhvilluar edhe dukuri të veçanta, siç janë habitorja dhe dëshirorja.

Siç dihet, shumica e foljeve përdoren në fjali me kuptimin e plotë të tyre. Por disa folje e humbasin kuptimin e tyre leksikor dhe përdoren si mjete gramatikore. Fjala është për foljet ndihmëse, modale dhe foljet aspektore. Folje ndihmëse janë foljet **kam** dhe **jam**, që shërbejnë për të formuar trajtat e përbëra të foljes (*kam larë, jam larë, kisha larë, isha larë, kisha për të larë* etj.).

¹⁰³ Zijadin Munishi, *Zgjedhimi i foljeve*, Prishtinë, 1998, f. 5.

Foljet modale shërbejnë për ta paraqitur veprimin e shprehur nga folja që e ndjek si të mundshëm ose të lejueshëm, të detyrueshëm ose të domosdoshëm. Si folje me vlerë modale në gjuhën shqipe janë foljet: *mund, duhet* etj.

Foljet aspektore shërbejnë për të shprehur fillimin, vazhdimin ose mbarimin e një veprimi, si: *filloj, nis, zë, bëj, marr; vazhdoj, vijoj; mbaroj, pushoj*.

Format sintetike dhe analitike të foljeve

Format e ndryshme gramatikore të foljes në gjuhën shqipe mund të ndahen në dy grupe:

a) **forma sintetike** (njëfjalëshe), si *punoj, punoja, punova, punuakam, punuakësha; shkruaj, shkruaja, shkrova, shkruakam...*; *dal, dilja, dola, dil, dilni* ...

b) **forma analitike** (dyfjalëshe): *kam punuar, kisha punuar, pata punuar, duke punuar, për të punuar ...*, *kam mësuar, u mësova, duke mësuar, për të mësuar, do të mësoj* ...

Foljet kalimtare dhe jokalistare

Kalimtare janë foljet veprimi i të cilave i kalon një personi ose një sendi tjetër, d.m.th. që pranojnë një kundrinor. Foljet që pranojnë një kundrinor të drejtë janë folje kalimtare të drejta, p.sh.: *Zana çdo ditë shikon televizorin. Nëna çdo ditë ujit lulet*.

Foljet që marrin kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë janë kalimtare të zhdrejta, p.sh.: *Agroni i hipi makinës*. Shpesh ndodh që një folje të marrë njëkohësisht një kundrinor të drejtë dhe një kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë. P.sh. *Ia dhashë librin Lindës*.

Folje jokalistare janë ato që nuk pranojnë kundrinor, si foljet: *fle, eci, rri, qëndroj, dal* etj. P.sh. *Dje fjeta gjithë ditën. Beni ecte* i shqetësuar.

Disa folje përdoren herë si kalimtare, herë si jokalistare. Për të gjetur se cilit grup i përkasin, duhet parë se në ç'kuptim janë përdorur.

folje kalimtare:

Mira *filloi* punën.

Nëna e *shkoi* perin në gjilpërë.

folje jokalistare:

Mësimi *fillon* në orën tetë.

Beni *shkon* në shkollë herët.

Format veprorë dhe joveprorë e foljeve

Foljet kalimtare të drejta kanë dy forma: **formën veprorë** dhe **joveprorë**:

Forma veprorë (aktive): *laj, fshij, thaj, shkruaj, mësoj, lexoj, punoj* ...

Forma joveprorë (pasive): *lahem, fshihem, thahem, mësohem* ...

Veprorë janë foljet që tregojnë se subjekti vepron (*laj* fytyrën, *fshij* dhomën, *thaj* rrobat). Joveprorë janë foljet që tregojnë se subjekti pëson, d.m.th. se i nënshtrohet veprimit të një tjetri ose se veprimi i tij kthehet po tek ai.

Vetë e foljes quhet forma foljore që tregon se kush e kryen veprimin (unë, ne, ti, ju, ai, ajo; ata, ato). Përgjithësisht, në gjuhën shqipe nuk është e domosdoshme që përemrat vetorë të përdoren para foljeve, siç ndodh në gjermanishten, anglishten ose frëngjishten.

Në frëngjishte, bie fjala, është e domosdoshme para foljeve të përdoren përemrat vetorë (unë, ti, ai, ajo) meqë në të tri vetat e njëjësit kemi vetëm një formë të vetme të foljes: *travaille* (punoj):

je travaille

tu travaille

il (elle) travaille

Foljet njëvetore

Folje njëvetore janë foljet që përdoren vetëm në vetën e tretë dhe që shënojnë:

- dukuri atmosferike: *bie* (shi, borë), *fryn* (erë), *bleron* (natyra), *gjelbëron* (bari), *ushton* (mali) etj.

- veprime karakteristike për kafshët: *hingëllin* (kali), *leh* (qeni), *pëllet* (gomari).

- foljet e tipit: (s'më) *besohet*, *bëhet*, *kujtohet*; *pëlqen* etj.

- folje të formës joveprore, si: *dihet*, *flitet*, *thuhet*, *kuptohet*, *parashikohet* etj.

- foljet: *jam*, *vij*, *shkoj*, *dal në shprehjet si: s'është mirë, s'është keq, s'më vjen mirë, s'më shkon* etj.

Foljet pavetore

Folje pavetore janë:

- disa folje ose shprehje që emërtojnë dukuri atmosferike: *vetëtin*, *bubullin*, *veson*, *bën ftohtë*, *bën ngrohtë*, *resh* etj.

- foljet *duhet* dhe *do*;

- foljet jokalimtare të formës joveprore: *s'shkohet*, *s'rrihet*, *s'lyhet*, *s'flihet* etj.

Foljet njëvetore ose pavetore nuk marrin kryefjalë. T'u bësh këtyre foljeve pyetjen *cili, cila* për ta gjetur kryefjalën është pa kuptim: *Dje bëri ftohtë*.

Mënyrat e foljeve

Kuptimi i asaj që shprehet nga folja mund të paraqitet prej folësit në mënyra të ndryshme. Trajtat e ndryshme që merr folja për të shprehur kuptimin e saj quhen mënyra. Në gjuhën shqipe folja ka gjashtë mënyra të ndryshueshme (të shtjelluara): *dëftore*, *lidhore*, *kushtore*, *habitore*, *dëshirore*, *urdhërore* dhe tri mënyra të pandryshueshme (të pashtjelluara): *pjesore*, *paskajore* dhe *përcjellore*.

Mënyrat e shtjelluara të foljes

1. **Mënyra dëftore** e paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçka të vërtetë ose reale, goftë ky pohim, mohim ose pyetje: *Iliri po mëson. Iliri nuk po mëson. A po mëson Iliri?*

2. **Mënyra lidhore** e paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçka që dëshirojmë ose presim të ndodhë. *Po të punosh, do të fitosh.*

3. **Mënyra kushtore** e paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçka të mundshme, që varet ose kushtëzohet nga një veprim tjetër: *Po të punoje më shumë, do ta mësoje më mirë kompjuterin.*

4. **Mënyra habitore** paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçka të papritur, që shkakton habi: *Sa qenka rritur! Ju mësuakeni shumë!*

5. **Mënyra dëshirore** paraqet kuptimin e shprehur prej foljes në mënyrë urimi ose mallkimi: *Shkofsh e ardhsh shëndosh! U bëfsh njëqind vjeç! Të raftë pika!*

6. **Mënyra urdhërore** paraqet kuptimin e shprehur prej foljes në formë urdhri, kërkesë ose këshille: *Punoni më mirë. Mësoni më shumë.*

Habitorja dhe dëshirorja janë ndër mënyrat karakteristike të shqipes, sepse për nga tipi strukturor nuk kanë shoqe në asnjë gjuhë indoevropiane. Habitorja shpreh habinë e folësit për një gjë të papritur *lexuakam, lexuekësha, paskam lexuar* etj., e afërt me dëftoren, në gjuhën shqipe është formuar me përngjitjen e së kryerës së përmbysur. Dëshirorja ka forma të veçanta nga mënyrat e tjera të foljes (*hapsh-a, punofsh-a*), ndërsa në gjuhët e tjera indoevropiane dëshira shprehet me mënyrën lidhore: maq. da zhivee mlladinata (rrallëherë edhe në shqipen, si *Rroftë rinia!* - në mënyrën dëshirore; *Të rrojë rinia!* – në lidhore).

Mënyrat e pashtjelluara

Veç këtyre mënyrave të foljeve që ndryshojnë formën, ka edhe forma foljore të pashtjelluara (që kanë vetëm një formë të vetme), të cilat nuk kanë as kohë, as vetë as numër. Format e pashtjelluara të foljeve janë:

Pjesorja: (kam, jam) *punuar, mësuar, blerë, gjetur, thënë* etj.

Paskajorja: *për të punuar, për të mësuar, për të marrë* etj.

Përcjellorja: *duke mësuar, duke larë, duke punuar* etj.

Në sistemin morfologjik dallime më të shprehura midis të folmeve janë ato që vërehen te foljet, rrjedhimisht edhe folësit shqiptarë krahinash të ndryshme jorrallë përdorin forma dialektore në vend të formave normative.

Në gjuhën standarde janë kodifikuar trajtat e foljeve, por në përdorimin e përditshëm ruhet ende një laramani e madhe e trajtave dialektore. Të tilla janë paskajorja e gegërishtes (me + pjesorja: *me punue*), e barasvlershme në toskërishte paskajorja *për të punuar* ose lidhorja *të punoj*; e pakryera asigmatike e mënyrës dëftore në diatezën veprorë në toskërishte *punoja* dhe sigmatike në gegërishte *punojsha*, forma sintetike joveprorë e toskërishtes *lahesha* dhe *u lajsha* /

u lajshna në të folmet geqe; ekzistimi i trajtave të dyta të mbipërbëra për kohën e shkuar në dialektin Verior (*kam pas punu.*, *kisha pas punu*, *pata pas punu.*), si dhe shumë forma të tjera foljore. Në vijim do të shpjegojmë pak më hollësisht këto dallime midis dy dialekteve që shfaqen te foljet, duke përcaktuar edhe formën normative:

1. Në toskërishte (dhe në shqipen standarde) e pakryera e mënyrës dëftore në formën veprorë është asigmatike (punoja, punonja), ndërsa në gegërishte është sigmatike (punojsa, punojshna)

Nëpër të folmet e shqipes gjejmë një larmi të madhe formash foljore të së pakryerës së dëftores. Dallohen dy areale kryesore:

- a) Areali i gjithë toskërishtes, i të folmeve kalimtare dhe i një numri shumë të vogël të folmesh të gegërishtes ku ruhet forma e vjetër **asigmatike** (josigmatike, pa -sh- në mbaresë). Mbaresat e së pakryerës në *diatezën veprorë* janë: (unë) *la-nja* ose *la-ja*, (ti) *la-nje* ose *la-je*, (ai, ajo) *la-nte*; (ne) *la-nim*, (ju) *la-nit*, (ata, ato) *la-nin*.
- b) Areali i gegërishtes ka forma sigmatike (me -sh-) në mbaresa, si për foljet që mbarojnë me temë në zanore: (une) *la-jsha* ose *la-jshna*, (ti) *la-jshe*, (aj, ajo) *la-nte* ose *la-jke*; (na) *la-jshim*, *la-jshëm* ose *la-jshmi*; (ju) *la-jshi*, (ata, ato) *la-jshin*; ashtu edhe për foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore: (une) *dal-sha* ose *dal-shna*, (ti) *dal-she*, (aj, ajo) *dil-te* ose *dal-ke*; (na) *dal-shim*, *dal-shëm* ose *dal-shmi*; (ju) *dal-shi*, (ata, ato) *dal-shin*.

Format asigmatike (toske) të foljeve me mbaresën -ja janë normative: *laja*, *laje*, *lante*; *lanim*, *lanit*, *lanin*.

2. E pakryera joveprorë e dëftores në toskërishte dhe në shqipen standarde është sintetike (lahesha), ndërsa në gegërishte është analitike (u lajsha, u lajshna)

Edhe në formën joveprorë të së pakryerës së dëftores ndërmjet dy dialekteve të shqipes ka dallime. Kështu:

- a) Në toskërishte, pavarësisht nga dallimet e pjesshme që vërehen në mbaresat, foljet në këtë diatezë kanë të njëjtën strukturë si në gjuhën standarde. E pakryera e mënyrës dëftore në formën joveprorë në toskërishte është **sintetike**. Temave të foljeve të kohës së tashme të zgjedhimit jovepror u shtohen mbaresat vetore: (unë) *la -(h)esha*, (ti) *-(h)eshe*, (ai, ajo) *-(h)ej*, *-(h)esh*; (ne) *-(h)eshim*, (ju) *-(h)eshit*, (ata, ato) *-(h)eshin*. Alomorfet me -h- i marrin foljet me temë në zanore (si *la-h-esha*, ...).
- b) Në pjesën më të madhe të gegërishtes kjo formë kohore është **analitike**, e përbërë nga pjesëza përemërore **u** dhe nga forma e së pakryerës veprorë të gegërishtes, me variantet përkatëse sipas të folmes: (une) *u lajsha* ose *u lajshna*, (ti) *u lajshe*, (aj, ajo) *u lante* ose *u lajke*; (na) *u lajshim*, *u lajshëm* ose *u lajshmi*; (ju) *u lajshi*, (ata, ato) *u lajshin*.

Normative janë format e foljeve sintetike (format toske): **lahesha**, **laheshe**, **lahej**; **laheshim**, **laheshit**, **laheshin**.

Po paraqesim paradigmen normative të disa foljeve në kohën e pakryer në formën veprorë:

shkoj - shkoja, shkoje, shkonte; shkonim, shonit, shkonin.
laj - laja, laje, lante; lanim, lanit, lanin.
kthej - ktheja, ktheje, kthente; kthenim, kthenit, kthenin.
luaj - luaja, luaje, luante; luanim, luanit, luanin.
hap - hapja, hapje, hapte; hapnim, hapnit, hapnin.
mbyll - mbyllja, mbyllje, mbyllte; mbyllnim, mbyllnit, mbyllnin.
lëviz - lëvizja, lëvizje, lëvizte; lëviznim, lëviznit, lëviznin.
pi - pija, piqe, pinte; pinim, pinit, pinin.
di - dija, dije, dinte; dinim, dinit, dinin.
dua - doja, doje, donte; donim, donit, donin.
vij - vija, vije, vinte; vinim, vinit, vinin.

Në formën joveprore:

lahem - lahesha, laheshe, lahej; laheshim, laheshit, laheshin.
bëhem - bëhesha, bëheshe, bëhej; bëheshim, bëheshit, bëheshin.
kthehem - kthehesha, ktheheshe, kthehej; ktheheshim, ktheheshit, ktheheshin.
lodhem - lodhesha, lodheshe, lodhej; lodheshim, lodheshit, lodheshin.
ulem - ulesha, uleshe, ulej; uleshim, uleshit, uleshin.

Koha e tashme dhe e pakryera përdoren edhe me pjesëzën "**po**":

Koha e tashme: *punoj – po punoj, shkruaj – po shkruaj, lexoj – po lexoj...*

Koha e pakryer: *punoja – po punoja, shkruaja – po shkruaja, lexoja – po lexoja...*

Detyrë: Foljet e dhëna ktheni në kohën e pakryer.

Petriti çdo mëngjes (ngrihem) në orën shtatë,
 (shkoj) në banjë, (lahem),(rruhem),
(fshihem) me peshqir dhe (krihem). Pastaj
 (kthehem) në dhomën e tij dhe (vishem). Kur (bëhem) gati,
 (shkoj) në dhomën e ngrënies, (ulem) në tryezë dhe
 (ha) mëngjes. Kur (bën) të ftohtë (vishem)
 trashë; në kokë (vë) një kapelë dhe (mbështillem) me shall,
 pastaj (nisem) për në zyrë. Në punë (shkoj) më këmbë.
 (Ndalem) në qoshkun e parë dhe (blej) gazetë. Në orën tetë
 (arrij) në zyrën e tij dhe (filloj) punën.

3. Gegërishtja ka edhe dy apo tri forma të dyta të mbipërbëra për kohën e shkuar (kam pas punu:, kisha pas punu, pata pas punu:), ndërsa toskërishtja dhe shqipja standarde nuk kanë kohë të dyta të mbipërbëra

Në qoftë se në variantin standard dhe në toskërishte janë karakteristike vetëm tri forma të përbëra të kohës së shkuar:

e kryera (*kam punuar*),
e kryera e plotë (*kisha punuar*) dhe
e kryera e tejshkuar (*pata punuar*),

në të gjitha të folmet e gegërishtes ekzistojnë edhe dy, vende-vende edhe tri, forma të tjera të përbëra (folja ndihmëse ‘kam’ + pas + pjesorja e foljes):

e kryera e dytë (*kam pas punu:, ki/ke pas da:l, ka pas shku:, ...*),

e kryera e plotë e dytë (*kisha/kishna pas punu:, kish pas da:l, kish pas shku:*), por edhe **e kryera e tejskUAR e dytë** (*pata pas punu:, pate pas da:l, pat pas shku:*).

Në të folmet e gegërishtes për rrëfyer ndonjë veprim a ngjarje që është kryer në një të kaluar shumë të largët, përdoren edhe dy apo diku edhe tri kohë të tjera. Në fakt, nga koha më se e kryer dhe koha e tejskUAR ndërtohen forma të dyta të mbipërbëra dhe me to tregohen veprime që kanë ndodhur në kohë të lashta, në kohët më të errëta të historisë së tyre fare pak të njohur, përkatësisht në kohën e panjohur e më të lashtë që mund të mbajë mend njerëzimi ose diçka që është bartur brez pas brezi në formën e folur, si në përralla, legjenda, gojëdhëna etj. Për shembull: *Ish pas kã:n ni bu:rr e ni gru: // Ata nuk kishin pas asni fmi: // Ish pas kãn ni arap i zi // Për dit e kish pas lyp me ngrãn ka ni njeri ...// Zakonisht me këto kohë të dyta të mbipërbëra të së shkuarës fillojnë përrallat, ndërsa më pas përdoren kohë të tjera foljesh që tregojnë kohë më afër të sotmes.*

Sipas strukturës që kanë, foljet e mbipërbëra janë analitike. Ndërtohen nga koha më se e kryer si dhe nga e kryera e tejskUAR me ndërfitjen e foljes **pas** ndërmjet foljes ndihmëse dhe pjesores, sipas tipit: *kishna shku:* (koha më së e kryer) - **kishna pas shku:** (më se e kryera II), gjegjësisht *pata dal* (koha e kryer e tejskUAR) - **pata pas da:l** (e kryera II e tejskUAR) etj.

Këto kohë të dyta të mbipërbëra, që tregojnë të shkuarën më të largët të mbamendjes kolektive, edhe në të folmet e Veriut kanë përdorim të kufizuar. Ndryshimet që po bëhen në shoqëri, në mënyrën e jetesës, sidomos me zhvillimit e teknikës e të teknologjisë, sjellin me vete edhe ndryshime në gjuhën e njerëzve. Te ne shqiptarët rrallëkund rrëfohen përralla, legjenda e gati më askund nuk ka oda të dikurshme kuvendesh, bile as në malësi. Njerëzit gjithnjë më pak flasin e evokojnë të kaluarën e largët. Pjesën më të madhe të kohës së lirë e kalojnë para televizorit, kompjuterit apo edhe gjithë ditën e kalojnë me telefon në dorë, duke këmbyer porosi ose duke surfuar në internet. Në gjuhën e komunikimit të përditshëm fare pak gjejmë kohët e shkuara, aspak të mbipërbërat. Më nuk tregon kush e as që dëgjon kush përralla e legjenda. Rrjedhimisht edhe këto dy kohë të mbipërbëra, edhe ashtu fare pak të ruajtura në të folmet e Veriut, do të humben, treten e shuhën plotësisht.

4. Të folmet e gegërishtes kanë pjesore të reduktuar (la:), ndërsa të folmet e toskërishtes dhe shqipja standarde kanë pjesore të plota (larë)

Siç dihet, të folmet e gegërishtes kanë **pjesore të reduktuar** (të cunguar, të shkurtuar, pa mbaresa), ndërsa të folmet e toskërishtes kanë **pjesore të plota**, me njërën nga mbaresat -ë, -rë, -në, -ur, -uar ; khs. pjesoret (participet) toske e gege:

<i>pjesore toske</i>	<i>pjesore gege</i>	<i>pjesore toske</i>	<i>pjesore gege</i>
(kam) vjelë / vjelur	vje:l	fshirë	fshĩ:
mbjellë / mbjellur	mbje:ll, mje:ll	blerë	ble:
marrë / marrur	ma:rr	lidhur	li:dh
thënë / thënur	thã:n	pjekur	pje:k
bërë	bã:	lexuar	lexu:
dhënë / dhënur	dhã:n	mësuar	msu:

lënë / lënur	lã:n	larë	la:
--------------	------	------	-----

4.9. FORMAT NORMATIVE TË FOLJEVE APOFONIKE

Foljet, te të cilat /a/-ja apo /e/-ja e theksuar e rrënjës shndërrohet në /o/ quhen *folje apofonike*. Termi *apofoni* rrjedh nga greqishtja: *apo* -parashtesë që tregon idenë e shmangies + *phon* - tingull (është kalk i fjalës gjermane *ab-laut*). Është dukuri morfonologjike që shqipja e ka trashëguar nga “nëna” e saj. *Apofonia është ai ndërrim historik, si pasojë e të cilit fitohet një zanore e prapme*. Apofonia në kuptimin e ngushtë të fjalës përfshin ndërrimet e zanoreve /a/ dhe /e/ të theksuara (por edhe /ie ose je/) në /o/.

Këto shndërrime vihen re kryesisht në sistemin foljor. Me këtë ndërrim fonetik historik, tani më të fonologjizuar, në gjuhën shqipe është krijuar kundërvënia e disa foljeve të kohës së tashme (prezent) dhe formave të tyre në të kryerën e thjeshtë (aorist). P.sh.:

koha e tashme		e kryera e thjeshtë	koha e tashme		e kryera e thjeshtë
<i>dal</i>	~	<i>dola</i>	<i>marr</i>	~	<i>mora</i>
<i>bredh</i>	~	<i>brodha</i>	<i>dredh</i>	~	<i>drodha</i>
<i>hedh</i>	~	<i>hodha</i>	<i>heq</i>	~	<i>hoqa</i>
<i>djeg</i>	~	<i>dogja</i>	<i>nxjerr</i>	~	<i>nxora</i>
<i>sjell</i>	~	<i>solla</i>	<i>vjel</i>	~	<i>vola</i>
<i>pjek</i>	~	<i>poqa</i>	<i>mbledh</i>	~	<i>mblodha</i>
<i>ndjek</i>	~	<i>ndoqa</i>	<i>vjell</i>	~	<i>volla</i>
<i>pjell</i>	~	<i>polla</i>	<i>rrjedh</i>	~	<i>rrodha</i>
					104

Foljet apofonike që dalin me temë në **-l**, **-ll** dhe **-rr** nuk marrin ndajshitesën **-ur** në format e pashtjelluara. Prandaj themi: *për të dalë* (dhe jo për të dalur), *për të marrë* (dhe jo për të marrur), *për të vjelë* (dhe jo për të vjelur), *për të mbjellë* (jo për të mbjellur). Rrjedhimisht, edhe mbiemrat e formuar prej këtyre pjesoreve të foljeve (që quhen mbiemra prejfoljorë, më saktësisht mbiemra prejpjesorë) përdoren pa **-ur**: *i (e) dalë, i (e) marrë, i (e) mbjellë*.

Foljet apofonike që në të tashmen mbarojnë me **-rr**, në të kryerën e thjeshtë shqiptohen dhe shkruhen me **-r**: *bjerr ~ bora, bore, bori, borëm* etj.; *marr ~ mora, more, mori, morëm* etj.; *nxjerr ~ nxora, nxore, nxori, nxorëm* etj.; *tjerr ~ tora, tore, tori, torëm* etj. Foljet e tjera joapofonike e ruajnë **rr**-në edhe në të kryerën e thjeshtë: *korr ~ korra, mburr ~ mburra, tkurr ~ tkurra* etj.

5. Të folmet e gegërishtes kanë paskajoren geqe (me punue), ndërsa të folmet toske nuk e kanë këtë formë, por në vend të saj përdorin lidhoren (të punoj) ose formën (për të punuar). Paskajorja geqe nuk konsiderohet si formë standarde.

¹⁰⁴ Në FGjSSh janë shënuar 28 folje me ndërrimin /je/ ~ /o/.

Tipi i **paskajores** së gjuhës letrare i përbërë nga pjesëza parafjalore **për** dhe emri foljor asnjansë i pashquar (**për të punuar**) ekziston në gjithë toskërishten (në të folmet kalimtare, të Shqipërisë së Mesme; paralelisht me paskajoren gege edhe në të folmet qendore); ndërsa në të folmet e gegërishtes është tipike paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore **me** dhe nga pjesorja e foljes (**me punue**). Kjo paskajore e quajtur gege kryen shumë funksione të lidhore dhe të paskajores toske. P.sh. geg. *shkova me punue* – tosk. *shkova për të punuar* – *shkova të punoj*; geg. *kam me dal, du me dal* – tosk. *kam për të dalur* – *do të dal*.

6. Koha e ardhme në pjesën më të madhe të të folmeve gege shprehet me të ardhmen e domosdoshme, ndërsa në të folmet toske (dhe në shqipen standarde) me të ardhmen e dëshiruar

Në mbarë shqipen (dialektore e standarde) koha e ardhme shprehet me dy forma të përbëra:

a) të folmet gege këtë kohë e formojnë nga folja ndihmëse **kam** + **paskajorja**, apo kam + me + pjesore: *kam me shku*;, *kam me punu*;, *kam me dal*, ...

b) tjetra formë (kushtimisht e thënë toske) ndërtohet me pjesëzën **do** (e desemantizuar nga folja due, du, dua) + **folja** themelore në mënyrën lidhore, sipas tipit: *do të shkoj*, *do të punoj*, *do të dal*, ...

Në fakt, njëra është karakteristike dhe mbizotëruese në të folmet e gegërishtes (kam me msu:), ndërsa tjetra në të folmet e toskërishtes (do të mësoj). Megjithatë, siç dihet, në të folmet e gegërishtes qendrore kemi përdorimin e dyfishtë të të dy formave (*kam me ardh* dhe *do t'vâi*), me shtrirje më të gjerë të formës së dytë (fatur volitiv).

Në studimet albanologjike përgjithësisht është pranuar se këto dy forma të veçanta foljore të së ardhmes dallojnë jo vetëm në pikëpamje strukturore, por edhe në pikëpamje kuptimore, ose së paku tregojnë nuanca me vlerë kuptimore (semantike).

Në fakt, forma gege e kohës së ardhme *kam me a:rdh*, e quajtur në shqip **e ardhme e domosdoshme** a **e detyrimit** (futurum necessitatis), është konstatuar se tregon veprime që duhen patjetër të kryhen, që janë të domosdoshme, të detyrueshme për t'u bërë, apo parashikimet e premtimet për t'u realizuar diçka thuhet me një siguri shumë të lartë, premtimet janë bindëse, folësi zotohet për atë që e thotë se do ta bëjë.

Ndërkaq, me formën tjetër toske e standarde *do të vi*, e emërtuar në shqip **e ardhme e dëshiruar** (fatur volitiv), shprehet një siguri më e ulët për atë që pritet të realizohet, një mëdyshje për atë që do të kryhet, diçka që është mirë të bëhet, por nuk është e domosdoshme. Me fjalë të tjera, me futur necessitatis tregohet një veprim që me të vërtetë do të kryhet, ndërsa me futur volitiv shprehet një veprim që duam të kryhet.

Kjo kundërvënie (dyshe) binare: e vërtetë, e sigurt ~ e mundshme, e pritshme apo e domosdoshme, e patjetërsueshme ~ e dëshirueshme, e parapëlqyeshme shihet edhe në përbërjen (strukturën) e tyre: forma foljore gege (kam me a:rdh) ndërtohet me mënyrën dëftore (indikativin), ndërsa forma toske (do të vi) me mënyrën lidhore (konjunktivin). Të rikujtojmë se me mënyrën dëftore shënjohej një e vërtetë, diçka reale; ndërsa me mënyrën lidhore – e dëshirueshmja, e pritshmja.

7. Përcjellorja në gegërishte formohet me pjesëzën tu dhe pjesoren (tue, tuj punu:), ndërsa në toskërishte dhe në variantin standard me duke + pjesoren e foljes (duke punuar)

Përcjellorja (gerundivi) është formë e pashtjelluar analitike që përbëhet nga *pjesorja* dhe pjesëza *tu* ose në variantet *tue*, *tuj*, sipas tipit: *tu he:c*, *tu fol*, *tu shkru:*, ... në të folmet e Veriut dhe *duke*, sipas tipit: *duke ecur*, *duke folur*, *duke shkruar*, ... në të folmet e Jugut. Në të dy dialektet përcjellorja ka funksion të njëjtë: me të tregohen veprime që zgjasin dhe që janë duke u bërë edhe në momentin kur flasim: *jam tu punu:* = *jam duke punuar*. Edhe forma gege (tu msu:) edhe forma toske (duke mësuar) shprehin po të njëjtin kuptim që shprehet nga forma analitike e mënyrës dëftore me pjesëzën po: *po punoj*.

Përkundër këtyre dallimeve të krijuara në rrjedhë të kohës, të folmet, rrjedhimisht edhe **dialektet, në pikëpamje strukturore në sistemin foljor kanë bazë të gjerë të përbashkët.**

4.10. ZGJEDHIMI NORMATIV I FOLJEVE

Foljet në mënyra, kohë, veta dhe numra të ndryshëm marrin forma të ndryshme. Tërësia e formave që merr një folje në mënyra, kohë, veta dhe numra quhet zgjedhim i foljes. Në gjuhën shqipe ka dy lloje zgjedhimesh: *zgjedhim vepror* dhe *jovepror*.

Gjatë zgjedhimit të foljeve dallojmë elemente të ndryshme: *temën*, *mbaresën*, *foljet ndihmëse*. Mbaresë quhet pjesa fundore e foljes që ndryshon dhe shërben për të shprehur diatezën (veprorë - joveprorë), mënyrën (dëftore, lidhore...), kohën (e tashme, e pakryer etj.), vetën (e parë, e dytë, e tretë) dhe numrin (njëjës - shumës).

Çdo folje ka temën prej së cilës formohet. Tema është pjesa që nuk ndryshon kur formohen kohët dhe vetat e ndryshme të saj. Kur tema është fjalë e thjeshtë, tema është njëkohësisht edhe rrënjë e foljes. Shumica e foljeve kanë një temë të përbashkët, nga e cila ndërtohen të gjitha format gramatikore: *lidh*, *kap*, *mbyll*, *mat*, *punoj*, *rrëfej*, *shkruaj*, *thyej*.

Si trajtë përfaqësuese e foljes shërben veta e parë njëjës e kohës së tashme e mënyrës dëftore në formën veprorë.

Foljet në gjuhën shqipe ndahen në **tri zgjedhime**: në zgjedhimin e parë, të dytë dhe të tretë.

Zgjedhimi i parë përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në zanore dhe marrin mbaresën -j. P.sh.: *punoj*, *laj*, *kthej*, *rrëfej*; *gjej*, *arrij*, *mbaj*; *bëj*, *hyj* etj.

Zgjedhimi i dytë përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në bashkëtingëllore, si *hap*, *mat*, *vendos*, *gjuaj*; *heq*, *marr*, *dredh*, *nxjerr*, *vjel*, *djeg* etj.

Zgjedhimi i tretë përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në zanore dhe nuk marrin asnjë mbaresë në numrin njëjës: *vë*, *zë*, *shpie*; *di*, *fle*, *ngre*, *pi*.

Përveç foljeve që klasifikohen në zgjedhime, ka edhe disa folje të tjera që quhen **folje të parregullta**. Folje të parregullta janë: *jap*, *bie*, *ha*, *jam*, *kam*, *rri*, *shoh*, *vij*; *dua*, *them*, *vdes*, *vete*, *lë*, *shpie*, *shtie*.

Kohët e foljeve në shqipen standarde

1. **Mënyra dëftore** ka tetë kohë. Ato janë: koha e tashme - *laj*, e pakryer - *laja*, e kryer e thjeshtë - *lava*, e kryer - *kam larë*, më se e kryer - *kisha larë*, e kryer e tejshtuar - *pata larë*, e ardhme - *do të laj*, e ardhme e përparme - *do të kem larë*.

2. **Mënyra lidhore** ka katër kohë: e tashme - *të laj*; e pakryer - *të laja*; e kryer - *të kem larë*; më se e kryer - *të kisha larë*.

3. **Mënyra kushtore** ka dy kohë: e tashme - *do të laja*; e kryera - *do të kisha larë*.

4. **Mënyra habitore** ka katër kohë: e tashme - *lakam*; e pakryer - *lakështa*; e kryer - *paskam larë*; më se e kryer - *paskështa larë*.

5. **Mënyra dëshirore** ka dy kohë: e tashme - *lafsha*; e kryera - *paça larë*.

6. **Mënyra urdhërore** ka vetëm vetën e dytë njëjës dhe shumës: *puno!*, *punoni!*

Koha e foljes tregon se kur kryhet veprimi. Për ta përcaktuar më mirë kohën e foljes, bëni pyetjen - **kur?**

Për nga struktura, kohët e foljes janë:

- a) të thjeshta (sintetike), dhe
- b) të përbëra (analitike).

Të thjeshta janë: e tashmja (mësoj), e pakryera (mësoja), e kryera e thjeshtë (mësova) dhe e ardhmja (do të mësoj). Ato formohen kryesisht me mbareta që i shtohen foljes.

Kohët e përbëra janë: e kryera (kam mësuar), më se e kryera (kisha mësuar), e kryera e tejshtuar (pata mësuar), e ardhmja e përparme (do të kem mësuar).

Kohët e përbëra formohen me foljen ndihmëse **kam** ose **jam** dhe pjesoren e foljes.

Ja disa forma normative të disa foljeve:

laj - lajmë, lajnë, (do të laj, (do të lajë, (do të lajmë, (do të lajnë, (do të laja, (do të laje,

mbaj - mbajmë, mbajnë, (do të mbaj, (do të mbajë, (do të mbajmë, (do të mbajnë,

(do të mbaja, (do të mbaje;

qaj - qajmë, qajnë ...;

thaj - thajmë, thajnë ... etj.;

blej - blejmë, blejnë, (do të blej, (do të blejë, (do të blejmë, (do të blejnë, (do të

blija, (do të blije;

dëfrej - dëfrejmë, dëfrejnë, (do të dëfrej, (do të dëfrejë, (do të dëfrejmë (do të

dëfreja, (do të dëfreje etj.;

bëj - bëjmë, bëjnë, (do të bëj, (do të bëjë, (do të bëjmë, (do të bëjnë, (do të bëja, (do

të bëje;

arrij - arrijmë, arrijnë, (do të arrij, (do të arrijë, (do të arrijmë, (do të arrijnë, (do të

arrija, (do të arrije;

fshij - fshijmë, fshijnë, (do të fshij, (do të fshijë, (do të fshijmë, (do të fshijnë, (do të

fshija, (do të fshije;

vij - vijmë, vijnë, (do të vij, (do të vijë, (do të vijmë, (do të vijnë, (do të vija, (do të

vije etj.;

qëndroj - qëndrojmë, qëndrojnë, (do të qëndroj, (do të qëndrojë, (do të qëndrojmë,

(do të) qëndrojnë, (do të) qëndroja, (do të) qëndroje;
punoj - punojmë, punojnë, (do të) punoj, (do të) punojë, (do të) punojmë, (do të) punojnë (do të) punoja, (do të) punoje; etj;
mbruj - mbrujmë, mbrujnë, (do të) mbruj, (do të) mbrujë, (do të) mbrujmë, (do të) mbrujnë, (do të) mbruja, (do të) mbruje etj.;
fryj - fryjmë, fryjnë, (do të) fryj, (do të) fryjë, (do të) fryjmë, (do të) fryjnë, (do të) fryja, (do të) fryje;
ndryj - ndryjmë, ndryjnë, (do të) ndryj, (do të) ndryjë, (do të) ndryjmë, (do të) ndryjnë, (do të) ndryja, (do të) ndryje etj.;
ndiej - ndiejmë, ndiejnë, (do të) ndiej, (do të) ndiejë (do të) ndiejmë, (do të) ndiejnë, (do të) ndieja, (do të) ndieje;
përziej - përziejmë, përziejnë, (do të) përziej, (do të) përziejë, (do të) përziejmë, (do të) përziejnë, (do të) përzieja, (do të) përzieje etj.;
paguaj - paguajmë, paguajnë (do të) paguaj, (do të) paguajë, (do të) paguajmë, (do të) paguajnë, (do të) paguaja, (do të) paguaje;
shkruaj - shkruajmë, shkruajnë, (do të) shkruaj, (do të) shkruajë, (do të) shkruajmë, (do të) shkruajnë, (do të) shkruaja, (do të) shkruaje, (do të) etj.;
lyej - lyejmë, lyejnë, (do të) lyej, (do të) lyejë, (do të) lyejmë, (do të) lyejnë, (do të) lyeja, (do të) lyeje;
kryej - kryejmë, kryejnë, (do të) kryej, (do të) kryejë, (do të) kryejmë, (do të) kryejnë, (do të) kryeja, (do të) kryeje etj.

Shënim. Foljet që në vetën e parë të së tashmes dëftore dalin më zanore, si *ha, fle, lë, nxë, vë, zë, di, pi*, nuk shkruhen me **-j** as në vetën e parë e të tretë shumës të së tashmes dëftore e lidhore dhe të së ardhmes, as në vetën e parë e të dytë njëjës të së tashmes lidhore, as në urdhërore:

ha - (do të) hamë, (do të) hanë; të ha, të hash; ha!
fle - (do të) flemë, (do të) flenë; të fle, të flesh; fli!
lë - (do të) lëmë, (do të) lënë; të lë, të lësh;
di - (do të) dimë, (do të) dinë; të di, të dish; di! etj.¹⁰⁵

Koha e kryer e thjeshtë (aoristi)

Shpeshherë në formën e folur e të shkruar dëgjojmë e lexojmë forma të gabuara të foljeve në **kohën e kryer të thjeshtë** (aorist). Ja zgjedhimi i drejtë i disa foljeve:

jam - qeshë, qe, qe; qemë, qetë, qenë.
kam - pata, pate, pati; patëm, patët, patën.
mësoj - mësova, mësove, mësoi; mësuam, mësuat, mësuam.
shkruaj - shkrova, shkrove, shkroi; shkruam, shkruat, shkruan.
laj - lava, lave, lau; lamë, latë, lanë.
kthej - ktheva, ktheve, ktheu, kthyem, kthyet, kthyen.
gjej - gjeta, gjete, gjeti; gjetëm, gjetët, gjetën.

¹⁰⁵ IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 77-78.

- luaj** - luajta, luajte, luajti; luajtëm, luajtët, luajtën.
- bëj** - bëra, bëre, bëri; bëmë, bëtë, bënë.
- hyj** - hyra, hyre, hyri; hymë, hytë, hynë.
- zë** - zura, zure, zuri; zumë, zutë, zunë.
- hap** - hapa, hape, hapi; hapëm, hapët, hapën.
- mbyll** - mbylla, mbylle, mbylli; mbyllëm, mbyllët, mbyllën.
- dal** - dola, dole, doli; dolëm, dolët, dolën.
- them** - thashë, the, tha; thamë, thatë, thanë.
- shoh** - pashë, pe, pa; pamë, patë, panë.
- vij** - erdha, erdhe, erdhi; erdhëm, erdhët, erdhën.
- dua** - desha, deshe, deshi; deshëm, deshët, deshën.

Koha e kryer (perfekti)

Si në të gjitha gjuhët, ashtu edhe në gjuhën shqipe për nga struktura kjo kohë është e përbërë (analitike). Forma *veprorë* ndërtohet me foljen **kam** + **pjesorë** (kam larë). Forma joveprorë formohet me foljen **jam** + **pjesorë** e foljes (jam larë).

forma veprorë (aktive)

- shkoj** - kam shkuar, ke shkuar, ka shkuar; kemi shkuar, keni shkuar, kanë shkuar.
- laj** - kam larë, ke larë, ka larë; kemi larë, keni larë, kanë larë.
- luaj** - kam luajtur, ke luajtur, ka luajtur; kemi luajtur, keni luajtur, kanë luajtur.
- hap** - kam hapur, ke hapur, ka hapur; kemi hapur, keni hapur, kanë hapur.
- pi** - kam pirë, ke pirë, ka pirë; kemi pirë, keni pirë, kanë pirë.
- di** - kam ditur, ke ditur, ka ditur; kemi ditur, keni ditur, kanë ditur.
- dua** - kam ditur, ke ditur, ka ditur; kemi ditur, keni ditur, kanë ditur.
- vij** - kam ardhur, ke ardhur, ka ardhur; kemi ardhur, keni ardhur, kanë ardhur.

forma joveprorë (pasive)

- lahem** - jam larë, je larë, është larë; jemi larë, jeni larë, janë larë.
- bëhem** - jam bërë, je bërë, është bërë; jemi bërë, jeni bërë, janë bërë.
- ulem** - jam ulur, je ulur, është ulur; jemi ulur, jeni ulur, janë ulur.

Koha e ardhme (futuri)

Foljet që tregojnë një veprim i cili pritet të kryhet pas çastit kur flasim, janë të kohës së ardhme. Ndërtimi i kohës së ardhme pa pjesëzën **të** të lidhores, sipas tipit: *do punoj, do mësoj, do tregoj ...* është jonormativ. Kjo prirje e ekonomisë së ligjërimit në mospërdorimin e të-së është i papranueshëm për normën morfologjike të shqipes standarde. Në vijim po japim paradigmat e disa foljeve:

jam - do të jem, do të jesh, do të jetë; do të jemi, do të jeni, do të jenë.

- kam** - do të kem, do të kesh, do të ketë; do të kemi, do të keni, do të kenë.
shkoj - do të shkoj, do të shkosh, do të shkojë; do të shkojmë, do të shkoni, do të shkojnë.
shkruaj - do të shkruaj, do të shkruash, do të shkruajë; do të shkruajmë, do të shkruani, do të shkruajnë.
hap - do të hap, do të hapësh, do të hapë; do të hapim, do të hapni, do të hapin.
pi - do të pi, do të pish, do të pijë; do të pimë, do të pini, do të pinë.
lahem - do të lahem, do të lalesh, do të lahet; do të lahemi, do të laheni, do të lahen.

Ushtrim: Zgjedhoni foljet *lexoj, mësoj, laj, rri* në kohën e ardhme.

Ushtrim: Foljet në kllapa vini në kohën e ardhme.

- Unë (punoj) gjatë fundjavës, po ju çfarë (bëj)?
- Ai (shkoj) në kinema me Tonin.
- Ju (lexoj) një roman.
- Ti (mësoj) tërë natën.
- Ne (fle).
- Ato (pushoj).
- Ajo (vizitoj) prindërit.
- Ata (shëtit) shumë dhe (lodhem).

Ushtrim: Foljet nga koha e tashme ktheni në kohën e ardhme.

P.sh.: Unë lexoj një libër. / Unë do të lexoj një libër.

- Arta blen një veturë. /
- Ajo rri në shtëpi. /
- Ne shkojmë në restorant. /
- Ai lahet në det. /
- Ato mësojnë shqip. /
- Ju bëheni gati. /
- Ata kuptojnë mësimin. /
- Punëtorët pushojnë tërë fundjavën. /
- Nitës i pëlqen filmi. /
- Ne pimë nga një lëng. /

4.11. PËRDORIMI I DREJTË I DISA NDAJFOLJEVE DHE I MBIEMRAVE

Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që plotëson kuptimin e një foljeje, një mbiemri a një ndajfoljeje tjetër. Ajo emërton një rrethanë të veprimit apo të gjendjes, Shkallën e cilësisë ose intensitetin e veprimit.

Ndajfolja nuk ka asnjë kategori gramatikore, përveç kategorisë së shkallës. Ndajfoljet në fjali mund të përdoren si rrethanorë, si përcaktorë dhe si pjesë emërore e kallëzuesit.

Dallohet grupi i ndajfoljeve përemërore: *ashtu, kështu, andej, këtej, aty, këtu, atje* etj. si dhe i ndajfoljeve përemërore pyetëse: *ku, kur, nga, si, qysh, pse, përse* etj. Kemi:

- a) ndajfolje mënyre
- b) ndajfolje sasi
- c) ndajfolje kohe
- ç) ndajfolje vendi dhe
- d) ndajfolje shkaku.

Ndajfoljet e mënyrës tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja. P.sh. *mirë, keq, bukur, ëmbël, hollë, lehtë, mbarë, pastër, qartë, qetë, shkurt, shtrembër, thjesht, vështirë, fuqishëm, natyrshëm, gëzueshëm, rrjedhshëm, menjëherë, papritur, rëndom, shpesh, vazhdimisht, cekët, gjerë, gjatë, thellë, hollësisht, trimërisht, shqip, frëngjisht, anglisht, maqedonisht* etj.

Ndajfoljet e sasisë shprehin intensitetin a shkallën e veprimit të shprehur nga folja. Të tilla janë: *fort, shumë, tepër, së tepërmi, njëfish, dyfish, trefish* etj.

Ndajfoljet e kohës emërtojnë kohën kur kryhet a kohën sa zgjat veprimi ose gjendja e shprehur nga folja. Me këtë kuptim përdoren ndajfoljet: *dje, nesër, pardje, pasdreke, sonte, sot, tani, vjet, dikur, njëherë, një ditë, së shpejti, gjatë, gjithmonë, gjithnjë, kurdoherë, përditë, ndonjëherë, rrallë, shpesh, ditë për ditë, natë për natë, kohë pas kohe, herë pas herë, aty për aty, motmot, asnjëherë, kurrë* etj.

Ndajfoljet e vendit tregojnë vendin ku kryhet një veprim a ku ndodh një ngjarje etj.; p.sh. *afër, atje, aty, djathtas, këtu, larg, majtas, përtej, pranë, rreth, diku, vende- vende, anembanë, kudo, ngado, askund, gjëkund* etj.

Ndajfoljet e shkakat shërbejnë për të treguar shkakun e kryerjes së një veprimi: *përse* dhe *pse*, të cilat shërbejnë për të pyetur për shkakun e kryerjes së një veprimi. Në këtë grup hyjnë edhe ndajfoljet *prandaj, andaj, për këtë arsye, për këtë shkak, për këtë qëllim* etj.

Ndajfoljet, ashtu si edhe mbiemrat kanë shkallën pohore, shkallën krahasore dhe shkallën sipërore. Mënyrat e ndërtimit të shkallëve të ndajfoljeve janë të njëjta me ato të mbiemrave.

Ushtrim: Mbiemrat e dhënë në fjalitë e mëposhtme zëvendësoni me ndajfolje. P.sh.:

- Arbeni është i shpejtë. (ecën)
- Arbeni ecën shpejt.
- Linda është e ngadalshme. (lexon)
- Kënga e Norës është e bukur. (këndon).
- Fjala e tij është e hapur. (flet)
- Takimi ynë ishte i rastit. (u takuam)
- Ky libër është i shtrenjtë. (kushton)
- Vonesa e saj është e zakonshme. (vonohet)

Ushtrim: Fjalët e dhëna me shkronja kursive, zëvendësoni me ndajfoljet përkatëse. P.sh.:

Sot në mbrëmje do të shkoj në teatër.

Sonte do të shkoj në teatër.

sot në mbrëmje = sonte

- Para dy ditësh isha te Shpendi.
- Vitin e kaluar isha në Shqipëri
- Dje në mbrëmje u takova me Artanin.
- Pas dy ditësh do të filloj studimet.
- Ka shumë kohë që nuk jemi parë.
- Nesër në mbrëmje do të jem i zënë.
- Gjatë ditës bën shumë nxehtë.
- Gjatë natës bën freskët.
- Gjatë verës shkojmë në det.
- Gjatë dimrit shkojmë në Malin Sharr.

Mbiemrat e formuar prej një teme më **-h** shkruhen me **-të**. Këta mbiemra e ruajnë **-ë-në** edhe përpara nyjës **-t** të emërores e të kallëzores së shquar të njëjësit asnjansës e të shumës të gjinisë mashkullore, si edhe përpara mbaresave **-sh** e **-ve**: *i ftohtë - të ftohtët, të ftohësh, të ftohtëve; i lehtë - të lehtët, të lehtësh, të lehtëve; i mprehtë - të mprehtët, të mprehtësh, të mprehtëve; i nxehtë - të nxehtët, të nxehtësh, të nxehtëve* etj.

Mbiemrat, të cilët përcaktojnë emrat mashkullore me shumësin më **-e**, në numrin shumës përdoren në trajtën e gjinisë femërore:

dete të thella, drejtime të reja, elementet kimike, kanale vaditëse, katunde malore, kënde të ngushta, kopshte të lulëzuara, kujtimet e mia, këto kushte më duken të papranueshme, këto lajme s'më duken të besueshme, lëngjet tretëse, ato livadhe të gjelbra, malet tona të larta, metale të rralla, minerale të dobishme, personalitete të shquara, përparime të dukshme, të gjitha qytetet e mëdha, ritme të shpejta, sende të gjetura, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtigje të ngushta, tipare themelore, tregime humoristike, ushtrime gjuhësore, vende liridashëse, vendet tona, vendime të prera, këto vendime janë të drejta, veprime luftarake, zakonet i kanë shumë të afërta etj.

Shkruhen njësoj mbiemrat dhe ndajfoljet: *(i, e) butë - butë, (i, e) ftohtë - ftohtë, (i, e) gjallë - gjallë, (i, e) gjatë - gjatë, (i, e) lehtë - lehtë, (i, e) mirë - mirë, (i, e) ngrohtë - ngrohtë, (i, e) shkretë - shkretë, (i, e) vonë - vonë.*

Në çiftet e fjalëve më poshtë mbiemrat shkruhen me **-ë**, ndajfoljet pa **-ë**:
*(i, e) drejtë - drejt, drejtpërdrejt, drejtshkrim; (i, e) fortë - fort, (i, e) kotë - kot, (i, e) lartë - lart, i lartpërmendur; (i, e) ligshhtë - ligshht, (i, e) mbrapshtë - mbrapsht, (i, e) mjaftë - mjaft, (i, e) plotë - plot, i plotfuqishëm; (i, e) shpejtë - shpejt, (i, e) thjeshtë - thjesht, (i, e) vërtetë - vërtet; po kështu: larg, pak, pakkush, shkurt.*¹⁰⁶

Mbiemrat që përcaktojnë emrat mashkullore e asnjansës, të cilët e formojnë shumësin me mbaresën **-ra**, në numrin shumës përdoren në trajtën e gjinisë femërore: *djathëra të mira, drithërat e sivjetme, fshatra të elektrifikuara, leshra të dredhura, mallra të jashtme, mishra të pjekura, ujëra të ftohta.*

Shënim: Të mos ngatërrohet kjo kategori me emrat që në emëroren e pashquar të njëjësit dalin me temë më **-r** dhe që e formojnë shumësin me mbaresën **-a**; mbiemrat që i përcaktojnë këta emra, përdoren në trajtën e gjinisë mashkullore: *emra të përveçëm, hekura të ndryshkur, mbiemra të nyjshëm, regjistra themeltarë* etj.

¹⁰⁶ Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 51-52.

4.12. SHKRIMI I DISA PJESËZAVE DHE I PARAFJALËVE

Trajtat foljore që formohen me **do të** shkruhen zakonisht të plota: **do të shkoj, do të shkoja, do të kem shkuar, do të kisha shkuar** etj.

Pjesëza **të**, që vihet përpara lidhoses ose përpara pjesores, shkruhet rregullisht në të gjitha rastet e përsëritjes së trajtave foljore përkatëse bashkë me parafjalët që mund të ketë përpara (**për, me**): **të jetojmë, të punojmë dhe të mendojmë si revolucionarë** etj.; për të **studiuar, për të kuptuar dhe për të zbatuar drejt udhëzimet; me të arritur e me të parë gjendjen, ai mori masa** etj. (dhe jo: *të jetojmë, punojmë dhe mendojmë si revolucionarë; me të arritur e parë gjendjen, ai mori masa* etj.).

Pjesëza **duke** e përcjellores shkruhet në të gjitha rastet e përsëritjes së kësaj trajte foljore; në raste mohimi, bash me të përsëritet dhe pjesëza **mos**: *ata shkonin duke kënduar e duke brohoritur; duke parë e duke bërë; duke mos njohur e duke mos marrë parasysh rrethanat* etj.

Pjesëza **pa** përpara pjesores shkruhet rregullisht në të gjitha rastet e përsëritjes së kësaj trajte foljore: **pa u lodhur e pa u përprjekur nuk bëhet gjë; pa punuar, pa ujitur e pa plehëruar mirë tokën, nuk merren prodhime të mëdha.**

Parafjalët **në, te (tek), me, nga, prej** e të tjera si këto zakonisht përsëriten në shkrim, sa herë që bashkërenditen dy a më shumë emra a përemra, me të cilët ato lidhen: **në pranverë, në verë, në vjeshtë e në dimër** etj.; **te ilirët, te trakasit e te popujt e tjerë** etj.; **me të ngrënë e me të pirë; me hekur e me zjarr; me mish e me shpirt; me thonj e me dhëmbë** etj.; **nga Elbasani, nga Gjirokastra e nga Vlora** etj.; **prej Himare e prej Mirditë; as në sjelljet, as në fytyrën e tij nuk vërehej shenjë tronditjeje; nga shtati, nga dituria, nga fjala nuk kishte shok** etj.

Këto parafjalë mund të mos përsëriten për arsye të caktuara kuptimore ose stilistike: **në fshatra e qytete; me shokë e shoqe; u nisën delegatët nga Shkodra, Durrësi, Berati e Korça; qindra partizanë, me pushkë e mitraloza, u turrën mbi armikun; shkolla jonë socialiste kërkon nga mësuesit e pedagogët një stil të ri pune** etj.

4.13. DREJTSHKRIMI I NUMËRORËVE

Numërori është pjesë e ligjëratës që tregon numra abstraktë ose sasi të caktuar sendesh a qeniesh të një fare. Numërorë të mirëfilltë janë elementet e numërimit: *një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë...*

Numërorët përdoren në sistemin e numërimit, në veprimet matematike, ose si përcaktues të sasisë së gjërave. Ata mund të përdoren më vete. P.sh.: $10 + 5 = 15$;

$30 \times 2 = 60$; $100 : 4 = 25$ etj.

Shumë shpesh numërori përdoret para emrit dhe përcakton sasinë e sendeve. P.sh.:

Dhoma kishte *një* dritare në ballë, *një* tryezë dhe *pesë* karrige, *dy* rafta për bibliotekë, *një* tufë lule mbi tryezë. Te shkallët u takuan *gjashtë* veta. Shqipja ka mbi 2000 fjalë të trashëguara nga fondi i lashtë indoevropian. Kongresi i alfabetit të gjuhës shqipe u mbajt më vitin 1908 në

Manastir. Ç'të bënte ai vetë, *një kundër treve!* Kam lindur më 20. 05. 1990. Lufta e Dytë Botërore u bë gjatë periudhës 1940 - 1945. Ishte ora *gjashtë e njëzet*.

Fjalë të parme janë numërorët 0 - 20: *zero, një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë*.

Fjalë të përngjitura janë numërorët 11 - 19: *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërmëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë*.

Fjalë të përbëra janë numërorët *tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë, tetëdhjetë, nëntëdhjetë, njëqind, dyqind* etj.

Shprehje janë numërorët nga 21-29, 31-39, 41-49 etj.; 101-109, 201-299, 1001-1999 etj. Shprehjet shkruhen ndaras, si *tridhjetë e një, dyzet e dy, dyqind e nëntëdhjetë e nëntë, një mijë, dy mijë, një milion* etj.

Gjinia e numërorëve

I vetmi numëror që ka dy gjini është numërori 3: **tre** për gjininë mashkullore dhe **tri** për gjininë femërore. P.sh. themi: *tre djem - tri vajza, tre nxënës - tri nxënëse, tre lapsa - tri fletore* etj.

Ushtrim: Rishkruajeni tekstin. Numrat shkruani me fjalë.

Artani po u tregonte dy shokëve të tij ç'kishte lexuar në një revistë: Një njeri, gjatë 50 vjetëve të jetës së tij, kalon në gjumë rreth 6 000 ditë, punon rreth 6 500 ditë, ecën rreth 800 ditë, ha rreth 1 500 ditë, pushon rreth 4 000 ditë dhe sëmuret rreth 500 ditë. Gjatë kësaj kohe njeriu ha mbi 8 700 kg bukë, rreth 3 500 kg mish, mbi 2 000 kg vaj, vezë, peshk dhe pi afërsisht 30 000 litra ujë, qumësht, kafe etj.

KREU V

5. LEKSIKU I SHQIPES DHE PËRDORIMI I TIJ

Gjuha është një oqean i pafund, me pasuri të pashtershme. Mirëpo, aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie te njerëzit është e shumëllojshme. Llojet e veçanta të të folurit ose të shkruarit përbëjnë stilin gjuhësor.

Si gjuhët e tjera, ashtu edhe shqipja ka një pasuri fjalësh e shprehjesh, që përbëjnë leksikun e saj. Ne e përvetësojmë këtë pasuri pak nga pak nga jeta e përditshme, nga shkolla e puna, por edhe nga librat, shtypi e radiotelevizioni. Sa më shumë fjalë të dimë, aq më mirë e më lehtë do t'i shprehim mendimet tona.

Kërkesa më kryesore është të zgjedhim fjalët dhe t'i përdorim drejt ato

Si në komunikimin tonë të përditshëm, ashtu edhe në letërsinë artistike (në prozë e në poezi) përveç në kuptimin themelor, fjalët shpeshherë përdoren në kuptim të bartur, në kuptim figurativ. Kështu, kur themi: *frymë*, kuptojmë ajrin që e thithim dhe e nxjerrim. Ky është kuptimi themelor i kësaj fjale. Mirëpo, fjala *frymë* kur lidhet me fjalët e tjera merr edhe një varg domethëniesh të tjera, që kanë rëndësi të dorës së dytë në krahasim me kuptimin e parë. P.sh. kur themi: *erdhi me një frymë*, domethënë me vrap; ai është *si fryma* – shumë i shpejtë; *dha frymën e fundit* – vdiq; ishin mbledhur *frymë më frymë* – një mori njerëzish afër njëri-tjetrit në një vend; *fryma e kësaj vepre* – ideja themelore e saj; kjo kope ka *pesëqind frymë* – dhen; *doli fryma* – u çua era; bisedimet u zhvilluan *në frymën e miqësisë* – atmosferën; *fryma e Renesancës* – prirja themelore; kjo nuk është *në frymën* e gjuhës shqipe – është jonormative, e huaj, e papranueshme etj.

Kështu, duke u lidhur me fjalët e tjera, fjala *frymë* është përdorur kudo në kuptimin figurativ. Në shembujt e mësipërm, ajo ka marrë kuptimin e *vrapit*, *shpejtësisë*, *vdekjes*, *dendësisë së madhe*, *idesë themelore*, *deleve*, *erës*, *atmosferës*, *prirjes themelore* dhe *të normës gjuhësore*.

Shumëkuptimësia e fjalëve është dukuri e rëndësishme si për gjuhën e letërsisë artistike, ashtu edhe për pasurimin e gjuhës kombëtare në përgjithësi. Sikur të hiqeshin tropet, gjuha do të varfërohej shumë, meqë fjalët do të përdoreshin vetëm në kuptimin e tyre të parë. Duke e shfrytëzuar edhe thesarin e kuptimeve figurative, shtohet aftësia shprehëse e fjalëve, pasurohet fjalori dhe lëvrohet gjuha.

Si çdo gjuhë, ashtu edhe shqipja ka mundësi të pakufizuara të shprehjes figurative. Kështu, ne themi: fjalë *e ëmbël*, *e hidhët*, *e rëndë*, *e pamatur*, *e pahijshme*, *e qëlluar*, *me vend*, *me peshë*; mendje: *e hollë*, *e trashë*, *e mprehtë*, *e kthjellët*, *e ndritur* etj., thujse fjala ka shije, peshë a trajtë lëndore; thujse mendja është e hollë si fija e mëndafshit, e trashë si trupi i një lisi qindvjeçar, e mprehtë si tehu i shpatës, e kthjellët si qielli pa re dhe e ndritur si rrezet e diellit. Bukuria e gjuhës, thellësia kuptimore e shprehjes, krijimi i tablove, ngjallja e emocioneve te lexuesi etj. varen nga aftësia krijuese e shkrimtarit.


Burime të zakonshme të shprehësisë edhe për leksikun janë variantet, opozicionet, lidhjet sinonimike, denduria dhe shpërndarja e tyre. Fjalët që përdoren më dendur në organizimin e parë të gjuhës zakonisht janë edhe më të vjetrat, me më shumë kuptime e me tipare formimi të gjuhës së folur. Ato janë edhe më të shkurtra. Kjo ka rëndësi të madhe për shprehësinë. Lidhur me gjatësinë e fjalës (vëllimin fonetik), është përdëftuar se fjalët më të shkurtra shfrytëzohen për të dhënë shpejtësinë e veprimtimit, emocionin, për të ndërtuar fraza-surpriza etj. Anasjelltas, fjalët e gjata shprehin më mirë tonin solemn dhe tonin mendimtar.

Meqenëse në krijimtarinë letrare përshkruhet çdo fushë e veprimtarisë së njeriut, shkrimtari i shfrytëzon të gjitha burimet gjuhësore. Ai zgjedh materialin e nevojshëm gjuhësor për veprën e vet, pastaj i përvishet përpunimit të këtij materiali që t'i japë ngjyrë të veçantë estetike. Kujdes të veçantë i kushtohet *zgjedhjes* së fjalëve dhe të shprehjeve nga thesari i fjalësit të një gjuhe. Siç dihet, shkrimtari nuk krijon gjuhë të re, por veçantia e gjuhës së shkrimtarit qëndron në të zgjedhurit e atyre fjalëve dhe shprehjeve, të cilat pasqyrojnë në mënyrën më të saktë botën mendore dhe psikike të tij. Ai bën çmos të arrijë deri në atë shkallë saqë përshkrimet, pikurat dhe personazhet e tij të jenë të fytyrëzuara (plastike) dhe veprës letrare t'i japë gjallërinë (muzikalitetin) e duhur.

Duke u futur fjala në gjithë organizimin artistik të një vepre letrare, fiton një shprehësi të veçantë, d.m.th. bëhet **fjalë poetike** (poetizëm). Tërësia e fjalëve poetike përbëjnë **leksikun poetik** a **fjalorin poetik**.

Leksiku i shqipes është shumë i larmishëm, që mbështetet:

1. në bazën semantostilistike të fjalëve (sinonimisë, homonimisë dhe antonimisë),
2. në bazën e shtresimeve historike të fjalëve (arkaizmat, historizmat, neologjizmat),
3. në bazën e etimologjisë së fjalëve (fjalë të gurrës shqipe dhe të huaja: ndërkombëtarizmat, huazimet, barbarizmat),
4. në saje të laramanisë territoriale të gjuhës (dialektizmat, krahinorizmat) dhe
5. mbi bazën e shtresimit funksional e shoqëror (stilete e ndryshme të ligjërit, profesionalizmat etj.).



5.1. SINONIMET

Me qëllim që të shprehin nuanca të holla kuptimore dhe të arrijnë efekte stilistike, përdorim edhe sinonime. Sinonimet e pasurojnë gjuhën me nuanca kuptimore e me ngjyime emocionale, që mundësojnë të shprehemi më bukur e shprehjet të jenë më të fuqishme. Sa më shumë sinonime të ketë gjuha, aq më i pasur është leksiku i saj. Gjuha shqipe është mjaft e pasur me sinonime.

Në leksikologji dhe në semasiologji thuhet se fjalët që kanë kuptime të afërta apo të njëjta, por përbërje të ndryshme tingullore janë sinonime (gr. *sin+onoma* - i njëjti emër, emër i ngjashëm). Kështu, kemi dy, tri a më shumë fjalë që shënojnë të njëjtin send, të njëjtin tipar, të njëjtin veprim a të njëjtën dukuri, si *rrugë, udhë; krye, kokë; vajzë, vashë, cucë, gocë, çupë, çikë; argëtim, dëfrim, zbavitje; mjerim, skamje, varfëri, vobektësi; shqetësim, brengë, kokëçarje* etj.

Në ligjërim ka raste kur kuptimisht njëri sinonim mund të zëvendësohet me tjetrin, por ndonjëherë ky ndërrim nuk mund të bëhet, meqë sinonimet dallohen ndërmjet tyre:

- a) nga nuanca kuptimore (shikoj - vërej - vështroj, laps - kalem);
- b) nga ngjyrimi stilistik emocional (p.sh. fjala *mësues* ka kuptim asnjans, ndërsa *dhaskal* kuptim përbuzës, keqësues; si edhe *fytyrë - surrat, tregti - pazarllëk* etj.), dhe
- c) nga aftësia për të krijuar fjalë të reja (fjalë të përbëra – kompozita) dhe për t'u lidhur me fjalë të tjera në togfjalësha ose në njësi frazeologjike (p.sh. fjalë të tjera formon emri *kokë*, si *kokëderr, kokëmish, kokëtul, kokëmadh, kokë drejtuese, kokë me rëndësi* “i ditur” etj. dhe të tjera fjalë formon emri *krye: kryeqytet, kryeministër, kryeinxhinier, kryetar, kryesues, krye e librit, në krye të javës*. Pra, *kokë* dhe *krye* janë sinonime, por nuk e mbulojnë plotësisht njëri-tjetrin në përdorim (sepse nuk mund të thuhet *kokëqytet, kokëministër* etj.).

Sinonimet, vështruar si burim shprehësie, e japin mendimin me një hijezim tjetër kuptimor, për të dalluar anë më të holla ose për ta saktësuar përshkrimin. P.sh. në një lajm të shkurtër në gazetë, për të thënë se cilët ishin në një mbledhje ka disa mënyra sinonimike: (në

mbledhje) *ishin, merrnin pjesë, ishin të pranishëm, kishin ardhur, asistonin, ndodheshin, ishin ftuar* etj.

Përsëritja e dendur e po asaj fjale pa ndonjë synim ngjall përshtypje të pakëndshme, prandaj kjo shmanget nëpërmjet sinonimisë. Kështu, fjalët e fjalisë: *Karakteristika kryesore që karakterizon karakterin e njeriut ...* do të ishte e udhës të zëvendësohen me: *Tipari themelor që dallon karakterin e njeriut*. Në gjuhën e përditshme dhe shkencore zëvendësimet sinonimike janë çështje të kulturës gjuhësore. Këtë e shfrytëzojnë edhe shkrimtarët. Por, përgjithësisht në shkrimet letrare, përdorimi ose mospërdorimi i fjalëve të njëjta shikohet në aspektin stilistik. Për të arritur efektin e menduar, shkrimtarët mund t'i përsërisin fjalët, por mund të përdorin edhe trope. P.sh. pasi është dhënë një herë *harabeli*, rimarrja vetëm me përemrin *ai* është e pamjaftueshme, kështu që autori kalon më tej te: *zogu, shpendi i vogël* dhe më pas: *zemërdridhuri, i ngrati* etj. Tashmë nga sinonimet leksikore kalohet te sinonimia kontekstuale.

Në shqipen e shkruar fjalët me prejardhje nga dialektet, huazimet, kalket etj., që krijojnë sinonime, gjithashtu shfrytëzohen si mjete shprehëse: *Një gjel, kokosh a këndes / kur u zgjua në mëngjes; pa një dhaskal që shkante. / Mësonjës i mallëkuar ...* (Çajupi).

Një dukuri e shpeshtë në shqipen është prania e sinonimeve në togje, në çift, të cilat kanë rol përforcues: *shend e verë, një herë e një kohë, çikë e thërrime, u qorroftë e u verboftë, paç ymër e jetë, fuqi e kuvet, halle e derte* etj. Kjo dukuri solli përngjitjen e disa fjalëve ose formime të tjera, si *lakadredhë* (lak e dredhë), *turravrap* (turr e vrap), *rrip kaishi, insan njeri* etj. Edhe tek autorët tanë përdoren dendur çiftet sinonimike, si *vaj e gjamë, i mbaruem e i sosmë, kemi folë e ligjruem* (P. Budi); *digjem e përvëlohem, jam i gjallë e jam në jetë; lyer e ngjyer; janë të verbuar e s' shohin; kraharorë e kam shpuar – e kam bërë vrima-vrima* (Naimi).

Në vargëzimin e shkallëzuar përfshihen edhe sinonime kontekstuale: *Vrajini ata, prejini, bëjini copa-copa* (I. Kadare, “Ura me tri harqe”). *Psherëtiu, rënkoj, qau, vajtoj ...* (përkthim i Nolit, “Don Kishoti i Mançës”).

Nga vargjet sinonimike, autori synon të zgjedhë fjalën më të përshtatshme për të shprehur përkatësinë dialektore, profesionale, shoqërore e kulturore të personazheve.

5.2. HOMONIMET

Homonimet (gr. *homo* - i njëjtë dhe *onoma* - emër) janë fjalë me përbërje tingullore të njëjtë, por me kuptim të ndryshëm, si *zë* (zëri - emër, zënë - folje); *vesh* (vesh-i – emër dhe vesh rroba – folje), *verë* (pije dhe stinë) etj.


Në gjuhën shqipe homonimet janë të rralla, krahasuar, p.sh. me frëngjishten, ku janë të shpeshta. Në letërsinë shqipe homonimia rrallë është parë si burim shprehësie. Nga folklori kemi një gjëzë të tillë për breshkën: *Kudo vete, shtëpinë me vete*; ndonjë lojë fjalësh, si: *Pashë një pashë me një mjekër shtatë pashë të gjatë*; një shprehje humoristike: *Qe si qe, u bë si ka, si dhe në ndonjë këngë:*

*Testembeli qesh e lot,
Qesh e lot,
Ç'ke nuse, që qan me lot,
Qan me lot?*

Çajupi e ka përdorur homoniminë, me sa duket nën ndikimin e modeleve të frëngjishtes:

Dhe në sis' e kisha

Kur erdhe nga kisha. (Katërbëdhjetë vjeç dhëndër)
Tekdo që vete,
thotë me vete. (Dhelpra dhe një shtat)



5.3. ANTONIMET

Antonimet (gr. *anti* - kundër, *onoma* - emër) janë fjalë të ndryshme me kuptim të kundërt, si emra: *gëzim* - *hidhërim*, *dritë* - *errësirë*, *ditë* - *natë*, *rini* - *pleqëri*; folje: *blej* - *shes*, *marr* - *jap*, *këndoj* - *vajtoj*; mbiemra: *i ri* - *plak*, *i mirë* - *i keq*, *i pastër* - *i fëlliqur*; ndajfolje: *afër* - *larg*, *këtu* - *atje*, *lart* - *poshtë* etj.

Si fjalët e tjera, ashtu edhe antonimet kanë një përdorim të gjerë, si në komunikimin e përditshëm, ashtu edhe në stilin letrar: me anën e tyre theksohet më tepër kundërvënien ndërmjet dukurive të ndryshme dhe i japin gjuhës gjallëri të veçantë. Kështu, kuptimi i fjalës *i ri* del më qartë në kundërvënien me kuptimin e fjalës *i vjetër*, kuptimi i fjalës *poshtë* kundrejt kuptimit të fjalës *lart*, ai i fjalës *ngrihem* kundrejt kuptimit të fjalës *ulem* etj.

Antonimet përdoren mjaft në urtitë popullore (fjalët e urta), si *Bëj mirë e harro, bëj keq e kujto. E keqja të shqyen, e mira të arnon. Ku s'hyn i miri, hyn i keqi* etj.

Antonimet në gjuhën shqipe janë dy llojesh:

a) antonime ndërmjet fjalësh krejt të ndryshme, si *jashtë* - *brenda*, *ngjitem* - *zbres*, *hap* - *mbyll*, *lirë* - *shtrenjtë*; dhe

b) antonime që lindin gjatë formimit të fjalëve me parashtesa me kuptim të kundërt: *anti-*, *ç-*, (*sh-*, *zh-*), *s-* (*z-*), *kundër-*, *mos-*, *pa-*, *jo-*. Këto fjalë kanë burim të përbashkët nga prejardhja, p.sh. *fashist* - *antifashist*, *lodhem* - *çlodhem*, *fuqizoj* - *shfuqizoj*, *dredh* - *zhdredh*, *kamje* - *skamje*, *sulm* - *kundërsulm*, *marrëveshje* - *mosmarrëveshje*, *i ditur* - *i paditur*, *i aftë* - *i paaftë*, *zyrtar* - *jozyrtar* etj. Përveç këtyre, ka antonime me temë të njëjtë, por me parashtesa të ndryshme, të tipit *mbishtresë* - *nënshtrësë*, *mbiçmoj* - *nënçmoj*, *paraardhës* - *pasardhës* etj.

Fjalët antonime krijojnë çifte në shkallë të ndryshme kundërvënies, për shkak të fjalëformimit mjaft të zhvilluar të shqipes, p.sh. *i pastër* - *i papastër*, *i fëlliqur*; *i rregullt* - *i parregullt*, *i çrregullt*; *i qepur* - *i paqepur*, *i shqepur* etj. Kur duam të zbusim tonin e ligjërit, përdorim formimet me *pa-*, *mos-*; ndërsa antonimet ndërmjet fjalëve krejtësisht të ndryshme janë më të fuqishme.

Për të krijuar kundërvënien kuptimesh të figurshme, përveç antonimeve të mirëfillta (që nuk varet nga konteksti: *dimër* - *pranverë*, *djalëri* - *pleqëri*), ndonjëherë përdoren edhe antonime *kontekstore*, që realizohet vetëm brenda një konteksti (*gaz* - *shkretëtirë*, *bukur* - *zi*), si p.sh.:

Sheh *gasn'* e pritme për *djalërinë*
Dhe *shkretëtirën* për *pleqërinë*,
Atje sa *bukur*, këtu sa *zi*,
O Moisi,
Këtej ka *dimrin*, andej *pranverën* ... (F. Noli)

Figura stilistike në të cilën bashkohen dy kuptime të kundërta që paraqesin një tërësi, në dukje të parë logjike, por kontradiktore në vetvete quhet *oksimoron*. (gr. *oksi* - i mprehtë dhe *moros* - budalla; budallallëk i mprehtë), si p.sh. *zë i heshtur, kufomë e gjallë, gëzim i hidhur, pleqëri rinore* etj. Kjo pak është shfrytëzuar në letërsinë shqiptare. I pari në shkrimet shqipe që ka përdorur oksimoronin është F. Konica. Këtë figurë e ka përdorur bashkë me disa stilema të tjera: Këto tru të pazhvilluara *çiliminjsh pleq; një lartësi e përlulur* etj. Në gazetari: Ne kemi shënuar *zenitin e rënies Qetësia shurdhon.... E ardhmja e së kaluarës. Çorganizim i organizuar; qetësitë e shqetësuar* (T. Laço, “Të gjithë lumenjtë rrjedhin”).

5.4. ARKAIZMAT

Arkaizmat (gr. *archaios* - i vjetër, i moçëm; që i përket një kohe të lashtë) janë fjalët e moçme që janë përdorur dikur; ndërsa sot, ose përdoren shumë rrallë te brezi i vjetër, ose kanë dalë fare nga përdorimi. Siç dihet, në rrjedhë të kohës disa fjalë kalojnë nga shtresa aktive (nga leksiku i sotëm: fjalë që njihen mirë e përdoren shpesh në jetën e përditshme nga të gjithë) në shtresën pasive të leksikut (në leksik të vjetruar: fjalë që nuk njihen më dhe përdoren rrallë). Fjalët vjetrohen dhe dalin nga përdorimi, për shkak se ose (a) zëvendësohen me fjalë të reja për të emërtuar po ato sende a dukuri, ose (b) dalin nga përdorimi sendet bashkë me emërtimet e tyre.

Të moçme janë disa fjalë që janë shkruar në veprat e autorëve të vjetër, por sot nuk i përdorim më: *ager* (gomar), *përmjellet* (përmiellet, përmillet, zbardhet), *përderës* (lypës), *hijezë* (ombrellë), *ujanë* (oqean), *regjëni* (mbretëri), *regjënoj* (mbretëroj), *gjellë* (jetë), *fëdigë* (mundim), *fëje* (gabo) etj. Edhe historizmat janë fjalë të vjetruara, që kanë dalë nga përdorimi, por që lidhen me një periudhë të caktuar historike të njohur për ne, si *kajmekam* (zëvendësprefekt, *grosh* (monedhë), *breshanë* (pushkë), *kaza* (njësi administrative), *bekçi* (rojtari fshati); *kobure*, *topuz*, *shishane* (emra armësh që janë përdorur dikur) etj.

Rëndom, fjalët e vjetruara nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës së sotme standarde, por në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta. Arkaizmat, si historizmat e dialektizmat, përdoren nga shkrimtarët për të arritur efekt shprehës, për të dhënë atmosferën historike, koloritin e mjedisit dhe për karakterizimin e gjuhës së personazheve. Kjo vërehet sidomos në romane historike, si te “Skënderbeu” e “Ali Pashë Tepelena” të S. Godos, “Kolorësi i Skënderbeut” i H. Stërmillit, “Kështjella” e I. Kadaresë, “Muret e Krujës” i Gj. Zhejit etj.

Kjo shtresë e vjetruar e leksikut të gjuhës shqipe shfrytëzohet sidomos për të sjellë tonin solemn ose të rëndë, pikërisht sepse këto mjete vijnë jo nga përdorimi i gjallë, por nga një kulturë e lashtë, bartin atmosferën e një kultivimi të ngurtësuar si lapidar, madje dhe nga një përfytyrim i mitologjizuar prej largësisë së kohës. I. Kadare e jep këtë ide poetikisht:

*Nga kaosi i gërmadhave,
që koha pas e la,
u ngrit e na erdhi
kjo fjalë: Embëtha!*

5.5. NEOLOGJIZMAT

Neologjizmat (gr. *neos* - e re, *logos* - fjalë; fjalë e re) janë fjalë dhe shprehje të reja, që sapo kanë filluar të përdoren në gjuhën letrare. Për një kohë fjalët e tilla janë të reja, ndërsa me kalimin e kohës ato bëhen pjesë e fondit aktiv të fjalorit.

Fjalët e reja krijohen për të përmbushur nevojat e reja të shoqërisë, shkencës e kulturës në përgjithësi, për t'i zëvendësuar arkaizmat, ndërkombëtarizmat e huazimet e panevojshme; pra gjuha kombëtare, më me shpejtësi të madhe leksiku, zhvillohet e pasurohet për të pasqyruar zhvillimin e gjithëmbarshtëm të një kombi. Fjalë të reja, në shqipen janë, p.sh. *bashkëbisedim* (ka zëvendësuar fjalën dialog), *drejtshkrim* (në vend të ortografi), *drejtshqiptim* (në vend të ortoepi), *bashkëjetesë* (koekzistencë), *përngjashmim* (asimilim), *vetëdije* (koshiençë), *cilësi* (kualitet), *sasi* (kuantitet), *përmasë* (proporcion), *risi* (novitet) etj.

Pasurimin e fjalorit me fjalë të reja e kërkon edhe zhvillimi i pandërprerë i industrisë, i bujqësisë, i teknikës dhe i të gjitha degëve shkencore. Fjalët e reja formohen kryesisht me parashtesa e prapashtesa, me anë të përbërjes e të përngjijtes së dy a më shumë fjalëve, si p.sh. *mbifitim*, *mbikalim*, *nënlëkurë*, *përçues*, *ujësjellës*, *vajgursjellës*, *paradhomë*, *furnnaltë* etj.

Neologjizmat mund t'i grupojmë duke i parë (a) nga përbërja dhe (b) nga burimi. Nga përbërja kemi **neologjizma fjalësh**, d.m.th. fjalë të reja si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja, p.sh. *njësit*, *atdhetar*, *lejekalim*, *tejkalim* etj.; **neologjizma kuptimesh**, d.m.th. fjalë të njohura që më parë, po që tashti kanë një kuptim të ri. Kjo lidhet me shumëkuptimësinë e fjalëve, p.sh. *çerdhe* fjalësh, *brez* gjeografik, *shtresë* shoqërore, *vendos* (marr vendim) etj. Për nga burimi dallojmë neologjizma që krijohen **nga populli** dhe neologjizma që krijohen **nga autorë** të veçantë për arsye stilistike.

Letërsia artistike ka qenë e prirur të ruajë pastërtinë e leksikut dhe ta pasurojë atë me krijime të reja fjalësh e kuptimesh. Neologjizmat stilistikë ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë ose edhe duke u shmangur prej tyre. P.sh. *-logji* shërben si pjesë e dytë e fjalëve që shënojnë një dije (si, biologji, gjeologji). Modeli atëherë kërkon që pjesa e parë të shënojë një fushë studimi. Shkelja e kësaj kërkese përfiton ndërtime tallëse: *barkologji*, *llafologji* (P. N. Luarasi). Me të njëjtën shmangie janë formimet: *karrikomania*, *rezervomania*, *depomania*, *traktoromania*, *kolltukomania* etj., duke pasur pjesë të dytë *-mania*, e cila rregullisht shënon një prirje të sëmurë dhe nuk duhej të lidhej me emra konkretë si këta. Kjo rrugë shfrytëzohet gjerësisht si në jetën e përditshme, edhe në letërsi e publicistikë, si *sherrxhinj*, *belakërkonjës*, *këmbëngulje kokëmushkore*, dështuan në *daljefaqebardhësinë* e tyre etj.

Neologjizmat mund të shërbejnë edhe si njëri nga treguesit e stilit të autorit ose të drejtimit. L. Poradeci, p.sh. ka disa kompozita poetike prej tri pjesësh: *leshëra-cullufe-dredhur*, *shtat-lëkundura-pallua*, që zbulojnë një ndikim nga gjermanishtja.

Gjatë punës së vet krijuese, shkrimtarët farkojnë një varg fjalësh të reja. Ata shquhen për fjalëkrijime. Disa nga to janë pranuar dhe janë bërë pronë e gjuhës së përgjithshme kombëtare, ndërsa disa kanë mbetur vetëm pronë e gjuhës së vetë autorit. Rilindësit tanë bënë një punë të madhe për pasurimin dhe pastërtinë e gjuhës shqipe. Shumë fjalë të krijuara që atëherë përdoren edhe sot; p.sh. N. Veqilharxhi: *fletore* etj.; K. Kristoforidhi: *kryeqytet*, *bukëpjekës*, *ndërgjegje*, *udhëheqës* etj.; Naimi: *cilësi*, *sasi*, *gjithësi*, *vetëdije* etj.; nga Samiu kemi terminologjinë gjuhësore: *rrokje*, *nyjë*, *mbiemër*, *presje*, *folje* etj.; nga J. Vretoja kemi terme të matematikës e fjalë të tjera: *mbledhje*, *zbritje*, *mëmëdhe* etj.

Shkrimtari që ka sjellë numrin më të madh të neologjizmave me funksione artistike është, pa dyshim, Ismail Kadareja. Për ta dëshmuar këtë, stilisti i njohur shqiptar Xhevat Lloshi në veprën studimore “Stilistika e pragmatika” ka sjellë afër 50 shembuj, si *borëtar, darkëtar, dyshimtar, kanuntar, qelqëri, mosfjetje, mospjellje, penglënës, kryeëndërr, kundërrjedhë, floknajë* etj.

Fjalët e reja ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare. Ato nuk hyjnë menjëherë në leksikun e gjuhës standarde. Më parë ato fitojnë, si të thuash, “qytëtarinë” në leksikun e gjuhës shqipe, pastaj me kohë, sipas vlerës që kanë, mund të bëhen pronë e gjuhës së sotme shqipe. Gjithashtu, neologjizmat nuk bëjnë përmbysje a kthesë të përnjëhershme në gjuhë, po një zhvillim të natyrshëm e të shkallëshkallshëm, sepse përndryshe, brezat njerëzorë s’do të merreshin vesh ndërmjet tyre.

5.6. KRAHINORIZMAT

Krahinorizmat (provincializmat < lat. *provincialis* - krahinor). Një burim tjetër i gjuhës së shkrimtarit janë të folmet popullore, me larushitë leksikore, fonetiko-fonologjike e gramatikore. Leksiku dialektor është i lidhur me një territor të caktuar, dialekt, nëndialekt, grup të folmesh, krahinë a të folme. Varësisht nga shtrirja gjeografike e fjalëve, shprehjeve a ndonjë dukurie që është karakteristike për të folmen e një vendi, emërtohen si *dialektizma*, d.m.th. fjalë që përdoren vetëm në një dialekt (për këtë shih në leksionin Dallimet ndërmjet dialekteve në fushë të leksikut) e *krahinorizma* - fjalë që janë tipike për një krahinë.

Pjesa më e madhe e fjalëve dialektore e krahinore në shqipen janë të përbashkëta, por dallime më të mëdha hetohen në variantet fonetike të të njëjtës fjalë, të tipit *borë, bor, vdorë, xborë, zborë; shtëpi, shpi, shpaj/shpoj/shpëj; lëshoj, lshoj, shloj; fëmijë, fmi, fmaj; syri, syni, sajni; punoja, punonja, punojsha, punojshna* etj. Përveç këtyre, ka edhe fjalë e dukuri gjuhësore që përdoren vetëm në një krahinë e nuk janë të përhapura nëpër trevat e tjera të shqipes.

Fjalë dialektore ose krahinore janë ato fjalë që përdoren vetëm në njërin dialekt, në një krahinë a të folme të caktuar, që nuk përdoren në dialektin, në krahinën a në ndonjë të folme tjetër, si p.sh. *korube* “zgjua bletësh”, *bodile* “shishe”, *bonjak* “jetim”, *dybek* “tundës”, *mëmëzote* “nëna e nënës”, *branë* “lesë”, *dac* “maçok”, *fultere* “tigan”, *kollomboq* “misër”, *korit* “turpëroj”, *kundër* “këpucë”, *thi* “derr”, *varrë* “plagë”, *nadje* “mëngjes”, *ain* “shqiponjë”, *athun* “kot”, *cinora* “qepalla”, *ninëza* “bebja e syrit”, *haidi* “lavdi”, *xhit* “çka”, *dixhit* “diçka” etj.

Shumë fjalë dialektore e krahinore kanë ngelur jashtë kufijve të gjuhës së njësuar e të përbashkët letrare, por ato janë pjesë e thesarit të gjuhës kombëtare. Ky fond i pasur i leksikut dialektor e krahinor është burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes standarde dhe për zëvendësimin e fjalëve të huaja. Kështu, janë përgjithësuar e janë bërë pronë e gjuhës letrare fjalët me burim krahinor, si *i aftë, anije, banoj, fli, gërvisht, gogël, i imët, jehonë, luginë, ndoshta, këqyr, vonë, i vrazhdët* etj.

Do përmendur se para formimit të gjuhës së njësuar letrare (në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 1972) pothuajse të gjitha veprat e shkrimtarëve tanë janë shkruar në gjuhën dialektore a krahinore, shpeshherë me përpjekje për një gjuhë mbidialektore a mbikrahinore.

MIKEL NDRECA

FJALOR
FJALËSH E
SHPREHJESH TË
HUAJA

Rilindja

Por, edhe pas formimit të gjuhës standarde shqipe, përdorimi i fjalëve dialektore e krahinore në letërsinë artistike është i lejueshëm: asaj i jep një ngjyrim popullor, bisedor. Fjalë të këtilla gjejmë edhe në shumë vepra të shkrimtarëve bashkëkohorë (si te veprat e Gj. Fishtës, L. Poradecit, J. Xoxës, M. Kutelit, D. Agollit e të shumë shkrimtarëve të tjerë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, në diasporë etj.).

Krahinorizmat janë mjete me prejardhje nga gjuha popullore e një vendi, por në një tekst letrar përfshihen për qëllime stilistike. Ato shpesh i përdorin shkrimtarët për tipizimin e gjuhës së personazheve dhe për karakterizimin e mjedisëve përkatëse në veprat letrare. Funkcionet që marrin krahinorizmat janë jo të pakta: për përshkrimin e peizazhit të fshatit ose të qyteteve të tjera, për riprodhimin e mjedisit, jetës familjare, për individualizimin ose tipizimin e personazhit (sepse shkrimtari e lidh personazhin për një të folme a krahinë, për një grup shoqëror, profesional ose kulturor) si dhe për efekte lirike a komike. Në prozën e M. Kutelit, p.sh. krahinorizmat janë përdorur për të arritur efekte të dyskajshme: si (a) shfaqje e një gjuhe pa prestigj, inferiore që pasqyron mungesën e zhvillimit, për të dhënë humor e satirë, dhe në skajin tjetër, (b) për të shprehur dinjitetin e jetës popullore, të banorëve të lashtë, të vlerave folklorike e burimore.

5.7. HUAZIMET

Përveç fjalëve të gurrës vetjake a vendëse (përfshirë këtu edhe rreth dy mijë fjalë të shqipes me origjinë indoevropiane, si *kokë, ditë, natë, dimër, ujë, ha, pi, jam, kam, zog, dem, elb* etj.), të cilat mbizotërojnë, në gjuhën shqipe ka edhe disa fjalë me prejardhje nga gjuhë të huaja. Fjalët që i ka marrë shqipja gjatë shekujve nga gjuhët e tjera quhen fjalë të huazuara ose **huazime**. Nuk ka gjuhë në botë që nuk ka huazuar fjalë prej gjuhëve të tjera, ndonëse dallohen për sasinë e tyre. Huazimet janë rezultat i kontakteve dhe marrëdhënieve të përhershme ekonomike, politike, kulturore etj. me pushtuesit si dhe me popujt fqinj. Kështu, në gjuhën shqipe kemi huazime latine, greke, turke, sllave, frënge, italiane etj.

Dihet se për shkak të sundimit të dikurshëm pesëshkullor të perandorisë romake e më vonë të asaj turke, edhe në tokat iliro-shqiptare, në gjuhën shqipe kemi huazime latine, si *qen* (kanis), *kalë* (kaballus), *gjel* (gallus), *këndoj* (cantare), *mjek* (medicus), *qytet* (civitatem), *pushtet* (potestatem) etj.; orientalizma (fjalë me burim nga turqishtja, persishtja, arabishtja; të cilat meqë në shqipen kanë depërtuar nëpërmjet turqishtes, shpeshherë quhen turqizma): *bori, daulle, dyfek, fitil, çarçaf, hambar, sahat, pazar, hendek, bilbil, xhep, tepsi, penxhere, aksham, gajle* etj. Në leksikun e shqipes ke edhe fjalë të burimit grek: *lakër, presh, qershi, trëndafil, pjepër* etj.; të burimit sllav: *kockë, grusht, memec, strehë, prag, oborr, kyç, kovë, lopatë, mace, kovaç, çekiç, pushkë, fllad, plaçkë, prashit, kosit, çudit* etj.; fjalë nga frëngjishtja: *dosje, burokrat, byro, adresë, broshurë, shofer, bluzë, pallto, ekip, etapë, turne* etj.; fjalë nga italishtja: *bankë, karrocë, barkë, vapor, timon, velë, marinar, kushton, fitoj, paguaj* etj. Huazimet e vonshme nga greqishtja e re dhe nga gjuhët sllave ndihen si krahinorizma të Shqipërisë Jugore, përkatësisht të shqipes verilindore e të Maqedonisë.

Përveç këtyre, në fjalorin e gjuhës shqipe kanë hyrë edhe disa fjalë që përdoren në shumicën e gjuhëve në fusha të ndryshme të shkencave teknike, të kulturës, të artit, të fushës politike e shoqërore etj., si *mekanikë, optikë, fonetikë, biologji, anatomi, gramatikë, radio,*

traktor, telegraf, telefon, revolucion, kushtetutë, parti, klasë, demokraci, roman, dramë, portret, peizazh, balet, skenë, teatër, shumica e emrave të figurave stilistike etj. Këto janë fjalë ndërkombëtare apo **ndërkombëtarizma** (internacionalizma), kryesisht me prejardhje nga greqishtja dhe latinishtja, por edhe nga italishtja, frëngjishtja, anglishtja e gjuhë të tjera. Ndërkombëtarizmat, si edhe një pjesë e madhe e latinizmave, greqizmeve, por edhe disa orientalizma, sllavizma, italianizma etj. janë mishëruar aq shumë me leksikun e shqipes, sa që vështirë se mund të zëvendësohen me fjalë anase.

Është e vërtetë që shqipja ka pësuar ndikime nga gjuhët e huaja, sidomos në leksik, por huazimet i ka përshtatur dhe ndryshuar sipas natyrës së vet, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj. Edhe përkrah ndikimeve të huaja në rrjedhë të kohës, gjuha shqipe ka ruajtur mëvetësinë e saj, si gjuhë e lashtë indoevropiane, me strukturë fonetike, gramatikore e leksikore të veçantë.

Në parim, edhe për huazimet, ashtu si për barbarizmat, **shkrimtarët** përgjithësisht kanë mbajtur qëndrim të drejtë: **kanë përkrahur pastërtinë e gjuhës**. Për stilistikën huazimet kanë vlera shprehëse, edhe pse hetohet se janë diçka e huaj kundrejt brumit të shqipes ose tekstit rrethues shqip. Kur jepen personazhe që flasin një gjuhë të huaj, autorët japin jo vetëm huazime, por edhe citime të drejtpërdrejta të gjuhës së personazhit. Kjo bëhet për të përshkruar mjedisin e huaj ose për vërtetësi të të folurit, përkatësisht për individualizimin e gjuhës së personazhit.

Nga huazimet, vend të veçantë në letërsinë artistike shqiptare zënë **orientalizmat**. Sundimi pesëshekullor i perandorisë Osmane ka lënë gjurmë të thella në shtresat popullore, si në veshje, zakone, gatime, muzikë etj., rrjedhimisht edhe terminologjinë e tyre. Meqë sfera më e gjerë për orientalizmat është gjuha bisedore dhe ligjërimi i shkujdesur, kur shkrimtarët shtjellojnë tema nga perioda e sundimit turk, personazhe të shtresave popullore, jetën e gjuhën e njerëzve të pashkolluar etj., duke e pasqyruar këtë, gjithsesi nuk mund t'u shmangen përdorimit të orientalizmeve, të cilat gjejnë vend sidomos në shkrimet historike, humoristike e satirike. Si shembull po sjellim disa vargje nga vjersha e F. Nolit "Kënga e Salep-Sulltanit":

*Një mexhli të madh na çeli
Pandeli Janko Vangjeli,
Me sulltan-llokum na veli
Si kofini pas të vjeli.*

*Koço Kota mjek hanxhari
Nis një valle palikari,
Se me një ferman kusari
Sadrazem u bë firari.
Se ç'u shporr xhumhurieti,
Se ç'u rehatos mileti,
Se Sulltanin prapë e gjeti.
Se, që kur e humbi, s'fjeti!.*

Disa orientalizma shkrimtarët i përdorin për të sajuar çifte sinonimike: *fukara* - *i varfër*, *aksham* - *mbrëmje*, *mëhallë* - *lagje*, *sabah* - *mëngjes*, *aferim* - *të lumtë*, *bahqe* - *kopsht*, *bajagi* - *mjaft*, *behar* - *pranverë*, *avash* - *ngadalë*, *sahat* - *orë*, *sakat* - *i gjymtë* etj.

5.8. BARBARIZMAT

Barbarizmat (gr. *barbaros* - i huaj) janë fjalë të huaja që nuk përkojnë me normën standarde. Të tilla janë fjalët *mister, senjor, senjorita, tet a tet, vizavi*; sllavizmat: *brazdë, kral, llovaçkë, grejalicë, gollman, strujë, potvërdë, okolla, apet (opet)* etj.; orientalizmat: *aksham, asker, azgan, badihava, begenis, çarshi, çoban, dost, gajle, haber, hyzmeqar, kollaj, sabah, sebeb, tuxhar, vakt* etj.

Elemente të huaja gjejmë në çdo gjuhë. Ato përhapen nëpërmjet ndikimit që ushtrojnë gjuhët mbi njëra-tjetrën. Fqinjësia shumëshekullore, bashkëjetesa e përzjerjet etnike të popujve në një mjedis janë kushtet themelore për përhapjen e barbarizmave. Popujt me gjuhët e tyre që kanë pasur epërsi politike, ekonomike, kulturore etj. kanë ndikuar shumë më tepër në gjuhët e popujve të tjerë.

Duhet dalluar huazimet leksikore nga barbarizmat. Thjesht, edhe huazimet edhe barbarizmat janë pasojë e ndikimeve të huaja gjuhësore. Parimisht, sa më pak fjalë të huaja të përdorim, do të ishte aq më mirë. Por, *disa fjalë të huaja* (si ndërkombëtarizmat, fjalët që kanë hyrë herët në shqipen, që kanë përdorim të gjerë territorial, janë përgjithësuar dhe tani më janë mishëruar me fjalët e brumit të shqipes, janë bërë prodhimtare dhe me vështirësi mund të hiqen nga përdorimi) *janë të lejueshme*, ndërsa **barbarizmat** (për të cilat shqipja ka fjalë anase, që mund të zëvendësohen lehtë me fjalë të shqipes) **janë të palejueshme**.

Parimisht, sa më pak fjalë të huaja të përdorim, do të ishte aq më mirë. Çdo popull përpiqet t'u vejë ndikimeve të huaja njëfarë ledhi, në mënyrë që **të ruhet pastërtia e gjuhës kombëtare**. Ata që luftojnë për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës së tyre quhen *puristë*. Një fushatë të tillë kanë zhvilluar shkrimtarët tanë të Rilindjes, si Kristoforidhi, Samiu, Naimi e shumë të tjerë. Tradita e tyre vazhdon edhe sot.

Barbarizmat mund të përdoren në letërsinë artistike që të jepet një ngjyrë tipike e mjedisit, të pasqyrohet një atmosferë e posaçme në të cilin veprojnë personazhet, t'i përafrohet lexuesit një kohë specifike e historisë. Shpeshherë barbarizmat mund të përdoren edhe për të ironizuar ngjarje, personazhe, rend shoqëror etj. Me përjashtim të letërsisë, **përdorimi i barbarizmave në fusha të tjera është i papranueshëm**.

Shkrimtarët shqiptarë përgjithësisht e kanë mbështetur pastërtinë e gjuhës dhe fuqishëm e kanë kundërshtuar përdorimin e panevojshëm të barbarizmave. Shumë prej tyre, përveç në shkrime letrare, kanë dhënë ndihmesë të madhe edhe në jetën e përditshme, në shkrime publicistike etj. Vlerësimin e shqipes si gjuhë e bukur, e përpunuar, e pastër, por që domosdo duhet të ruhet e kultivohet, e kanë dhënë shkrimtarët:

*Kur flet shqyp, asht çud' m'e ndi,
gjysëpërgjysë tue e perzi me fjalë t'gjuhve t'hueja!
Thotë: me thanë la veritá,
ktu në Shkodër sot diçka janë civilizuemun
La goiventù ka studiue,
di me folë, me ragionue.*

(F. Shiroka, *Si po prishet gjuha shqype?*)

Pyetje dhe detyra:

1. Nga fjalët e dhëna, gjeni sinonimet: *i vjetër, flas, vështroj, armik, i lashtë, bishë, egërsoj, plak, vëzhgoj, hajvan, i pashëm, ashpërsoj, kuvendoj, i hijshëm, shtazë, acaroj, i bukur, bisedoj, simpatik, gjë, kafshë, shikoj, i moçëm, ligjëroj.*

2. Shpjegoni kuptimin e homonimeve: *dhe – dhe, ka – ka, kisha – kisha.*

3. Dalloni antonimet në një strofë të vjershës “Syrgjyn vdekur” të F. Nolit:

*Se të deshte dhe s’ të deshnin,
Se të qante kur të qeshnin,
Se të veshte kur të zhveshnin,
Nëno, moj, të ra dëshmor.*

4. Gjeni fjalët e vjetruara në këtë copë të nxjerrë nga romani “Kështjella” e I. Kadaresë:

“Që këtë dukeshin flamurët e bardhë si dëbora të jeniçerëve dhe kazani i tyre prej bakri që po e lidhnin në një pemë të madhe. Akëxhinjtë po çonin kuajt për të pirë ujë te lumi i vogël. Tutje, si një mizëri pa fund, zbardhnin çadrat e azapëve. Pas tyre vinte moria e çadrave të eshkyxhinjve dhe pastaj vinin me radhë çadrat e dallkëllëçëve, të sendergjeshblerëve, të ushtarëve myselenë, çadrat e bukura të spahinjve ...”.

5. Përpiquni të krijoni ndonjë fjalë të re dhe shpjegojeni arsyeshmërinë e tyre!

6. Dalloni krahinorizmat në disa pjesë të shkëputura nga letërsia artistike e ligjërimit dialektor të personazheve:

Oda ishte tejpërtej me njerëz. I shkruajtëm një kartë në kurbet e aj na thotë se është gjallë... Ishim njo dhet çobanë bashkë, i shlojmë berret pa hongër bukë. Kur vjen uku, mue ma varroi nji delme, njonit i çarti tremdhet, mue sall nji ... Mendova një herë me vete ta hiqja branë nëpër odë, po u mbajta, se do të patakseshin gratë e çiliminjtë. Desha s’desha, hodha gunën në kokë e u kumbisa për çimentoje... Na Markolajt tjetër nafakë nuk kemi ... Shuej, moj, se po kujtojn robt se njimend çika vdiq!...

7. Gjeni barbarizmat stilistikë në këtë strofë nga “Marshi i Barabbajt” i Fan Nolit:

*Allalla, o rezil e katil, allalla,
Shtroni udhën me hithr’e me shtok trufanda
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,
Lehni, laro, kaba, Hosanna, Barabba!*

5.9. FRAZELOGJIZMAT

Fjalët përdoren zakonisht jo të veçuara, por të lidhura me të tjerat. Lidhjet e tyre përcaktohen në bazë të lidhjes së gjërave siç paraqiten në realitet dhe të logjikës. Mund të thuhet, p.sh. *dru molle, dru i fortë; pres dru, djeg dru* etj., por jo *dru libri, dru i qelqtë; shkruaj dru* etj. sepse biem ndesh me realitetin e logjikën, edhe pse gramatikisht këto lidhje janë të rregullta. Pra, çdo fjalë mund të lidhet me një varg fjalësh të tjera, ka një fushë semantiko-sintaksore të gjerë dhe formohen kështu togfjalësha të ndryshëm.

Një pjesë e lidhjes së fjalëve në togje krijohen në çastin kur flasim ose kur shkruajmë, ndërtohen me lidhje të lira aty për aty gjatë ligjërimin, prandaj edhe quhen *togfjalësha të lirë*, si *lule fushe, dega e lisit, bukë gruri; rrugë e gjerë, tokë e fortë; lexoj librin, ndërtoj një shtëpi; flas haptas, shkruaj* bukur etj. Pa dyshim, këta togfjalësha nuk i përdorim veç e veç, por të lidhur në njësi më të madhe gjuhësore, në fjali e fjalitë në periudha.

Përveç këtyre togfjalëshave të lirë, në gjuhë ka edhe **togfjalësha të qëndrueshëm**, që nuk formohen në çastin e ligjërimin, po janë ndërtuar historikisht, janë bërë të pazbërthueshëm dhe përdoren si njësi e gatshme, njësoj si fjalët. Të tillë janë *të zitë e ullirit, var hundët, ha dru, i hurit e i litarit, shkel e shko, ngre krye, e merr nëpër këmbë, e merr me mend* etj. Këto shprehje quhen **njësi frazeologjike** ose **frazeologjizma**.

Njësitë frazeologjike. - Njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë quajtëse (shënjuese, kuptimplota, fjalë emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme. Gjithë togfjalëshat e këtij lloji në gjuhën tonë përbëjnë frazeologjinë shqipe.

Elementet përbërëse të njësive frazeologjike e humbin pavarësinë kuptimore, kështu që kuptimi i frazeologjisë nuk del nga shuma e kuptimit të fjalëve, por nga shkrirja e tyre në një kuptim figurativ tërësor. Shumë njësi frazeologjike janë të barasvlershme me një fjalë të vetme, por kanë figurshmëri më të fuqishme, si p.sh. *zë besë* (besoj), *vë re* (vërej), *marr vesh* (kuptoj); *U bënë pikë e pesë* (u shpërndanë). *Nuk bën pesë para* (fare s'vlen); *Mori dheun. Nga sytë, këmbët* (u arratis). *Punon nën dhe* (në fshehtësi të madhe). *I tregoi derën* (e përzuri). *Nuk e zë dera* (është trashur shumë) etj.

Struktura dhe vlera e madhe shprehëse e frazeologjizmave. - Njësitë apo shprehjet frazeologjike për nga modelimi strukturor përbëhen prej fjalëve shënjuese (emra, mbiemra, folje, ndajfolje, numërorë e përemra) dhe fjalëve shërbyese (parafjalë, lidhëza, pjesëza).


Një numër i vogël përbëhen prej një gjymtyrë: flet *në tym* (kot), punon *pas shpine* (tinëzisht); por shumica kanë strukturë dygjymtyrëshe, të cilat mund të jenë dy emra: *kockë e lëkurë, udhë e pa udhë, me mish e me shpirt*, (si) *mali me borë*; një emër dhe një mbiemër: *punë e madhe, përshkrim i gjallë*; dy folje (*dha e mori, shkel e shko, hyn e del, thur e shthur*); një folje + një emër: *lëshoj pe, ia dal në krye, m'u mbush mendja, heq dorë, e mori në qafë, i doli boja*; prej shumë gjymtyrësh, si (folje + emër + emër): *s'ka sy e faqe, e ka halë në sy*; (emër + mbiemër + emër): *vrima e fundit e kavallit* etj., dhe njësi frazeologjike më shumë se tri gjymtyrë ose me strukturë fjalie: *Ha bukën e përmbys kupën. Ia vuri të dy këmbët në një këpucë. I lirë në miell e i shtrenjtë në krunde. Ku rafsha mos u vrafsha.*

Sikurse fjalët, edhe njësitë frazeologjike mund të marrin shumë kuptime, krijojnë sinonimi, antonimi e homonimi. Karakteristikë e përgjithshme e frazeologjizmave është se ato kanë një kuptim (ndryshe nga fjalët), por disa kanë më shumë se një kuptim, varësisht nga konteksti, si p.sh. frazeologjia *hap sytë* mund të shprehë: 1. çudi, 2. kujdes, 3. kërkesë, 4. arsimim, 5. përpëlitet e fundit të jetës (së dikujt) etj.: 1. I hapi sytë sa të kaut kur e pa. 2. Hapi mirë sytë. 3. Mos i hap sytë, se mjaft të dhashë. 4. Shkolla t'i hap sytë. 5. I hapi sytë, e shkoi n'at dynja.

Ka variante të shumta frazeologjike, që krijohen me ndryshime gramatikore dhe leksikore, duke shprehur nuanca të ndryshme kuptimore e emocionale: *e nxjerr nga zemra* (dikë) - *e shkul*

nga zemra (dikë) - e shlyj nga zemra (dikë); i hapi barkun (dikujt) - i hapi zemrën (dikujt); më hyri në shpirt (dikush) - më hyri në zemër (dikush); më dhemb në shpirt (për dikë a diçka) - më therr në zemër (për dikë a diçka) etj.

Me njësi frazeologjike mund të ndërtohen çifte sinonimike, si: *rreh ujë në havan - çan dërrasa - i bie legenit, shkel e shko - sa për sy e faqe - sa për sy të botës, ma ha mendja - ma merr mendja - ma pret mendja - ma kap mendja etj.*; si edhe antonime: *ngul këmbë - lëshoj pe, shtie në dorë - më doli nga dora, i iku mendja - i erdhi mendja etj.* Rastet e homonimeve janë të rralla (*merr erë* “kupton nga ndonjë punë”, *merr erë* “qelbet”).



Frazeologjizmat, si pjesë e leksikut, janë pasuri e madhe shprehëse. Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* vetëm me foljen *bëj* ose me emrin *dorë* janë dhënë mbi 200 njësi frazeologjike, me emrin *sy* mbi 250, me foljen *ha* 150 njësi. Ja disa njësi frazeologjike që kanë si gjymtyrë fjalën *sy*: *s' më punojnë sytë, ia bën me sy, i shkeli synë, më vret sytë, i nguli sytë, ia ka vënë synë, më mbetën sytë (në të), mbylli sytë (vdiq), i hedh një sy (gazetës), nuk ma zuri syri, si sytë e ballit, e ka halë në sy, s' i trembet syri...* Mund të merrni me mend se ç'pasurim e zgjerim të leksikut të gjuhës sonë sjell frazeologjia në përgjithësi.

Leksikologu i shquar shqiptar, Jani Thomai botoi një “Fjalor frazeologjik të gjuhës shqipe” (Tiranë, 1999) me një vëllim prej 10.000 – 12.000 njësisht frazeologjike. Nga fundi i parathënies thuhet: “vlerat e fjalorit frazeologjik pasqyrojnë vlerat e vetë frazeologjisë gjuhësore: normative dhe ekspresive, teorike e praktike. Frazeologjia, veç vlerave gjuhësore, më shumë se fjalët, mbart tregues të psikologjisë e të mendësisë së popullit, të historisë e të kulturës së tij.”

Secila gjuhë ka frazeologji të veten, prandaj ato nuk mund të përkthehen fjalë për fjalë nga një gjuhë në një tjetër, por duhet gjetur një frazeologjizëm paralel a të ngjashëm, ose duhet të përkthehet kuptimi me ndonjë fjalë përkatëse të natyrës së asaj gjuhe.

Proverbat e disa fjalë të urta i afron me frazeologjinë gjuhësore figurshmëria dhe qëndrueshmëria e strukturës. Shprehjet e figurshme të gjuhës me anën e frazeologjizmave janë shpesh përshkrime të gjalla domethënëse, të lidhura me fakte e shoqërime emocionale, që kanë të bëjnë me historinë e popullit e të vendit, me jetën dhe kulturën e popullit. *Duart nga mielli, sytë nga qielli* – është një tablo e vogël për amvisen që nuk e ka mendjen aty kur mbrun bukën, por përbën edhe një përgjithësim për pakujdesinë në punë.

Frazeologjia është sidomos karakteristike për ligjërimin bisedor, ajo buron nga populli dhe përdoret më së shumti në gjuhën dialektore, rrjedhimisht edhe në krijimtarinë folklorike. Nga goja e popullit dëgjojmë më shumë frazeologjizma, që kanë ngarkesë emocionale e figurshmëri të fuqishme.

Përdorimi i shprehjeve frazeologjike në letërsinë e shkruar është tipar i stilit popullor të shkrimtarit.- Shembull i përdorimit të goditur të njësisht frazeologjike janë veprat e Naimit, Çajupit, Nolit, J. Xoxes, Sh. Musarajt, D. Agollit, Dh. Shuteriqit, A. Kondos, T. Laços etj. Po japim disa vargje të D. Agollit:

*Ka njerëz që pakëz pozitë të kenë
E ngysin ballin dhe fjalët shtrëngojnë në dhëmbë,*

*Dhe janë të lumtur kur shpirtin ta brejnë
Dhe janë të lumtur
Kur ndjenjat t'i shtypin me këmbë! ...
O njerëz, kur dega thyhet dhe bini,
Atëherë ju njohim më mirë,
Atëherë edhe duart tona lëpini, ...*

Frazeologjizmat përdoren më shpesh në prozë: *Jeta vërtet mund të jetë e vështirë, por mendjen duhet ta ruash dhe të mos e kesh kurrë zembrën akull. Edhe shumë i bindur nuk jam, por po shkel në akull e të dalë ku të dalë. Mirëpo Hysniu na doli arrë e fortë dhe ata të së majtës nuk e bënë dot për vete. Fali Zot, bagëti e trashë, nuk dinë ç'bëjnë. Në atë çast te dera bëri ballë Pali Milla. Po mileti nuk ha bar.*

Në poezinë e sotme, frazeologjia e mirëfilltë gojore është pak e pranishme, sepse më shumë përdoret frazeologjia librore dhe kulturore, që në pjesën më të madhe është kalkuar, d.m.th. është përkthyer fjalë për fjalë nga gjuhë të tjera, si *i hedh hije, shpërthen një derë të hapur, thyej akullin, kullë e fildishtë, më bën përshtypje, ka vend, marr masa, marr pjesë* etj. Në shkencë, në fushën politiko-shoqërore, në gazetari etj., përdoren kryesisht pa ngjyrim emocional dhe në një stil të ngritur: *Kjo është alfa dhe omega e çështjes që duhet ta kuptojnë të gjithë. Nuk është se ashtu mendoj, por po bëhem avokat i djallit që të shoh ç'mendon ti. Para këtij rreziku të papritur, ra boria, që të çoheshin të gjithë për të mbrojtur kështjellën* etj.

Ushtrim. Me njësitë e dhëna frazeologjike formoni nga një fjali.

Vuri flakën, i ka duart flori, jap fund, gacë e mbuluar, vë buzën në gaz, hap gojën, derdh gjak, rrah gjoks, s'i pushon gjuha, i doli gjumi, i mbeti hatri, i hodhi pluhur syve, i ka hije, u bë hirrë, merr hov, ngrënë hudhra, e ka çuar hundën, dhashë e mora, erdhi te hunda, lidh jetën, i heq kapelën, s'ka këmbë, me këmbë të mbarë, me mish e me shpirt, luaj këmbët, prerë kërthizën, kokë më kokë, lë kokën, ha bukën kot, ia lidhi kryet, hyri nëpër lakra, u bë lesh, nuk e nxë lëkura, i lëshon goja lëng, më ranë thonjtë.


5.10. INTONACIONI DHE SHENJAT E PIKËSIMIT

Intonacioni është ndryshimi i tonit themelor, i intensitetit, ritmit, timbrit dhe melodikes, që e ndan rrjedhën ligjërimore në njësi intonacioni si grupe kuptimore në theks logjik, për të dalluar kuptimet sintaksore dhe për të dhënë konotacione emocionale e shprehëse.

Edhe në ligjërimin bisedor intonacioni është shoqërues e komentues i përhershëm i mendimeve dhe i vlerësimeve. Në bazë të tij, dallohen fjalitë dëftore (Bie shi.), pyetëse (Bie shi?) ose thirrmore (Bie shi!). Në shembujt si këta, si edhe në rastet e tjera kur kemi përbërje të njëjtë sintaksore, intonacioni i rrafshët me zbritje në fund dallon pohimin, nga fjalitë pyetëse, që kanë ngritje të zërit në fillim ose në fund dhe nga fjalitë me ngjyrim të theksuar emocional (fjalitë

thirrmore), që kanë një regjistër më të lartë e intonacion ngjitës, me një zbritje më të madhe melodike.

Melodia e ligjërimit emocional ka disa tipare të veçanta. Ngjyrim emocional mund të marrë çdo tip fjalie. Këtë ngjyrim fjalia e fiton në saje të melodisë, intensitetit dhe timbrit të zërit. Fjalitë me ngjyrim të theksuar emocional quhen edhe **fjali thirrmore**. Fjalitë e tilla shprehin nuanca të ndryshme emocionale dhe mund të shoqërohen me pasthirra ose me fjalë të tjera, që shprehin emocione. Ato karakterizohen zakonisht nga një regjistër më i lartë dhe nga një vijë zbritëse e melodisë. P.sh.:



Mjafton të shqiptohet me intonacion tjetër *Faleminderit!* dhe ajo merr kuptim tjetër, deri edhe të kundërt; domethënë që nuk ta di për mirënjohje. Në gjuhën librore është përpunuar **intonacioni pyetës** për të ashtuquajtura **pyetje retorike**, si edhe për të dhënë keqardhjen, padurimin, sarkazmin, emocionet e përmbajtura. **Ironia** përftohet nëpërmjet intonacionit karakteristik, që shoqëron shqiptimin e fjalëve, të cilat përndryshe do të kishin kuptim pozitiv nga përbërja e tyre leksikore: *Ty të paçim sa malet, o Sali efendi, se vërtet na mbron nga gjermanët, edhe shtëpitë na i ruan nga zjarri, edhe foshnjat nuk qajnë kur vjen zotrote...* (D. Agolli). **Intonacioni i njëtrajtshëm bën të bjerë vëmendja e dëgjuesve, por ai shfrytëzohet me ulje e ngritje për të mbajtur zgjuar vëmendjen e tyre.**

Në shkrim, për t'i perceptuar njësitë intonative shërben pikësimi.

Detyrë: Lexoni dy fjalitë e dhëna. Thoni çfarë kuptimi ka fjalia e parë. Ç'kuptoni me fjalinë e dytë. Pse ndryshojnë në kuptim?

Mëso si babai, mos u bëj i paditur.

Mëso, si babai mos u bëj i paditur.

Shpjegim:

Në këtë fjali presja mund të vihet në dy vende, që japin dy kuptime të ndryshme.

Shenjat e pikësimit (interpunkcionit) përdoren për të siguruar lexueshmërinë e një teksti dhe qartësinë e tij.

Shenjat kryesore të pikësimit janë: **pika, presja, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, dy pikat, tri pikat, viza, thonjëzat, kllapat.**

Ato mund të ndahen në tri grupe:

- a) shenjat që përdoren në fund të fjalisë, pra shenjat e intonacionit të fjalisë;
- b) shenjat që përdoren brenda fjalisë për të shënuar një pushim të shkurtër;
- c) thonjëzat, viza.

a) Shenjat që përdoren në fund të fjalisë

(shenjat e intonacionit)

Katër shenjat e pikësimit *pika*, *pikëpyetja*, *pikëçuditja* dhe *tri pikat*, që përdoren në fund të fjalisë, shënojnë grafikisht pauzën që ndan dy fjali në gjuhën e folur. Këto janë shenja të intonacionit.

Pika shënon intonacionin zbritës, që shoqëron zakonisht fundin e fjalisë dëftore. P.sh.: *Drita dhe Besa janë shoqe. Ato mësojnë bashkë në një fakultet. Ato janë shoqe të pandashme.*

Pikëpyetja shënon grafikisht intonacionin ngjitës që karakterizon pyetjen gjatë të folurit: *Si quhesh?, Nga jeni?, Sa vjeç je?, Kur do të shkoni në bibliotekë?* etj.

Pikëçuditja shënon grafikisht intonacionin dhe intensitetin e veçantë që karakterizon shprehjen e gjallë të një emocioni (një e papritur, kundërshtim, zemërim, gëzim). P.sh. *Oh sa e bukur qenka kjo lule!, Obobo sa qenke rritur!, Merre librin dhe mëso!*



etj.

Tri pikat tregojnë që fjalia përmban një nëntekst, që mendimi mbetet i pambaruar. Me tri pikat shënojmë lëshimin apo mungesën e një fjale ose fjalie. Ky mosshqiptim i fjalëve në të folurit sinjalizohet përmes intonacionit të posaçëm. Heshtja, intonacioni i papërfunduar, mban pezull, si kuptimin ashtu edhe njerëzit, tërheq vëmendjen dhe na bën përshtypje emocionale. P.sh. *Të them të drejtën ..., kjo fare nuk më pëlqen. Ma merr mendja se ... nuk e di ..., nuk e di ç'të them.*

b) Shenjat që përdoren brenda fjalisë

(shënojnë një pushim të shkurtër)

Presja shënon grafikisht një pushim të shkurtër brenda fjalisë. P.sh.:

Stinët e vitit janë: pranvera, vera, vjeshta dhe dimri. Artani, djali më i madh, po mëson rregullisht. Ajo figurë mishëron vetitë më pozitive të popullit: urtësinë, besën, mençurinë e trimërinë. Zogu, për çudi, nuk shkoi larg; u kthye e fluturoi fare ulët.

Pikëpresja shënon grafikisht një pushim më të gjatë sesa presja: *Ata që na donin, erdhën; ata që s'na donin nuk erdhën.*

Dy pikat shënojnë një pushim që zgjat pothuajse sa pikëpresja, por, ndryshe prej saj, dy pikat kanë një vlerë logjike: ato paralajmërojnë një shpjegim, një varg shembujsh etj. P.sh.: *Tani më ra ndër mend: librin ta kam dhënë brenda në bibliotekë. Më është mbushur mendja për diçka: njeriu i fortë ia del mbanë, edhe kur e ka pis.*

Dy pikat përdoren gjithnjë pas fjalëve të autorit kur i thotë fjalët e tjetrit me përpikëri. P.sh.: *Drita i tha s'ëmës: "Nesër të më zgjosh në orën gjashtë"*.

Kllapat shënojnë një pushim të shkurtër, si presja. Shërbejnë për të dalluar shquar dhe izoluar një grup fjalësh që shpreh një sqarim ose mendim të ndërshtënë. *Te Fusha e Kuqe (ajo quhej kështu, se në mes të saj ngrihej një shkëmb i kuq), Baton e priste Agimi.*

Përpara pikëpresjes ose dy pikave, intonacioni mund të ngrihet ose të ulet, sipas rastit; ngrihet, nëse të folurit është i vazhdueshëm dhe i shpejtë; zbret, kur të folurit është i ndërprerë dhe i ngadaltë, pra me pauza të gjata.

c) Thonjëzat dhe vizat

Shërbejnë për të rrethuar fjalët e një ose më shumë bashkëbiseduesve në një ligjëratë të drejtë, si *Naimi ka thënë: "Punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë"*.

Thonjëzat shërbejnë gjithashtu për të shënuar emërtimet e rrugëve, të institucioneve etj. P.sh.: *Rruga "Xhon Kenedi", shkolla fillore "Naim Frashëri" etj.*

Detyrë: Rishkruajeni këtë tregim, duke i përdorur drejt shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe.

e ëma e donte agronin dhe i erdhi keq qe iu prish qejfi por qenin kurrsesi nuk donte ta mbante tani zuri t'ia mbushte mendjen ndryshe më qetësisht më butësisht

dëgjo agron qeni nuk është i pastër i bien qimet dhe do të fluturojnë nëpër banesë qimet janë të dëmshme sepse po të përpish ndonjë sosh do të kesh komplikime shëndetësore

në qoftë se qimja hy në trup të njeriut do të mbledhë qelb si i thati që më vonë duhet bërë operacion as operacioni nuk do të jetë i lehtë

më në fund ku do t'i shkundësh ato qime pos nëpër dritare edhe prej qilimit edhe prej mbulesës e pastaj ato do të bien në ballkonet e huaja me poshtë në katin e dymbëdhjetë në të trembëdhjetin dhe kush e di se deri ku

5.11. LIGJËRATA E DREJTË DHE E ZHDREJTË

Ligjërimi ynë realizohet nëpërmjet *ligjëratës së drejtë* dhe *ligjëratës së zhdrejtë*.

1. Ligjëratat e drejtë

Dje takova babanë e Ardit. I foli për talentin e të birit, *"Zemra e prindit gëzohet kur dëgjon fjalë të mira"* - tha ai.

Në ligjëratën e drejtë përsëriten me përpikëri fjalët e një personazhi ose tonat. P.sh.:

"Nga Vlora vjen?" - pyeti buzagaz vajza.

"Sot, - filloi profesori, - do të flasim për veprën e Migjenit".

Pasi më përshëndeti, ajo tha: *"Sa paske ndryshuar, more Andi!"*

Në të folur, ligjëratat e drejtë veçohet nga fjalët e autorit me anë të pauzës.

Fjalët e riprodhuara shqiptohen me theksin dhe tonin e natyrshëm të bisedës.

Në të shkruar ligjërata e drejtë shkruhet ndërmjet thonjëzave. P.sh.:

Ai tha: "Ashtu si zogjtë, edhe të vegjlit kanë këngët e tyre të mëngjesit!"

"Është duarflori ky djalë", - tha ai duke më renë shpatullave.

"Sa bukur qenka këtu!" - thirri ajo.

"Fli, - më thoshte, - se nesër je për udhë të gjatë".

"Trimëria s'ka kuptim pa zgjuarsinë", - tha ai.

"Sidoqoftë, Skënderi është i zgjuar!"

"E keni lexuar këtë libër?" - pyeti mësimdhënësi.

2. Ligjërata e zhdrejtë

Detyrë: Lexoni dy versionet e të njëjtit mendim:

Vajza i tha shkrimtarit: "Më pëlqejnë shumë librat tuaj."

Vajza i tha shkrimtarit se i pëlqenin shumë librat e tij.

Çfarë ndryshimesh vëreni në fjalitë e mësipërme?

Në periudhën e parë kemi ligjërata të drejtë, ndërsa në të dytën kemi ligjërata të zhdrejtë.

Në ligjëratën e zhdrejtë fjalët e një tjetri ose tonat jepen në një formë të ndryshuar.

Shndërrimi i ligjërates së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë

Gjatë zëvendësimit të ligjërates së drejtë me të zhdrejtën, duhet t'u kushtohet kujdes formave vetore të foljeve dhe përemrave vetorë e pronorë. P.sh.:

ligjëratë e drejtë	ligjëratë e zhdrejtë
1. "Fishta është shkrimtar që e lexoj me shumë ëndje" – tha ajo.	1. Ajo tha se Fishta është shkrimtar që e lexon me shumë ëndje.
2. "Genci s'do të na lërë në baltë" – iu përgjigj Dritani.	2. Dritani iu përgjigj se Genci s'do t'i linte në baltë.
3. "Në cilin fakultet studion?" – e pyeti Arbri Zanën.	3. Arbri e pyeti Zanën se në cilin fakultet studion.

Kur flasim e shkruajmë duhet të kujdesemi për kulturën e të shprehurit, për zgjedhjen më të përshtatshme të fjalës, për respektimin e normave gjuhësore si dhe për shprehjet stilistike.

Bashkë me çdo lëndë mësimore duhet të mësojmë edhe gjuhën e drejtë me të cilën ajo shprehet.

Fjalët janë si lulet

Ato gjenden kudo përreth nesh. Disa janë këtu. Disa janë atje. Disa i di unë. Disa i di nëna. Disa i di mësuesja. Disa i gjen në gazeta. Disa i dëgjon në radio. Disa i mëson nga televizori. Por më së shumti fjalë ka në libra.

Fjalët janë si urat

Pa to çdo njeri do të mbetet i vetmuar. Merreni me mend, ç'do të bënim po të mos ishin fjalët? Si do t'ia shfaqnim nënës dashurinë tonë të pamatur? Si do të loznim me shoku-shokun? Si

do ta përshëndetnim mësuesen kur të shkonim në shkollë? Si do ta njihnim botën përreth? Si do t'i shkruanim vargjet e tyre të bukura Naimi, Migjeni ...? Si do të jepte kushtrimin Skënderbeu?

Fjalët janë si fëmijët

Edhe ato kanë dëshirat dhe huqet e veta. Duan që të përdoren me kujdes. Dëshirojnë të ruhet radha dhe forma. E kanë mërzi sidomos po t'u heqim *ë*-në. U vjen shumë keq po t'ua ndërrojmë vendet *ç*-së dhe *q*-së, ose *gj*-së e *xh*-së. Dhe kanë të drejtë. Mendoni vetë, si do t'ju dukej juve sikur dikush, nga pakujdesia, t'jua përdridhte qafën, t'jua thyente gishtërinjtë, t'jua shtypte hundën, t'jua priste veshin ...?

Fjalët janë si armët

E ne si ushtarët. Sa më shumë fjalë të kemi, më të fuqishëm do të jemi. Secila fjalë është një armë më vete.

Fjalët janë si ilaçet

Kush ka fuqi më të madhe shëruese se fjala e ëmbël e nënës, se fjala e çiltër e shokut, se fjala nga zemra e mikut? Askush. Prandaj t'i përdorim vetëm si ilaçe. Si? Të flasim vetëm fjalë të mira, që ato të na shërbejnë si ura, që të na i mbushin zemrat me dashuri.

Atëherë edhe unë në fund po ju them një fjalë të mirë:

MIRUPAFSHIM!

(Arif Demolli)

KREU VI

6. (MOS)PËRDORIMI I SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONI

6.1. GJENDJA DHE PERSPEKTIVA E STUDIMEVE GJUHËSORE NË MAQEDONI

Shkurtime

Në këtë kumtesë do të japim një pasqyrë të studimeve gjuhësore në Maqedoni, duke u përpjekur të hartojmë një bibliografi të punimeve të derisotme. Më pas do të shtjellojmë çështjen se ç' duhet bërë në të ardhmen për të thelluar e zgjeruar studimet gjuhësore në Maqedoni, veçmas në fushën e dialektologjisë, onomastikës e të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët në takim, sidomos me maqedonishten.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.

Fjalë kyçe: bibliografi, gjuhësi, studim, zgjerim, thellim, bashkërendim, perspektivë

Tani kur shënojmë 104-vjetorin e alfabetit, 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe 40- vjetorin e Drejtshkrimit mund të krenohemi edhe me vlerat e letrave shqipe. Në shqipen janë shkruar mijëra e mijëra vepra letrare zhanresh të ndryshme, monografi shkencore, gramatika normative e historike, përshkrime dialektore, fjalorë shpjegues, fjalorë dygjuhësh e shumëgjuhësh, tekste mësimore e një mal shkrimesh të tjera.

Pas Kongresit të Drejtshkrimit e deri më tani gjuhësia shqiptare ka zhvilluar një veprimtari të dendur për të krijuar vepra madhore, si: “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, “Fjalori drejtshkrimor”, “Gramatika e gjuhës shqipe” në dy vëllime, “Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe”, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” dhe “Fjalori i shqipes së sotme”, “Rregullat e pikësimit të gjuhës shqipe”, “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe”, “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”, “Fjalor enciklopedik shqiptar” si dhe një varg fjalorësh terminologjikë dhe veprash të tjera për shqipen e sotme e për kulturën gjuhësore, ndër të cilat edhe një numër tekstesh mësimore universitare.¹⁰⁷

Që nga viti 2005 u mundësua zbatimi i një programi kompjuterik për drejtshkrimin e shqipes AS 2.0. Me këtë program të rëndësishëm edhe gjuha shqipe u fut në mesin e gjuhëve të kompjuterizuara. Kjo shënon një epokë të re për gjuhën shqipe, bazuar në përvojat që kanë pasur gjuhët e kombeve të zhvilluara.

Në kuadrin e këtyre arritjeve të mëdha të gjuhësisë shqiptare, në këtë paraqitje tonë të shkurtër do të themi pak fjalë për gjendjen e studimeve gjuhësore në Maqedoni.

Gjëja e parë që më bie ndërmend të them tani është se: qëndrimi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit (Remzi Nesimi, Petro Janura, Sefedin Sylejmani) si edhe qëndrimi i gjithë shqiptarëve të Maqedonisë lidhur me shqipen e njësuar ka qenë dhe mbetet i pandryshuar: se ne jemi për një gjuhë të përbashkët standarde. Edhe në përvetësimin dhe zbatimin praktik të standardit, edhe pse me disa mangësi natyrash të ndryshme, që kanë të bëjnë veçmas me dygjuhësinë a shumëgjuhësinë (maqedonishte, shqipe dialektore, shqipe standarde), prapëseprapë mund të themi se praktika gjuhësore e përdorimit të shqipes në Maqedoni është relativisht e mirë.

Po të përiqemi të japim një pasqyrë të veprimtarisë gjuhësore Maqedoni, do të na përvijohen disa fusha veprimi:

1. Një numër i konsiderueshëm gjuhëtarësh të Maqedonisë një pjesë të veprimtarisë së tyre ia kanë kushtuar pikërisht problemeve të zbatimit të normës letrare në këto troje e më gjerë (Remzi Nesimi, Qemal Murati, Asllan Hamiti, Valbona Toska, Berton Sulejmani, Ajten Qamili etj.).
2. Për nga sasia, shquhen punimet e studimet në lidhje me të folmet shqipe të Maqedonisë (Remzi Nesimi, Fadil Sylejmani, Esat Hoxha, Mojsi Lutfiu, Haki Ymeri, Zihni Osmani, Qemal Murati, Abedin Zenku, Agim Poloska, Sefedin Haruni, Naim Basha, Fehim Reçani, Zeqir Kadriu, Mustafa Ibrahim, Asllan Hamiti, Ismet Osmani, Ajten Qamili, Lulzim Aliu etj.). Të përkujtojmë se pas Luftës së Dytë Botërore për të folmet shqipe në Maqedoni janë shkruar mbi 40 skica e monografi dialektore.

¹⁰⁷ Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” (mbajtur në Tiranë, 11 dhe 12 nëntor 2002), *Studime filologjike* 3-4, 2002, Tiranë, f. 6.

3. Në grupin e tretë mund të vëmë studimet për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera, veçmas me maqedonishten (Olivera Jashar – Nasteva, Qemal Murati, Agim Poloska, Haki Ymeri, Safet Hoxha, Asllan Hamiti, Idajete Mustafa, Zekirija Ibrahim, Berton Sulejmani etj.).
4. Në fushën e onomastikës po kështu janë arritur disa rezultate (Qemal Murati, Xhemaludin Idrizi, Haki Ymeri, Mustafa Ibrahim etj.).
5. Janë bërë edhe disa vëzhgime sociolinguistike (Mustafa Ibrahim, Hamit Xhaferi, Vebi Bexheti, Zeqir Kadriu, Ajten Qamili, Izmit Durmishi, Zarije Nuredini etj.).
6. Nuk mungojnë edhe vrojtime gjuhësore për gjuhën dhe stilin e ndonjë shkrimtari (Remzi Nesimi, Zeqirja Neziri, Asllan Hamiti, Bukurije Mustafa, Lulzim Aliu etj.).
7. Është punuar edhe në fushën e leksikografisë, veçmas në hartimin e fjalorëve dygjuhësh: shqip – maqedonisht e anasjelltas (Lutfi Rusi, Mile Qorvezirovski, Haki Ymeri, Zihni Osmani, Adnan Agai, Kimete Agai) si edhe në fjalorët dygjuhësh terminologjikë (Shaban Prevalla etj.).
8. Hartimi i teksteve shkollore për gjuhë shqipe e letërsi për arsimin fillor, të mesëm e të lartë si dhe tekste për mësimin e shqipes nga të huajt ka qenë një ndër veprimtaritë e shpeshta të gjuhëtarëve shqiptarë të Maqedonisë (Remzi Nesimi, Xhevat Gega, Mahmut Hysa, Zihni Osmani, Islam Karanfili, Vehbi Kadriu, Asllan Hamiti, Zeqirja Neziri, Nehas Sopaj, Mustafa Ibrahim, Ismail Hamiti, Xhemaludin Idrizi, Valbona Toska, Avzi Mustafa, Gjylmsere Kasapi etj.).
9. Në Konferencat shkencore ndërkombëtare në fushën a albanologjisë gjuhëtarët shqiptarë të Maqedonisë janë gjithnjë të pranishëm me referate të vlefshme. Kumtesat janë me tema të ndryshme. Edhe përkaj vështirësive të natyrave të ndryshme, megjithatë edhe në Maqedoni nuk mungojnë aktivitetet e tubimeve shkencore për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Të rikujtojmë se dy universitetet e Tetovës: Universiteti i Evropës Juglindore dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës me sukses po organizojnë konferenca albanologjike. Konferenca e sivjetme është e shtata me radhë që e mban UEJL-ja, ndërsa e gjashta që e organizoi Universiteti Shtetëror i Tetovës. Edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve ka mbajtur 3-4 tubime shkencore. Dega e albanologjisë së Alb-shkencës nga Maqedonia, po ashtu është mjaft aktive dhe deri më tani ka mbajtur dy takime shkencore në Maqedoni (të parën në Tetovë e të dytën sivjet në Shkup).

Nuk duhen mohuar rezultatet e arritura deri më tani në vëzhgimet gjuhësore në Maqedoni, me këtë edhe ndihmesën e studiuesve të Maqedonisë në fushën e gjuhësisë shqiptare në përgjithësi. Për fat të mirë, me kalimin e viteve në studimet gjuhësore në Maqedoni hetohet një përparim cilësor dhe sasior. Megjithëkëtë, vështruar nga pikëpamja e përgjithshme e studimeve albanologjike, mund të thuhet se ne kemi ngecur pak prapa. E kemi kaluar vetëm fazën e parë, ndërsa në të ardhmen na pret edhe realizimi i fazës së dytë. Vëzhgimet gjuhësore në Maqedoni deri më tani janë bërë në mënyrë individuale e sporadike, në të shumtën e rasteve si punime magjistrature e doktorati.

Jemi të vetëdijshëm se gjuha, letërsia e kultura shqiptare si dhe njerëzit që merren me studimin e tyre nuk duhet e nuk mund të ndahen në krahina e në regjione, por ajo trashëgimi

kulturore që kemi është pronë e gjithë kombit, rrjedhimisht edhe kontributi i veprimtarëve duhet vështruar në përmasa kombëtare. Megjithëkëtë, qëllimi im është të themi se edhe ne shqiptarët e Maqedonisë po japim një ndihmesë modeste në ngritjen e piramidës së përbashkët kombëtare e qytetëruese.

Në bazë të disa veprave të botuara si dhe të punimeve të magjistraturave e doktoratave që kemi në dorë, gjykojmë se do të ishte e dobishme të përpiqemi të japim një pasqyrë të bibliografisë së studimeve të gjuhëtarëve shqiptarë të Maqedonisë si dhe i disa albanologëve që dhanë ndihmesë veçmas për vëzhgimin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera në takim. Këtu kemi shënuar kryesisht vepra të plota, e jo edhe artikuj e punime me vlerë për gjuhësinë shqiptare (me ndonjë përjashtim). Jemi të vetëdijshëm se do të mbeten pa u regjistruara edhe shumë punime e studime me vlerë. Në mungesë të të dhënave për to, nuk kemi pasur mundësi t'i shënojmë, andaj, kërkojmë ndjesë nga autorët që nuk i kemi përfshirë këtu. Sidoqoftë, kjo radhitje emrash e veprash duhet plotësuar e përditësuar, e tek e fundit le të shërbejë kjo listë e mangët ndihmesash si pikënisje në punën e hartimit të një bibliografie të plotë të punimeve e të studimeve gjuhësore të gjuhëtarëve të Maqedonisë për shqipen:

- Abidin Zenku, *Disa karakteristika të krahinës së Kërçovës*, Jehona 3, Shkup, 1968.
- Agim Poloska, *Pasuria leksikore në të folmen e Prespës*, Jehona, nr. 8, Shkup, 1984.
- Agim Poloska, *Vëzhgime mbi leksikon e kuzhinës në regjionin e Prespës*, Jehona, nr. 1, Shkup, 1987.
- Agim Poloska, *Interferenca leksikore e të folmes shqipe dhe maqedonase të Prespës* (punim magjistrature), Shkup, 1988.
- Agim Poloska, *Interferenca leksikore e shqipes dhe maqedonishtes dialektore* (disertacion doktorate), Shkup, 1996.
- Agim Poloska, *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*, Asdreni, Shkup, 2003.
- Adnan - Kimete Agai, *Fjalor maqedonisht - shqip*, Shkup, 1999.
- Adnan - Kimete Agai, *Fjalor shqip - maqedonisht*, Shkup, 2005.
- A. Selimi, *Të folmet e Zajazit me disa karakteristika*, Përparimi 6, Prishtinë, 1961.
- Ajten Qamili, *Variantet shoqërore në të folmet e Strugës dhe ndikimi ndër-gjuhësor te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh* (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2008.
- Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2012.
- Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.
- Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Arben Xhemailloski, *Nomina agentis në gjermanishte, në maqedonishte dhe në shqipe* (me theks të veçantë në prapashtesat –er/-in (gjer.), aç/-ka (maq.) dhe –ës/-es (shq.)) (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2011.
- Berton Sulejmani, *Gjuha standarde shqipe dhe shkolla* (zotërimi i saj nga nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit), Shkup, 2011.
- Berton Sulejmani, *Kongruenca e gjymtyrëve kryesore të fjalisë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase – analizë krahasimtare* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2010.
- Bukurije Mustafa, *Gjuha e romanit "Lumi i Vdekur" i Jakov Xoxës*, ITShKSh, Shkup, 2011.

- Borçe Nadin - Mirlinda Krifca - Muharrem Vyshko, *Fjalor i shkurtër maqedonisht – shqip*, Shkup, 1994.
- Dervish Alimi, *Sistemi i përemrave vetorë në gjuhën shqipe, në anglishten dhe në frëngjishten si dhe përdorimi i tyre në ligjërimin juridik, politik dhe në medime* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2010.
- Farketa Dibra, *Funksioni i lektyrës në shkollat e mesme me mësim në gjuhën shqipe në R. e Maqedonisë* (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2011.
- Hasan Hoda, *Gjuha e lektyrave të arsimit fillor të përkthyer nga maqedonishtja në shqip* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2010.
- Ismet Osmani, *Ndërrimet morfonologjike në të folmet e gegërishtes*, Shkup, 2005.
- Jusuf Mustafai, *Ndikimi i gjuhës amtare në përvetësimin e leksikut të anglishtes si gjuhë e huaj te nxënësit shqiptarë në R. e Maqedonisë* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2012.
- Qemal Murati, *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, 1990.
- Qemal Murati, *Konservacione dhe inovacione gjuhësore në fushë të shqipes*, 1991.
- Qemal Murati, *Fjalor dialektor i të folmeve të Maqedonisë*, Prishtinë, 1992.
- Qemal murati, *Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*, 1993.
- Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.
- Qemal Murati, *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985.
- Qemal Murati, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*, Logos-A, Shkup, 2003.
- Qemal Murati, *Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë*, Albas, Tetovë, 2004.
- Qemal Murati, *Drejtpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore*, 1996.
- Qemal Murati, *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve*, 1999.
- Qemal Murati, *Gramatika e gabimeve – kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*, 2000.
- Qemal Murati, *Fjalor idiomatik shqip – maqedonisht*, Tetovë, 2003.
- Qemal Murati, *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.
- Qemal Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.
- Qemal Murati, *Probleme të gjuhës së sotme dhe historike të shqipes*, Shkup, 1994.
- Qemal Murati, *Kërçova në traditat e saj të vjetra*, Shkup, 1996.
- Qemal Murati, *Kokrra urtësie për gjuhën*, Tetovë, 2001.
- Esat Hoxha, *E folmja toske e rrethit të Strugës*, Jehona nr. 6, Shkup, 1979.
- Fadil Sylejmani, *Dukuritë fonetike në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Dituria 1, Prishtinë, 1983.
- Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Feim Reçani, *E folmja e rrethit të Gostivarit* (punim magjistrature në dorëshkrim), Prishtinë, 1977.
- Fehim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Haki Ymeri, *Veçoritë morfologjike të së folmes së Kumanovës me rrethinë*, Jehona 1-2, Shkup, 1981.
- Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.

- Haki Ymeri - Petar Atanasov - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht - shqip dhe shqip – maqedonisht*, Kumanovë, 1997.
- Haki Ymeri – Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht - shqip*, Shkup, 2000.
- Haki Ymeri – Bina, *Fjalor shqip - maqedonisht*, Logos A, Shkup, 2012.
- Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Çabej, Tetovë, 2011.
- Lulzim Aliu, *Folja në romanet e Ismail Kadaresë të përkthyer nga shqipja në maqedonisht* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2010.
- Mojsi Lutfiu, *Ndikimi reciprok i gjuhëve sllave dhe i shqipes në të folunit e Dibrës*, Përparimi, nr. 1-2, Prishtinë, 1962.
- Mustafa Ibrahimimi, *Interpretime dhe studime gjuhësore*, Interlingua, Shkup, 2003.
- Mustafa Ibrahimimi, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005.
- Mustafa Ibrahimimi, *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2007.
- Mustafa Ibrahimimi, *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Interlingua, Shkup, 2010.
- Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.
- Olivera Jashar - Nasteva, *Vlijanieto na makedonskiot jazik vrz albanskite i turskite govori vo Makedonija*, Makedonski jazik VIII, libri 2, Shkup, 1957.
- Olivera Jashar – Nasteva, *Albanski zborovi vo makedonskite tajni jazici*, Makedonski jazik IV, nr. 3, 4, 5-6, Shkup.
- Olivera Jashar – Nasteva, *Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmet shqipe*, GJA nr. 19, Prishtinë, 1989.
- Olivera Jashar – Nasteva, *Shfaqja e diglosisë dhe bilinguizmit në RS të Maqedonisë*, Gjuha shqipe, nr. 3, Prishtinë, 1990.
- Olivera Jashar – Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998.
- Petro Janura, *Vrojtime gjuhësore (fonetike) dhe folklorike-etnografike te shqiptarët e Pollogut të Gostivarit*, Gostivarskiot kraj (makedonskiot, albanskiot i turskiot jazik), Gostivar, 1970.
- Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 81-152.
- Remzi Nesimi, *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.
- Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.
- Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327 - 352 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Rexhep Ismajli, *Disa fjalë shqipe në maqedonishte*, GJA nr. 1, Prishtinë, 1972.
- Safet Hoxha, *Elemente leksikore të shqipes në disa të folme të maqedonishtes*, BShUT, nr. 1, Shkodër, 1984.
- Sefedin Haruni, *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.
- Sejfedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Shkup, 1994.
- Valbona Toska, *Mënyra e të shprehurit të kategorisë semantike të posesivitetit në sintagmën emërore në shqipen dhe në maqedonishten* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2009.
- Vebi Bexheti – Hamit Xhaferi – Mustafa Ibrahimimi, *Studime etnolinguistike, folklorike*

- dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*, Tetovë, 2008.
- Xhemaludin Idrizi, *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.
- Zarije Nuredini, *Fjalë të veçanta në krijimtarinë e Salajdin Salihut*, Tetovë, 2012.
- Zarije Nuredini, *Aspektet metodike-didaktike në lëndën e morfologjisë me mësim në gjuhën shqipe në arsimin fillor* (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2007.
- Zarije Nuredini, *Arkaizmat në të folmet shqipe në Republikën e Maqedonisë* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2010.
- Zeqir Kadriu, *Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni*, Blana, Tetovë, 2002.
- Zekirija Ibrahimimi, *Konjuksioni si mjet i kohezionit në gjuhën standarde shqipe* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 2010.
- Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996.
- Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997 etj.

Me krijimin e kushteve më të volitshme për shkollimin edhe të shqiptarëve të Maqedonisë në gjuhën amtare, si më të rëndësishme ndër to po përmendim: punën 40-vjeçare të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare e të Akademisë Pedagogjike në Shkup, shkollimin e mesëm të detyrueshëm të të rinjve, hapjen e dy universiteteve në Tetovë, themelimin e Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve presim të kemi një zgjerim, thellim dhe profesionalizëm më të madh edhe në studimet gjuhësore.

Mendojmë se në të ardhmen duhet të shtrohen detyra të tjera më të mëdha: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm më të madh si dhe me metoda bashkëkohore. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt, te ne sidomos me maqedonishten.

Ç'duhet bërë në të ardhmen?

Përmbledhtas, veprimtaria e gjuhëtarëve shqiptarë të Maqedonisë mund të orientohet në disa fusha:

1. Të hartohet një bibliografi e plotë e artikujve, punimeve dhe e monografive gjuhësore autorësh shqiptarë nga Maqedonia.
2. Disa nga veprat me vlerë, sidomos monografite të përditësohen e të ribotohen, ndërsa artikujt e shpërndarë nëpër revista e kudo që janë (të botuara e të pabotuara deri më tani) të redaktohen e të botohen në përmbledhje punimesh.
3. Të sigurohen monografite në dorëshkrim dhe të botohen.
4. Të vilet materiali dialektor, veçmas pasuria leksikore e frazeologjike dhe në bazë të punimeve të mëparshme dhe materialit të siguruar, të hartohet një fjalor fjalësh krahinore si dhe një fjalor frazeologjik i të folmeve shqipe në Maqedoni.
5. Të themelohet një kartotekë, fonotekë dhe një laborator i fonetikës eksperimentale.
6. Të vazhdojë puna e përshkrimit monografik të të folmeve të caktuara si dhe të bëhen studime për dukuri të veçanta gjuhësore në të gjitha fushat: në fonetikë e fonologji, në morfologji, në leksik e në sintaksë.

7. Të hartohet një atlas dialektor i të folmeve shqipe në Maqedoni.
8. Të zgjerohen e të thellohen vëzhgimet për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët sllave, veçmas me maqedonishten.
9. Të themelohet një Këshill i gjuhës shqipe që do të përkujdeset për çështje të planifikimit gjuhësor: zbatimin, mbrojtjen, pastrimin dhe pasurimin e shqipes standarde.
10. Gjuhëtarët të japin ndihmesën e tyre në përmirësimin e nivelit gjuhësor të teksteve shkollore të përkthyer nga maqedonishtja në shqipe.
11. Të merren masat e nevojshme për përvetësimin dhe zbatimin e normave të shqipes standarde në mjetet e informimit publik, në administratën shtetërore e publike, në shkolla fillore, të mesme e fakultete.
12. Të angazhohemi që statusi i shqipes të përmirësohet, nga gjuhë me përdorim të kufizuar territorial, vetëm në komunat ku ka mbi 20% shqiptarë, në gjuhë zyrtare (krahas maqedonishtes) në gjithë territorin e Maqedonisë.

Këto punë madhore kërkojnë përkrahjen e organeve shtetërore, bashkërendimin e gjuhëtarëve të Maqedonisë dhe bashkëpunimin e specialistëve dhe institucioneve arsimore e shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.

Le të shërbejë ky libër takim yni si një nxitje e thirrje për gjithë studiuesit e gjuhës shqipe, intelektualët, pedagogët, shkrimtarët, gazetarët, studentët, nxënësit dhe gjithë folësit e shkruarit e shqipes që me veprimtarinë e tyre ta përdorin drejt shqipen standarde dhe të japin ndihmesë profesionale e kërkimore-shkencore në punën e tyre.

Epoka jonë është epokë e ngritjes historike, e pasurimit dhe e forcimit të identitetit gjuhësor e kombëtar. Ta duam, ta ruajmë, ta mësojmë e ta studiojmë gjuhën amtare, sepse ashtu do të ta ruajmë qenien tonë kombëtare.

6.2. ANALFABETIZMI FUNKSIONAL NË MAQEDONI

- **Ç'është analfabetizmi funksional?**

Kohëve të fundit në mediat e shkruara dhe ato elektronike në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni po flitet për analfabetizmin funksional. Së pari, për lexuesit ndoshta do të ishte e dobishme të themi se ka dy lloj analfabetizmash: analfabetizëm klasik dhe analfabetizëm funksional. Analfabet është njeriu që nuk i di shkronjat, që nuk di të shkruajë e të lexojë; ndërsa analfabet funksional apo “analfabet me diplomë” është njeriu që di shkrim-lexim, por atë nuk

është në gjendje ta përdorë si duhet e kur duhet në praktikë, pra nuk di të shprehet me shkrim ose shkrimin di ta lexojë, por nuk e kupton atë mjaftueshëm, nuk kupton atë që ka lexuar.

Me keqardhje mund të pohojmë se në Maqedoni, si edhe në vendet e tjera të Ballkanit, të Evropës e të botës ka pasur dhe ende kemi njerëz mbi moshën 7-8-vjeçare, e veçmas të moshuar, që nuk i dinë të shkruajnë e të lexojnë. Ky lloj analfabetizmi (i njerëzve të moshuar) tani më i takon së kaluarës, por fatkeqësisht nga analfabetizmi klasik po kalojmë në analfabetizmin funksional, kushtimisht nëse mund ta quajmë “analfabetizëm modern”. Tani me shkollimin “në masë” pothuajse të gjithë fëmijët tanë ndjekin shkollë fillore e të mesme, shumica prej tyre edhe universitete dhe rrjedhimisht marrin edhe diplomë. Por, disa prej tyre nuk arrijnë dot të përdorin, për të mirën e vet dhe të tjerëve, shkathtësinë e të shkruarit dhe e të kuptuarit.

- **Sa është i pranishëm analfabetizmi funksional në Maqedoni?**

Analfabetizmi funksional shfaqet në të gjitha vendet e botës, por diku më shumë e diku më pak. Një raport i fundit i Bankës Botërore ka dalë me rezultatin tronditës se 57% e 15-vjeçarëve në Shqipëri janë analfabetë funksionalë. Shqetësues është fakti se sipas të dhënave statistikore të këtij institucioni, Shqipëria radhitet në 3-4 vendet e fundit, me analfabetizëm modern shumë të lartë. Nuk besoj se në Shqipëri analfabetizmi është kaq i shprehur, me 57%, meqë kujtoj se sistemi i shkollimit atje është i një niveli më të lartë sesa i disa vendeve të tjera ballkanike.

Nuk kemi të dhëna statistikore për analfabetizmin funksional në Maqedoni. Megjithatë, nga ajo që po shohim e dëgjojmë çdo ditë, nga përvoja jonë pedagogjike në universitet, me keqardhje mund të themi se përgjithësisht niveli i kulturës gjuhësore i rinisë sonë është jo i kënaqshëm: shumë nxënës të filloreve e të shkollave të mesme nuk dinë t'i shprehin mendimet e veta as me shkrim e as me gojë, por edhe atë që e lexojnë nuk janë në gjendje ta reprodukojnë. Ky analfabetizëm funksional, kjo paaftësi e tyre në shkrim-leximin me kuptim vërehet shpesh edhe te studentët. Fjala vjen, në provimet me shkrim a me gojë ata po përgjigjen vetëm duke i mbetur besnik me përpikëri tekstit mësimor, në të shumtën e rasteve duke e mësuar përmendësh ose duke e kopjuar. Rrallëherë lexojmë përgjigje origjinale me fjali që nuk janë kopje e tekstit. Ka edhe të tillë që nuk dinë të plotësojnë fletëparaqitjet e provimit si dhe formularë të tjerë, nuk dinë të shkruajnë një ftesë, letërrurim, njoftim, lutje, kërkesë, ankesë, letër, procesverbal, fletëpalosje etj. Rrjedhimisht, mund të përfundohet se te adoleshentët shqiptarë në Maqedoni kemi analfabetizëm funksional, që mund të supozojmë se sillet prej 30-50%.

- **Cilat janë arsyet e kësaj gjendjeje trishtuese e me pasoja të rënda për ardhmërinë tonë?**

Për shkaqet e analfabetizmit funksional dhe përgjithësisht për gjendjen e mjerueshme të shkollimit shqip në Maqedoni e në rajon mund të flasë çdokush e mund të thotë shumëçka. Ky nivel i ulët i cilësisë së arsimit tonë duhet të na shqetësojë të gjithëve: prindërit, arsimtarët, nxënësit, sociologët, hartuesit e teksteve, gazetarët, politikanët ... Me një punë të përbashkët të koordinuar mirë, mund të përmirësohet cilësia e shkollimit, përfshirë edhe zvogëlimin e analfabetizmit funksional te rinia jonë. E gjithë kjo që u tha deri më tani, mund të përmbledhet me konstatimin se në shumicën e vendeve në tranzicion, përfshirë vendet ballkanike, edhe Maqedoninë, Kosovën e Shqipërinë, kemi anarki në arsim, te ne veçmas në arsimin shqip.

- **Çfarë masash duhet të ndërmerren për të përmirësuar këtë gjendje?**

Për të përmirësuar këtë epidemi të kohës, këtë gjendje alarmante, të pamirë, me pasoja të rënda për ardhmërinë tonë, duhet kushtrimuar të gjithë: familja, shkolla, institucionet shtetërore, politika dhe gjithë shoqëria jonë. Çfarë masash duhet ndërmarrë:

- a) prindërit duhet të kujdesen më shumë për fëmijët e tyre;
- b) mësimdhënësit duhet të punojnë më me përkushtim, me zell dhe me metoda të reja ndërvepruese (interaktive);
- c) të motivohen nxënësit e studentët;
- ç) të përmirësohet gjendja ekonomike e popullatës;
- d) të sigurohen tekste mësimore cilësore;
- dh) mjetet e informimit të emetojnë më shumë programe arsimore e edukative.
- e) nga organet kompetente, të investohet më shumë në arsim;
- ë) të mos mashtrujmë njëri-tjetrin me fryerje notash;
- f) të hartojmë një strategji afatgjate arsimore.

Në këtë pikëpamje, dua të flas pak më shumë.

a) Prindërit duhet të kujdesen më shumë për fëmijët e tyre. Rëndom, ne i gëzohemi vetëm rastit kur fëmija jonë regjistrohet në shkollë, në klasën e parë dhe nuk mungon edhe interesimi ynë për punën e tij deri sa të mësojë të shkruajë e të lexojë, ndërsa në klasat e mëvonshme interesimi ynë zvogëlohet ose shuhet krejtësisht. Prindërit merren vetëm me punët e përditshme të mbijetesës, ndërsa për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve nuk qajnë kokën. Po të kemi ndonjë ankesë nga nxënësi për masat pedagogjike e ndëshkuese të arsimtarit, jorrallë prindi bëhet arrogant, agresiv e ndonjëherë edhe kërcënues, madje i dhunshëm ndaj arsimtarit. Gjatë vitit shkollor rrallë shihet prind në shkollë, në fund të vitit shkolla mbushullon me prindër që intervenojnë për nota “të shkëlqyeshme” për fëmijët e tyre. Fëmija duhet të jetë gjithnjë nën përkujdesjen e prindit: A shkon në shkollë?, Kur shkon e kur kthehet?, Çfarë sjelljesh e çfarë edukate ka? A lexon, çka e sa lexon? A i bën detyrat? Si e kalon kohën e lirë? Kur zgjohet e kur fle? Sa kohë qëndron në internet? Çka shfrytëzon nga rrjeti i internetit? etj.

b) Mësimdhënësit duhet të punojnë më me përkushtim, më me zell dhe me metoda ndërvepruese (interaktive). Për të qenë të suksesshëm, mësimdhënësi duhet të përpiqet që ta bëjë punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Metoda klasike e mësimdhënies, veçmas metoda frontale (e ligjërimit të arsimtarit) me gjeneratat e tanishme të të rinjve nuk po jep rezultate, as edhe në fakultet. Andaj, duhet zbatuar metodat bashkëkohore në mësimdhënie. Në orët e gjuhës amtare të shmanget mësimi skolarik, të mos kërkohet nga nxënësit vetëm që të riprodhojnë atë që e dëgjojnë ose e lexojnë, por të kërkohet nga ta të flasin e të shkruajnë me një origjinalitet, stil dhe kreativitet. Mësimi i gramatikës të vihet në funksionin e zbatimit praktik në jetën e përditshme. Nxënësit të nxiten që të lexojnë sa më shumë vepra artistike me vlerë letrare e gjuhësore. Ata të motivohen të thonë atë që mendojnë (qoftë edhe gabimisht), duke mbështetur e argumentuar mendimin, të kuptojnë atë që kanë lexuar a dëgjuar si dhe të kenë qëndrim vlerësues e kritik ndaj tyre. Mësimdhënësi në vlerësimet që jep për nxënësit duhet të jetë i matur, i drejtë, jofyes. Ndonjëherë, për fat të keq ne “luleve të njoma” (nxënësve) u hedhim ujë të valuar (valë).

c) Të motivohen nxënësit e studentët. Për të arritur sukses në ngritjen profesionale, njeriu duhet të jetë i motivuar. Jo vetëm nxënësit e shkollave fillore e të mesme, por as edhe studentët vërejt se

nuk janë të motivuar. Ata nuk mund të kenë vizion të qartë për të ardhmen, asgjë nuk mund të parashikohet në këtë shoqëri anarkie, ku asnjë gur më nuk gjendet në vendin e vet. Puna mund të sigurohet vetëm nëpërmjet partisë në pushtet ose nëse ikin jashtë shtetit. Të rrallë janë ata që gjejnë punë për shkollimin përkatës që kanë kryer. Kam dëgjuar shumë herë nga studentët: “nuk është me rëndësi se çfarë fakulteti mbaron, pajisu me një diplomë dhe bëju ushtar i partisë në pushtet.”

ç) *Të përmirësohet gjendja ekonomike e popullatës.* Të shumtë janë edhe studentët që për të siguruar kafshatën e gojës dhe shpenzimet e shkollimit detyrohen të punojnë punë të ndryshme jointelektuale, punë krahu. Në rastet e tilla, kur punohet 8-10 orë në ditë nuk mbetet kohë për të mësuar.

d) *Të përmirësohen tekstet mësimore.* Planet e programet mësimore, përmbajtjet e tyre, aparatura didaktike-metodike, gjuha në to duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me moshën dhe aftësitë psikike të nxënësit. Shumë libra shkollorë janë të stërngarkuar me informata të panevojshme e kërkesa të rënda, që sjellin efekte negative te nxënësit, duke shkaktuar mosinteresim dhe averzion. Thjesht, nxënësi të ngarkohet me barrë aq sa mund të bart, të qëndrojë në këmbë e të mos rrëzohet, sepse mund të mos ngrihet më asnjëherë për të qëndruar në këmbë të shëndosha dhe për të ecur përpara.

dh) *Mjetet e informimit të emetojnë më shumë programe arsimore e edukative.* Po të shëtisim nëpër programet televizive, aty më së shpeshti shohim antivlera: seriale me përmbajtje të shfrenuara filmike, luftë, dhunë, programe politike me gjuhë të urrejtjes, këngëtare e valltare gjysmëlakuriqe, përmbajtje të turpshme këngësh e “pislleqe” nga më të ndryshmet.

e) *Nga organet kompetente, të investohet më shumë në arsim.* Kushtet hapësinore të këqija, veçmas të shkollave shqipe, pagat e ulëta të mësimitdhënësve, mungesa e mjeteve didaktike janë një ndër faktorët që ndikojnë në nivelin e dobët të shkollimit të ne, përfshirë edhe analfabetizmin funksional.

ë) *Të mos mashtrrojmë njëri-tjetrin me fryerje notash.* Konstatim i përgjithshëm është se arsimit shqip gjatë 20-30 viteve të fundit ka pasur një rënie të përherëshme dhe fatkeqësisht nuk ka shenja përmirësimi. Ne për disa vite jemi duke e gënjyer e mashtruar njëri-tjetrin: nxënësi mashtron prindin – prindi mashtron mësuesin – mësuesi mashtron shkollën – shkolla mashtron ministrinë, ministria mashtron qeverinë – qeveria mashtron botën. Thjesht, çdokush mashtron çdokend. Praktikisht, nxënësi mashtron e gënjen prindin se po mëson; prindit i parapëlqen të besojë se fëmija i tij është në rrugë të drejtë, i bën trysni arsimtarit që t’i japë nota të larta, arsimtari mashtron nxënësin duke “kopjuar, ndihmuar e treguar” në testimin intern dhe ekstern si dhe në provimin e maturës; ministria e arsimit e mirëpret dhe vetkënaqet me mashtrimin e shkollave, pastaj këtë gënjeshtëri e përhap nëpër botë. Jo vetëm në ciklin e arsimit fillor e të mesëm, por edhe në radhët e profesorëve universitarë ka të tillë që mbulojnë dhe arsyejnë papunësinë e tyre, praktikisht gënjejnë veten dhe mashtrojnë studentët, prindërit e gjithë të tjerët me kalueshmëri të qind për qindtë të studentëve, madje të gjithë me nota të larta.

f) *Të hartojmë një strategji afatgjate arsimore.* Na mungon një strategji afatgjate për ngritjen e cilësisë në arsim. Lipset ristrukturuar rrënjësisht sistemin arsimor. Rinia është ardhmëria jonë. Një urti popullore thotë: “Çfarë të mbjellësh, do të korrësh”.

6.3. PËRDORIMI I GABUESHËM I RASAVE NË PËRKTHIMET NGA MAQEDONISHTJA NË SHQIP

Në këtë kumtesë kemi shqyrtuar ndikimin e maqedonishtes në morfosintaksën e variantit standard të shqipes në Maqedoni, përkatësisht përdorimin e gabueshëm të rasave në tekstet e përkthyer, që i përkasin stilit shoqëror-administrativ. Folësit e përkthyesit dygjuhësorë maqedonisht-shqip e anasjelltas është e nevojshme të njohin dallimet ndërmjet dy gjuhëve edhe në sistemin rasor: shqipja ka sistem rasor të emrave që përdoren pa dhe me parafjalë, ndërsa maqedonishtja nuk ka rasa, por përdor emra në formë të ngurosur me e pa parafjalë.

Për të trajtuar këtë temë jemi mbështetur në materiale burimore, në tekste të përkthyer nga maqedonishtja në shqip, duke dhënë përkthimet e gabueshme e më pas format e përkthimit të drejtë. Punimi ka edhe dobi praktike: për të tërhequr vëmendjen, shtuar kujdesin dhe vetëdijesuar përdoruesit e shqipes, veçmas përkthyesit dhe interpretuesit që të ruajnë e përdorin me vend sistemin rasor të shqipes e të mos e shëmtojnë atë gjatë përkthimit.

Fjalët kyçe: përkthim, ndikim, morfosintaksë, rasë, parafjalë.

I. HYRJE

Kultura gjuhësore është pjesë përbërëse e kulturës së përgjithshme shoqërore dhe individuale. Shqipja standarde ka marrë një rrugë të mbarë të përsosjes së përhershme, pasurimit, herrjes dhe zhvillimit të hovshëm. Gjuha, siç dihet, është pasqyrë e kulturës dhe e të arriturave të gjithëmbarshme të një populli, por edhe e çdo pjesëtari të tij. Ajo pëson ndryshime, zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Por, ky zhvillim i gjuhës varet prej njerëzve që e flasin atë.

Pasi dëgjuan kumtesat e programit dhe diskutimet rreth tyre, ku u vunë në dukje mjaft të meta dhe u shprehën shqetësime për gjuhën e shtypit, pjesëmarrësit e konferencës shkencore me temë “Gjuha e shtypit”, të zhvilluar në Institutin Albanologjik të Prishtinës më 10 maj 2017 në hapjen e veprimtarisë së përvitshme “Java e Albanologjisë”, miratuan njëzëri thirrjen e mëposhtme që iu drejtua gjithë organeve të shtypit, radiove dhe televizioneve në gjuhën shqipe me këtë përmbajtje: “Duke njohur dhe vlerësuar rëndësinë që ka gjuha e shtypit për zhvillimin e mëtejshëm të shqipes standarde, për pasurimin e saj me fjalë e shprehje të reja, për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme dhe për ngritjen e kulturës gjuhësore të shoqërisë, e quajmë të nevojshme t’ju bëjmë thirrje për të treguar kujdesin më të madh për kulturën gjuhësore në shtypin e shkruar e të folur dhe për të bërë një kthesë të ndjeshme drejt përmirësimit të gjendjes së sotme. Kultura gjuhësore e shtypit dhe kujdesi për mbarëvajtjen e gjuhës shqipe në tërësi janë pa dyshim tipar themelor i qytetërimit tonë dhe shenjë domethënëse nderimi ndaj kësaj vlere të lartë kulturore të trashëguar e të ruajtur gjatë shekujve.”

Në mediumet e shkruara dhe elektronike në gjuhën shqipe në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri e gjetiu shpeshherë hetohen shkelje të normës gramatikore (morfologjike e sintaksore). Një ndër gabimet më të shpeshta vërehet në mospërshtatjen e emrave të huaj në rasë.

II. LITERATURA E KONSULTUAR

Dihet se emri (qoftë anas apo i huaj) në fjali përdoret si kryefjalë, si pjesë plotësuese e kryefjalës ose e kallëzuesit, kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë, përcaktor, rrethanor, ndajshtim etj. Në varësi nga funksioni që ka, ndryshon edhe forma e tij.

Në morfologjinë e gjuhës standarde shqipe çështja e lakimit të emrave është përcaktuar qartë. Në të thuhet se **në gjuhën shqipe lakohen të gjithë emrat, pa përjashtim, cilido qoftë burimi i tyre.**¹⁰⁸

Përdorimi i emrave të përveçëm të huaj vetëm në formë të ngurosur është rrjedhojë e mendimit të gabuar të disave se emrat e tillë duhet të përdoren vetëm në formën origjinale, pra në trajtë të pashquar, me grafi autentike dhe pa mbaresa rasore ose me fjalë të tjera që emrat e huaj nuk duhet t'i përshtaten natyrës së shqipes apo nuk duhet "shqipëruar", sepse kjo është në modë dhe kështu e kërkuaka "bota e qytetëruar".

III. METODOLOGJIA

Për të trajtuar këtë temë jemi mbështetur në materiale burimore, në tekste të përkthyer nga maqedonishtja në shqip, në tekste gazetash, kryesisht të përditshmeve "Koha" dhe "Lajm", duke sjellë nga to përkthimet e gabueshme e më pas duke u përpjekur të gjejmë format e përkthimit të drejtë.

IV. REZULTATET

Është përdëftuar se shqipja është gjuhë sintetike-analitike, sepse kuptimet gramatikore dhe lidhjet sintaksore midis gjymtyrëve të fjalisë shprehen me anë formash sintetike të ndërtuara nga mbaresat (rasore e vetore), nëpërmjet ndërrimeve morfonologjike dhe supletivizmit; por është edhe analitike sepse krahas formave rasore të emrave, përdor edhe parafjalë. Ajo ka pesë rase në katër paradigma lakimi (2 në njëjës dhe 2 në shumës: në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar), por nuk ka forma të veçanta për të pesë raset.

Emri lakohet në njëjës e në shumës, në trajtën e pashquar e në të shquarën. **Shqipja nuk ka forma të veçanta për çdo rasë, por emrat në përgjithësi na shfaqen në tetë forma rasore, si:**

laps, lapsi, lapsit, lapsin, lapsa, lapsat, lapsash, lapsave.

vëlla, vëllai, vëllait, vëllanë, vëllezër, vëllezërit, vëllezërish, vëllezërve.

shok, shoku, shokut, shokun, shokë, shokët, shokësh, shokëve.

vajzë, vajze, vajza, vajzën, vajzës, vajzat, vajzash, vajzave.

¹⁰⁸ AShSh, IGjL, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 105.

Për të konkretizuar këtë, po japim paradigmen e emrit *lule*:

	<i>numri njëjës</i>		<i>numri shumës</i>	
<i>rasa</i>	<i>trajta e pashquar</i>	<i>trajta e shquar</i>	<i>trajta e pashquar</i>	<i>trajta e shquar</i>
Emërore	(një) lule	lulja	(disa) lule	lulet
Gjinore	i, e (një) luleje	i, e lules	i, e (disa) luleve	i, e luleve
Dhanore	(një) luleje	lules	(disa) luleve	luleve
Kallëzore	(një) lule	lulen	(disa) lule	lulet
Rrjedhore	prej (një) luleje	(prej) lules	prej (disa) lulesh	(prej) luleve

Po të shënojmë të gjitha format e paradigmës së lakimit të këtij emri, do të kemi:

lule	lule-je	lul-ja	lule-s	lule-n	lule-t	lule-sh	lule-ve
1	2	3	4	5	6	7	8

Rëndom forma e emrit në rasën emërore është e njëjtë me formën e kallëzores, ndërsa rasa gjinore çdo herë është e njëjtë me dhanoren (me përjashtim se në rasën gjinore kemi edhe një të përparme: i, e, të, së) e nganjëherë edhe me rrjedhoren.

Në të vërtetë, ndonjë emër mund të ketë më pak se 8 forma rasore: emrat e gjinisë asnjane, përkatësisht emrat prejpjesorë dhe ata prejmbiemërorë (të folur, (i) të foluri, të folurit; të ecur, (i) të ecuri, të ecurit; të zitë, të kuqtë etj., ose edhe ndonjë emër i gjinisë mashkullore a femërore, që i përket lakimit I, II apo III), por edhe më të paktë janë emrat që shfaqen në nëntë forma (të tipit: luftë, lufte, lufta, luftës, luftën, luftëra, luftërash, luftërat, luftërave).

Në ligjërimin e sotëm shqip ka prirje që format rasore të emrit të pakësohen. Funkcionin e rrjedhores po e merr gjithnjë e më tepër rasa emërore me parafjalë (p.sh.: folësit gegë thonë: Jam prej Shkupi, Prishtine, Prizreni – folësit toskë e në variantin standard: Jam nga Vlora, Korça, Gjirokastra). Në përvojën tonë pedagogjike në Maqedoni e Kosovë kemi vënë re se studentët, por jo vetëm ata, rrallëherë ose aspak nuk po e përdorin trajtën e shumësit të rrjedhores së pashquar të emrit me –sh ëprej (disa) lulesh, malesh, librash, ...,], meqë atë e kanë zëvendësuar me formën e trajtës së shquar ëprej (disa) luleve, maleve, librave, ...].

Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që vihet para një emri, përemri a numërori dhe këta i vë në lidhje me fjalë të tjera në një rasë të caktuar.

Parafjalët na ndihmojnë edhe për të gjetur rasat e emrave a të përemrave, sepse çdo parafjalë kërkon një rasë të caktuar. Emrat në rasën gjinore e dhanore nuk kanë parafjalë.

Ja pasqyra e përdorimit ose e mospërdorimit të parafjalëve në rasa:

Emërore // nga, te, tek, deri te, gjer te.

Gjinore // -----

Dhanore // -----

Kallëzore // në, me, mbi, pa, më, nën, për, nëpër, për në, ndër, përmbi etj.

Rrjedhore // prej, ndaj, sipas, rreth, buzë, afër, larg, para, pas, prapa, kundër,
ndërmjet, poshtë, përmes, përveç, tej, përballë etj.

Gjatë zhvillimit të gjuhës shqipe numri i parafjalëve ka ardhur duke u shtuar. Përdorimi i gjerë i parafjalëve ka shtuar tiparet analitike të sistemit gramatikor të shqipes së sotme.¹⁰⁹ Në përcaktimin rasor të një trajte, veç formës, merret parasysh edhe funksioni sintaksor e kuptimi.

Dihet se emri në fjali përdoret në funksione të ndryshme sintaksore, në rolin e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Ai në fjali përdoret si kryefjalë, si pjesë plotësuese e kryefjalës ose e kallëzuesit, kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë, përcaktor, rrethanor, ndajshim etj. Në varësi nga funksioni që ka, ndryshon edhe forma e tij. Emrat e përveçëm në gjuhën shqipe zakonisht përdoren në trajtën e shquar. Në këtë pikë shqipja dallohet nga shumë gjuhë të tjera. Në trajtën e pashquar ata hasen vetëm në disa funksione të pakta sintaksore, ku edhe emrat e përgjithshëm dalin gjithashtu të pashquar.¹¹⁰

Nga vetë funksioni i tyre, emrat e përveçëm, qofshin anas apo të huaj, janë të dalluar kuptimisht, kështu që përdorimi i tyre në trajtë të shquar ose të pashquar nuk ka vlerë kuptimore. Por, në përputhje me natyrën e shqipes si gjuhë me eptim (lakim dhe zgjedhim), këta emra duhet t'u nënshtrohen gjedheve të saj të lakimit, ashtu si dhe emrat e përgjithshëm. Ka disa rregulla që përcaktojnë kur emri i përveçëm përdoret i shquar dhe kur i pashquar.

Emrat e huaj të përveçëm po përdoren në formë të ngurosur, zakonisht në trajtë të pashquar edhe pse funksioni i tyre sintaksor kërkon që të jenë në një formë të caktuar rasore, si p.sh.: **Ivanov** nuk ia jep mandatin **Zaev** (kush?, kujt?) në vend të: *Ivanovi nuk ia jep mandatin Zaevit* (pra, emri i parë në rasën emërore, i dyti në dhanore); **Hamilton** hyn para **Vettel** (Në vend të përkthimit të drejtë: Hamiltoni hy para Vittelit), *Presidenti albanofob refuzoi qeverinë e Zoran Zaev* (drejt: Presidenti albanofob refuzoi qeverinë e Zoran Zaevit), ... *do të jetë në shënjestër nga Real nëse Bayern vendos ta shesë* (drejt: ... do të jetë në shënjestër të Realit nëse Bajerni vendos ta shesë). **Putin** thotë se është i gatshëm ... (drejt: Putini thotë se është i gatshëm ...). *Moska ka thënë se Trump dhe Putin janë pajtuar për të rritur dialogun* (drejt: Moska ka thënë se Trumpi dhe Putini janë pajtuar për të rritur dialogun), **Zaev** porosi **Gruevski**: *koha e uzurpuesve si ty ka mbaruar ...* (Gazeta Lajm, Maqedoni, e postuar më 14. 05. 2017) (drejt: Zaevi porositi Gruevskin: koha e uzurpuesve si ti ka mbaruar ...). *Nga LSDM kanë bërë të ditur se Zaev tanimë është duke përpiluar një garanci me shkrim ...* (drejt: Nga LSDM-ja kanë bërë të ditur se Zaevi ...). *Dorëzohet Ivanov, ja kur do t'ia japë mandatin Zaevit* (drejt: Dorëzohet Ivanovi, ja kur do t'ia japë mandatin Zaevit). *Takimi mes Ivanovit dhe Zaev mund të ndodhë në fillim të javës* (<http://indeksonline.net/lajmet/>) (drejt: Takimi mes Ivanovit dhe Zaevit mund të ndodhë në fillim të javës). **Vuçiç** ndryshon qëndrim pas takimit me **Putin**: *Të respektojmë shqiptarët!* (<http://www.infoshqip.com/>, 16. 05. 2017) (drejt: Vuçiçi ndryshon qëndrim pas takimit me Putinin: Të respektojmë shqiptarët!) etj.

¹⁰⁹ ASHSh, IGjL, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 383.

¹¹⁰ ASHSh, IGjL, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 126.

V. DISKUTIMI

Shqiptarët e Maqedonisë janë dygjuhësorë: përveç gjuhës amtare dinë edhe maqedonisht e ndokush edhe turqisht ose ndonjë gjuhë tjetër. Maqedonishtja ka qenë dhe sot e kësaj dite është gjuhë zyrtare, gjuhë e shkollimit sipëror të një numri të konsiderueshëm shqiptarësh, gjuhë që krahas gjuhës amtare zhvillohet në shkollat fillore e të mesme që nga klasa e tretë. Ajo ka përhapje shumë më të madhe se gjuha shqipe në mjetet e informimit, në jetën publike, shoqërore, sportive, administrative e shoqërore. Në këtë gjendje diglosie janë huazuar shumë sllavizma, konstrukte fjalësh, janë krijuar kalke e sintaksa e ligjërimit shqip në Maqedoni është vërshuar nga renditja e natyrës sllave. Edhe pse parimisht shumica e intelektualëve shqiptarë përpiqen ta ruajnë natyrën e shqipes, duke respektuar parimin sa më pak fjalë e ndërtime të huaja në ligjërimit tonë, është aq më mirë; megjithkëtë ndikime nga maqedonishtja hetohen mjaft shpesh.

Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimit e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip.¹¹¹

Po sjellim disa përkthime të pasakta e të dobëta që kemi arritur të sigurojmë nga materiali i vjelë burimor. Në kolonën e parë kemi dhënë versionin në maqedonisht, më pas përkthimin e gabueshëm dhe në kolonën e tretë përkthimin e drejtë në shqip:

<i>Teksti në maqedonisht</i>	<i>Përkthimi i gabueshëm në shqip</i>	<i>Përkthimi i drejtë në shqip</i>
оригинални документи	original dokument	dokumente origjinale
прекршочни одредби	kundërvajtja e dispozitave	dispozitat e kundërvajtjes
задолжително капитално финансирано пензиско осигурување	sigurim i detyruar pensional kapital financiar	sigurim pensional i detyrueshëm i kapitalit
емитува странска телевизиска програма	emeton program nga jashtë televiziv	emeton program të huaj televiziv
отстранување на константираните недостатоци и неправилности	largimi i mangësive të konstatuara dhe parregullsive	largimi i mangësive dhe i parregullsive të konstatuara
соодветна и правична застапеност	përfaqësim përkatës dhe juridik	përfaqësim i drejtë dhe përkatës
Со ова се уредува системот на плати, надомест на плати, надоместоци и други примања на судиите	Me këtë rregullohet sistemi për rroga, kompensim për rrogë, kompensime tjera dhe pranimit i gjyqtarëve	Me këtë rregullohet sistemi i pagave, kompensimet e pagave, kompensimet dhe të ardhurat e tjera të gjykatësve
се избира заменик на претседател	zgjedhet zëvendësi i kryetarit	zgjidhet zëvendëskryetari

¹¹¹ Asllan Hamiti, *Shqipja në dokumentet zyrtare në Maqedoni*, Kumtesat nga konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës” 2016, Prishtinë, 2017, f. 21.

недостаток на волја	mangësi vullneti	mungesë vullneti
воена вежба	stërvi tje luftarake	stërvi tje ushtarake
прекршочна пријава	fletëparaqitje kundërvajtëse	kallëzim për kundërvajtje
државен просветен инспектор	inspektori arsimor shtetëror	inspektori shtetëror i arsimit
болницата има потреба од специјалистички кадри	spitali ka nevojë për kuadër specializues	spitali ka nevojë për kuadër të specializuar

Në tekstet e përkthyer, që i përkasin stilit shtetëror-administrativ, shpeshherë gjejmë edhe përkthime të fjalëpërfjalshme e periudha të pakuptueshme në shqip, si p.sh.:

пациентот има право на грижа, лекување и рехабилитација	Pacienti ka të drejtë për brengosje, shërim dhe rehabilitim	Pacienti ka të drejtën e kujdesit, shërimit dhe të rehabilitimit
со ова се уредува системот на плати, надомест на плати, надоместоци и други примања на судиите	rregullohet sistemi për rroga, kompensim për rrogë, kompensime tjera dhe pranimi I gjyqtarëve	rregullohet sistemi I pagave, kompensimet e pagave, kompensimet dhe të ardhurat e tjera të gjykatësve
членови на семејството чија деловна способност е делумно или целосно одземена.	anëtarë të familjes të cilëve u është marrë aftësia punuese pjesërisht ose tërësisht.	anëtarë të familjes të cilët e kanë humbur aftësinë e punës pjesërisht ose tërësisht.
„Дискриминација” е правење на разлика помеѓу луѓето во исти или слични случаи врз основа на раса, пол, религија, политичка определба, морални и културни вредности и религиозни убедувања, национално и социјално потекло, национална припадност или сексуална склоност.	„Diskriminimi“ është bërja e dallimeve në mes njerëzve në raste të njeta apo të ngjashme në bazë të rasave , gjinis , rreligjionit , politikës e caktuar , vlerat morale dhe kulturore të bindjes së rreligjionit ,nacionale dhe preardhje sociale , prirje natyrore seksuale ose përkatësia nacionale .	“Diskriminimi” është dallimi që bëhet ndërmjet njerëzve për raste të njëjta a të ngjashme në bazë të acës, të gjinisë, të religjionit, të përcaktimit politik; të vlerave morale e kulturore si dhe të prirjes seksuale.
„Медицински податоци” се податоци што се однесуваат на здравјето на пациентот. Тоа се податоци што имаат јасна и блиска врска со	„Тë dhënat medicinale“ janë të dhënat të cilat sjellen në shëndetin e pacientit ,Ato janë të dhënat të cilat janë të qarta dhe në lidhje të	“Тë dhëna shëndetësore” janë të dhënat që lidhen (kanë të bëjnë) me shëndetin e pacientit. Ato janë të dhëna që kanë lidhje të ngushtë e të drejtpërdrejtë me shëndetin e

здравјето на пациентот, како и генетичките податоци за пациентот.	afërt me shëndetin e pacientit , si dhe të dhënurat gjenetike të pacientit .	pacientit, si edhe të dhënat gjenetike për pacientin.
Ако пациентот не го разбира вообичаениот јазик на обраќање во здравствената установа, тој има право на соодветен превод.	<i>Nëse pacienti nuk e kupton gjuhën e parapar në djeftimin e institucionit shëndetësor , ai ka të drejtë në formë përkatëse për përkthim .</i>	<i>Nëse pacienti nuk e kupton gjuhën e komunikimit të zakonshëm të institucionit shëndetësor, ai gëzon të drejtën e përkthimit përkatës.</i>
Во програмата задолжително треба да се предвидат контролни прегледи, заради тековно утврдување на состојбата со здравјето на пациентот.	Në programin detyruet duhet të parashikohen pasqyrat kontrolluese, për shkak të vërtetimit rrjedhës të gjendjes me shëndetin e pacientit.	Në program detyrimisht duhet të parashikohen kontrollet mjekësore, për shkak të përcjelljes së gjendjes shëndetësore të pacientit.
Мандатот на членовите на Комисијата изнесува две години, со право на повторен избор.	Mandati I anëtarëve të Komisionit nxjerr dy vite, me të drejtat e zgjedhjes së sërishme (përsëritshme).	Mandati I anëtarëve të Komisionit zgjat dy vjet, me të drejtë për rizgjedhje.

VI. KONKLuzionET

Me këtë kumtesë u përpoqëm të vëmë në dukje ndikimin e fuqishëm të maqedonishtes, po edhe të gjuhëve të tjera, gjatë përkthimit e interpretimit, veçmas në përdorimin e gabueshëm të emrave nëpër rasa në variantin standard të shqipes që po përdoret në Maqedoni, disa thyerje normash të përhapura edhe më gjerë. Vlerësojmë se folësit që njohin e përdorin dy e më tepër gjuhë: duhet t'i ruajnë e të mos i përziejnë kodet gjuhësore, sidomos të përdorin drejt sistemin rasor të shqipes.

Folësit e përkthyesit dygjuhësorë shqip – gjuhë e huaj e anasjelltas duhet të njohin dallimet e ngjashmëritë ndërmjet gjuhëve: shqipja ka sistem rasor të emrave që përdoren pa dhe me parafjalë, ndërsa shumë gjuhë të tjera indoevropiane nuk kanë raso, por emrat në to përdoren në formë të ngurosur me e pa parafjalë.

Ky artikull ka edhe dobi praktike: për të vetëdijesuar e tërhequr vëmendjen sidomos përkthyesve e interpretuesve që të ruajnë e përdorin me vend sistemin rasor të shqipes e të mos e shëmtojnë apo, siç shprehet prof. Gjovalin Shkurtaj, të mos e “masakrojnë” atë.

Në qoftë se emrat në shqipen nuk i përdorim në formën e duhur rasore, varësisht nga funksioni i tij në fjali, atëherë bëjmë dy krime gjuhësore:

- a) rrënojmë sistemin rasor për ta shndërruar shqipen nga tipi sintetik-analitik (gjuhë me raso dhe me parafjalë) në gjuhë analitike (gjuhë pa raso);
- b) prishim rregullat sintaksore dhe errësojmë kuptimin e fjalive.

Epoka jonë është epokë e ngritjes historike të popullit shqiptar, e pasurimit dhe e forcimit të identitetit kombëtar e gjuhësor. Ta ruajmë e ta modernizojmë gjuhën tonë, sepse ashtu do ta ruajmë e do ta pasurojmë identitetin kombëtar në këtë botë të globalizimit, që aq fort i kërcënon të veçantat etnike kulturore, që, megjithatë, përfaqësojnë pasurinë e planetit.

VII. BURIMET

Dokumente zyrtare të përkthyer nga maqedonishtja në shqip
Gazeta “Koha”, “Lajm” etj.
<http://www.infoshqip.com>
<http://indeksonline.net/lajmet>

VIII. REFERENCAT

AShSh, IGjL (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë.
Конески, Блаже (1967), *Грамматика на македонскиот литературен јазик, I и II дел*, Скопје.
Hamiti, Asllan (2005, 2011), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup.
Hamiti, Asllan (2011), *Gjuha e teksteve shkollore të kimisë të arsimit fillor në Maqedoni*, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, 3-4. 10. 2011, Tetovë-Shkup, f. 47-51.
Hamiti, Asllan (2011), *Niveli metodologjik i gramatikave të gjuhës shqipe*, Seminari XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 301-308.
Hamiti, Asllan (2012), *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni*, Scupi 2, “Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare”, Shkup, 71-86.
Hamiti, Asllan (2012), *Shqipja e gazetave në Maqedoni*, Konferencë Shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde”, Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.
Hamiti, Asllan (2017), *Shqipja në dokumentet zyrtare në Maqedoni*, Kumtesat nga konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës” 2016, Prishtinë, f. 21-29.

6.4. SHQIPJA E GAZETAVE NË MAQEDONI

Kultura gjuhësore është pjesë përbërëse e kulturës së përgjithshme shoqërore dhe individuale. Shqipja standarde ka marrë një rrugë të mbarë të përsosjes së përhershme, pasurimit, herjes dhe zhvillimit të hovshëm. Gjuha është pasqyrë e kulturës dhe e të arriturave të gjithmbarshme të një populli, por edhe e çdo pjesëtari të tij. Ajo pëson ndryshime, zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Por, ky zhvillim i gjuhës varet prej njerëzve që e flasin atë.

Shqipja standarde në Maqedoni po përdoret në institucionet arsimore, në mjetet e informimit, në veprat letrare e shkencore, në tekstet shkollore etj. Mjetet e informimit, si shtypi ashtu edhe radioja e televizioni, kanë rëndësi të madhe jo vetëm si medime më masive të informimit publik, por edhe si mjete e burime për formimin gjuhësor të lexuesve, dëgjuesve dhe të teleshikuesve, meqë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë për përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare te e gjithë popullata shqiptare në Maqedoni e më gjerë.

Marrë në tërësi, norma e shqipes standarde dukshëm po zbatohet në shkollat shqipe, në mjetet e informimit publik e gjetiu. Megjithëkëtë, jemi dëshmitarë se në praktikën gjuhësore shpeshherë po thyhen normat në të gjitha rrafshet, si në rrafshin leksikor, sintaksor (si pjesë më të lëvizshme të gjuhës e më të eksponuara ndaj ndikimeve të huaja), në rrafshin morfologjik, fonetik e fonologjik etj. Disa gazetarë, redaktorë gjuhësorë, përkthyes, lektorë, korrektorë etj., nga pakujdesia, puna e ngutshme, joserioziteti në punë, papërgjegjësia ose nga mosnjohja e mjaftueshme e normave të shqipes standarde, bëjnë gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme.

Përgjithësisht dihet se thyerja e normës ka shumë shkaqe. Gabimet rrjedhin ngaqë nuk njihen rregullat drejtshkrimore dhe fjala shkruhet sipas shqiptimit vetjak të individit. Ata që pohojnë pamjaftueshmërinë e strukturës dhe varfërinë leksikore të shqipes standarde, në të vërtetë nuk e njohin atë dhe parapëlqejnë një arsytim të tillë vetjak. Përveç padijes e injorancës, ndër shkaqet kryesore të thyerjes së normës së shkrimit dhe të shqiptimit letrar janë:

- a) veçoritë dialektore të folësit,
- b) ndikimi i gjuhëve të huaja në leksikun dhe në gramatikën e folësve,
- c) ligjërimi i shkujdesur dhe
- ç) shqiptimi shkronjë për shkronjë i fjalëve të shkruara.

Për gjendjen e sotme të shqipes standarde, tri shkaqet e para përbëjnë problemin kryesor për vendosjen e normave të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit dhe ato paraqesin vështirësi më të mëdha për t'u kapërcyer.

Veçoritë dialektore të shqiptimit folësi zakonisht i mëson që në fëmijëri, prandaj duhet një punë e gjatë dhe këmbëngulëse për të shmangur ato dhe për të përvetësuar shprehitë e shqiptimit letrar, rrjedhimisht edhe të drejtshkrimit. Te shumica e shqiptarëve ndihet nënshtresa e së folmes krahinore; disa as që bëjnë përpjekje për të njohur e zbatuar rregullat e shkrimit e të shqiptimit letrar.

Pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972) e deri më tani u pa shumë qartë se si gjuha standarde shqipe, sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja gege, mëton ta zbatojë gjuhën letrare, porse me një *ngjyresë fonike gegizuese* (p.sh. shqiptimi i /è/-së si /ê/: *bêj, nê:n, bêra, rêra, zêri* etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë “qethje” sado të pjesshme të bëra nga “Rregullat e drejtshkrimit”, tërheq nga *hipertoskizmi* (p.sh. shqiptimi me ëë] të prapme i fjalëve me ëe]: *vënt, kuvënd, mëndje, mëndoj, qëndër, fëmër, zëmër* etj.).

Shqiptarët e Maqedonisë përgjithësisht njohin dhe përdorin *varietetin territorial* të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), *shqipen standarde* (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e informimit publik) si dhe *maqedonishten standarde* (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) shpeshherë ndodhin përzierje kodesh, situatë në të cilën asnjë gjuhë e përdorur vetëm, nuk do të ishte e mjaftueshme. Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor – pak fjalë nga shqipja e pak fjalë nga maqedonishtja, pastaj kthehen tek e para me disa fjalë më shumë (me huazime), me shprehi nyjëtimore të shqipes kur flasin maqedonisht, sidomos në theksimin e

fjalëve; me një morfologji e sintaksë të ndërmjetme (herë sipas natyrës së shqipes e herë sipas asaj të maqedonishtes).

Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip. Përkthimet lëngojnë sidomos në zëvendësimin e formave rasore të shqipes me forma analitike: parafjalë + emër, meqë maqedonishtja nuk ka lakim emrash.

Sidoqoftë dukuritë e tilla janë me interes e për gjuhët në kontakt dhe ndikimin ndërgjuhësor e përgjithësisht për sociolinguistikën. Por, në këtë kumtim vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në problemet praktike që janë pasojë e përdorimit të maqedonishtes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, pra si “gjuhë e lartë” dhe të shqipes si “gjuhë e ulët”.

Për të parë shkallën e zbatimit a moszbatimit të normës letrare në ligjërimin e shkruar në Maqedoni, shfletuam tri gazeta ditore: “Lajm-in”, “Kohën” dhe “Zhurnalin”. Në një shtjellim përmbledhës, nuk mund të përshkruhen të gjitha, por me këtë rast po përmendim disa nga to.

Gjëja e parë që na ra në sy në shkrimet e këtyre gazetave është ndarja e gabueshme e fjalëve në rrokje. Në ndarjen e tekstit në kolona të ngushta, shpeshherë ndahen edhe dyshkronjëshat, si në fjalët: *mar-rveshje*, *fil-limit*, *lid-hur*, *urd-hërdhënësi* (f. 2), *dal-lim* (f. 3), *ndër-roi* (f. 5), *pjesëmar-rësve* (f. 5), *hol-lësi* (f. 6), *menax-him* (f. 14), *gjithn-jë* (24), *mrekul-li* (f. 24), *ndër-roni* (f. 24), *mrekul-lueshëm* (f. 26) në gazetën “Lajm” të datës 07. 12. 2012; *mar-rëveshje*, *shkol-lë* (Koha e datës 07. 12. 2012, f. 2, 9), por ka raste edhe kur një shkronjë e vetme mbetet në fund të rreshtit, si *u sh/-pall* (Koha, 07.12. 2012, f. 7) etj.

Në shkrimin e fjalëve bashkë, ndaras dhe me vizë në mes, po kështu hetohen gabime: *kundër akuza* (duhet: kundërakuza, Koha, 07.12. 2012, f. 8), ky projekt është *shumë vjeçar* (duhet: shumëvjeçar, Koha, 07. 12. 2012, f. 3), pauzë e shkurtë *dy javore* (Lajm, 07.12.2012, f. 23, duhet: dyjavore) etj.

Edhe gabimet teknike janë të shpeshta, si: arsimtar për *lnëdet* mjekësore (Lajm, 07.12.2012, f. 29), *kushtret* (duhet: kushtet, f. 29), pas zgjedhjes së *nabruar* (Lajm, 07.12. 2012, f. 29). Herë-herë në këto gazeta në vend të <i>-së së vogël gjejmë shkronjën e madhe <I>. P.sh.: Në vendet ku është *I* zhvilluar sporti *I* skitarisë garat zyrtare fillojnë ... (Lajm, 07.12.2012, f. 23). Përgatitjet e tyre *I* kanë filluar që nga gushti *dhe atë* nëpër vende ku ka kushte adekuate për sportin e skitarisë. (Lajm, 07.12.2012, f. 23).

Është bërë mode gjuhësore, si duket nën ndikimin e anglishtes, që emrat e muajve të shkruhen me shkronjën e parë të madhe (ndonjëherë edhe pa parafjalën më), si: Mbledhja e nënshkrimeve bëhet *07 Dhjetor* 2012.

Përdorimi pa vend i ëë]-së në pozitë fundore është i shpeshtë, si: *parasyshtë*, *zgjatë*, (Lajm 07.12.2012, f. 13, 12). Oferta e tyre është e ndërlidhur *drejtpërdejtë* me popullatën (Koha, 07.12.2012, f. 6).

Trajta e shkurtër e bashkuar e kallëzores *ma* (më + e) ndonjëherë ndahet me apostrof (m’a), ndërsa ato që duhet të ndahen me apostrof: *m’i* dhe *t’i* shpeshherë shkruhen bashkë: Duhet *ti* shpalosen krejt kuptimet (Lajm, 07. 12. 2012, f. 11).

Edhe shenjat e pikësimit shpeshherë nuk përdoren me vend: *Nuk ka dëshirë nuk ka vullnet nuk ka gatishmëri* (askund nuk ka presje e do të duhej: Nuk ka dëshirë, nuk ka vullnet, nuk ka gatishmëri. Koha, 07. 12. 2012, f. 4).

Shpeshherë hetohen edhe shkelje të normës gramatikore (morfologjike e sintaksore). Përdorimi i formës së shumësit pa <ë> fundore, si *shqiptar* (në vend të formës së drejtë *shqiptarë*), *arsimtar* (në vend *arsimtarë*) etj.; emra *qesharak* (duhet me <ë>), ata *qytetar* (f. 15, Lajm, 07. 12. 2012), synon të vetëdijësojë afaristët *shqiptar* (pa <ë> në Lajm, 07. 12. 2012, f. 6) tubon afaristët *shqiptar* (Koha, 07. 12. 2012, f. 6,), Komisioni *shtetror* (Lajm, 07.12.2012, f. 15). Dializa realizohet nën mbykqyrje të mjekëve *specialist* (Koha, 07.12.2012, f. 8). Maqedonisë një porosi e *drejtpërdrejt* i erdhi edhe nga vet eurokomisari i zgjerimit (Koha, 07. 12. 2012, f. 2). Struga e gatshme *ta përballoj* dëborën (duhet: ta përballojë, Koha, 07. 12. 2012, f. 8) etj.

Përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën të ndeshet shpesh, si: *do lexoj, do punoj* (në vend: *do të lexoj, do të punoj*). Mjaft shpesh gabohet në përdorimin e formës standarde të lidhore, sepse ose në vend të /ë/-së përdoret /e/-ja ose pjesëza të + forma e mënyrës dëftore e kohës të tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh. (duhet) *të shkoje* ose *të shkon, të punoje* ose *të punon, të mësoje* ose *të mëson* (< duhet të shkojë, të punojë, të mësojë) etj. Struga e gatshme *ta përballoj* dëborën (Koha, 07. 12. 2012, f. 8).

Në analogji me foljet e zgjedhimit të parë, edhe foljet e zgjedhimit të tretë disa herë si në të folurit ashtu edhe në të shkruarit përdoren jo sipas rregullave gramatikore (pa mbaresa vetore në numrin njëjës në kohën e tashme të mënyrës dëftore), por me mbaresa në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit, si (ti, ai, ajo) *din, pin, han, flen* (< duhet: di, pi, ha, fle) etj.

Në prirjen për rrafshimin e formave të foljeve, edhe foljet apofonike (me këmbimet e fonemave /a/ ose /je/ në /o/) në kohën e kryer të thjeshtë dhe në pjesore shpeshherë po përdoren gabimisht. Bie fjala dëgjojmë e lexojmë: *mjel - mjela - (kam) mjelur* (< duhet: mjel - mola - (kam) mjelë, *vjel - vjela - vjelur* (< duhet: vjel - vola - vjelë), *mbjell - mbjella - mbjellur* (< duhet: mbjell - mbolla - mbjellë), *sjell - sjella - sjellur* (< duhet: sjell - solla - sjellë) etj.

Emrat e huaj vetjakë, jorrallë po përdoren në formë të ngurosur, edhe pse funksioni i tyre sintaksor kërkon që të jenë në formë të caktuar rasore dhe në trajtën e shquar: jo *u takua me Obama*, por *u takua me Obamën*. Paraprakisht Veljanovski ka dërguar shkresë *deri te Ivanova ...* (do të duhej: Paraprakisht Veljanovski i ka dërguar shkresë Ivanovës ... Koha, 07. 12. 2012, f. 3).

Mosdallimi i gjinisë së përemrave vetorë të vetës së tretë të numrit shumë *ata* dhe *ato: ata burra* dhe *ata gra* ose *ato burra* dhe *ato gra* (për të dy gjinitë) është dukuri mjaft e përhapur në të folmet shqipe të Maqedonisë, rrjedhimisht kjo veçori shfaqet shpesh edhe në ligjërimin letrar të folësve të këtij areali, qoftë në formën e folur, qoftë në formën e shkruar. Po kështu, jorrallë në vend të përemrave vetorë *ne, ju* përdoren trajtat e tyre të dhanores *neve, juve* (*neve* kemi punuar, *juve* jeni të zellshëm).

Një sëmundje e stilit shoqëroro-politik e administrativ ka qenë dhe mbetet ende përdorimi i gabuar i emrave në rasi, nën ndikimin e gjuhëve të tjera që nuk kanë sistem rasor, te ne duke përfshirë edhe maqedonishten, e cila nuk ka lakim emrash, por funksionin e emrit në fjali e shpreh nëpërmjet një parafjale + emrit në njëjës a shumë, në trajtë të shquar a të pashquar. P.sh.:

Gjashtë shtete *nga BE* (Lajm, 07.12.2012, f. 7; duhet: gjashtë shtete të BE. ...). Të rritet bashkëpunimi me institucione dhe universitete *nga Republika e Francës* (Lajm, 07.12.2012, f. 8). BE-ja do të mund sërish të vendos obligim të përkohshëm për pezullimin e regjimit të vizave për

pesë shtete nga Ballkani (Lajm, 07.12.2012, f. 7; këtu kemi mospërshtatje në rasë: të Ballkanit, pra jo me emërore, por me gjinore). Trajko Veljanovski ka dërguar kërkesë me shkrim *deri te kryetarja e Komisionit për Punë dhe Politikë Sociale ...* (Lajm, 07.12.2012, f. 5). Dokumentet dorëzohen *deri te Arkivi i Drejtorisë ...* (Lajm, 07.12.2012, f. 12; duhet: dokumentet i dorëzohen Arkivit ...). Paragrafi 1 nga *Ligji për marrëdhënie pune dhe neni 60 nga Ligji për arsim të mesëm ...* (Lajm, 07.12.2012, f. 20). Sipas nenit 77 nga *Ligji për arsim fillor* (Lajm, 07.12.2012, f. 13; duhet: të Ligjit) etj.

Gabimet në mospërdorimin e rasës gjinore në shkrimet gazetareske në Maqedoni janë shumë të shpeshta. Në shpalljet a konkurset për punësim, në gazetat shqipe në Maqedoni rëndom lexojmë: *Një arsimtar për gjuhë maqedonase, për histori, për fizikë, për kimi, për gjuhë angleze, për sociologji* (Lajm, 07.12.2012, f. 28, 29, 30; në vend: një arsimtar të maqedonishtes, të historisë, të fizikës, të kimisë, të anglishtes, të sociologjisë). Zakonisht në gazetat tona lexojmë: *Ministri për Punë të jashtme të Maqedonisë* (ndikim nga maqedonishtja); *Ministria për arsim dhe shkencë* (në vend: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës); *Fakulteti filologjik, Fakulteti ekonomik* (në vend Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Ekonomisë etj.)

Një dukuri shumë e përhapur në tekstet e mjeteve të informimit shqip në Maqedoni është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i disa fjalive, togfjalëshave e shprehjeve, me fjalë e shprehje sipas gjedhës së huaj. Në pjesën më të madhe të rasteve përdoret gabimisht ndonjë fjalë në vend të fjalës përkatëse që përdoret në mbarë shqipen, si “*edhe atë*” nën ndikimin e maqedonishtes “i toa”: *Numri i aksidenteve edhe atë për 400 më pak se vitin e kaluar. ... është votuar vendim* (maq. e izglasana odluka), *për vitin shkollor 2012/2013 viti* (në maqedonishten pas shifrës së vitit rregullisht shkruhet fjala vit - godina): *deri më datë 31. korrik 2012 viti* (Lajm, 07.12.2012, f. 18), *profesor i çrregullt* (nga maq. vonreden profesor - në vend të prof. inordinar ose prof. asistent), *përgatitje dimërore* (Koha, 07.12.2012, f. 9, në vend të fjalës pajisje).

Po kështu, e gabueshme është edhe shprehja “*ndaj mendimin me ...*” në vend “pajtohem me mendimin e...” “Një dukuri e shpeshtë në mjetet e informimit në gjuhën shqipe në Maqedoni është shprehja “*vjen deri te*” që është kalk nga maqedonishtja “doagja do” si në fjalinë: *Nëse vjen deri te takimi ...*, (për: Nëse takohen)... *Dokumentet dorëzohen deri te Arkivi I Drejtorisë ...* (Lajm, 07. 10. 2012, f. 12) etj.

Në adresimin e letrave, të shkresave zyrtare etj. në të shumtën e rasteve shkruhet: *deri te ... Ministria për arsim dhe shkencë, Byroja për zhvillimin e arsimit, Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit filologjik ...* në vend që emri i institucionit të shkruhet në rasën gjinore, pra: Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, Këshillit Mësimor-shkencor të Fakultetit të Filologjisë etj. Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e saposhënuar, epidemi e përhapur te ne është jo vetëm përdorimi i emrave në emërore me parafjalë në vend të formës së drejtë të tyre në rasën gjinore, por edhe shkrimi i emrave të institucioneve vetëm me shkronjën e parë të madhe e me të gjitha shkronjat e tjera të vogla, nën ndikimin e rregullave të drejtshkrimit të maqedonishtes.

Një ndikim tipik është edhe përdorimi i ndajfoljes “*gjatë kohë*” kalk nga “dollgo vreme” në vend të shprehjes “për një kohë të gjatë”. Formë e papranueshme është edhe kalku “*në pyetje është*” nga “maq. vo prashanje e” në vend që të thuhet “fjala është për” ose *kjo është pyetje e rëndësishme* nga “maq. ova e značajno prashanje” në vend që të thuhet “kjo është çështje e rëndësishme”.

Jo rrallë vërehen ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku pëstjellohet mendimi deri në moskuptim. Ndikime sintaksore të maqedonishtes në shqipen që flitet e shkruhet në Maqedoni hetohen veçmas në rendin e përcaktorëve. Në shqipen kemi topikën *emër + përcaktor*, ndërsa në maqedonishten *përcaktor + emër*. Krahaso shqip: *djalë i mirë* – maqedonisht: *dobar dečko*, shqip: *kati i pestë* – maqedonisht: *petti sprat*; shqip: *prodhim vendor* – maqedonisht: *domashno proizvodstvo*. Kur ka dy e më tepër përcaktorë të njëpasnjëshëm, siç dihet rendi i rëndomtë në gjuhën shqipe është: *emër + përcaktor + përcaktor*; d.m.th. *emër + mbiemër* (i nyjshëm, i panyjshëm, numëror), *emër në rasën gjinore, përemër*. Ndërsa topika e përcaktorëve në gjuhën maqedonase është ky: *përcaktor + përcaktor + përcaktor + emër*; d.m.th. *mbiemër* (i panyjshëm, numëror), *emër me parafjalë, përemër + emër*. Nëse grupi emëror në shqipen ka topikën 1, 2, 3 maqedonishtja ka topikë të anasjelltë 3, 2, 1 ose 2, 3, 1; por gjithnjë fjala që përcaktohet mbetet në fund, sipas modelit: shq. *marrëdhënie pune* (1, 2) – maq. *raboten odnos* (2, 1); shq. *ndihmë e plotë juridike* (1, 2, 3) – maq. *celosna pravna pomosh* (2, 3, 1).

Në stilin administrativ, shoqëror-politik si dhe në stile të tjera të ligjërimit në Maqedoni është e shpeshtë renditja e fjalëve në fjali sipas gjedhes së maqedonishtes. Ja disa të tilla: *Në origjinal ose kopje e vulosur të diplomës ose certifikatë për arsimin e mbaruar* (Lajm, 7.12.2012, f. 29). *Origjinal ose kopje e vulosur nga diploma ose vërtetim për arsimin e kryer* (Lajm, 07.12.2012, f. 30). *Të zotërojnë gjuhën maqedonase dhe literaturë* (në vend: *Të zotërojnë gjuhën dhe letërsinë maqedonase*; në një shpallje, Lajm, 07.12.2012, f. 28). *Deri më 31.08. 2013 viti* (maq.: do 31. 08 2013 godina; Lajm, 07.12.2012, f. 28, 29, 30); *deri më datë 31.08.2012 viti* (Lajm, 07.12.2012, f. 18). *Që pritet të jep mundësi për pranimin në kohë të sa më të shpejt të kësaj dispozite* (Lajm, 07.12.2012, f. 7). *Takimi shpejtë është dashur të ndërpritet sepse në aspektin e kohës kaloi në ditën e enjte* (duhet: *shpejt, presje para lidhëzës sepse, mendimi nuk shprehet qartë*; Lajm, 07. 12.2012, f. 2). *Shpallje publike për punësim në kohë të caktuar deri më datë 31 gusht 2012 viti në dimensionet vijuese: një arsimtar për informatikë, dy arsimtarë për mësim klasor ...* (Lajm, 07.12.2012, f. 30).

Gjatë shfletimit të këtyre gazetave ditore gjejmë edhe fjali me mospërshtatje të përcaktorëve në gjini, përdorime të gabueshme të fjalëve nga pikëpamja kuptimore etj., si p.sh.: *Paralajmërohet drejtuesit e automjeteve që të mos marrin rrugë pa ndonjë nevojë dhe pa përgatitje dimërore* (duhet: *Paralajmërohen ...pa pajisje...*, Koha, 07. 12. 2012, f. 9). Më 19 dhjetor do të zhvillohet *spektri i bukurës* (Lajm, 07.12.2012, f. 16, duhet: konkursi, spektakli i bukurisë) etj.

Shqiptarët e Maqedonisë janë dygjuhësorë: përveç gjuhës amtare dinë edhe maqedonisht e ndokush edhe turqisht ose ndonjë gjuhë tjetër. Maqedonishtja ka përhapje shumë më të madhe se gjuha shqipe në mjetet e informimit, në jetën publike, shoqërore, sportive, administrative e shoqërore. Si pasojë e ndikimit shumëshekullor të gjuhëve sllave, si edhe sot e gjithë ditën të përdorimit të kufizuar zyrtar të shqipes në Maqedoni e në gjendje diglosie te ne janë huazuar shumë sllavizma, konstrukte fjalësh, janë krijuar kalke e sintaksa e ligjërimit shqip në Maqedoni është vërsuar nga renditja e natyrës sllave. Edhe pse parimisht shumica e gazetarëve shqiptarë përpiqen ta ruajnë natyrën e shqipes, duke respektuar parimin sa më pak fjalë e ndërtime të huaja në ligjërimit tonë, është aq më mirë; megjithkëtë ndikime nga maqedonishtja hetohen mjaft shpesh.

Shqipja standarde është dhe duhet të jetë mbarëkombëtare, ka përhapje në tërë kombin, ajo po përdoret si nga shqiptarët brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë kufijve të saj. Njëjtësimi

gjithëkombëtar i gjuhës është i domosdoshëm. Përpjekjet për të krijuar përsëri gjendjen me shumë variante letrare janë të padëshirueshme, të dëmshme, prapakthyesë dhe me pasoja të dëmshme e përçarëse për kombin tonë.

Procesi i globalizimit po bëhet i rrezikshëm për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë edhe më tej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Sot, problem qenësor është ballafaqimi i gjuhës shqipe me gjuhët e mëdha, veçanërisht me anglishten në rrafshin leksikor e terminologjik. *Për profilin e gazetarëve, të politikanëve, të përkthyesve, të administratorëve dhe të gjithë shqiptarëve në Maqedoni paraqitet një sfidë e re: ballafaqimi i shqipes me maqedonishten, sidomos në rrafshin leksikor e terminologjik.*

Detyrë jona është të përpiqemi të ngrisim vazhdimisht kulturën tonë gjuhësore, ta kultivojmë e pasurojmë shqipen standarde dhe të tregojmë kujdes të përhershëm për të. Duke e ditur peshën e madhe të ligjërimit të shkruar e të folur në mjetet e informimit, punonjësit e këtyre mediave duhet të jenë të vetëdijshëm për punën dhe misionin e tyre të shumëfishtë, jo vetëm për informimin objektiv të masës së gjerë, por edhe për ngritjen e kulturës gjuhësore të popullatës në përgjithësi.

Në Evropën e Bashkuar, ky synojmë të hyjmë, gjuhët kombëtare duhet të bëhen të pajtueshme në nivelin e aftësive shënjuese e komunikuese. Duhet përcaktuar se si do të quhen në gjuhën shqipe shumë nocione dhe sende të botës së sotme, qoftë me fjalë shqipe ose të ndonjë burimi tjetër.

Planifikimi gjuhësor duhet bërë me ndërgjegje të plotë, për arsye se ndërtimet e huaja gramatikore prekin strukturën e gjuhës, por edhe kur fjalët e huaja përdoren për një kohë më të gjatë dhe më shpesh, ato çrrënjosen më me vështirësi. Pasurimi i gjuhës sonë letrare me fjalë, shprehje e frazeologjizma të reja nga të folmet tona jep ndihmesë të madhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes standarde nga ndikimet e huaja, duke përfshirë edhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të gurrës shqipe. Gjithsesi edhe fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë janë të dobishme për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe.

Literatura:

1. Gazetat *Lajm, Koha, Zhurnal*, Shkup, 2012.
2. R. A. Hudson, *Sociolinguistika*, Kumanovë, 2007.
- ³ Emil Lafe, *Gjuha e medias sot - probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë.
4. Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.
5. IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.
6. Bllazhe Koneski, *Gramatika na makedonskiot literaturen jazik (pjesa I, II)*, Shkup, 1976.
7. Emil Lafe, *Gjuha e medias sot - probleme dhe detyra*, Gjuha jonë nr. 1-2, 2000, Tiranë, 9-21.
8. Grup autorësh, *Pravopis na makedonskiot jazik*, Shkup, 1988.
9. Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit - tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, 31-36.

10. Stojka Bojkovska, Liljana Minova - Gjorkova, Dimitar Pandev, Zhivko Cvetkovski, *Makedonski jazik za srednoto obrazovanie*, Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2001.
11. Gjovalin Shkurtaj, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë nr. 1-2, 2000, Tiranë, 31-40.
12. Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2011.
13. Asllan Hamiti, *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni*, Shqyrtime albanologjike 8, Shkup, 2005, f. 48-58.
14. Asllan Hamiti, *Sistemi rasor i shqipes dhe përdorimi i emrave të përveçëm të huaj*, kumtesë e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, mbajtur më 13 - 24. 08. 2007 në Prishtinë.
15. Asllan Hamiti, *Shqipja standarde dhe kultura gjuhësore te ne*, Konferenca e dytë Albanologjike, Ohër, 23-27 shtator 2008.
16. Asllan Hamiti, *Diglosia në Maqedoni dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe*, “Java e Shkencës 2012”, mbajtur në Prishtinë, më 16 - 19. 05. 2012, f. 187-190.

6.5. SHQIPJA NË DOKUMENTET ZYRTARE NË MAQEDONI

Abstrakt

Në këtë kumtim vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në problemet e moszbatimit të normave gjuhësore të shqipes standarde në dokumentet zyrtare në Maqedoni. Në kushtet e diglosisë, në variantin shqip të dokumenteve zyrtare në Maqedoni kemi një “shqipe të maqedonizuar”. Përkthimet lëngojnë sidomos në zëvendësimin e formave rasore të shqipes me forma analitike të maqedonishtes.

Në to gjejmë gabime të të gjitha rrafsheve gjuhësore: fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore, por më të rënda janë shkarjet morfo-sintaksore e leksikore. Në shtjellimin tonë do të pasqyrojmë veç e veç disa nga gabimet më të shpeshta dhe në fund do të japim edhe disa propozime konkrete për përmirësimin e gjendjes.

Fjalët kyçe: diglosi, përkthim, normë gjuhësore, gabime

Shqiptarët e Maqedonisë përgjithësisht njohin dhe përdorin *varietetin territorial* të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), *shqipen standarde* (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e

informimit publik) si dhe *maqedonishten standarde* (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) shpeshherë ndodhin përzierje kodesh, situatë në të cilën asnjë gjuhë e përdorur vetëm, nuk do të ishte e mjaftueshme. Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor – pak fjalë nga shqipja e pak fjalë nga maqedonishtja, pastaj kthehen tek e para me disa fjalë më shumë (me huazime), me shprehje nyjetimore të shqipes kur flasin maqedonisht, sidomos në theksimin e fjalëve; me një morfologji e sintaksë të ndërmjetme (herë sipas natyrës së shqipes e herë sipas asaj të maqedonishtes).

Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip.

Në këtë kumtim vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në problemet praktike që janë pasojë edhe e përdorimit të maqedonishtes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë dhe e shqipes që ka përdorim të kufizuar zyrtar dhe po përdoret vetëm pas vitit 2001 (pra me traditë të shkurtër 14-vjeçare).

Si është rregulluar me dispozitat ligjore përdorimi i gjuhëve në Maqedoni?

E drejta e përdorimit të gjuhëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë rregullohet me Kushtetutë dhe me disa ligje. Pas një debati shumëvjeçar, në qershor të vitit 2008, Kuvendi solli një Ligj të përgjithshëm për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Maqedoni dhe në njësitë e pushtetit vendor. Në periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 2006 janë sjellë 30 amendamente. Amendamenti më i rëndësishëm ku rregullohet përdorimi i gjuhëve është amendamenti V dedikuar përdorimit të gjuhëve, i cili thotë:

“Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare me alfabetin e saj. Edhe pse popullatë me mbi 20% në Maqedoni janë vetëm shqiptarët, hartuesit e ligjeve qëllimisht iu kanë shmangur emërtimit gjuhë shqipe, duke përdorur shprehjen perifrastike “gjuha që e flasin mbi 20% e qytetarëve”.

Tani, dokumentet personale të qytetarëve shqiptarë (letërnjoftimi, pasaporta) jepen në maqedonisht e anglisht, me kërkesën e palës edhe në shqip. Por, shqipja kufizohet në përdorim, përkatësisht maqedonishtja ka shtrirje të përgjithshme, ndërsa shqipja mund të përdoret vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë.

Kjo në zbatimin praktik do të thotë se në ato bashki ku shqiptarët nuk arrijnë 20% nuk e gëzojnë të drejtën që me organet bashkiake të komunikojnë në gjuhën shqipe. Fjala vjen, në qytetin e Shkupit, përveç maqedonishtes si e domosdoshme, vetëm në komunën e Çairit lejohet përdorimi publik i shqipes në institucionet e pushtetit vendor, në mbishkrime rrugësh, firmash etj. Nga ana tjetër, maqedonishtja mbrohet me ligj, me gjopa të parapara prej 2500 deri më 3 000 euro për thyerjen e normave të saja, ndërsa shqipja nuk mbrohet me ligj e as që ndëshkohet shkelja e normave.

Në këto rrethana të pafavorshme, kur të gjitha dokumentet zyrtare me nguti u përkthyen e vazhdojnë të përkthehen nga maqedonishtja në shqip, s’do mend se në variantin shqip të dokumenteve zyrtare në Maqedoni lexojmë një “shqipe të maqedonizuar”. Përkthimet lëngojnë sidomos në zëvendësimin e formave rasore të shqipes me forma analitike të maqedonishtes.

Në dokumentet zyrtare gjejmë gabime të të gjitha rrafshëve gjuhësore, por më të rënda janë shkarjet morfo-sintaksore e leksikore. Këtu hetohen po të njëjtat shkëlqe gjuhësore që shfaqen edhe në mjetet e informimit publik, por edhe disa thyerje më të rënda normash. Po të heqim gabimet që na dalin në media, ndër thyerjet më të rënda të normës kujtojmë se janë:

1. Mospërdorimi me vend i <rr>-së. Dihet se varianti standard i shqipes ka dy fonema bashkëtingëllore dridhëse: /r/ dhe /rr/ gjë që provohet me çifte minimale fjalësh të tilla, si *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë, deri ~ derri, rimë ~ rrimë* etj. Ngjashmëria nyjetimore dhe ngarkesa e vogël funksionale ka mundësuar rrafshimin e kundërvënieve fonologjike të bashkëtingëllores njëdridhëse /r/ dhe shumëdridhëses /rr/ në disa të folme tona: në të folmet e Jugut si dhe në shumë të folme të gegërishtes jugore.

Si në ligjërimin e folur, ashtu edhe në të shkruar vihet re një përzierje e këtyre bashkëtingëlloreve, me kahje nga /rr/-ja te /r/-ja, përkatësisht të humbjes së opozicionit fonologjik /r/ ~ /rr/. Po sjellim disa shembuj të mospërdorimit me vend të <rr>-së në dokumentet zyrtare në Maqedoni: *zjaret* (në vend: *zjarret*), *marrje* (duhet: *marrje*), *sipërmarrësi* (duhet: *sipërmarrësi*).

2. Përdorimi i gabuar i emrave në rasa. Një sëmundje e stilit politiko-shoqëror e administrativ në Maqedoni ka qenë dhe ende mbetet përdorimi i gabuar i emrave në rasa, nën ndikimin e gjuhëve të tjera që nuk kanë lakim emrash, te ne përfshirë edhe maqedonishten. Është e njohur se shqipja është gjuhë sintetike-analitike që shkon drejt analitizmit. Por, shqipja në dokumentet zyrtare në Maqedoni tani më pothuajse ka kaluar në gjuhë analitike, veçmas nën trysninë e maqedonishtes, që bën pjesë në grupin e gjuhëve më analitike indoevropiane (ajo tani më nuk ka rasa, por vetëm mbetje rasore. Funksionet e emrit në fjali në këtë gjuhë shprehen me parafjalë + emër në formë të ngurosur, në njëjës ose në shumës, në trajtë të shquar a të pashquar). P.sh.:

Gjashtë shtete nga BE (Lajm, 07.12.2012, f. 7; duhet: gjashtë shtete të BE-së. ...). Të rritet bashkëpunimi me institucione dhe universitete nga Republika e Francës (Lajm, 07.12.2012, f. 8). BE-ja do të mund sërish të vendos obligim të përkohshëm për pezullimin e regjimit të vizave për pesë shtete nga Ballkani (Lajm, 07.12.2012, f. 7; këtu kemi mospërshtatje në rasë: *të Ballkanit*, pra jo me emërore, por me gjinore). Trajko Veljanovski ka dërguar kërkesë me shkrim *deri te kryetarja e Komisionit për Punë dhe Politikë Sociale ...* (Lajm, 07.12.2012, f. 5). Dokumentet dorëzohen *deri te Arkivi i Drejtorisë ...* (Lajm, 07.12.2012, f. 12; duhet: dokumentet i dorëzohen Arkivit ...). Paragrafi 1 nga Ligji për marrëdhënie pune dhe neni 60 nga Ligji për arsim të mesëm ... (Lajm, 07.12.2012, f. 20). Sipas nenit 77 nga Ligji për arsim fillor (Lajm, 07.12.2012, f. 13; duhet: të Ligjit) etj.

3. Adresimi i letrave me “deri te”. Në adresimin e letrave, të shkresave zyrtare etj., ashtu siç e jep edhe Komisioni i Prishtinës në parashtrësë, në të shumtën e rasteve shkruhet: *deri te Ministria për arsim dhe shkencë, Byroja për zhvillimin e arsimit, Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit filologjik ...* në vend që emri i institucionit të shkruhet në rasën gjinore, pra: Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, Këshillit Mësimor-shkencor të Fakultetit të Filologjisë. Ivanov dërgoi letër ngushëllimi *deri te* presidenti i Turqisë. Për këtë çështje Qeveria në gjysmën e parë të vitit ka dhënë drejtime konkrete *deri te* ministrinë kompetente me çka, sipas Atanasoskit, punët kanë shkuar në drejtim më të mirë, ndërsa Drejtoria

doganore ka marrë një seri aktivitete për lehtësimin dhe shpejtimin e transportimi të dërgesave ndërkombëtare. (Koha, 12 tetor 2015) etj.

Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e sjellë, epidemi e përhapur te ne është jo vetëm përdorimi i emrave në emërore me parafjalë në vend të formës së drejtë të tyre në rasën gjinore, por edhe shkrimi i emrave të institucioneve vetëm me shkronjën e parë të madhe e me të gjitha shkronjat e tjera të vogla, nën ndikimin e rregullave të drejtshkrimit të maqedonishtes.

4. Përdorimi i panevojshëm i nyjës së trajtës së pashquar një: Qindra mijëra refugjatë do të mund të qëndrojnë në Evropë për një kohë të gjatë dhe një fund i valës së tyre nuk parashikohet dot se kur mund të ndodhë. Por sirianët që po vijnë janë me një nivel arsimor më të lartë se shumica e popullsisë që kanë lënë pas (Koha, 11 tetor 2015).

5. Përdorimi i paqëlluar i fjalëve për nga kuptimi, si: ... *dhënia e elektroneve* – duhet: lirim apo emetimi i elektroneve); *Pranë vetive të përbashkëta* ... duhet: përveç vetive të përbashkëta...; *Bërllogu prej metali që duhet të reciklohet* (f. 39, duhet: Mbetjet metalike që duhet ricikluar ...; *Gjatë të fotografuarit të freskave, ngjyrat kanë qenë të futura në mallter ose gjips* (duhet: Gjatë pikturimit të freskave, ngjyrat paraprakisht janë përzier me llaç ose gjips...; *nga provat e zhvilluara* (duhet: nga provat e bëra) etj.

6. Fjala shqipe a termi i shqipëruar në vend të fjalës së huaj apo termit joshqip. Në vend të disa fjalëve të huaja, do të ishte më mirë të përdorehin fjalët shqipe tani më mjaft të përhapura, apo termi i shqipëruar, si: peshore *precize* – peshore e saktë; *definicion* - përkufizim; *kuantitet* – sasi; mënyrë *direkte* – mënyrë e drejtpërdrejtë; *presion* - trysni; *esencial* – themelor; *medicinë* – mjekësi; *inorganike* - duhet: joorganike); *nomenklaturë* – emërtim, emërtesë etj.

7. Renditja e përcaktorëve sipas gjedhes së huaj. Jo rrallë vërehen ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku përshtjellohet mendimi deri në moskuptim. Ndikime sintaksore të maqedonishtes në shqipen që flitet e shkruhet në Maqedoni hetohen veçmas në rendin e përcaktorëve.

Në ligjërimin asnjans, në shqipen kemi radhitjen *emër + përcaktor*, ndërsa në maqedonishten *përcaktor + emër*. Krahaso shqip: *djalë i mirë* – maqedonisht: *dobar deçko*, shqip: *kati i pestë* – maqedonisht: *petti sprat*; shqip: *prodhim vendor* – maqedonisht: *domashno proizvodstvo*. Kur ka dy e më tepër përcaktorë të njëpasnjëshëm, siç dihet rendi i rëndomtë në gjuhën shqipe është: emër + përcaktor + përcaktor; d.m.th. emër + mbiemër (i nyjshëm, i panyjshëm, numëror), emër në rasën gjinore, përemër. Ndërsa topika e përcaktorëve në gjuhën maqedonase është ky: përcaktor + përcaktor + përcaktor + emër; d.m.th. mbiemër (i panyjshëm, numëror), emër me parafjalë, përemër + emër. Nëse grupi emëror në shqipen ka topikën 1, 2, 3 maqedonishtja ka topikë të anasjelltë 3, 2, 1 ose 2, 3, 1; por gjithnjë fjala që përcaktohet mbetet në fund, sipas modelit: shq. *marrëdhënie pune* (1, 2) – maq. *raboten odnos* (2, 1); shq. *ndihmë e plotë juridike* (1, 2, 3) – maq. *celosna pravna pomosh* (2, 3, 1).

Në dallim nga maqedonishtja që një emër mund të përcaktohet nga më shumë se tre përcaktorë, në shqipen nuk është e rëndomtë që emri të ketë më shumë se tre përcaktorë. Këtu edhe na shfaqen gabime të shumta gjatë përkthimit nga maqedonishtja në shqip, sidomos të dokumenteve zyrtare. P.sh.: maqedonisht: *zadollzhitelno kapitalno finansirano penzisko osiguruvanje* (zadol`itelno kapitalno finansirano penzisko osiguruvawe) gabimisht është

përkthyer në: *sigurim i detyruar pensional kapital financiar* / duhet: sigurim pensional i detyrueshëm i kapitalit.

8. Në stilin administrativ, shoqëror-politik si dhe në stile të tjera të ligjërimit në Maqedoni është e shpeshtë renditja e fjalëve në fjali sipas gjedhes së maqedonishtes. Ja disa të tilla: *Në origjinal ose kopje e vulosur të diplomës ose certifikatë për arsimin e mbaruar* (Lajm, 07.12.2012, f. 29). *Origjinal ose kopje e vulosur nga diploma ose vërtetim për arsimin e kryer* (Lajm, 07.12.2012, f. 30). *Të zotërojnë gjuhën maqedonase dhe literaturë* (në vend: *Të zotërojnë gjuhën dhe letërsinë maqedonase*; në një shpallje, Lajm, 07.12.2012, f. 28). *Deri më 31.08. 2013 viti* (maq.: do 31. 08 2013 godina; Lajm, 07.12.2012, f. 28, 29, 30); *deri më datë 31.08.2012 viti* (Lajm, 07.12.2012, f. 18). *Që pritet të jep mundësi për pranimin në kohë të sa më të shpejt të kësaj dispozite* (Lajm, 07.12.2012, f. 7). *Takimi shpejtë është dashur të ndërpritet sepse në aspektin e kohës kaloi në ditën e enjte* (duhet: shpejt, presje para lidhëzës sepse, mendimi nuk shprehet qartë; Lajm, 07. 12.2012, f. 2). *Shpallje publike për punësim në kohë të caktuar deri më datë 31 gusht 2012 viti në dimenzionet vijuese: një arsimtar për informatikë, dy arsimtarë për mësim klasor...* (Lajm, 07.12.2012, f. 30).

Propozim për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë Maqedoninë:

Në këtë paraqitje përmendëm disa nga kufizimet juridike të përdorimit të shqipes në Maqedoni, përkatësisht lejimin për përdorim vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë dhe mospërdorimit të saj në shumë institucione shtetërore, me disa shembuj konkretë për problemet e zbatimit praktik të saj, duke nxjerrë si përfundim nevojën për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, krahas maqedonishtes, në tërë shtetin.

Modele të përdorimit zyrtar të dy e më tepër gjuhëve gjejmë në disa shtete shumetnike e shumëgjuhësore. Pra, në Kushtetutën e Maqedonisë mund të përcaktohet shkurt e qartë se: gjuhë zyrtare në Maqedoni janë maqedonishtja dhe shqipja.

Avancimi i statusit të shqipes në përdorim zyrtar nga një gjuhë e dytë vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë në gjuhë zyrtare shtetërore, nga njëra anë do të ndihmonte shumë përmirësimin e nivelit të zbatimit të normës letrare edhe në stilin shtetëror-administrativ dhe nga ana tjetër, do të jetë në dëm të askujt, por në të mirën e gjithë qytetarëve të këtij vendi.

Literatura:

Gazeta “Koha”, “Lajm”

IAP, *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.

Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005.

Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, Konferenca Shkencore Mbarëshqiptare “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Durrës, 15-17 dhjetor 2010.

Asllan Hamiti, *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni*, Shqyrtime albanologjike 8, Shkup, 2005, f. 48-58.

Asllan Hamiti, *Sistemi rator i shqipes dhe përdorimi i emrave të përveçëm të huaj*, kumtesë e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, mbajtur më 13 - 24. 08. 2007 në Prishtinë.

Asllan Hamiti, *Shqipja standarde dhe kultura gjuhësore te ne*, Konferenca e dytë Albanologjike, Ohër, 23-27 shtator 2008.

Asllan Hamiti, *Diglosia në Maqedoni dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe*, “Java e Shkencës 2012”, mbajtur në Prishtinë, më 16 - 19. 05. 2012, f. 187-190.

Gjovalin Shkurtaj, *Drejtskrimi dhe drejtshtqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë.

Qemal Murati, *Gramatika e gabimeve – Kulla babilonike dhe përzjerja e shqipes*, Shkup, 2000.

Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtskkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë

Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë

Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë.

Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015.

Shefkije Islamaj, *Shqipja standarde dhe modernizimi i saj*, Gjuha shqipe 3/2008, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2008.

Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtskkrimit të saj*, Tiranë, 1973.

Shtojcë me copa dokumentesh zyrtare:

Komisioni për mbrojtje dhe shpëtim ka për obligim të mbroj dhe të ndihmoj banorët nga fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet, zjaret, epidemit etj).

3. Pëlqim për legalizimin e objekteve të paligjëshme në rugën regjionale 11|7.....5

Nëpunësit publikë janë përgjegjës për kryerjen cilësore, të shpejtë dhe efikase të detyrave me interes publik të cilat u janë ngarkuar.

Komuna e Studeniçanit Jep pëlqimin për themelimin e bordit Regjional për menaxhimin e mbeturinave në bashkupunim me Komunat e Planit Regjional të qytetit të Shkupit të Republikës së Maqedonisë për menaxhimin e integruar të mbetjeve rajonale.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 nga Ligji për vetqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr.5/02), dhe neni 3 i Ligjit për bashkupunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare e RM nr.79/09) dhe neni 24 pika 40 i Statutit të Komunës së Studeniçanit (Fleta Zyrtare e Komunës së Studeniçanit nr.04/2013) Këshilli i Komunës së Studeniçanit, solli:

Ipjet pëlqim për fillimin e procedurës për marje të DUPL (Dokumentacioni për planin urbanistik lokal) nga T- mobile KK.Koliçan i Epërm në PK.1213|

Për kompenzim të pjesës së kompenzimeve, se janë përdëftuar kushtet nga paragrafi 1 ,ahere kërkuesi në Ministrinë e Ekonomisë parashton këto dokumenta:

1. Ministria e Ekonomisë, me qëllim që të stimuloj të shfrytëzuarit e energjisë solare në RM-së, për sistemeve kolektore termiko solare, në muajin janar do të shpall Tjhirrje publike në tre gazeta ditore dheil njëjti do të jet i hapur deri më 31 maj 2014. Për kohëzgjatjen e publikimit, së paku dy here do të ketë lajmërim për punlikun.
- 2.975.000,00 (dy million e nëntëquin e shtatdhjetë e pestë mijë) denarë, të siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, për vitin 2013 , – Programi 11 – Politika e industrisë, llogaria 637, paragrafet 462 dhe 464,dedikuar për imlementimin e masave nga Plitika e industrisë së Republikës së Maqedonisë për 2009-2020; dhe

Me këtë program përcaktohet dedikimi i mjeteve për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi, dhe sipërmarrësi me shumë të plotë prej **13.371.000,00** (trmbëdhjetë million etreqind e shttdhjetë e njëmij) denarë edhe ate:

Tjhirrje publike në tre gazeta ditore dheil njëjti do të jet i hapur deri më 31 maj 2014. Për kohëzgjatjen e publikimit, së paku dy here do të ketë lajmërim për punlikun.

Ministria e Ekonomisë, para publikimit të listës, së kërkuesve, nga pjesa IV e këtij Programi, do të kontrolloj kërkuesit e tërhequr, ato të cilët kanë dokumente të rregullta dhe të plota, se vallë e kanë shfrytëzuar të drjtë e shfrytëzimit për herë të parë për pjesën e mjeteve në bazë të thirrjeve paraprake publike të Ministrisë së Ekonomisë, për kompenzim të pjesës së kompenzimeve, për system kolektorësh termike solare të blera, të ndërtuara sipas shpalljeve në vitet, 2007, 2009, 2011, 2012 и 2013

Nëse, konstatohet se ndonjë prej kërkuesve të tërhequr, i plotëson kushtet sipas dokumenteve të parashtruara të plota, kurse më parë i kanë shfrytëzuar mjete e kompenzimit, të njejtët NUK do të publikohen në listen e kërkuesve sipas pjesës IV të këtij Programi, dhe nuk do ta realizojnë të drejtën për kompenzim, disa prej kërkuesve të tërhequr, të cilët i kanë dokumente të plota dhe të rregullta, dhe nuk do ti jepet e drejta për kompenzim për vitin 2014.

III

Kompenzimin e pjesës së mjeteve për sistemin e kolektoreve të blera, termike solare, do ta realizojnë vetëm individët të cilët:

- Kanë blerë dhe kanë ndërtuar në shtëpitë e tyre system kolektorësh, pas ditës së shpalljes të Thirrjes publike, të pjesës së IV. Të Kësaj programe, që dëshmohet me dokumentat të paragrafit 2 të kësaj pjese.

II

Mjetet nga pjesa I, të këtij Programi në sasi globale prej 6.000.000, 00 denarësh, do të shfrytëzohen për kompenzim të pjesës së shpenzimeve për sisteme kolektorësh solar, apo të ndërtuare kolektorë termike solare, tek amvisëritë do kompenzohet për 30% ,por jo më tepër se 300 euro në kundërvlerë denarësh për amvisëri, për vitin 2014.

Mjetet, nga Buxxheti janë dedikuar për programin, të cilat i sistemon Ministria e Ekonomisë.

Ato që nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën për herë të parë, për pjesë të mjeteve për sigurim dhe ndërtim të sistemeve kolektore termiko-solare, në shtëpinë e tij, në harmonizim me thirrjet publike paraprake, të Ministrisë së Ekonomisë, për kompenzimin e pjesës së kompenzimeve për blerje dhe ndërtim të sistemeve të kolektorëve termike solare, të publikuar më vitet 2007, 2009, 2011, 2012 и 2013, që dëshmohet me dokumentacionin sipas paragrafit 2, të kësaj pjese..

Për kompenzim të pjesës së kompenzimeve, se janë përdëftuar kushtet nga paragrafi 1, atëherë kërkuesi në Ministrinë e Ekonomisë parashtron këto dokumenta:

Tjhirrje publike **në tre gazeta ditore** dheil njëjti do të jet i hapur deri më 31 maj 2014. Për kohëzgjatjen e publikimit, së paku dy herë do të ketë lajmërim për punlikun.

caktoj Ministria e Ekonomisë do të jep lajmërim ,li cili do botohet në tre gazeta ditore, dh në televizionin kombëtar ,në këtë mënyrë të gjithë kërkuessit do të ftohen,

1. Ministria e Ekonomisë, me qëllim që të stimuloj të shfrytëzuarit e energjisë solare në RM-së, për sistemeve kolektore termiko solare, në muajin janar do të shppall Tjhirrje publike në tre gazeta ditore dheil njëjti do të jet i hapur deri më 31 maj 2014. Për kohëzgjatjen e publikimit, së paku dy here do të ketë lajmërim për punlikun.

Dorëzuar deti te:

- Inspektorati shtetëror për vetëqeverisje lokale
- Arhiva

Kufiri i komunës Aerodrom fillon prej urës së vijës hekurudhore në Kufiri i komunës Butel fillon prej gardhit verior të Varrezave të Qytetit “Butel”

Kufiri i komunës Gazi Babë fillon prej pikëtakimit të tre kufijve të

Kufiri i komunës Gjorçe Petrov fillon prej udhëkryqit në autostradën Shkup – Tetovë

Регионалниот одбор за управување со отпад ќе биде надлежен за: Утврдување на нацрт на Регионален

Bordi regional për menaxhimin e mbetjeve do të jet mbikqyrës për: Përcaktimi i projekt-planin rajonal për

Ato qët nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën për here të pare, për pjesë të njeteve për sigurim dhe ndërtim të sistemeve kolektore termiko-solare, në shtëpin e tij, në harmonizim me thirrjet publike paraprake, të Ministrisë së Ekonomisë, për kompensimin e pjesës së kompensimeve për blerje dhe ndërtim të sistemeve të kolektorëve termike solare, ,të publikuar më vitet 2007, 2009, 2011, 2012 и 2013 , që dëshmohet me dokumentacionin sipas paragrafit 2, të kësaj pjese..

Për kompensim të pjesës së kompensimeve, se janë përdëftuar kushtet nga paragrfi 1 ,ahere kërkuessi në Ministrinë e Ekonomisë parashtron këto dokumenta:

Nëse blerësi ofron dëshmi në **original document** për shpenzimin e bërë,

Në bazë të nenit 36, paragraf 5 i Ligjit të Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ бр. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008 и 82/2008, 88/2008, 115/2008 и 10/2010) Qeveria e Republikës së Maqedonisë në seancën e mabajtur më 3.01. të vitit 2013 miratoi:

9. Mbrojtja dhe shpëtimi

- mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve dhe i të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës dhe nga fatkeqësitë elementare dhe nga fatkeqësi tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga të njëjtat.

LITERATURA E KONSULTUAR

- Agalliu, prof. dr. Fatmir - Angoni, dr. Engjëll - Demiraj, prof. Shaban - Dhrimo, prof. dr. Ali - Hysa, as. prof. dr. Enver - Lafe, prof. dr. Emil - Likaj, prof. dr. Ethem:** *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi I), Morfologjia*, Tiranë, 1995.
- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë:** *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1983. 1989, 137-221.
- AShRPSH; IAP,** *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973; Prishtinë, 1974.
- Beci, Bahri:** *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1985, 93-109.
- Beci, Bahri – Topi, Ermira:** *Vëzhgime për dendurinë e përdorimit të fonemave zanore e bashkëtingëllore në gjuhën e sotme letrare shqipe*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1986, 61-76.
- Beci, Bahri:** *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.
- Beci, prof. dr. Bahri:** *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Prishtinë, 2001.

- Besho, Faruk:** *Mbi mundësinë e rritjes së shpejtësisë së transmetimit të njoftimeve në telegrafi duke marrë parasysh probabilitetin e përdorimit të shkronjave dhe fonemave të ndryshme në gjuhën shqipe*, Buletin i UShT, SShN 2, Tiranë, 1969, 113-120.
- Boriçi, Lumnie:** *Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe*, Studime filologjike nr. 2, Tiranë, 1987.
- Boriçi, Lumnie:** *Kontribut mbi aspektin akustik të zanoreve të shqipes e të disa zanoreve të frëngjishtes*, Studime filologjike nr.1, Tiranë, 1977, 103-118.
- Bugariski, Ranko:** *Uvod u opštu lingvistiku*, Beograd – Novi Sad, 1991.
- Canaj, Afërdita:** *Mbi dendurinë e përdorimit të fonemave në gjuhën shqipe, përqasur me frëngjishten*, Studime filologjike nr. 1-2, Tiranë, 1999, 103-118.
- Çabej, dr. Eqrem:** *Studime gjuhësore I – IX*, Prishtinë, 1977; ribotuar më 1989.
- Çeliku, Mehmet - Domi, Mahir - Floqi, Spiro - Mansaku, Seit - Përnaska, Remzi - Prifti, Stefan - Totoni, Menella:** *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi II), Sintaksa*, Tiranë, 1996.
- Demiraj, Shaban:** *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*, Studime filologjike nr. 3-4, Tiranë, 2002, 92-100.
- Dika, Agni:** *Kodi optimal për alfabetin e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 21. 07. 1984.
- Dodi, Anastas:** *Fusha e shpërndarjes së zanoreve dhe problemet e normës së shqiptimit*, Gjuha jonë nr. 1- 4, Tiranë, 1986.
- Dodi, Anastas:** *Intonacioni në gjuhën shqipe, komponentët dhe funksionet e tij gjuhësore*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000.
- Dodi, Anastas:** *Kundërvëniet e bashkëtingëlloreve të shqipes sipas tipareve akustike e qartë/e zbehtë (strident/mat)*, Studime filologjike nr. 1-2, Tiranë, 1999, 97-101.
- Dodi, Anastas:** *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2, Tiranë, 1990.
- Dodi, Anastas:** *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë, 1996, 759-765.
- Filipoviq, dr. Rudolf:** *Suvremena lingvistika nr. 1*, Zagreb, 1966; *Suvremena lingvistika nr. 3*, Zagreb, 1964.
- Gokaj, Nuri:** *Baza të Gjuhësisë së Përgjithshme*, Shkodër, 1997.
- Guberina, Petar:** *Zvuk i pokret u jeziku*, Zagreb, 1967.
- Gjinari, Jorgji:** *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1976.
- Gjinari, Jorgji:** *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
- Gjinari, Jorgji:** *Rotacizmi në dialektet dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë 2, Tiranë, 1986.
- Gjinari, Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin:** *Dialektologjia*, Tiranë, 1997 (ribotuar më 2000).
- Hajdari, Ahmet:** *Doracak i gjuhësisë*, Shkup, 1988.
- Hamiti, Asllan:** *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (disertacin doktorate në dorëshkrim), Universiteti “Shën Qirili dhe Metodi”, Shkup, 1999.
- Hamiti, Asllan:** *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011.
- Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten;** *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, www.albanologjia.com, kumtesa.
- Hysa, Enver:** *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, 76-80.
- Instituti Albanologjik i Prishtinës,** *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.
- Ismajli, Rexhep:** *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987.

- Kostallari, Androkli** (kryetar) - **Lafe, Emil - Totoni, Menella - Cikuli, Nikoleta**: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë (elemente të normës së sotme letrare kombëtare)*, Tiranë, 1976.
- Kostallari, prof. Androkli**: *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973.
- Kostallari, A. - Thomaj, J.- Lloshi, Xh. - Samara, M. - Kola, J. - Daka, P. - Haxhillazi, P. - Shehu, H. - Leka, F. - Lafe, E. - Sima, K. - Feka, Th. - Keta, B. - Hidi, A.**: *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, A-M; N-Zh*, Prishtinë, 1981
(ribotuar sipas botimit të Akademisë së Shkencave të RPSSH – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980).
- Lafe, Emil**: *Një analizë matematike të formimit të fjalëve shqipe prej rrokjeve*, në Studime filologjike 3, Tiranë, 1969.
- Lafe, Emil**: *Gjuha e medias sot – probleme dhe detyra*, Gjuha jonë nr. 1-2, 2000, Tiranë, 9-21.
- Lafe, Emil**: *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, 10-21.
- Lyons, John**: *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Londër, 1968 (përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe, Dituria, 2001).
- Lloshi, Xhevat**: *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- Martine, Andre**: *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983.
- Memushaj, Rami**: *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
- Memushaj, Rami**: *Diftongjet e shqipes standarde*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Tiranë, 2004, 233-244.
- Munishi, mr. Zijadin**: *Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit* (për klasën III-IV të arsimit të mesëm të orientuar), Prishtinë, 1984.
- Munishi, Shkumbin**: *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015.
- Murati, dr. Qemal**: *Gramatika e gabimeve – Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*, Shkup, 2000.
- Ndreca, Mikel**: *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë, 1986.
- Nesimi, Remzi**: *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme (fonetika, leksikologjia dhe morfologjia) I*, Shkup, 1997.
- Nushi, dr. Pajazit**: *Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988.
- Qosja, Rexhep**: *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, 31-36.
- Simeon, Rikard**: *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, Zagreb, 1969.
- Simeon, Rikard**: *Opća enciklopedija 5*, Zagreb, 1979.
- Sulejmani, mr. Fadil**: *Praktikumi i gjuhës së sotme letrare shqipe*, Prishtinë, 1984.
- Shehu, Hajri**: *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, 92-100.
- Shkurtaç, Gjovalin**: *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999.
- Shkurtaç, Gjovalin**: *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë nr. 1-2, 2000, Tiranë, 31-40.
- Shkurtaç, Gjovalin**: *Kultura e gjuhës*, ShBLU, Tiranë, 2006.
- Shkurtaç, Gjovalin**: *Si të shkruajmë shqip*, Toena, 2008.
- Shkurtaç, Gjovalin**: *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, ShBLSh, Tiranë, 1988.

- Shkurtaç, Gjovalin:** *Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur*, ShBLSh, Tiranë, 1998.
- Shkurtaç, Gjovalin:** *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003.
- Topalli, Koleç:** *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995.
- Trubeckoi, N. S.:** *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985.
- Ymeri, Haki:** *Për një sistem grafik më ekonomik të gjuhës së sotme shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.